

QEVERISJA E KORPORATAVE NË KUADRIN E ZHVILLIMIT EKONOMIK TË SHQIPËRISË

REZART DIBRA

Dorëzuar
Universitetit Europian të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në **SHKENCA
EKONOMIKE**, me profil **MENAXHIM**, për marrjen e gradës shkencore
“Doktor”

Udhëheqës shkencor :
Prof.Dr. SHYQYRI LLACI

Numri i fjalëve: 68600

Tiranë, Qershor 2015

DEKLARATA E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time personale, deklaroj se ky studim është punë origjinale dhe nuk përmban plagjiaturë. Punimi është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe të referuara.

ABSTRAKTI

QEVERISJA E KORPORATAVE NË KUADRIN E ZHVILLIMIT EKONOMIK TË SHQIPËRISË

Qeverisja e korporatave është një temë me interes dhe rëndësi të madhe në ekonominë e zhvilluara si dhe kohët e fundit po merr shtrirje dhe në vendet në zhvillim. Ajo po kryeson hulumtimet akademike për shkak të rolit vital që luan në shëndetin e përgjithshëm të sistemeve ekonomike. Kriza financiare e viteve 2008-2009 tregoi mangësi të theksuara në zbatim të parimeve nga kompanitë në fushën e qeverisjes së korporatave. Kjo krizë ka rinxjerrë përsëri në epiqendër të interesit ekonomik çështjet e mprehta të qeverisjes. Qeverisja e korporatave përmbledh koordinimin e gjithë aktorëve që përcaktojnë suksesin në menaxhim, si aksionerët, këshillat mbikëqyrës, drejtuesit teknikë, personelin, bankat, klientët, partnerët e jashtëm, etj. Punimi me temën e lartpërmendur, synon të tregojë statin se ku ndodhet qeverisja e korporatave në vendet në zhvillim së bashku me qeverisjen në Shqipëri si dhe në një pjesë të shoqërive shqiptare duke realizuar një analizë teorike dhe statistikore. Pyetjet kërkimore : *A kemi një qeverisje të mirëfilltë të korporatave në Shqipëri në krahasim me vendet e tjera në zhvillim? Në cilën fazë ndodhet qeverisja e korporatave, mbështetur në analizën e disa shoqërive që veprojnë në Shqipëri?* ishin pararendëse të hipotezave të ngritura : *“Qeverisja e korporatave në Shqipëri larg praktikave më të mira të publikuar dhe të rishikuara në kuadrin e krizës financiare nga OECD-ja krahasuar me vendet e tjera në zhvillim, është faktor ndikues dhe për zhvillimin ekonomik të vendit”. “Nëse shoqëritë në Shqipëri në përgjithësi në aktivitetin e tyre nuk do të zbatojnë të paktën ato parime që janë publikuar në kode apo manual atëherë nuk do të kemi një qeverisje efektive korporate dhe për rrjedhojë kultura e qeverisjes do të jetë e reduktuar vetëm në disa shoqëri dhe jo më gjerë”*. Punimi përqendrohet në matjen e qëndrimeve mbi këtë qeverisje, perceptimin mbi këtë qeverisje, gadishmërisë mbi zbatimin e parimeve të kësaj qeverisje. Për kryerjen e këtij studimi është grumbulluar dhe studiuar literaturë me qëllim realizimin e analizës dhe krijimin e bazës teorike për hulumtim të mëtejshëm.

FUSHA E STUDIMIT : Menaxhim

FJALËT KYÇE : Qeverisje korporate, parimet e qeverisjes, transparenca, përgjegjshmëria, indeksi i qeverisjes së përgjegjshme të korporatave etj.

ABSTRACT

CORPORATE GOVERNANCE IN THE CONTEXT OF ALBANIAN'S ECONOMIC DEVELOPMENT

Corporate governance is a topic of interest and importance in developed economies and recently taking stretch and in emerging economies. Corporate governance has come to the forefront of academic research due to the vital role it plays in the overall health of economic systems. The financial crisis 2008,2009 years showed deficiencies in the implementation of the principles of the companies in the field of corporate governance. This crisis has reissued again in the focus of economic interest thorny issue of governance. Corporate governance summarizes coordinating all actors that define success in management, as shareholders, supervisory boards, management technique, staff, banks, customers, external partners, etc. This study with the topic above, aims to show the stage where corporate governance is in developing countries, together with the government in Albania and the Albanian part of the societies by conducting theoretical and statistical analysis. Research questions: *Do we have a proper corporate governance in Albania compared with other developing countries? In which stage is corporate governance, based on the analysis of several companies operating in Albania?* previous hypotheses were raised: *“Corporate governance in Albania away best practices published and reviewed in the context of the financial crisis by OECD compared with other developing countries, and influential factor for economic development”. “If companies in Albania in general, their activity will not implement at least those principles that are published in code or manual then we will not have an effective corporate governance and culture of governance therefore will be reduced only in some societies and not beyond”*. The study focuses on the measurement of attitudes on this government, this government perception, readiness on the implementation of the principles of this government. We have collected literature for the purpose of analysis and the creation of a theoretical basis for further research.

SCOPE OF STUDY : Management

KEY WORDS : Corporate governance, principles of governance, transparency, accountability, responsible corporate governance index etc.

Këtë punim ia dedikoj prindërve të mi të dashur, nënës time dhe babait tim. Dashuria, sakrifica dhe mbështetja e madhe e tyre më ka ndihmuar dhe frymëzuar shumë në punën time. Shumë mirënjohje për ta.

FALËNDERIME

Finalizimi i një punimi në nivelin doktoratë do të ishte i vështirë nëse nuk do të ishte e mundur mbështetja edhe nga njerëz të tjerë të cilëve do të doja t'u dedikoja pjesën e falenderimeve, njerëz të cilët mundësuan këtë ndihmë deri në momentin përmbyllës.

Kanë qenë të shumtë personat që kam bashkëpunuar dhe që kam pasur kënaqësinë të njoh gjatë rrugëtimit tim dhe që meritojnë falënderime, mirënjohje dhe respekt.

Një falënderim i veçantë shkon për udhëheqësin tim në këtë punim Prof.Dr. Shyqyri Llaci. E falenderoj për mendimet, këshillat dhe sugjerimet e vazhdueshme, e mbi të gjitha për mbështetjen morale gjatë gjithë kësaj kohe duke më ndihmuar të përmirësoj mendimin kritik. Ishte privilegj për mua të punoja me të për realizimin e këtij punimi. Një falënderim tjetër i shkon pedagogëve: Frederik Dara (Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës), Fatmir Memaj (Fakulteti Ekonomisë, Univesiteti i Tiranës), Arjanit Shkurti (Instituti Kanadez i Teknologjisë, CIT), Albana Idërshai (Fakulteti Ekonomisë, Universiteti i Tiranës) për këshillat dhe sugjerimet shumë të vlefshme për analizën statistikore të të dhënave dhe temën në përgjithësi. Një falënderim i veçantë për pedagogët Elvin Meka, Eniel Ninka (Universiteti Evropian i Tiranës) për opinionet, konsultimet e vlefshme dhe ndihmën e pakursyer krahas udhëheqësit tim në materiale akademike dhe jo vetëm, duke kontribuar në përmirësimin cilësor të këtij punimi. Një tjetër falënderim shkon për miqtë e mi të cilët ndihmuan në gjetjen e informacioneve për bizneset, kontakteve pranë tyre për mbledhjen e të dhënave për këtë punim. Gjithashtu falënderoj të gjithë menaxherët, koleget apo punonjësit e bizneseve për kohën që më kushtuan për plotësimin e pyetësorëve si dhe vërejtjet dhe sugjerimet e vlefshme, të cilët pranuan të jenë pjesë e këtij studimi, studim i cili mund të shfrytëzohet dhe nga vetë këta biznese.

Së fundi, por jo për nga rëndësia, falënderoj familjen time pa mbështetjen e të cilës realizimi i këtij punimi nuk do kishte qenë i mundur.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Abstrakti.....	iv
Dedikimi.....	vi
Falënderimet.....	vii
Lista e shkurtimeve dhe fjalorit.....	xi
Permbledhje ekzekutive	xiii

HYRJE 1

1. Objektivat e studimit.....	4
2. Qëllimi i punimit.....	5
3. Pyetjet kërkimore dhe hipotezat.....	6
4. Kufizimet e punimit	7
5. Rëndësia e studimit	8
6. Strukturimi i punimit.....	9

KAPITULLI I: METODOLOGJIA E STUDIMIT 11

1.1 Procedura metodologjike (fazat kryesore të procesit të hulumtimit)	11
1.2 Teknika sasiore.....	13
1.2 Arsyet e zgjedhjes së pyetësorit si metodë për mbledhjen e të dhënave.....	18
1.3 Përcaktimi i mostrës dhe procedura e mbledhjes së të dhënave	19

KAPITULLI II: Rishikimi i literaturës mbi qeverisjen e korporatave.

Aspektet themelore të qeverisjes së korporatave..... 21

2.1 Qeverisja e korporatave parë në këndvështrime të ndryshme nga literatura	22
2.2 Evoluimi i literaturës së qeverisjes së korporatës. Roli i bordeve	27
2.3 Një vështrim mbi debatet në lidhje me teoritë e qeverisjes së korporatave	36
2.4 Modelet e sotme të qeverisjes së korporatave. Karakteristikat e tyre	42
2.4.1 Rëndësia e transparencës dhe zbulimit	47
2.5 Parimet e OECD-së. Rishikimi i parimeve të qeverisjes	52
2.5.1 Dështimet e qeverisjes së korporatave, rekomandimet për daljen nga kriza	56
2.6 Qeverisja e korporatave në Shqipëri mbështetur në kodet e publikuara të qeverisjes.....	57
2.7 Qeverisja e shoqërive publike në Shqipëri.....	64

KAPITULLI III: Qeverisja e korporatave (QK) në vendet evropiane në zhvillim	69
3.1 Lidhja ndërmjet qeverisjes së korporatave dhe zhvillimit ekonomik	69
3.2 Në drejtim të qeverisjes së përgjegjshme të korporatave. Kuptimi i kësaj pikëpamje	71
3.3 Matja e qeverisjes së korporatave në studime të ndryshme në vende të ndryshme	74
3.4 QK dhe sistemi bankar. Indeksi i qeverisjes bankare në Shqipëri	77
3.5 Metodologjia e përcaktimit të një indeksi të qeverisjes së përgjegjshme të korporatave për vendet evropiane në zhvillim	78
3.6 Ecuria e veprimeve për të arritur tek rezultatet e kërkimit.....	83
3.7 Rezultatet e marra nga kërkimi	84
3.8 Klasifikimi i shteteve sipas përdorimit të indeksit GCR dhe GDP (PBB)/frymë. Analizë krahasuese e Shqipërisë me vendet e tjera të rajonit	87

KAPITULLI IV: Qeverisja e korporatave në shoqëri që veprojnë në Shqipëri..... 95

4.1 Njësitë matëse dhe hartimi i pyetësorit	95
4.2 Analiza e të dhënave	98
4.2.1 Informacion i përgjithshëm mbi shoqëritë e marra në studim	99
4.2.2 Analiza e indeksit të qeverisjes së përgjegjshme të korporatave (GCR) (dimensioneve të shoqërive)	101
4.2.3 Analiza e variablave. Lidhja funksionale ndërmjet tyre	105
4.3. Analiza e tabelës së kontigjencave. Testi Hi-katror i koeficientit Pearson.....	109
4.4. Analiza e tabelave të kryqëzuar (kontigjencave) të rasteve të marra në studim ...	141
4.4.1 Analiza e disa rasteve specifike	141

KAPITULLI V: Analiza e rezultateve të kërkimit në shoqëritë shqiptare 148

5.1 Të drejtat e aksionerëve	148
5.2 Roli i aktoreve në praktikat e qeverisjes së shoqërisë.....	152
5.3 Transparenca dhe zbulimi	153
5.4 Roli dhe përgjegjësia e këshillave mbikëqyrës	156
5.5 Detyrimi dhe zbatimi.....	159
5.6 Njohjet, vlerësimet, politikat dhe pengesat në kuadrin e qeverisjes së korporatave	161
5.7 Zbatimi i parimeve të drejtimit të brendshëm për shoqëritë jo të regjistruara në bursë, politikave për mbrojtjen nga risku i krizës dhe manuali për mbrojtjen e biznesit familjar	164
5.8 Përfitimet e një qeverisje më të mire në shoqëritë aksionere në këndvështrimin e administrimit të biznesit të këtyre shoqërive. Analizë krahasuese e një pjese të rezultateve marrë nga studimet përkatëse	171

KAPITULLI VI: Konkluzione dhe rekomandime.....	182
6.1 Konkluzione specifike nga analiza statistikore mbi qeverisjen e korporatave	183
6.2 Konkluzione të përgjithshme	187
6.3 Rekomandime	191
 Faqet e shënimeve	198
Shënime 1.Kodet e qeverisjes së korporatave publikuar në Shqipëri	199
Shënime 2. Analiza e teorive statistikore në ndihmë të përpunimit të të dhënave të studimit	203
2.1 Variablat.....	203
2.1.1 Variablat e pavarur dhe të varur.....	203
2.1.2 Nivelet e matjes.....	203
2.1.3 Gabimi i matjes	204
2.2 Analizimi i të dhënave	204
2.3 Analiza e të dhënave cilësore	204
2.4 Teoria e analizimit të të dhënave kategorike.....	205
2.5 Analiza bivariate	206
2.5.1 Testi Chi Square i Koeficientit Pearson	206
2.5.2 Koeficienti i përgjasisë (Likelihood Ratio)	208
 SHTOJCA.....	210
Shtojcë 1. Grafikë dhe tabela të shoqërive të studimit si dhe shoqërive tregtare që veprojnë në Shqipëri.....	211
Shtojcë 2. Grafikë dhe tabela të renditjes së shteteve sipas indeksit GCR dhe GDP(PBB)/frymë, renditja e shoqërive të marrë në studim mbështetur në raporte si dhe rezultatet e analizës së korrelacionit statistikor	222
Shtojcë 3. Grafikët e analizës së përgjigjeve të pyetësorit ndarë në kapituj	238
Shtojcë 4. Kuptimet e shteteve të përdorur në studim	279
Shtojcë 5.Pyetësor mbi qeverisjen e korporatave për shoqëritë që veprojnë në Shqipëri	280
 LISTA E REFERENCAVE/BIBLIOGRAFIA	303

LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT

BSH	Banka e Shqipërisë
GDP	Produkti i Brendshëm Bruto (PBB)
OECD	Organizata për Kooperim dhe Zhvillim Ekonomik
QKR	Qendra Kombëtare e Regjistrimit
INSTAT	Instituti i Statistikave të Shqipërisë
UNDP	Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara
METE	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
MZHETS	Ministria e Zhvillimit Ekonomik Tregtisë dhe Sipërmarrjes
MF	Ministria e Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
KE	Komuniteti Evropian
BE	Bashkimi Evropian
WEF	Forumi Ekonomik Botëror
NSH	Ndërmarrje Shtetërore
IFC	Korporata Financiare Ndërkombëtare
CEO	Drejtori Ekzekutiv i Korporatës
IHD	Investimet e Huaja Direkte
BB	Banka Botërore
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
GCR/GCI	Indeksi i Qeverisjes së Përgjegjshme të Korporatave
SME	Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme.
AMF	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.
SHA	Shoqëri Aksionere
DRT	Drejtori Rajonale Tatimore
CG/QK	Qeverisja e Korporatave
QKL	Qendra Kombëtare e Liçensimit

- Corporate Governance – Qeverisja e korporatave
- Family owned – Zotëruar nga familja (në pronësi të familjes)
- Laissez-fair – Udhëheqje e lirë
- Corporate Governance Index - Indeksi i qeverisjes së korporatave
- Corporate Governance Principles- Parimet e qeverisjes së korporatave.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Qeverisja e Korporatave (QK) është ndër çështjet më të debatuarat sot për sot pasi ndikon mënyrën si drejtohet, administrohet dhe kontrollohet një shoqëri private apo publike.

Qeverisja e Korporatave ka tërhequr vëmendjen dhe po merr shtrirje të gjerë veçanërisht në ditët e sotme, si në mbarë botën dhe në Shqipëri. Ndjekja dhe zbatimi i një praktike të mirë qeverisjeje gjatë aktivitetit të përditshëm të çdo shoqërie vendos një pilastër të qëndrueshme në modelimin e një menaxhimi cilësor në periudha afatmesme dhe afatgjata, në krijimin e vlerës së shtuar për aksionerët si dhe në përgjegjshmërinë e çmuar shoqërore. Qeverisja e Korporatave ka për qëllim t'i mundësojë pronarëve apo menaxherëve të biznesit që të kenë një drejtim strategjik dhe transparent në të gjithë biznesin. Kjo i lejon të gjithë ata që janë përfshirë në proces për të kuptuar pjesën që ata luajnë në rritjen e vazhdueshme të organizatës.

Praktikat efektive të qeverisjes së korporatave janë thelbësore për sa i përket cilësisë së administrimit të çdo shoqërie, në arritjen dhe ruajtjen e besimit të publikut. Gjerësisht mendohet se falimentimi i Lehman Brothers, një bankë investimesh, e krijuar që në vitin 1850, bankës 150 vjeçare, shkaktoi humbjen globale të besimit në financa veçanërisht në sistemin bankar. Ky falimentim mund të konsiderohet si një nga kulmet e krizës financiare, ose e krizës së kredive të këqija në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kriza financiare e vitit 2008 ka nxjerrë përsëri në epiqendër të diskutimeve të ndryshme akademike çështjet e mprehta të qeverisjes, çështje të cilat janë bërë jo vetëm primare por kanë hapur një debat të gjerë jo vetëm në universitete të vendeve të ndryshme, debate televizive, mediatike, samite apo konferenca shkencore por edhe midis vetë ekonomistëve, roli i të cilëve më shumë së kurrë në këto momente për mendimet dhe sugjerimet merr rëndësi të veçantë. Prezenca e një sistemi efektiv të qeverisjes së korporatave brenda një shoqërie si dhe në tërësi të një ekonomie ndihmon në ofrimin e një shkalle besimi, që është e nevojshme për mirëfunksionimin e tregut ekonomik. Kriza e vitit 2008 në industrinë financiare, midis shkaqeve të tjera, nxori në dritë konfliktin e interesit ndërmjet arritjes së rezultateve “agresive” nga drejtuesit për përfitimin e shpërblimeve dhe të riskut afatgjatë që shoqëron shoqërinë tregtare.

Në vendet në zhvillim zbatimi i qeverisjes së korporatave është në fazat e para, por po shihen përpjekje për të përfshirë parimet e OECD-së mbi qeverisjen e korporatave si në sektorin privat ashtu dhe në sektorin publik. Shoqëritë janë duke marrë masat e tyre në kuadrin e krizës financiare duke zbatuar parimet e qeverisjes së korporatave, duke u përmirësuar në marrëdhëniet ndërmjet aksionerëve dhe pretendentëve, përmirësime në performancën e bordeve të drejtorëve, auditëve dhe kontabilitetit si dhe janë duke i kushtuar rëndësi të veçantë mënyrës sesi drejtohen dhe kontrollohen shoqëritë.

Ekonomitë në zhvillim si Shqipëria, si një vend i vogël, frymëzohen nga vendet e zhvilluara jo vetëm për zgjedhjen e praktikave të QK që i përshtaten më mirë infrastrukturës ligjore të tyre, reformave, historisë dhe kulturës, por edhe për të përmirësuar efikasitetin e ekonomive të tyre në periudha krizash ekonomike.

Potenciali i qeverisjes së korporatave për të ngritur një biznes në një sukses më të madh tregtar nuk është i njohur përgjithësisht në Shqipëri. Shqipëria si një vend i vogël është në hapat e para të debatit mbi qeverisjen e korporatave dhe sistemet e qeverisjes janë në fazën e ndërtimit. Në dhjetor të vitit 2011, METE, e mbështetur nga Shërbimet Këshilluese të IFC-së, miratoi Kodin e Qeverisjes së Korporatave për shoqëritë e pa listuar në Shqipëri. Ky kod që sot është në dorën e aksionerëve dhe drejtuesve të shoqërive thekson parimet kryesore që drejtojnë një biznes si dhe është mjaft e dobishme për shoqëritë që ta përfshijnë atë në praktikatat e tyre pavarësisht faktit që kjo nuk është e detyrueshme për ta. Përgjegjshmëria, raportimi, transparenca e informacionit dhe kontrolli i shoqërive, janë bërë faktorë të rëndësishëm jo vetëm për aksionerët, investitorët e ndryshëm, huadhënësit, furnizuesit etj, por veçanërisht për shoqëritë aksionere dhe jo vetëm, por shoqëritë aksionere mbeten pjesa më e organizuar e shoqërive tregtare nga ku gjejnë zbatim më mire parimet e qeverisjes, veçanërisht në institucionet me kapital të huaj që veprojnë në mjedisin ekonomik në Shqipëri. Rëndësi primare në ditët e sotme merr aplikimi i praktikave më të mira në strategjitë e bizneseve, zbatimi i parimeve të Kodit të Qeverisjes së Korporatave dhe përdorimi i instrumentit vlerësues (scorecard). Vetëm në këtë mënyrë një shoqëri mund të jetë konkurruese dhe afatgjatë dhe nga ana tjetër mund të krijohet një mjedis i përshtatshëm për punonjësit dhe për komunitetin pasi dimë që shoqëria i shërben edhe komunitetit me veprimtarinë e saj (sipas parimeve të OECD-së roli i grupeve të interesit në QK. Korniza ligjore e QK duhet të njohë të drejtat e grupeve të interesit të përcaktuara në ligj ose marrëveshje të

përbashkëta).

Argumenti kryesor i temës është se qeverisja e mirë e korporatave është një domosdoshmëri në sigurimin e vlerave të kërkuara veçanërisht nga grupet e ndryshme të interesit (stakeholdersat). Ajo rrit performancën e korporatave, duke krijuar një mjedis që i motivon menaxherët për të maksimizuar kthimin nga investimet, rrit efikasitetin operacional dhe siguron rritjen afatgjatë të produktivitetit. Në shumë vende në zhvillim, qeverisja e korporatave mbetet një ide e diskutueshme në aspektin e bazës konceptuale, karakteristikave, efikasitetit dhe zhvillimin e ardhshëm (Kuznetsov & Kuznetsova, të vitit 2009), gjithashtu duke theksuar rëndësinë e qeverisjes së mirë të korporatave, aplikimi i saj duhet të rezultojë me rritje në çmimin e aksioneve dhe në tërheqjen e kapitalit (McGë, 2008).

Kohët e fundit përgjegjshmëria dhe transparencia janë bërë faktorë kryesorë jo vetëm për aksionerët por gjithashtu dhe për investitorët, blerësit, ofruesit dhe pretendentët e tjerë por pa harruar dhe performancën. Psh Macey (1998), sugjeron mënyra empirike për të matur performancën e një sistemi të qeverisjes së korporatave.

Për qëllimet e këtij punimi do të kryhet një rishikim i literaturës mbi teoritë e qeverisjes së korporatave, aspektet themelore të qeverisjes së korporatave, renditja e vendeve evropiane në zhvillim mbështetur në një indeks të qeverisjes së përgjegjshme të korporatave duke identifikuar dimensionet e nevojshme (D) për të matur këtë qeverisje dhe komponentët e çdo dimensionit si dhe do të analizohet situata aktuale e zbatueshmërisë së parimeve të qeverisjes së korporatave në disa shoqëri që veprojnë në Shqipëri. Rezultatet e punimit kanë si qëllim të japin rekomandime për propozimin e një modeli më të përshtatshëm të qeverisjes së korporatave duke i dhënë përgjigje pyetjeve kërkimore dhe hipotezave.

Në epilog mund të themi se globalizimi ka mundësuar atë që lidhjet midis shoqërive të vendeve të ndryshme për shkëmbimin e mallrave dhe shërbimeve të jenë të shumta dhe të shumëllojshme. Ecuria drejt qëndrimeve të njëjta politike ka forcuar tendencën për rregulla të njëjta drejt standartizimit jo vetëm të pasqyrave raportuese (një pjesë e vendeve në zhvillim apo të EJT-së kanë adoptuar ose janë në proces adoptimi të IFRS-ve për ndërmarrjet e mëdha) por dhe Q.K-së.

HYRJE

Cyret dhe March (1969) kanë argumentuar se firma është një bashkësi e grupeve të ndryshme – aksionerëve, punonjësve, klientëve, furnitorëve dhe shtetit - ku secili prej tyre duhet të paguajë një minimum për të marrë pjesë në bashkësi (C.Drury Kontabiliteti Kosto Drejtimi, 2006).

Në ditët e sotme korporatat luajnë një rol të madh në jetën ekonomike dhe sociale kudo ku ato kanë shtrirë aktivitetin e biznesit. Jean Tirole, president i Shkollës Ekonomike të Tuluzës në Francë, një shkollë me frymëzim anglo-sakson fitues i çmimit Nobel nga Akademia Mbretërore e Shkencave e Suedisë për vitin 2014, ka realizuar një progres teorik dhe ka dhënë kontribut në sferën e kërkimit në një numër të madh fushash, por mbi të gjitha ai ka qartësuar mënyrën se si duhet kuptuar dhe rregulluar funksionimi i industrisë, e dominuar nga disa korporata apo sipërmarrje të fuqishme. Ai thekson se korporata është pjesa më e rëndësishme e realitetit të ekonomisë dhe tregut në përgjithësi dhe mënyra se si ata sillen në treg, përbën një tjetër element që duhet studiuar me kujdes. Korporatat përfaqësojnë një entitet ligjor shumë të rëndësishëm, mbështetur në strukturën e tyre ligjore por dhe organizimin e brendshëm, numrin e punonjësve etj. P. Drucker, për rëndësinë dhe përgjegjësinë e menaxhimit, pohon se: “Përgjegjësia e menaxhimit në shoqërinë tonë është vendimtare jo vetëm për organizatën, por edhe përqëndrimin publik ndaj menaxhimit, për suksesin dhe statusin e tij, për të ardhmen e sistemit tonë ekonomik e social dhe për mbijetesën e organizatës si një institucion i pavarur” (P. Drucker, 1989). Qeverisja e korporatave ka qenë pjesë e hulumtimit në ekonomi e biznes që nga viti 1776, kohë kur Adam Smith publikoi *Bazat e Kërkimit mbi Natyrën dhe Shkaqet e Pasurisë së Kombeve* dhe më pas në vitin 1932 kemi botimin klasik të Berle¹⁾ dhe Means për ndarjen e pronësisë të korporatave nga kontrolli. *Modern corporation and private propriety* thekson se shpërndarja e madhe e pronësisë prish lidhjen ndërmjet pronësisë dhe kontrollit. Megjithatë edhe në kohën e sotme, të cilësuar si “periudha e liberalizimit” dhe filozofisë së shtetit *laissez-fair*, John Keynes vazhdon të kujtohet edhe 68 vjet pas vdekjes, pikërisht për theksin që vinte në

¹⁾Berle ishte profesor në Columbia Law School në vitin 1927. Libri i tij, *The Modern Corporation and Private Property* është një nga studimet me të mira në fushën e qeverisjes së korporatave. Berle dhe Means “The modern corporation and private property”, Macmillan 1932, Edition revised by A Berle, Columbia University, 1967, Harcourt, Brace and World, New York 1967.

faktin se ekonomia duhet të kalojë në plan të dytë përpara etikës dhe politikës”. Evoluimin i qeverisjes së korporatave, ka bërë që ajo të jetë në epiqendër të biznesit, madje jo vetëm të “rritet” me shpejtësi si një temë me interes në literaturën akademike por edhe të marrë më shumë vëmendje nga rregullatorët, politikëbërësit dhe media (Clarke, 2004). Rëndësia e qeverisjes lindi në korporatat moderne për shkak të ndarjes së menaxhimit nga kontrolli pronësisë në organizata. Interesat e aksionerëve janë të ndryshme me interesat e menaxherëve. Problemi kryesor (ose principal siç e njohim) - agjent, pasqyrohet në menaxhimin dhe problemet e drejtimit, të lidhura për shkak të interesave të aktorëve të firmës. Nuk ka një përkufizim të vetëm të qeverisjes së korporatave, aq më tepër ajo mund të shihet nga këndvështrime të ndryshme. Berle & Means (1932) dhe madje edhe më herët Smith (1776) kanë dhënë përkufizimet e tyre.

Rëndësia e qeverisjes së korporatave në aspektin e performancës dhe cilësisë së raportimit financiar është bërë fokusi i hulumtimit që nga shpërthimi i skandaleve dhe mashtrimeve në shoqëri të tilla si Parmalat (2002-2003), Enron (Tetor 2001), Xerox (në vitin 2000) Aig (në vitin 2004) të cilët ulën nivelin e besimit tek aksionerët dhe investitorët potencialë në aftësinë e ekipeve të menaxhimit për të raportuar një informacion financiar transparent dhe të saktë. Këto dështime të transparencës dhe besueshmërisë së informacionit financiar në shumë shoqëri çuan në nevojën për të përmirësuar cilësinë e raportimit, zgjerimin e strukturave të korporatës duke implementuar: komitetin e auditimit, strukturën dhe karakteristikat e bordit të drejtorëve, auditimin e jashtëm dhe rregulla të tjera të qeverisjes së korporatave.

Skandalet e korporatave në fillim të shekullit 21 (të tilla si Enron dhe WorldCom) të cilët në fund çuan në aprovimin e legjislacionit Sarbanes-Oxley në vitin 2002, ishin një kujtesë e pakëndshme që kostot e agjencisë janë shumë reale (Jensen, 2000) dhe mund të shkatërrojnë vlerë dhe pasuri anembanë (Akti Sarbanes-Oxley në vitin 2002, akt i cili u pasua me rregullimet në ligjet e shumë vendeve si Kanadaja (2002), Gjermania (2002), Afrika e Jugut (2002), Franca (2003), Australia (2004), India (2005), Japonia (2006), Italia (2006), Izraeli (2006) dhe Turqia (2006)).

Pesë forcat që hedhin dritë më shumë mbi qeverisjen e korporatave janë: numri i madh i privatizimeve në dekadat e fundit, reformat në sektorin e fondit të pensioneve, numri i madh i sipërmarrjeve në vitet 1980 (sidomos në SHBA), integrimi i tregjeve të kapitalit

(sidomos Bashkimi Evropian), liberalizimi në mbarë botën, dhe së fundi kriza në Azinë Lindore, Rusi dhe Brazil (Becht *et al.* 2005).

Studimet empirike në lidhje me qeverisjen e korporatave të kryera në vende të ndryshme të botës kanë nxjerrë në pah tiparet e qeverisjes së korporatave në lidhje me ecurinë ekonomike, strukturën e pronësisë, industrinë, sistemin juridik, veprimet e kontrollit duke demonstruar natyrën vullnetare të zbatimit të praktikave të qeverisjes së korporatave.

Qeverisja e korporatave është bërë një çështje e rëndësishme në vendet evropiane në zhvillim në vitet e fundit, por është akoma e panjohur gjerësisht në shumë vende të tjera. Parimet e OECD-së e përkufizojnë qeverisjen e korporatave si përfshirje e një grupi të marrëdhënieve ndërmjet menaxhimit të korporatës (shoqërisë), bordit drejtues të tij, aksionerëve të tij dhe partnerëve të tjerë. Qeverisja e korporatave (IFC) paraqet strukturën me anë të së cilës përcaktohen objektivat, gjithashtu edhe mjetet me anë të të cilave arrihen këto objektiva, si dhe mënyra e monitorimit të ecurisë së tyre (një sistem marrëdhëniesh, të përcaktuara nga strukturat dhe proceset: marrëdhëniet midis aksionerëve dhe menaxhimit, marrëdhëniet midis kompanisë dhe grupeve të interesit (stakeholders). Si furnizues dhe krijues burimesh, punonjësit, kreditorët dhe furnizuesit, të gjithë së bashku japin ndihmesë në arritjen e suksesit të shoqërisë. Prezenca e një sistemi efektiv të qeverisjes së korporatave brenda një shoqërie si dhe në tërësi të një ekonomie ndihmon në ofrimin e një shkalle besimi që është e nevojshme për mirëfunksionimin e tregut ekonomik. Duhet veçuar në këtë kontekst ndarja e pronësisë nga menaxhimi i shoqërisë, cilësia e bordit të drejtorëve i cili luan rol kyç në qeverisjen e shoqërisë, përgjegjësia mbi grupet e interesit si dhe çështje të tjera të rëndësishme bazuar në parimet e qeverisjes së korporatave.

Parimet e Qeverisjes së Korporatave sipas OECD-së synojnë (OECD Principles, 2004) :

- Kuadër të përshtatshëm ligjor dhe rregullator për shoqëritë me kapital shtetëror/publik;
- Mbrojtje dhe lehtësim të ushtrimit të rolit të aksionerëve;
- Trajtim të barabartë të të gjithë aksionerëve qoftë ata në mazhorancë ashtu dhe minorancë;
- Publikim të informacionit dhe transparencë;
- Menaxhim strategjik, monitorim efektiv nga bordi dhe përgjegjshmëri të tij

(bordit) ndaj shoqërisë dhe aksionerëve si investues të burimeve.

Fokusi i këtij punimi është analiza e tendencës së qeverisjes së korporatave duke realizuar matjen e saj në vendet evropiane në zhvillim si dhe në disa prej shoqërive që veprojnë në Shqipëri duke u fokusuar në analizën e situatës aktuale dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësime të mëtejshme. Qeverisja e korporatave varet nga :

(i) kuadri ligjor, (ii) institucional dhe (iii) rregullator. Kuadri ligjor në Shqipëri për QK është në hapat fillestare, ndonëse ka përmirësime. Këto përmirësime përfshijnë shoqëri në fusha ose sektorë të caktuar të ekonomisë shqiptare ku sektori kryesor është ai financiar. Një risi që duhet përmendur është Ligji Nr. 9901 datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregëtare”. Përsa i përket kuadrit institucional dhe rregullator në Shqipëri ekzistojnë disa institucione që kanë të paktën një veprimtari të tyre që përqendrohet në qeverisjen e korporatave (AMF, METE etj). Në Shqipëri nuk ka ligj të detyrueshëm as për shoqëritë publike dhe as për ato private për të zbatuar parimet e qeverisjes së korporatave.

1. Objektivat e studimit.

Ky punim është mbështetur në përmbushjen e disa objektivave ndër të cilat mund të përmëndim:

1. Rishikimi i literaturës për sa i përket disa koncepteve kryesore të qeverisjes së korporatave, mekanizmave kryesorë që përdoren për vlerësimin e kësaj qeverisje. Ky kuadër do të shërbente si një kuadër teorik për të bazuar punën e analizës.
2. Përcaktimin e një metodologjie për të matur qeverisjen e përgjegjshme të korporatave.
3. Kryerja e një pyetësoi për të evidentuar dhe kuptuar si realizohet qeverisja dhe për të kuptuar problematikën që mund të ndeshen gjatë këtij procesi dhe se si kjo qeverisje ndikon në shoqëri të ndryshme.
4. Kryerja e një analize të dhënash bazuar në informacionin cilësor të mbledhur.
- 5 Paraqitja e disa konkluzioneve dhe rekomandimeve të punimit mbështetur në këtë analizë të rezultateve.

2. Qëllimi i punimit

Origjina e konceptit të QK lidhet me atë të qeverisjes i cili si nocion është i lidhur me zhvillimin e shtetit dhe të së drejtës.

Qeverisja e korporatës synon rritjen e efikasitetit të administrimit të shoqërisë aksionere me qëllimin final maksimizimin e të ardhurave të aksionerëve. Për arritjen e këtij synimi, përveç motivimit të strukturave administruese, përdoren edhe një sërë instrumentash që nxisin biznesin, duke përfshirë kontrata të ndryshme, struktura organizative të shoqërisë dhe përmirësime legjislative (Matiesen, 2002 : 218, E drejta Shqiptare e Shoqërive Tregtare Malltezi. A, 2011).

Globalizimi financiar i mundësoi shumë shoqërive, në veçanti atyre të cilat kanë akses në tregjet financiare globale, të zbatojnë praktika të mira të qeverisjes së korporatave. Ndërsa rëndësia e qeverisjes së korporatave tashmë është pranuar, ka vende akoma në zhvillim të cilët duhet të bëjnë më shumë në drejtim të mekanizmave të qeverisjes së korporatave (Shleifer & Vishny, 1997). Ky studim ka për qëllim të tregojë nëpërmjet analizës stadin e ndodhjes së kësaj qeverisje dhe të kontribuojë veçanërisht në kuptimin e mekanizmave të qeverisjes së korporatës duke analizuar vendet në zhvillim përfshirë dhe Shqipërinë, veçanërisht shoqëritë shqiptare nëpërmjet disa indekseve të cilët janë pjesë e llogaritjes së dimensioneve të përcaktuar dhe të rekomanduara nga literatura për qeverisjen e korporatave, të cilët do t'i shpjegojmë më poshtë. Kjo analizë do të zgjerojë aplikimet empirike duke integruar faktorët e zgjedhur për t'u analizuar në një model statistikor, konkretisht në një regresion të thjeshtë linear si dhe duke bërë një analizë të detajuar gjithashtu statistikore të këtyre faktorëve. Shoqëritë aksionere aktive në përgjithësi, përbëjnë pjesën më dinamike të bizneseve shqiptare ku sigurisht këtu bëjnë pjesë dhe shoqëritë që kemi zgjedhur në studim. Një pjesë janë shndërruar të tilla që nga viti 1993 deri në qershor 2014 (sipas interesimit në QKR). Shndërrimi i subjekteve në shoqëri aksionere si një formë e avancuar e organizimit të kapitalit dhe aktivitetit tregtar, përkon edhe me konsolidimin e bizneseve dhe maturimin e kapitalit të tyre. Kërkesë e kohës mbetet fakti real që shoqëritë aksionere duhet të ndjekin parimet e qeverisjes së korporatave të publikuar në kode, pasi një qeverisje e mirë padyshim që do t'i sjellë përfitime atyre. Qëllimi i këtij studimi në të njëjtën kohë është matja e perceptimeve të aksionerëve, menaxherëve apo drejtuesve të tjerë me pozicione kyçe në

shoqëri mbi qeverisjen e korporatave. Nëpërmjet studimit do të shohim stadin e ndodhjes së qeverisjes së korporatave të ndarë në dy pjesë, në vendet evropiane në zhvillim ku bën pjesë edhe Shqipëria si dhe situatën e kësaj qeverisje në disa nga shoqëritë që veprojnë në tregun shqiptar, shoqëri të cilët janë zgjedhur nga xhiro e tyre (qarkullimi), por dhe nga numri i punonjësve që e përbëjnë atë si dhe nga kapitali, kapital i cili siç dihet është i përcaktuar me ligj që në fillim të krijimit të tyre. Shoqëritë aksionere sipas ligjit i kemi me ofertë publike (aksionet e të cilave janë të regjistruara zyrtarisht në bursën e letrave me vlerë, vlera minimale e kapitalit themeltar duhet të jetë 10 milionë lekë) dhe pa ofertë publike (vlera minimale e kapitalit themeltar është 2 milion lekë). Për të arritur qëllimin e studimit është bërë rishikimi i disa modeleve të ndryshme duke konkluduar në një model i cili na ndihmon për të parë se ku ndodhet kjo qeverisje duke realizuar renditjen e vendeve evropiane në zhvillim në bazë të një indeksi të qeverisjes së përgjegjshme të korporatave. Hapat e ndjekur në këtë studim janë përcaktuar në metodologjinë e studimit. Edhe në rastin e shoqërive shqiptare kemi realizuar të njëjtën gjë duke përcaktuar indeksin e qeverisjes së korporatave për shoqëritë që kemi marrë në studim të cilët veprojnë në Shqipëri. Në funksion të përmbushjes së qëllimit të punimit objektivi është rishikimi i literaturës mbi qeverisjen për të krijuar bazën e modelit konceptual të këtij punimi.

3.Pyetjet kërkimore dhe hipotezat

Punimi, siç e kemi përmendur, synon të tregojë stadin se ku ndodhet qeverisja e korporatave në vendet në zhvillim së bashku me qeverisjen në Shqipëri si dhe në një pjesë të shoqërive shqiptare duke realizuar një analizë teorike dhe statistikore. Pyetjet e ngritura ishin pararendëse të ‘hipotezave’ që përmenden dhe në kapitujt e mëposhtëm. Për të arritur këtë qëllim, punimi do t’u japë përgjigje pyetjeve kërkimore dhe hipotezave si më poshtë :

- Pyetjet kërkimore

a) *A kemi një qeverisje të mirëfilltë të korporatave në Shqipëri në krahasim me vendet e tjera në zhvillim?*

b) Në cilën fazë ndodhet qeverisja e korporatave, mbështetur në analizën e disa shoqërive që veprojnë në Shqipëri?

- **Hipotezat**

a) *“Qeverisja e korporatave në Shqipëri larg praktikave më të mira të publikuar dhe të rishikuara në kuadrin e krizës financiare nga OECD-ja krahasuar me vendet e tjera në zhvillim, është faktor ndikues dhe për zhvillimin ekonomik të vendit”.*

b) *“Nëse shoqëritë në Shqipëri në përgjithësi në aktivitetin e tyre nuk do të zbatojnë të paktën ato parime që janë publikuar në kode apo manual atëherë nuk do të kemi një qeverisje efektive korporate dhe për rrjedhojë kultura e qeverisjes do të jetë e reduktuar vetëm në disa shoqëri dhe jo më gjerë”.*

4. Kufizimet e punimit

Pavarësisht se ky punim synon të japë një pamje sa më të plotë përsa i përket fushës së qeverisjes së korporatave, i cili përbën një profesion të ri si dhe praktikatat e qeverisjes janë një dukuri relativisht e re (Civici A, www.arkivalajme.com, intervistë në Gazetën MAPO) shumë më kompleks se menaxhimi i biznesit dhe mundësisë së aplikimit të suksesshëm të kësaj qeverisje kryesisht nga shoqëritë që zhvillojnë aktivitet në Shqipëri veçanërisht kompanive shqiptare, përveç kontributeve, ky punim shoqërohet edhe me disa kufizime. Më të rëndësishmit përmbledhen si më poshtë:

- Madhësia e përgjigjeve të pyetësorëve nga bizneset e marra në studim ishte jo shumë e madhe (76 shoqëri), por nisur nga vështirësitë e marrjes së përgjigjeve mendojmë se jemi në një nivel të pranueshëm pasi pyetësi siç do ta shohim më poshtë i është adresuar një numri të gjerë biznesesh (shoqëri). Si rezultat duhet kushtuar kujdes në përpjekjen për të përgjithësuar të dhënat e këtij punimi. Vështirësitë në marrjen e përgjigjeve nga pyetësi kanë qenë të mëdha për arsye të neglizhencës nga bizneset.

- Të dhënat janë mbledhur në një periudhë kohore, jo në periudha të ndryshme. Ndërkaq do të ishte me interes shtrirja e tyre në kohë për të kuptuar më mirë

dinamikat e ndryshimit. Biznesi dihet që ka dinamikën e tij dhe mbi gjithçka është në ndryshim në lidhje me treguesit apo ecurinë në treg. Pikërisht është tregu që i jep “vlerë” biznesit. Situatat ekonomike dhe pozicionet në treg variojnë sipas faktorëve politikë, social etj.

5. Rëndësia e studimit

Origjina e konceptit të QK-së lidhet me konceptin e gjerë dhe të përgjithshëm të qeverisjes, si një nocion i lidhur me zhvillimin e shtetit dhe të së drejtës. Qeverisja e korporatave (Q.K) është një strukturë marrëdhëniesh midis aksionerëve, anëtarëve të bordit dhe administratorëve të kompanie, e ndërtuar sipas statutit të kompanisë, rregulloreve, politikave zyrtare dhe shtetit të së drejtës (The Corporate Library :217).

Një qeverisje e mirë korporatash kontribuon në zhvillimin e një ekonomie të qëndrueshme duke rritur kështu performancën e kompanisë dhe aksesin në burimet hyrëse të kapitalit. Kjo do të bënte një shoqëri më fitimprurëse dhe rentabël, duke favorizuar rritjen e saj ekonomike. Qeverisja e korporatës është e rëndësishme si për shoqëritë ashtu dhe për ekonominë kombëtare madje thuajse e njëjtë po rezulton në koncepte me qeverisjen kombëtare e cila përfaqëson procesin e marrjes së vendimeve dhe mënyrën e implementimit të këtyre vendimeve. Kjo theksohet dhe nga J Wolfensohn-shefi i BB-së në “A battle for corporate honesty” The Economist” The World in 1999, f. 38. Ashtu sikurse mirëqeverisja kombëtare përfaqëson transparencë dhe përgjegjshmëri, qeverisja e korporatave kërkon së pari transparencë për transaksionet e korporatës si kontabilitet, procedura auditimi etj. Në shkencat ekonomike Qeverisja (Governance) ka të bëjë me rolin e personave që janë të autorizuar për mbikëqyrje, kontrollin dhe drejtimin e një subjekti. Ata që janë të ngarkuar me qeverisje zakonisht janë përgjegjës për të siguruar që subjekti i arrin objektivat e tij, raportimin financiar dhe raportimin në palët e interesuara. Nëpërmjet këtij punimi synohet *së pari*, të jepet një kontribut për ato shoqëri që veprojnë në mjedisin ekonomik në Shqipëri, kryesisht me kapital shqiptar për të qenë sa më aktiv në zbatimin e parimeve të qeverisjes së korporatave, të cilët duke nxjerrë mësimet e dhura nga kriza financiare e vitit 2008 të shohin në perspektivë mbi këtë qeverisje. Pavarësisht se ekziston një literaturë e gjerë në fushën e qeverisjes së korporatave, manuale dhe kode,

në vendin tonë kjo fushë studimi vazhdon të mbetet e re dhe kërkon pak kohë për t'u njohur dhe zbatuar nga shoqëritë. Për më tepër, ndryshimet e mëdha pas viteve '90-të, patën ndikimin e tyre si tek shoqëritë ekzistuese të cilët u transformuan në përputhje me ligjet, siç ishte psh rasti i Ligjit "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare" ashtu dhe në metodat e drejtimit, por edhe në bizneset e reja që lindën. Në këtë kuadër, punimi synon ndër të tjera të japë një kontribut modest në ndihmë të drejtuesve të bizneseve dhe menaxherëve të niveleve të ndryshëm për të kuptuar mesa munden rëndësinë e qeverisjes së korporatave. Studimi aktual mund të shërbejë edhe si pikënisje për studime më të thelluara në këtë fushë duke zgjeruar gamën e faktorëve të marrë në studim ose duke ndryshuar ndonjë prej tyre duke ditur faktin që qeverisja e korporatave është një fushë e gjerë për hulumtime. *Së dyti*, studimi mund të pasurohet me të dhëna të reja në kohë të ndryshme dhe ti shërbejë çfarëdo lloj shoqërie duke nxjerrë konkluzione të ndryshme në varësi të kohës kur do të merret iniciativa për ta pasuruar me këto të dhëna.

Nëpërmjet identifikimit të dimensioneve të QK-së mund të hartohen politika të ndryshme mbi këtë qeverisje si dhe të nxirren konkluzione apo të bëhen rekomandime specifike nga strukturat përkatëse të shoqërisë.

6. Strukturimi i punimit

Për këtë studim është hartuar një strukturë me synimin për të qenë sa më argumentues në lidhje me temën në fjalë. Punimi ndahet në 6 kapituj ku secili prezanton një aspekt të veçantë, gjithmonë e lidhur dhe në raport me objektin kryesorë të trajtimit : qeverisjen e korporatave.

Në kapitullin e parë, paraqitet metodologjia e studimit e cila është e ndarë në tre nënkapituj ku përmendim teknikën sasiore, arsyen e zgjedhjes së pyetësorit për mbledhjen e të dhënave si dhe përcaktimin e mostrës dhe procedurës së mbledhjes së të dhënave.

Në kapitullin e dytë paraqitet një rishikim i literaturës mbi qeverisjen e korporatave, aspektet themelore të qeverisjes së korporatave. Qeverisja parë nga këndvështrime të ndryshme nga literatura. Evoluimin e kësaj literature. Rolin e bordeve. Ky kapitull vijon më pas me një vështrim mbi debatet në lidhje me teoritë e qeverisjes së korporatave dhe

modelet e sotme në fushën e qeverisjes së korporatave. Duke analizuar modelet e sotme në fushën e qeverisjes së korporatave ne kuptojmë më mirë konvergimin e tyre. Pjesë të këtij kapitulli, të cilët na ndihmojnë për të kuptuar aspektet teorike, kemi dhe transparencën dhe zbulimin, parimet e qeverisjes dhe rishikimin e tyre, dështimet e qeverisjes së korporatave, rekomandimet për daljen nga kriza si dhe qeverisjen e korporatave në Shqipëri mbështetur në kodet e publikuara të qeverisjes. Sigurisht që parimet dhe zbatimi i parimeve të publikuar në kode përbëjnë dhe bazën e punimit tonë. *Në kapitullin e tretë* jemi përqendruar në analizën e qeverisjes së korporatave në vendet evropiane në zhvillim e bazuar në gjetjet nga literatura. Kapitulli fillon me lidhjen ndërmjet qeverisjes së korporatave dhe zhvillimit ekonomik, mënyrën që na dërgon për tek qeverisja e përgjegjshme e korporatave, matjen e qeverisjes së përgjegjshme të korporatave në studime të ndryshme në vende të ndryshme, do të ndalemi tek përcaktimi i një indeksi të qeverisjes së përgjegjshme të korporatave për këto vende ku do të tregohet mënyra e mbledhjes së të dhënave dhe burimi përkatës dhe në fund rezultatet e hulumtimit (kërkimit).

Ne kapitullin e katërt paraqitet analiza e qeverisjes së korporatave në disa shoqëri të cilët veprojnë në mjedisin ekonomik në Shqipëri. Shoqëritë e kërkuara dhe të marra në studim janë të tipit shoqëri anonime (sh.a) si shoqëri të cilët janë më të konsoliduar në treg. Edhe ky kapitull vijon me të njëjtat procedura të llogaritjes së indeksit të qeverisjes së përgjegjshme të korporatave ashtu si në rastin e vendeve evropiane në zhvillim. Në këtë kapitull një pjesë e rëndësishme është ajo e procedurës së mbledhjes së të dhënave, mënyra e hartimit të pyetësorit, duke përfunduar në epilog me vlefshmërinë dhe besueshmërinë e pyetësorit.

Kapitulli i pestë përmbledh analizën e rezultateve të kërkimit. Kapitulli është i përbërë nga disa nënkapituj të cilët na japin një analizë të hollësishme të rezultateve të marra nga puna në terren nëpërmjet shpërndarjes së pyetësorëve nga ku kemi parë më nga afër qeverisjen e korporatave në shoqëritë shqiptare.

Kapitulli i gjashtë vjen si kapitull përmbyllës i këtij punimi. Në këtë kapitull pasqyrohen konkluzione specifike të punimit duke u shoqëruar dhe me disa rezultate statistikore nga gjetjet që ndihmojnë këto konkluzione si dhe disa konkluzione të përgjithshme që mendoj se janë të rëndësishme, gjithashtu në fund të këtij kapitulli jepen dhe disa rekomandime në lidhje me qeverisjen e korporatave (QK).

KAPITULLI I

METODOLOGJIA E STUDIMIT

1.1 Procedura metodologjike (fazat kryesore të procesit të hulumtimit).

Qëllimi i metodologjisë është që të kuptohet thelbi i njohurive shkencore dhe të vendos parimet themelore në përvetësimin e saj dhe shqyrtimin kritik. Ajo ka rolin e vet kryesor në çdo studim.

Të dhënat. Çdo punë hulumtuese-shkencore empirike fillon me mbledhjen e të dhënave. Të dhëna shkencore relevante janë ato të dhëna që janë në funksion të hulumtimit, ose, të cilat janë të specifikuara në qëllimin e hulumtimit dhe që mund të lidhen me hipotezën e parashtruar. Pastaj, këto janë të dhëna të mbledhura me teknika dhe procedura të standardizuara për mbledhjen e të dhënave.

Metodologjia e përdorur është në funksion të qëllimeve të vëna në fillim të studimit. Studimi është mbështetur në një kërkim empirik. Në ndërtimin e metodologjisë së kërimit kam synuar që të realizoj kontakte direkte me persona që mbajnë pozita kyçe në shoqëri për të shmangur sa më shumë përgjigjet e pavlefshme dhe krijimin e një tabloje joreale për qeverisjen e korporatave. Fokusin kryesor të punimit e përbën matja e qeverisjes së korporatave si në vendet evropiane në zhvillim ashtu dhe në shoqëritë shqiptare. Punimi përqëndrohet në matjen e qëndrimeve mbi këtë qeverisje, perceptimin mbi këtë qeverisje, gadishmërisë mbi zbatimin e parimeve të kësaj qeverisje. Për kryerjen e këtij studimi është grumbulluar dhe studiuar literaturë me qëllim realizimin e analizës dhe krijimin e bazës teorike për hulumtim të mëtejshëm. Mbi bazën e literaturës së studiuar janë ngritur dhe hipotezat përkatëse për t'u vërtetuar në vijim. Nga rishikimi i literaturës mbi qeverisjen e korporatave rezultoi se ekziston një literaturë e gjerë mbi këtë çështje, qëllimi i këtij studimi është të tregojë lidhjen që ekziston ndërmjet variablave.

Metodologjia e përdorur në këtë punim kombinon të dhënat primare me ato sekondare. Të dhënat primare janë siguruar nëpërmjet pyetësorëve, pasqyruar në kapitullin e dytë të shpërndarë në qytete të ndryshme në shoqëri anonime si shoqëri të konsoliduara në treg dhe që përbëjnë dhe mbajnë padyshim një pjesë të rëndësishme të sektorit të ekonomisë dhe më konkretisht nga sektori i prodhimit, shërbimit, fason apo industria përpunuese

etj. Të dhënat sekondare janë rezultat i rishikimit të një literature të gjerë dhe bashkëkohore mbi qeverisjen e korporatave. Kjo literaturë është siguruar nga kërkimet në Bibliotekën Kombëtare, në atë të Universitetit të Tiranës në Fakultetin e Ekonomisë dhe në bibliotekat elektronike të disa universiteteve evropiane apo amerikane, si dhe nga burime interneti. Gjithashtu rishikimi teorik është mbështetur dhe në legjisllacionin shqiptar që specifikon mënyrën e funksionimit të shoqërive tregtare në përgjithësi dhe Sh.a-ve në veçanti si dhe V.K.M-ve të ndryshme apo Udhëzimeve të DRT-ve. Gjithashtu kanë shërbyer raportet vjetore të bankave të ndryshme, buletine ekonomike apo buletine të shoqatave të ndryshme, si dhe libra akademike mbi fushën studimore. Punimet akademike si kërkimet shkencore, punime konferencash apo dhe leksione mbi fushën kërkimore, kanë plotësuar kuadrin e burimeve sekondare. Të dy tipet e informacioneve kanë shërbyer në analizat e kryera në këtë studim, si dhe kanë ndihmuar metodologjinë e përdorur për të parë se cilat janë problemet e qeverisjes së korporatave në Shqipëri dhe se si mund ta përmirësojmë këtë qeverisje. Metodologjia e përdorur në kapitullin e dytë e cila ka të bëjë me *qeverisjen e korporatave në vendet evropiane në zhvillim* mbështetet në të dhënat sekondare. Politikat e zhvillimit të qëndrueshëm të zbatuara nga disa vende të botës kanë vënë theksin në mënyrë të qartë mbi rolin kyç të përgjegjësisë sociale të korporatës. Përgjegjësitë mjedisore dhe sociale, por veçanërisht ato që lidhen me qeverisjen e përgjegjshme të korporatave janë pjesë integrale e performancës dhe e qëndrueshmërisë afatmesme dhe afatgjatë. Studimet empirike në lidhje me qeverisjen e korporatave të kryera në vende të ndryshme kanë nxjerrë në pah tiparet e qeverisjes së korporatave në lidhje me ecurinë ekonomike, strukturën e pronësisë, industrinë, sistemin ligjor, veprimet e kontrollit dhe demonstrimin e natyrës vullnetare të zbatimit të praktikave të kësaj qeverisjeje (qeverisjes së korporatave). Qeverisja e korporatave është bërë një çështje e rëndësishme në vendet evropiane në vitet e fundit, por është thuajse e panjohur ose në disa raste pak e njohur në shumë vende të tjera, kryesisht ato në zhvillim. Në shumë vende në zhvillim, qeverisja e korporatave mbetet një ide e diskutueshme në aspektin e bazës konceptuale, karakteristikave, efikasitetit dhe zhvillimin e ardhshëm (Kuznetsov & Kuznetsova, 2009), gjithashtu duke theksuar rëndësinë e qeverisjes së mirë të korporatave, aplikimi i saj duhet të rezultojë me rritje në çmimin e aksioneve dhe në tërheqjen e kapitalit (McGë, 2008). Qëllimi në këtë pjesë të studimit (kapitulli i dytë) është të realizojmë

renditjen e vendeve evropiane në zhvillim mbështetur në një indeks të qeverisjes së përgjegjshme të korporatave. Për të vënë në zbatim këtë qëllim, *së pari* kemi identifikuar dimensionet e nevojshme (D) për të matur qeverisjen e përgjegjshme të korporatave (GCR). Komponentët e çdo dimensionit janë nën-indekse, *së dyti* është përcaktuar një metodë për të llogaritur indeksin e qeverisjes së përgjegjshme të korporatave (GCR) për vendet evropiane në zhvillim, *së treti* kemi realizuar rankimin e shteteve sipas vlerës së indeksit të qeverisjes së përgjegjshme të korporatave, *së katërti* kemi realizuar lidhjet (korrelacionet) ndërmjet treguesve që formojnë dimensionet e ndryshme të qeverisjes së përgjegjshme të korporatave. Gjithashtu, duke pasur informacion dhe për GDP-në (PBB) për vendet e marra në studim kemi realizuar dhe klasifikimin e shteteve sipas përdorimit të indeksit të qeverisjes së përgjegjshme të korporatave GCR dhe atij të GDP-së (PBB)/frymë. *Së fundi* kemi realizuar një korrelacion ndërmjet indeksit të qeverisjes së përgjegjshme të korporatave dhe GDP (PBB)/frymë për vërtetimin e hipotezës së kësaj pjese.

Në këtë pjesë të analizës, në raport me vendet e tjera në zhvillim, do shikojmë edhe rastin e Shqipërisë e cila edhe vetë si vend bën pjesë në vendet në zhvillim prej nga do t'i japim përgjigje pyetjes kërkimore që përmendëm dhe më lart : *A kemi një qeverisje të mirëfilltë të korporatave në Shqipëri në krahasim me vendet e tjera në zhvillim?* Në të njëjtën kohë do të vërtetojmë hipotezën: *“Qeverisja e korporatave në Shqipëri larg praktikave më të mira të publikuar dhe të rishikuara në kuadrin e krizës financiare nga OECD-ja krahasuar me vendet e tjera në zhvillim, është faktor ndikues dhe për zhvillimin ekonomik të vendit”*, duke realizuar një lidhje pozitive midis dimensioneve të nevojshme për të matur qeverisjen e përgjegjshme të korporatave ndërmjet vendeve të marra në studim dhe produktin e brendshëm bruto GDP (PBB), ku dihet që ky produkt është vlera e tregut e të gjitha mallrave dhe shërbimeve përfundimtare të njohura zyrtarisht që prodhohen brenda një vendi. PBB/frymë përdoret si një tregues i standardit material të jetesës së një vendi.

1.2 Teknika sasimore

Një nga strategjitë e kërkimit të përdorura për realizimin e studimeve është ajo e mbështetur nëurvejime dhe pyetësorë. Një teknikë kjo jo vetëm efikase por dhe profesionale për studime (Saunders *et al.*, 2009).

Gjithashtu sipas literaturës (Saunders, Lewis dhe Thornhill, 2009) anketimi është mënyra më efikase për të mbledhur të dhëna nga individë ose përfaqësi, me synim që të bëjë përgjithësim për popullsinë në tërësi. Për analizën e të dhënave të kapitullit të tretë e cila ka të bëjë me *qeverisjen e korporatave në shoqëritë që veprojnë në mjedisin ekonomik në Shqipëri* kemi realizuar shpërndarjen e pyetësorëve pranë disa bizneseve që operojnë në disa qytete. Konkretisht në qytetet e Shkodrës, Lezhës, Tiranës, Durrësit, Lushnjës, Vlorës, Sarandës, Shkodrës, Gjirokastrës, Elbasanit, Korçës. Shpërndarja e pyetësorëve pranë këtyre bizneseve u realizua nëpërmjet kontakteve personale si dhe duke përdorur postën elektronike si mënyra më e shpejtë e kontaktit. Për arritjen e objektivave të kësaj pjese të studimit u mendua të merret opinioni i specialistëve, aksionerëve, drejtuesve të korporatave në vend lidhur me qeverisjen e korporatave, veçanërisht në korporatat ku ata bëjnë pjesë, çështjet më të rëndësishme që lidhen direkt apo indirekt me to. Fakt real është se teknika sasiore analitike përdoret për të analizuar lidhjet dhe për të nxjerrë konkluzione nga të dhënat e fituara nëpërmjet pyetësorëve apo intervistave të strukturuar.

Kujt i është drejtuar pyetësori? Theksojmë se krahas informacionit të grumbulluar nga burime të ndryshme përsa i takon qeverisjes së korporatave, kryesisht në vendet në zhvillim, u krye një vërtetim për të marrë mendimin e drejtpërdrejtë të përfaqësuesve të këtyre korporatave në Shqipëri mbi qeverisjen në shoqëritë ku bëjnë pjesë. Në këtë vërtetim kanë marrë pjesë 119 shoqëri/biznese nga të cilët 76 i janë përgjigjur pyetësorit, 43 shoqëri nuk u përgjigjën, ndërkohë 11 shoqëri nuk e morën atë për neglizhencë. Të anketuarit, përfaqësues të bizneseve kanë qenë të gjinive, profesioneve dhe të grup-moshave të ndryshme të cilët mbanin pozicione kyçe në shoqëritë e tyre si menaxherë apo drejtues departamentesh, etj. Për të qenë sa më i suksesshëm vërtetimi, shpërndarja e pyetësorëve u bë e tillë që kampioni i përzgjedhur i këtij studimi të ishte sa më përgjithësues. Përsa i takon kualifikimeve, pjesa më e madhe tyre zotërojnë një diplomë të studimeve të ciklit të dytë dhe të tretë (68%), kryesisht në fushat financë, ekonomiks ose të menaxhimit. Një nga strategjitë e kërkimit të përdorura për realizimin e studimeve është ajo e mbështetur në vërtetime me pyetësorë e cila është një nga teknikat e mbledhjes së të dhënave që i përket kësaj strategjie. Përdorimi i strategjisë së vërtetimit mundëson mbledhjen dhe analizën sasiore të të dhënave duke përdorur statistikën përshkruese dhe atë analitike. Gjithashtu të dhënat e mbledhura nëpërmjet

kësaj strategjie mund të përdoren për të sugjeruar arsyetime të mundshme për lidhje të caktuara ndërmjet variablave dhe për të krijuar modele të këtyre lidhjeve. Metodën e arritjes së qëllimit të studimit janë nga më të ndryshmet duke parë dhe duke vlerësuar njëkohësisht avantazhet dhe disavantazhet e secilës prej tyre. Përdorimi i pyetësorëve si metodë për mbledhjen e të dhënave në këtë material mundëson jo vetëm analizimin e lidhjeve të mundshme ndërmjet variablave të marrë në studim, por jep mundësinë edhe të disa rekomandimeve lidhur me qeverisjen e korporatave. Gjithashtu gjatë hartimit të tij u bë kujdes që të mbaheshin parasysh dy elementë kryesorë si: besueshmëria, e cila ka të bëjë me faktin nëse pyetësi do të prodhojë ose jo rezultate të qëndrueshme në kohë të ndryshme dhe për zgjedhje të ndryshme, si dhe vlefshmëria e pyetjeve. Për të vlerësuar vlefshmërinë e përmbajtjes u përdor metoda e “panelit të ekspertëve”, të cilët morën pjesë në hartimin e pyetësorit. Pyetjet janë formuluar në mënyrë të tillë që të jenë sa më të kuptueshme nga i anketuari duke zgjedhur përgjigjen nëpërmjet alternativave të parashikuara në pyetësor, ku një pjesë është shkallëzuar sipas shkallës Likert (1 deri në 3) ku siç dihet në këtë shkallë subjektet tregojnë shkallën e pajtimit ose mospajtimit me secilën nga formulimet.

Gjatë hartimit të pyetësorit një rëndësi të veçantë ju kushtua jo vetëm strukturimit të pyetjeve por edhe formulimit të tyre në mënyrën e duhur në mënyrë që edhe përgjigjet të ishin të vlefshme dhe në dobi të synimit kryesor. Lidhur me testin e besueshmërisë, një mënyrë për t’u vlerësuar atë është matja e qëndrueshmërisë së brendshme, psh nëpërmjet llogaritjes së Koeficientit Cronbach Alfa. Bazuar në llogaritjet për koeficientët Cronbach Alfa për matjen e qëndrueshmërisë së brendshme të pyetësorit u arrit në konkluzionin se vlera e tyre ishte më e lartë se 0.7, (norma e lejuar) duke treguar qëndrueshmëri të pyetësorit. Duke ditur se secila nga pyetjet paraqet një variabël i cili mund të marrë më shumë se një përgjigje, është menduar që në pyetjet e mbyllura alternativat e përgjigjeve të jenë sa më reale në mënyrë që të merret informacioni i nevojshëm. Pyetësi (bashkëlidhur shtojca 5) përbëhet nga disa pjesë. Pjesa e parë (A) na siguron informacion të përgjithshëm mbi shoqërinë, duke përfshirë këtu vitet e aktivitetit, mënyrën e krijimit të shoqërisë, madhësia e saj në varësi të numrit të të punësuarve, njohuritë e tyre lidhur me *Kodin e Drejtimit të Brendshëm të Shoqërive Aksionere* etj. Pjesa e dytë (B) na siguron informacion lidhur me parimet e qeverisjes së korporatave (bazuar në manualin (kodin) e qeverisjes së korporatave), duke u fokusuar

në disa nga aspektet kryesore si – Të drejtat e aksionerëve (Kapitulli I), Roli i aktorëve në praktikat e qeverisjes së shoqërive (Kapitulli II), Transparenca & Zbulimi, (Kapitulli III), Roli dhe përgjegjësia e këshillave mbikëqyrës (Kapitulli IV), Detyrimet & Zbatimi (Kapitulli V), Njohuritë, Vlerësimet, Politikat dhe Pengesat (Kapitulli VI), Zbatimi i parimeve të brendshme për shoqëritë e paregjistruara në bursë si dhe politikat e mbrojtjes nga risku i krizës (Kapitulli VII). Të gjithë kapitujt sigurojnë një informacion të plotë lidhur me çështjet kryesore dhe pyetjet e ngritura për studim. Vrojtimi në terren zgjati rreth 10 javë, dhe intervistat u kryen nëpërmjet ballafaqimit ballë për ballë me të intervistuarin pasi marrja e përgjigjeve në rrugë elektronike nuk pati sukses. Mbështetur në neglizhencën që u vu re gjatë studimit, u pa e arsyeshme që shoqëritë të kontaktohen drejtpërsëdrejti dhe të dhënat janë marrë plotësisht nëpërmjet intervistave të drejtpërdrejta. Fakt real është që edhe në disa studime të ngjashme intervistimi ka rezultuar i suksesshëm kjo pasi përgjigjet me e-mail nuk janë dhënë nga i intervistuari. Pjesë e këtij procesi ishte krijimi i databazës me të dhënat e grumbulluara si dhe përpunimi dhe analiza statistikore e tyre. Crosstabulation, frequencies, correlation u realizuan nëpërmjet paketës statistikore SPSS 17 dhe programit Excel (opsioneve statistikore). Analiza e të dhënave është kryer nëpërmjet analizës deskriptive, tabelave të kryqëzuara, testeve të pavarësisë, korrelimet midis variablave, ndërtimit dhe shqyrtimit të hipotezave etj. Pra, jo vetëm një analizë përshkruese por edhe një analizë analitike. Pyetësi u testua paraprakisht në 10 biznese. Rezultati i testit tregoi se pyetjet e pyetësit ishin të formuluar saktë dhe të qarta për t'u kuptuar. Në këtë kapitull do t'i japim përgjigje pyetjes kërkimore: *Në cilën fazë ndodhet qeverisja e korporatave mbështetur në analizën e disa shoqërive që veprojnë në Shqipëri?* si dhe do të vërtetojmë hipotezën: *“Nëse shoqëritë në Shqipëri në përgjithësi në aktivitetin e tyre nuk do të zbatojnë të paktën ato parime që janë publikuar në kode apo manual atëherë nuk do të kemi një qeverisje efektive korporate dhe për rrjedhojë kultura e qeverisjes do të jetë e reduktuar vetëm në disa shoqëri dhe jo më gjerë”*. Edhe në këtë pjesë të analizës për shoqëritë shqiptare kemi ndjekur të njëjtën rrugë për të përcaktuar indeksin e qeverisjes së përgjegjshme të korporatave (si indeks i përbërë nga nën-indekse) ku së pari, kemi identifikuar dimensionet e nevojshme (D) për të matur qeverisjen e përgjegjshme të korporatave (GCR) duke vijuar me hapat e tjerë që i kemi përmendur më lart dhe për vendet evropiane në zhvillim dhe do i shohim konkretisht më poshtë të

analizuar. Përpara fillimi të analizës mbajtem parasysh faktin se shoqëritë me kapital të lartë dhe qarkullim të lartë në përgjithësi janë shoqëri të mirëstrukturuara. Shoqëri të mëdha shqiptare, edhe pse të dobësuar nga viti i 5-të radhazi i krizës së pas 2008-ës vijojnë të përpiqen për të mbijetuar, të përshtaten, sofistikohen dhe të konkurojnë në treg. Kështu për vitin 2013 shoqëria e parë në renditje është Bankers Petroleum Ltd, me një qarkullim vjetor rreth 484 milionë euro ndjekur nga shoqëria Kastrati Sha, operator në tregtimin e karburanteve, me xhiro vjetore 457 milionë euro. Struktura e kapitalit, sipas Margaritis & Psillaki (2010) i referohet strukturës së borxhit dhe të kapitalit të mbajtur nga një firmë veçanërisht në terma afat-gjatë. Gjithashtu Margaritis & Psillaki (2010) argumentojnë se është e rëndësishme për të gjetur një strukturë optimale të kapitalit ose kombinim optimal të borxhit dhe të kapitalit në mënyrë që kjo strukturë të maksimizojë vlerën e firmës. Qeverisja e korporatave ndihmon për të siguruar një përdorim eficient të kapitalit nga korporatat. Gjithashtu qeverisja e mirë e korporatave ndihmon edhe faktin që ato të marrin në konsideratë interesat e një diapazoni të gjerë aktorësh si edhe komunitetit në të cilën ato operojnë dhe që bordet të jenë përgjegjës para shoqërisë dhe aksionerëve. Kjo nga ana e vet ndihmon që korporatat të operojnë në të mirë të shoqërisë si një e tërë. Ajo ndihmon për ruajtjen e besimit të investitorëve vendas dhe të huaj dhe të tërheqë kapitalin afatgjatë (OECD, 1999). Qeverisja e korporatave gjatë dy dekadave të fundit është bërë gjithnjë e më e rëndësishme si dhe e debatueshme. Krizat financiare kanë nxjerrë në pah si një prej shkaqeve kryesore qeverisjen e dobët të korporatave, ndaj dhe bizneset “duke nxjerrë mësim” duhet të bëhen shumë më të ndjeshme në këtë drejtim për të mos “ndjerë” më pasoja negative, pasi kriza financiare vazhdon të mbetet prezent, pra nuk ka kaluar plotësisht. Sipas Weston & Brigham (1992), kapitali optimal është ai që maksimizon vlerën e tregut të aksioneve të firmës ndërsa Graham & Harvey (2001) sugjerojnë se firmat duhet të identifikojnë strukturën e tyre optimale të kapitalit dhe të përpiqen për ta arritur dhe për ta mbajtur atë. 76 shoqëritë e studimit tonë, të cilët dhanë përgjigje të plotë (përfshirë këtu të gjithë shoqëritë 119), janë shoqëri me qarkullim kapitali të lartë, të zgjedhur që në vitin 2012 të cilat operojnë suksesshëm në treg në Shqipëri. Arsyeja e kësaj përzgjedhje është se shoqëritë me qarkullim kapitali më të lartë kanë mundësi, ose më saktë prirjen për të zbatuar parimet qeverisjes së korporatës, në mënyrë që të kenë ecuri të mirë në treg dhe të mbajnë dhe/ose rrisin pozicionin e tyre e për rrjedhojë fitimet. Të

dhënat e përgjithshme publike për bizneset ku bëjnë pjesë: numri i shoqërive, statusi apo forma ndodhen në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR), të cilët lidhen me emrat e individëve të regjistruar si aksioner, administrator/drejtor ekzekutiv për të gjitha tipet e shoqërive përfshirë këtu edhe dy llojet më të rëndësishme, atë anonime – Sh.a – dhe të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar – Sh.p.k – si dhe të dhënat e kontaktit për shoqëritë përkatëse. Për qëllimin e studimit në Korrik të vitit 2012, kur filluam punën hulumtuese, ju drejtua QKR-së për informacion, ku pas mbledhjes së të dhënave për listën e shoqërive dhe vendndodhjen e tyre mbështetur dhe në informacione për qarkullimin e tyre (xhiron vjetore që realizojnë) morëm edhe mendime informuese dhe teknike mbi shoqëritë për të patur mundësi për t’ju drejtuar atyre. Gjithashtu me sa mundësi u krijuan morëm informacion dhe prej Drejtorive Rajonale Tatimore, ku siç dihet këtu është një pjesë e vështirë për informim në kuadër dhe të konfidencialitetit, pikërisht ku ata bëjnë pjesë si DRT, p.sh Tiranë, Durrës etj. Kontaktova gjithashtu për disa informacione dhe QKL-në.

1.2 Arsyet e zgjedhjes së pyetësorit si metodë për mbledhjen e të dhënave

Përdorimi i metodave kërkimore është i një rëndësie të veçantë sidomos sot ku përzgjedhja e përpunimi i informacionit është gjithmonë e më i vështirë, për shkak të shtimit dhe rritjes së frekuencës së këtij të fundit. Konkretisht, përdorimi i strategjisë sëurvejimit mundëson mbledhjen dhe analizën sasiore të të dhënave duke përdorur statistikën përshkruese (deskriptive) dhe atë inferenciale (representative), dhe padyshim kjo strategji është një mënyrë efikase rekomanduar nga literatura mbi metodologjinë e kërkimit (Saunders et al., 2000 & Brace, 2004). Gjithashtu të dhënat e mbledhura nëpërmjet kësaj strategjie mund të përdoren për të sugjeruar arsye të mundshme për lidhje të caktuara ndërmjet variablave dhe për të krijuar modele të këtyre lidhjeve (Saunders et al., 2009: 144). Zgjedhja e metodologjisë kërkimore që do të përdorej në këtë punim ishte një sfidë më vete, aq më tepër duke ditur rëndësinë e instrumenteve kërkimore dhe lidhjen që kanë këto me cilësinë e punimit. Sipas Khandwalla (1976) nuk ka një metodë kërkimi që mund të konsiderohet si më e mira. Secila nga metodat e përdorura shoqërohet me avantazhe dhe disavantazhe. Zgjedhja e metodës mund të bëhet duke u mbështetur në disa kritere. Për shembull Khandwalla (1976) përdor si kritere për të krahasuar metodat e kërkimit: kontrollin mbi variablat, përgjithësimin e të

dhënave, vlefshmërinë e matjes, shpejtësinë dhe lehtësinë për përdorimin e metodës. Mundësia për të përgjithësuar të dhënat duke përdorur metodën e kërkimit me pyetësorë vlerësohet e lartë në rastin e pyetësorëve. Si rezultat, përdorimi i pyetësorëve si metodë për mbledhjen e të dhënave në këtë punim mundëson hetimin e lidhjeve të mundshme ndërmjet variablave të marrë në studim. Lënia e kohës së mundshme për plotësimin e pyetësorit ka ndikuar në dhënien e përgjigjeve të sakta. Theksojmë se duke ditur numrin e pyetësorëve dhe duke u kujdesur që në to të shkruhej realiteti, mendoj se edhe përqindja e gabimeve është e papërfillshme.

1.3 Përcaktimi i mostrës dhe procedura e mbledhjes së të dhënave

Qëllimi kryesor ishte mbledhja e të dhënave nga këto biznese për të kuptuar mënyrën se si realizohet qeverisja e korporatave në shoqëritë shqiptare. Për shpërndarjen e pyetësorit u mendua të përdoren dy mënyra: shpërndarja e pyetësorëve pranë bizneseve nëpërmjet kontakteve personale dhe shpërndarja nëpërmjet postës elektronike, por mënyra e dytë nuk rezultoi efikase për arsye se bizneset nuk u përgjigjen ashtu siç pritej, ndoshta për mungesë kohe, ndoshta për neglizhim apo mosdhënie informacioni si sekret, pasi konsiderohej prej tyre konfidencial (ky është një dizavantazh i mbledhjes së të dhënave me anë të pyetësorit, kryesisht në rrugë elektronike). Pyetësorët u shpërndanë në qytetet Shkodër, Durrës, Lezhë, Tiranë etj, pasqyruar kjo në grafikët dhe tabelat e shtojcës 1. Kampioni i këtij studimi përbëhet: gjithsej 119 pyetësorë nga ku në fund morëm për përpunim 76 pyetësorë. Kampioni i përdorur në studim në këtë mënyrë është i pranueshëm pavarësisht se mund të konsiderohet i vogël. Pikërisht edhe këtë mund ta konsiderojmë një ndër kufizimet e këtij punimi. Megjithatë ajo mund të konsiderohet përfaqësuese nëse marrim në konsideratë raportin ‘numër përgjigjesh/variabël’. në momentin fillestar, të nisjes së punës duke marrë për bazë numrin e shoqërive që mendohej se do sillnin përgjigje, ajo përfaqësonte afërsisht 10% të totalit të shoqërive aktive. Sipas informacionit të marrë nga QKR-ja numri i shoqërive anonime deri në Korrik 2012 aktive ishte 1225 gjithsej (1146 sh.a aktive nga 3.9.2007-dhjetor 2010 sipas raportit të QKR-së, Malltezi. A, 2011).Ndërkohë një klasifikim i hollësishëm për të gjitha tipet e shoqërive jepet gjithashtu në grafikët dhe tabelat e pasqyruara në shtojcën 1 të punimit. Në këtë shtojcë grafiku 1 tabela 1, pasqyrojnë ndarjen e pyetësorit sipas qyteteve, grafiku 2 tabela 2, shoqëritë, pra shoqëritë anonime

që nuk i janë përgjigjur pyetësorit të studimit, grafiku 3 tabela 3, shoqëritë (shoqëritë anonime) që i janë përgjigjur pyetësorit, grafiku 4 tabela 4, ndarjen e shoqërive sipas aktivitetit, grafiku 5 tabela 5, shoqëritë e grupuara sipas aktivitetit, grafiku 6 tabela 6, ndarja sipas prefekturave, grafiku 7 tabela 7, pasqyron numrin e shoqërive kolektive, grafiku 8 tabela 8, pasqyron numrin e shoqërive komandite, grafiku 9 tabela 9, pasqyron shoqëritë me partner të huaj, grafiku 10 tabela 10, pasqyron shoqëritë aktive (sh.a) sipas rretheve, grafiku 11 dhe grafiku 12, pasqyrojnë statusin dhe numrin e shoqërive anonime, tabela 11 shoqëritë anonime vetëm si numër gjithsej, grafiku 13 tabela 12, pasqyrojnë numrin e degëve për shoqëritë e huaja, grafiku 14 tabela 13, pasqyrojnë numrin e degëve sipas statutit dhe së fundi për këtë shtojcë (shtojca1) grafiku 15 tabela 14, pasqyron numrin e shpk-ve sipas qyteteve ku ato ndodhen.

KAPITULLI II

RISHIKIMI I LITERATURËS MBI QEVERISJEN E KORPORATAVE.ASPEKTET THEMELORE TË QEVERISJES SË KORPORATAVE

Në këtë kapitull trajtohen konceptet teorike të punimit. Synimi kryesor i këtij kapitulli është pasqyrimi i bazës teorike të punimit për qeverisjen e korporatave parë nën këndvështrimin e kërkimeve të realizuara nga studiues apo studime të ndryshme. Në ditët e sotme korporatat si entitete ligjore me profile të ndryshme luajnë një rol të madh në jetën ekonomike dhe sociale kudo ku ato kanë shtrirë aktivitetin e tyre të biznesit. Korporata është forma dominante e organizimit të firmave, në lidhje me fitimin neto. Angazhojnë në punë në pjesën më të madhe të rasteve për të maksimizuar fitimet e tyre miliona e miliona njerëz dhe kanë në përbërje nga një në shumë aksionerë. Aktivitetet e tyre ndikojnë në jetën e secilit punonjës. Termi korporatë në një përkufizim është përcaktuar në këtë mënyrë: “Një korporatë është një qenie artificiale e padukshme, e paprekshme që ekziston vetëm në sajë të respektimit dhe të sositjes së ligjit” (Financial Management, George A. Aragon 1987). Duke qenë se korporata është një qenie artificiale shpesh njerëzit i referohen asaj si qenie reale. Ajo ka fuqinë e qenies njerëzore ndaj ajo mund të ndjekë e mund të ndiqet, ajo mund të bëjë pjesë dhe të marrë pjesë në kontratat që përpilon e nënshkruan dhe njeh pronësinë në emër të saj.

Qeverisja e korporatave është bashkudhëtare e qenies së ekzistencës së korporatave, ajo i referohet strukturave dhe procedurave për drejtimin dhe kontrollin e shoqërive tregtare, duke vështuar në mënyrë strategjike marrëdhëniet ndërmjet drejtorëve, pronarëve/aksionerëve dhe partnerëve të tjerë – Komiteti Cadbury (Britaninë e Madhe). Studimet mbi qeverisjen e korporatave tregojnë se shoqëritë përdorin forma dhe aftësi për të menaxhuar dhe padyshim që qeverisja është një përbërës i rëndësishëm i aftësisë së organizatës për të konkuruar me sukses (Burnes, 2009). Të qeverisësh me efektivitet duhet të mbështetesh mbi baza të qëndrueshme dhe të specifikuara qartë në organizata (Velnampy & Prathëpkanth, 2014). Qeverisja e një korporate është art më vete dhe kërkon krahas vizionit dhe kapacitete dhe aftësi si binom ky në unison (Judge & Douglas, 2009).

Qëllimi i këtij kapitulli është të eksplorojë literaturën mbi qeverisjen, për të krijuar bazat për ndërtimin e modelit të propozuar. Rishikimi i literaturës fillon me qeverisjen, çfarë përfaqëson ajo, përkufizime të ndryshme, nga ku kemi vënë re që nuk ka një përkufizim të vetëm mbi qeverisjen, duke vazhduar në pjesën e dytë me teoritë e modelet kryesore të qeverisjes së korporatave.

2.1 Qeverisja e korporatës parë në këndvështrime të ndryshme nga literatura

Identifikimi i parimeve kryesore për qeverisje të suksesshme sipas parimeve të qeverisjes në përgjithësi ka të bëjë me standarde të larta qeverisje për ruajtjen e besimit publik, nevoja për përmirësim të vazhdueshëm në një botë në ndryshim.

Në këtë fillim shekulli të ri ekonomia botërore po pëson ndryshime rrënjësore jo vetëm me ritme marramendëse të zhvillimit, por njëkohësisht edhe me mekanizmat e funksionimit dhe në filozofinë e saj. Në radhë të parë dhe në mënyrë më të dukshme shfaqet i ashtuquajti “ globalizim ekonomik”, i lidhur ngushtë me përhapjen në shkallë botërore të shërbimeve, lëvizjen e kapitalit, të fuqisë punëtore, të inovacioneve, krijimin e tregjeve globale, të zgjerimit të firmave dhe shoqërive multinacionale dhe i produkteve “made in world” etj. Globalizimi në ditët e sotme ka përfshirë ndër të tjera edhe prodhimin e mallrave dhe shërbimeve. Në këtë kuadër mund të themi që globalizimi, nevoja për t’ju përgjigjur më shpejt kërkesave në rritje të konsumatorit për mallra dhe shërbime (orientimi nga konsumatori si objektiv strategjik), shkrirjet dhe blerjet, inovacioni, teknologjia, riorganizimi, rënia e shitjeve ose pjesës së tregut etj, janë disa nga faktorët që nxisin nevojën për një qeverisje të efektshme në korporata (Victor & Franckeiss, 2002; Cao et al., 2003; Clegg & Walsh, 2004; Stanleigh, 2008). Studimet tregojnë se gati 60% e korporatave dështojnë për efekt të keqmenaxhimit (Kotter 1996; Bër & Nohria 2000; Boonstra 2004; Balogun & Hope Hailey 2008; Judge & Douglas, 2009).

Qeverisja e Korporatave i referohet strukturave dhe procedurave për drejtimin dhe kontrollin e shoqërive tregtare, duke vështuar në mënyrë strategjike marrëdhëniet ndërmjet drejtorëve, pronarëve/aksionerëve dhe partnerëve të tjerë – bazuar në Komitetin Cadbury (UK) dhe parimet e OECD-së. Parimet e OECD-së për Qeverisjen “mbështetin raportimin e njëkohshëm të informacionit për të gjithë aksionerët në mënyrë që të sigurohet trajtimin i barabartë i tyre. Për të mbajtur marrëdhënie të ngushta

me investitorët dhe pjesëmarrësit e tregut, shoqëria duhet të jetë e kujdesshme që të mos shkelet parim themelor i “trajtimit të barabartë”.

Praktikat e mira të qeverisjes së korporatave të integruara në objektivat e biznesit hapin “dritën e gjelbër” për shoqëritë tregtare dhe institucionet financiare që ata të përparojnë dhe arrijnë qëllimet e tyre. Qeverisja e korporatave është tërësia e proceseve, zakoneve, politikave, ligjeve dhe institucioneve, që ndikojnë në mënyrën se si drejtohen subjektet e biznesit, si administrohen e kontrollohen ato, për më tepër një sistem i tillë korporativ është thelbësor për të inkurajuar investitorët dhe investimet. Edhe pse disa shtylla mbi të cilat mbështetet qeverisja e korporatave janë të përfshira në ligje dhe rregullore, qeverisja e korporatave është shumë më tepër se thjesht pajtim dhe harmonizim me standardet e përgjithshme.

Qeverisja e korporatave sjell përfitime të vërteta për shoqëritë dhe institucionet financiare ndërsa parashtron një kuadër të qartë për përcaktimin dhe arritjen e objektive të korporatës. Praktikrat e mira të qeverisjes së korporatave në mjaft shoqëri ndërkombëtare janë të integruara në objektivat e biznesit, duke lejuar shoqëritë tregtare dhe institucionet financiare të përparojnë dhe arrijnë qëllimet e tyre. Përmendim shoqëri që zënë peshë të konsiderueshme tregu si : Vodafone Albania, AMC, Raiffeisen Bank, BKT, ProCredit Bank, Eagle Mobile, Plus Communication (në fushën e bankave BKT zë 23% të tregut, Raiffeisen Bank po ashtu 23% të tregut dhe së bashku me Credins Bank 55% të tregut ose industrisë bankare ose rreth 50% të GDP-së).

Në lidhje me qeverisjen e korporatës nuk kemi një përkufizim standard, aq më tepër ajo mund të shihet nga këndvështrime të ndryshme, por ato variojnë sipas konceptit të autorëve të ndryshëm duke konvergjuar në një pikë, në atë të drejtimit të brendshëm efektiv të shoqërisë për të arritur rezultate të kënaqshme financiare. Funksionim i strukturave dhe mekanizmave të brendshëm drejt atyre që ekonomistët neoklasikë e quajnë “kënaqësi për ata që investojnë paranë e tyre”.

Një përkufizim që përdoret gjerësisht në literaturë është bërë nga Komiteti Cadbury (Mallin, 2007): "sistemi me të cilin shoqëritë janë të drejtuara dhe të kontrolluara". Pavarësisht sa më sipër, përkufizimet për Qeverisjen kanë disa elementë të përbashkët si më poshtë: Keasy & Wright e përcakton Qeverisjen si “strukturat, proceset, kultura dhe sistemet, të cilat bëjnë të mundur operimin e suksesshëm të organizatave”. Qeverisja e korporatave sipas IFC-së është një sistem marrëdhëniesh, të përcaktuara nga strukturat

dhe proceset: Marrëdhëniet midis aksionerëve dhe menaxhimit konsistojnë në sigurimin e kapitalit, përdorimin e tij siç duhet do të sigurojë (do të sjellë) një kthim më të lartë të investimeve të aksionerëve (ROE).

Shleifer & Vishny (1997) vënë theksin në faktin se qeverisja e korporatave lidhet me mënyrën se si “ofruesit e burimeve” dhe investitorët financiarë sigurojnë rentabilitetin e investimeve të tyre. Qeverisje korporate do të thotë: "leadership, struktura dhe procese organizative të cilat ndihmojnë arritjen e funksioneve të organizatës, mbështesin dhe zgjerojnë objektivat si dhe ndihmojnë në të njëjtën kohë në zbatimin efektiv të strategjisë së saj. E thënë më thjesht, ajo përfaqëson kulturën, politikën, procedurat dhe kontrollat që ndihmojnë një shoqëri për të përmbushur qëllimet e saj të biznesit"(Lamm, 2010), "një sistem i rregullave dhe normave, i institucioneve ose natyrës së tregut, brenda të cilit kategori të ndryshme të palëve të interesuara (stakeholders), aksionerëve, menaxhimit, administrimit publik, stafit, klientëve, furnizuesve, etj, ku ato lindin ose zhvillohen" (Bostan & Bostan, 2010), "një koncept që përfshin një gamë të gjerë të aktiviteteve, rregullave, proceseve dhe procedurave të dizenuara për të siguruar përdorimin optimal të burimeve dhe strategjive të korporatës në mënyrë që ajo të përmbushë objektivat e veta "(Dobroteanu *et al.*, 2011).

Një seri modelesh të qeverisjes së korporatave janë individualizuar në literaturën shkencore akademike. Albert (1993) dallon dy modele të qeverisjes së korporatave: modelin e vlerës aksionere (modeli anglo-sakson) dhe të modelin e grupeve të interesit (modeli Rhineland). De Jong (1997) konsideron se ka tre modele alternative të qeverisjes së korporatave: amerikan (anglo-sakson ose sistemit të orientuar drejt tregut), kontinental (sistemi gjerman apo sistemit të rrjetit të orientuar) dhe latin (të përfaqësuar nga shoqëri nga vendi si : Italia, Franca, Spanja, etj). Yoshimori (1995) beson se ne mund të identifikojmë tre koncepte të ndryshme në lidhje me qeverisjen e korporatave: "monistike, dualiste dhe pluraliste". Në një tjetër vizion (Bostan & Bostan 2010) dy modelet e qeverisjes së korporatave janë : modeli i "sistemit të brendshëm" dhe modeli i "sistemit të jashtëm".

Zingales (1998) përcakton qeverisjen e korporatës si "ndarjen e pronësisë, strukturës së kapitalit, skemave stimuluese menaxheriale, sipërmarrjes, bordit të drejtorëve, strukturës organizative” etj. Garvey & Swan (1994) pohojnë se "Qeverisja përcakton se sa vendimmarrësit e lartë (drejtuesit) në të vërtetë janë të aftë për të administruar

kontrata të ndryshme”. Shleifer&Vishny (1997) përcaktojnë qeverisjen si "mënyrat në të cilat ofruesit e financimeve të korporatave sigurojnë vetveten për të marrë një kthim të investimit të tyre”.Keasy&Wright (1993) qeverisjen e përcaktuan si “strukturat, proceset, kultura dhe sistemet, të cilët bëjnë të mundshme operimin e suksesshëm të organizatave”.

Oman (2001) qeverisjen e korporatave e përkufizon si term që i referohet institucioneve private dhe publike dhe që rregullohen nga ligjet, rregulloret dhe praktikat e biznesit. Monks & Minow (2001) e përkufizojnë si “marrëdhëniet ndërmjet pjesëmarrësve të ndryshëm në përcaktimin e drejtimit të performancës së korporatave. Pjesëmarrësit kryesorë janë: 1-aksionerët, 2-menxhimi dhe 3-bordi i drejtorëve”. Monks & Minow (2008) shprehen se “qeverisja e korporatave është mekanizmi me të cilin ne trajtojmë rebusin themelor të kapitalizmit : kostot e agjencisë”. Robert Monks dhe Nell Minow janë bërë tashmë “dekanë” ose thënë ndryshe “të pandashmit e ideve të fushës së qeverisjes së korporatave”, pasi kanë mbi 30 vjet që kontribuojnë në këtë fushë. Ata kanë ndihmuar ndjeshëm aksionerët ndaj konfliktit të interesit i cili ndodh atëherë kur shefi ekzekutiv i një shoqërie gjithashtu shërben dhe si kryetar i bordit të saj, të bordit që është menduar për të mbikëqyrur CEO-të. Kohë para krizës financiare, ata kritikuan paketat e pagave afat-gjata thuajse për të gjithë drejtuesit që i përfitojnë ato. Sipas tyre “Paga e CEO-ve mund të barazohet me një termometër, çka do të thotë përfitim sipas asaj që ata kontribuojnë. Në një situatë në të cilën, në thelb, njerëzit paguajnë vetveten, pa iu referuar historisë apo vlerës së shtuar, ose ndonjë kriteri objektiv, nuk do të kemi progres në lidhje me menaxhimin, veçanërisht me pjesën e të qenit të përgjegjshëm”. Madje për skemat e shpërblimit të menaxherëve, arsyetimi i teorisë së agjencisë është që stimujt financiar ofrojnë shpërblime dhe dënime, duke synuar harmonizimin e interesave primar-agjent. Duhet theksuar se Monks dhe Minow kanë ndihmuar jo vetëm kohët e fundit por dhe më parë dialogun e hapur për gamën e qeverisjes së korporatave, por ne duhet të pranojmë, shprehen ata, se nuk duhet të mbetet i paprekur roli i shefit ekzekutiv për të emëruar në bord njerëz të tjerë nga ata të nominuarit për anëtarë bordi, dhe pikërisht ai (shefi ekzekutiv) të dominojë të drejtat e bordit duke përfshirë dhe pagesën e vetvetes (Kathlën Day, Special for “USA Today”,2014). Për strukturat qeverisëse, theksohet se bordi i drejtorëve mban nën kontroll menaxherët me anën e auditimit dhe të vlerësimit të performancës. Bordi gjithashtu, ju komunikon

menaxherëve objektivat e aksionerëve dhe i monitoron ata, me qëllim që të mbajë nën kontroll kostot e agjencisë. Primari, ka kosto të mbikëqyrjes dhe kontrollit të agjentit (Whëler D,Colbert B,Frëman R.E (2002)). Monks, shprehet se gjithë nocioni i qeverisjes së korporatave është bazuar në idenë e funksionimit të një korporate si një entitet me rregulla të caktuara, çka do të thotë funksionim sipas një sistemi të strukturuar në të gjitha hallkat. Në 30 vitet e fundit, vërtet ne kemi parë një shkallë globalizimi që nuk të besohet, por nuk ka një ligj ndërkombëtar për qeverisjen e korporatave. Stadi ndërkombëtar përfshin kodet dhe marrëveshjet e tregtisë por jo të drejtën ndërkombëtare të qeverisjes së korporatave (“USA Today”,2014”). La Porta, Silanes dhe Shliefer (2000, 2002) e shohin qeverisjen si një grup i mekanizmave nëpërmjet të cilave investitorët e jashtëm (aksionerët) mbrojnë veten e tyre nga të brendshmit (menaxherët). Organizata për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik (OECD) 2009, jep një tjetër perspektivë duke deklaruar se "qeverisja e korporatave është sistem me të cilin korporatat e biznesit janë të drejtuara dhe të kontrolluara. Struktura e qeverisjes së korporatave përcakton shpërndarjen e të drejtave dhe përgjegjësi ndërmjet pjesëmarrësve të ndryshëm në korporatë, të tilla si bordi drejtues, menaxherët, aksionerët dhe aktorët e tjerë si dhe parashikon rregullat dhe procedurat për marrjen e vendimeve në vendin e duhur dhe kohën e duhur për çështjet e korporatave. Duke bërë këtë, ajo gjithashtu siguron strukturat përmes të cilave shoqëria vendos objektivat dhe mjetet e arritjes së këtyre objektivave dhe monitorimin e performancës”. Sipas OECD-së qeverisja e korporatave lidhet me mënyrat e brendshme, me anën e të cilave operojnë dhe kontrollohen korporatat. Ndërsa qeveritë luajnë një rol qendror në trajtën që merr kuadri ligjor, institucional dhe rregullator brenda së cilës zhvillohen sistemet e qeverisjes së korporatave, përgjegjësia kryesore bie mbi sektorin privat. “Candbury Report” thekson se qeverisja e korporatave mund të konsiderohet tërësia e rregullave që përcaktojnë marrëdhëniet ndërmjet aksionerëve, menaxherëve, kreditorëve, qeverisë, punonjësve dhe pretendentëve të tjerë të brendshëm dhe të jashtëm në lidhje me të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, ose si sistemi me anën e të cilit drejtohen dhe kontrollohen shoqëritë. Theksi kryesor i raportit Candbury ishte në efektivitetin e bordeve të drejtorëve në shoqëritë e listuara. Sipas literaturës akademike, ndarja e rolit të kryetarit dhe shefit ekzekutiv është një nismë e qeverisjes së korporatave e cila nga ana e saj mund të zvogëlojë problemet e agjencisë dhe pikërisht

kjo ndarje të rezultojë në vijim me përmirësim të performancës së korporatave për arsye se i bën më të pavarur vendimmarrjet e ndryshme brenda saj (Donaldson & Davies, 1994). Problemet e agjencisë mund të pakësohen nga mekanizmat që ndihmojnë monitorimin e bordeve në mënyrë që të ndërthuren interesat e aksionerëve me menaxhimin. Disa studime kanë treguar se ndarja sjell në të vërtetë një performancë të lartë financiare (Pël & O'Donnell 1995). Megjithatë provat në praktikë nuk ishin në mënyrë të mjaftueshme bindëse (The Daily Dalton, 1997).

2.2 Evoluimi i literaturës së qeverisjes së korporatës. Roli i bordeve.

Literatura ekonomike sot është fokusuar në marrëdhënien e menaxhimit të lartë, performancës financiare të korporatave dhe futjen e nismave të qeverisjes së tyre. Mekanizma të mirë të qeverisjes së korporatave, role të ndarë apo një ekuilibër ndërmjet drejtorëve ekzekutivë dhe jo ekzekutivë, bëjnë të mundur më shumë monitorim efektiv të menaxhimit. Lëvizjet e shpeshta të drejtorëve jo gjithmonë mund të shoqërohen me zëvendësim të menaxhereve jorezultativ. Shoqëritë me menaxhimin të lartë, mekanizma të mirë të qeverisjes së korporatave dhe të anëtarëve të bordit janë më efektive në treg dhe shfaqin performancë financiare të lartë në krahasim me shoqëritë e tjera që nuk realizojnë këtë gjë. Bazuar, mbi këto supozime, në analizat e tyre Dahya *et al.*, 2002 kanë gjetur se qarkullimi menaxhereve të lartë ishte më i madh se më parë, por vetëm në shoqëritë që kanë ndryshuar strukturën e tyre të bordit (ky rezultat i kohës së raportit Candbury). Ata gjithashtu kanë gjetur se qarkullimi i menaxhimit të lartë ishte statistikisht i lidhur me performancën financiare të varfër, për një grup të gjerë të shoqërive në Mbretërinë e Bashkuar në kohën e këtij raporti.

Gjithashtu autorët e mësipërm theksojnë se numri i aksioneve dhe kontrolli mbi menaxhimin e korporatës janë në përpjesëtim të drejtë, gjë që do të thotë se sa më pak aksione të zotërojë një aksioner aq më i vogël do të jetë dhe kontrolli mbi punën e menaxherëve në korporatë. Një korporatë me aksionerë dispersë (të shpërndarë), nuk mund të ketë fuqi kontrolluese menaxheriale, gjë që do të thotë që menaxhimi mund të mos arrijë objektivin e maksimizimit të fitimit dhe për rrjedhojë menaxherët të cilët kontrollojnë korporatën (të cilëve ju janë dhënë të drejta kontrolli) nuk kanë pasoja të rënda financiare, që mund të vijnë nga veprimet e tyre, sikurse kanë aksionerët që në

rast falimentimi humbin kapitalin e investuar. Ky botim klasik vazhdon të ketë interes në fushën e qeverisjes së korporatave.

Përqendrimi i pronësisë apo shpërndarja e saj si dilemë, kanë gjetur pasqyrime të ndryshme në literaturë. Kështu, përqendrimi i pronësisë është shqetësues për disa autorë (De Miguel *et al.*, 2005), ndërsa mjedisi institucional për mbrojtjen e investitorëve ka gjetur përkrahje nga disa të tjerë (Shleifer & Vishny, 1997; La Porta *et al.*, 1998; 1999; 2000; Pedersen & Thomsen, 1999; Denis & McConnell, 2003; Durnev & Kim, 2005), dhe në varësi të faktorëve politikë dhe social-kulturore, vende të ndryshme kanë raportuar efekte të ndryshme të qeverisjes së korporatave në suazën e firmës (Pagano & Volpin, 2001; Klapper & Love, 2004). Në Spanjë p.sh, disa studime, raportuan një efekt pozitiv të përqëndrimit të pronësisë mbi performancën, por Demsetz & Lehn's (1985) vëzhguan se struktura e pronësisë mund të jetë endogjene (që varet nga faktorët e brendshëm), ku shumica e rezultateve të të dhënave duhet të trajtohen me kujdes në varësi dhe të kufizimeve metodologjike të përdorura. Qeverisja e korporatave duhet parë në marrëdhëniet midis firmës dhe të gjithë aktorëve (pretendentëve) të saj, dhe jo vetëm aksionerëve, pasi firma vepron si një njësi e një entiteti më të madh social. Në mesin e viteve 80-të u zgjeruan kërkimet mbi qeverisjen e korporatave. Madje Baysinger & Butler (1985) por dhe Romano (1985) nën termin qeverisje e korporatës analizuan efektin e ndryshimeve në përbërjen e bordit mbi performancën e korporatës, rolin e drejtorëve të jashtëm, strukturës së pronësisë etj.

Në fushën e qeverisjes së korporatave marrëdhëniet brenda strukturave rregullohen nga teoria e agjencisë e cila argumenton se interesat e aksionerit kërkojnë mbrojtje nga ndarja e roleve të kryetarit të bordit dhe CEO-së ndërsa teoria e kujdestarisë (stewardship theory) argumenton se interesat e aksionerit janë të maksimizuara nga mbajtja e postit të përbashkët të këtyre roleve që përmendëm. Ndonëse teoria e kujdestarisë është rezultati i reagimit drejt teorisë së agjencisë, të dyja teoritë kanë shumë të përbashkëta. Ashtu si tek teoria e agjencisë, fokusi i teorisë së kujdestarisë është ndarja ndërmjet pronësisë dhe kontrollit dhe mbi marrëdhënien ndërmjet principalit dhe agjentit (Tosi, Brownlë, Silva, & Katz, 2003). Teoria e kujdestarisë trajton interesin e aksionerit, por nëse do ti referohemi rolit të pushtetit që ushtron menaxheri kjo teori presupozon që menaxheri përdor pushtetin personal të ekspertit dhe referentit (Tosi *et al.*, 2003). Megjithatë të dyja këto teori ndryshojnë në një aspekt të rëndësishëm që është pikëpamja mbi motivimin

njerëzor dhe rolin e menaxherit. Teoria e agjencisë në arsyetimin e saj nisët nga përdorimi i pushtetit institucional, pra të pushtetit legjitim shtrëngues dhe shpërblyes në lidhje me pushtetin e menaxherit (Tosi *et al.*, 2003). Ndërsa teoria e agjencisë i sheh qeniet njerëzore, të qenit përfitues, teoria e kujdestarisë, e bazon këndvështrimin mbi teoritë e psikologjisë dhe sociologjisë, dhe i sheh qeniet njerëzore si komplekse (Donaldson, 1990). Relacioni primar-agjent është marrëdhënie besimi sipas kësaj të fundit ndërsa sipas asaj të agjencisë marrëdhënie kontrolli. Sipas teorive moderne të financave të korporatave, kosto agjencisë është një nga përcaktuesit e strukturës së kapitalit ndërsa qeverisja e korporatave është e strukturuar për të lehtësuar problemet e agjencisë. Prandaj qeverisja e korporatave dhe struktura e kapitalit janë të lidhura nëpërmjet ndërlidhjes së tyre me shpenzimet e agjencisë. Qeverisja e korporatave ka qenë një zonë në rritje e hulumtimeve të menaxhimit (Claessens, 2002). Teoria e agjencisë si një term akademik buron nga një interes thelbësor i organizatës: sjellja sipas interesit personal. Teoria agjencisë argumenton se në një korporatë moderne, në të cilën ndarja e pronësisë ekziston gjerësisht, veprimet menaxheriale ndahen nga ato që kërkojnë për të maksimizuar kthimin nga kapitali aksioner (Berle & Means 1932; Pratt & Zeckhauser 1985). Madje e lidhur me këtë teori është dhe një teori tjetër ajo që quhet teoria e buxhetimit të kapitalit e cila pajtohet me qëllimet e mbijetesës dhe leverdisshmërisë duke supozuar që drejtimi ka si qëllim maksimizimin e vlerës së tregut të aksioneve të zakonshme. Meqenëse maksimizimi i fondeve të aksionerëve është objektivi i firmës, qëllimet e rendësishme të mbijetesës dhe leverdisshmërisë mund të kombinohen në një tregues të vetëm (Drury, C. p 709 Account Cost and Management 2006). Ekziston një kosto për zgjidhjen e konfliktit ndërmjet principalit dhe agentit duke vënë theksin në interesat e të dy palëve, harmonizimin e tyre. Kosto e agjencisë është një koncept ekonomik i cili lidhet me koston e marrëdhënieve brenda një entiteti siç janë organizatat. Teoria e koston së transaksioneve nënvizon faktin që njerëzit janë shpesh oportunistë në sjellje dhe pikërisht është teoria e agjencisë e cila diskuton për rreziqet morale brenda marrëdhënies së agjencisë duke e rregulluar atë. Menaxheret janë ata që ndjekin përfitimet e korporatës dhe nga ana tjetër realizojnë transaksione të ndryshme, ku në teorinë e koston së transaksionit njësia e analizës është transaksioni, ndërsa tek teoria agjencisë objekt i analizës është individi. Ndarja e pronësisë nga kontrolli mundësoi lindjen e problemit të agjencisë. Duhet theksuar se Ross (1972, 1973)

“eksploroj” në këtë drejtim. Ross është përgjegjës për origjinën ekonomike të teorisë së agjencisë parë dhe nga këndvështrimi i mekanizmave të përcaktimit të sistemeve nxitëse të shpërblimit, brenda kuadrit të marrëdhënieve të agjencisë. Kontrata e shpërblimit sipas tij mbetet faktor nxitës dhe motivimi. Në aspektin ekonomik të agjencisë, problemi është zgjedhja e sistemit të shpërblimit që do të prodhojë një sjellje nga agjenti, në përputhje me preferencat e principalit. Prandaj fokusi është në natyrën e sistemit nxitës dhe në sistemin e kontratës që udhëheq shpërndarjen e këtyre nxitësve, duke përfshirë këtu dhe kushtet e riskut dhe informacionit që kushtëzojnë zgjedhjet e palëve në një marrëdhënie agjencie (Ross 1972). Ndërsa në mënyrë më të detajuar ekspozimi teorik i agjencisë u bë nga Jensen & Menckling (1976), të cilët përcaktuan menaxherët si agjentë dhe aksionerin si principal. Jensen & Menckling (1976) e përkufizojnë marrëdhënien e agjencisë si një kontratë nën të cilën njëra palë (primari) ngarkon një palë të dytë (agjentët) për të kryer shërbime të ndryshme për llogari të palëve të tretë. Problemet e agjencisë lindin për arsye se është e pamundur që të realizohet një “kontratë e përkryer”, që të parashikojë çdo veprim të agjentit, vendimet e të cilit ndikojnë si në mirëqenien e tij, ashtu dhe në mirëqenien e primarit, ku agjenti mund të jetë bordi i drejtorëve ose menaxherët e korporatës, ndërsa primari aksionerët e shoqërisë (Brenan 1995). Menaxherët sigurisht janë përgjegjës për kostot e dështimit të arritjes së objektivave të tyre (vënë nga aksionerët), por nga ana tjetër ashtu siç marrin përsipër riskun e moskthimit nga investimi i tyre, aksionerët marrin përfitime në rast suksesi, njëkohësisht edhe menaxherët përfitojnë nga ky fakt jo vetëm pagën por dhe shpërblimet përkatëse (bonuset, shpërblim me anë të opsioneve të aksioneve etj). Kontrolli i shoqërisë teorikisht ndahet ndërmjet dy organizmave: bordit të drejtorëve dhe aksionerëve. Mbas mbledhjes së përgjithshme të aksionerëve (MPA) organi që vjen pas tij është bordi i drejtoreve, i cili përbën padyshim trupën më të rëndësishme vendimmarrëse. Është mbledhja e përgjithshme e aksionerëve që zgjedh bordin e drejtorëve. Madhësia e pushtetit të bordit varet nga tipi i shoqërisë dhe madhësia e saj. Bordi i drejtorëve në shoqëritë e mëdha monitoron performancën e ekzekutivit. Bordi i drejtorëve është një institucion qendror në qeverisjen e një shoqërie. Përveç drejtimit strategjik, anëtarët e tij bëjnë dhe monitorimin e shoqërisë, funksion i cili lidhet me problemet e agjencisë në firmë (Fama, 1980, Jensen, 1993). Në pronësinë e shpërndarë (disperse), funksioni i monitorimit duhet të përqendrohet në zvogëlimin e problemeve të

agjencisë ndërmjet aksionerëve dispersë dhe menaxhimit (Hermalin & Weisbach, 2001). Megjithatë, për shoqëritë me një përqendrim të lartë të pronësisë, konflikti në firmë është midis aksionerëve kontrollues dhe aksionerëve në pakicë ose në minorancë (Lefort & Urzu'a, 2008; Morck & Yeung, 2003). Teorikisht drejtorët ndahen në drejtorë ekzekutivë dhe drejtorë jo-ekzekutivë. Drejtorët ekzekutivë janë të punësuar në pozita menaxheriale. Drejtoret jo-ekzekutivë nuk kanë pozita menaxheriale, por janë individë me njohje strategjike dhe politika të biznesit, prandaj ata luajnë një rol të rëndësishëm në mbikëqyrjen dhe kontrollin e menaxhimit duke analizuar me kujdes performancën e menaxhimit. Në Britaninë e Madhe legjislacioni nuk bën një dallim të tillë, por Common Law, pranon se drejtorët ekzekutivë (CEO) kanë njohuri të cilat janë më të plota mbi shoqërinë, menaxhimin dhe politikat ekonomike në krahasim me drejtorët-jo-ekzekutivë. Common Law, siç dihet është legjislacion i zhvilluar si rezultat i vendimeve gjyqësore të kaluara dhe që aplikohet në Britani ku njihen : familja e të drejtës civile (civil law) dhe ajo common law. Reformat ndërkombëtare në fundin e viteve '90 dhe fillim të viteve 2000 janë fokusuar në rolin e drejtoreve jo-ekzekutiv. Rekomandime të ngjashme janë bërë që në vitin 1992 nga Komiteti Canbury në Britaninë e Madhe. Drejtoret në çdo korporatë veprojnë si agjente të mbledhjes së përgjithshme të aksionerëve, sipas teorisë së agjencisë. Gjithashtu roli i bordit të drejtorëve, dhe anëtarëve të jashtëm të bordit (drejtorë jo-ekzekutivë), në veçanti, është që të mbrojnë aksionerët në minorancë ndaj “koalicionit” të anëtarëve aksionerë të familjes të cilët zotërojnë numrin më të madh të aksioneve (Anderson & Reeb, 2004). Teoria e agjencisë fokusohet në marrëdhënien ndërmjet principalit dhe agentit (Eisenhardt, 1989). Principali është aktori që i delegon punën një tjetër aktori, agentit. Në një shoqëri ku ndarja e pronësisë dhe kontrollit shfaqen, formohet një marrëdhënie agjencie (Muth & Donaldson, 1998). Pronarët bëhen principalit që delegon punën tek menaxheri që është agjenti. Me ndarjen e pronësisë dhe kontrollit menaxheri merr kontrollin mbi shoqërinë, por me prezencën e interesave divergjente, nuk është e qartë dhe ka dyshime për faktin që menaxheri vepron në linjë me interesin e pronarëve, duke qenë se qeniet njerëzore sillen në mënyrë përfituese dhe janë subjekt i racionalitetit (Donaldson, 1990). Kjo është pika kyçe ose “rrënja e problemit” të agjencisë (Shleifer & Vishny, 1997). Firmat e vogla kanë më shumë liri në caktimin e bordit në krahasim me firmat e listuara publikisht. Për më tepër, firmat familjare janë forma mbizotëruese e biznesit në

ekonomitë e ndryshme duke kontribuar gjerësisht në GDP-në (PBB) si dhe për krijimin e vendeve të reja të punës (International Family Enterprise Research Academy (IFERA) (2003)). Megjithatë, duhen më shumë hulumtime mbi efektin e drejtorëve të jashtëm në performancën e firmës në pronësi private, familjare (SME), në mënyrë që njohuritë të zgjerohen mbi rolin e këtyre drejtorëve në këto biznese (Gabrielsson & Huse, 2005). Aspekte të ndryshme të mekanizmave të brendshëm dhe të jashtëm, kanë qenë të orientuara drejt korporatave apo shoqërive të listuara në bursë. Në vendet e zhvilluara punësimi në sektorin privat në masën 60% i atribuohet këtyre ndërmarrjeve. BE-ja 98-99% të bizneseve i ka biznese të inkuadruara në SME të cilët zënë 66-68% të fuqisë punëtore (Barnes, 2007). Në Gjermani janë mbi 2.5 milion shoqëri të mesme dhe të vogla-German Mittelstand- të cilët punësojnë 4 deri në 5 punonjës. Në sektorin privat ata llogariten në 2/3 e GDP-së (PBB). Afërsisht 40% e këtyre shoqërive janë shoqëri që zotërohen nga familjarë (family owned). Një veçori që duhet të përmendim është se shumë shoqëri në Gjermani dhe Francë kanë një aksioner të madh të vetëm. Kështu ndërmjet 170 firmave me aksionerë të rëndësishëm, afërsisht 80% e firmave franceze dhe 85% e firmave gjermane kanë një aksioner të vetëm që zotëron më tepër se 25% të aksioneve, dhe në pjesën më të madhe të shoqërive të të dyja vendeve gjendet një aksioner i vetëm i cili zotëron pjesën më të madhe të aksioneve (aksioner mazhoritar ose kontrollues). Sipërmarrjet e vogla dhe të mesme janë shtylla kurrizore e ekonomisë shqiptare dhe përbëjnë pjesën më të madhe të shitjeve dhe të punësimit. Ata përbejnë mbi 70% të të gjithë punësimit, më shumë se 70% të GDP-së vjetore dhe përbëjnë gati 99% të të gjitha bizneseve të regjistruara në Shqipëri. SME-të në Shqipëri përfaqësojnë 99,6% të ndërmarrjeve aktive (96.20 janë mikro-ndërmarrje) duke kontribuar në formimin e 72,9% të PBB-së dhe punësojnë 71,4% të fuqisë punëtore. Madje edhe në Kosovë përbëjnë shtyllën kurrizore të ekonomisë. Sipas të dhënave të Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK), në fund të 2011, SME-të (përfshirë ndërmarrjet mikro) përbënin rreth 99,97% të të gjitha bizneseve që vepronin në vend.

2.2 a) Rolet e bordeve në strategjinë e shoqërive

Kontrolli i shoqërisë siç dihet ndahet ndërmjet dy organizmave: bordit të drejtorëve dhe aksionerëve. Rolet e bordit ose bordeve kanë qenë fokusi i hulumtimit të autorëve të shumtë që nga viti 1980 (Donaldson & Davis, 1991; Weir, Laing, dhe McKnight, 2002;

Denis & McConnell, 2003; Babiq, 2010). Nën kushtet e ndarjes së pronësisë nga kontrolli, interesat e pronarëve dhe interesat e drejtuesve mund të ndryshojnë. Pikërisht kjo është dhe arsyeja se si të sigurohemi që menaxherët të veprojnë në interes të pronarëve. Vitet 2000, përkuan me tronditje të mëdha financiare të shkaktuara nga kriza e qeverisjes, e cila sikurse e dimë tashmë, kulmoi me falimentimin e shoqërisë Enron. Kriza financiare nxori në qendër të vëmendjes rolin e bordeve, rol i cili u vërtetua katërcipërisht që nuk kishte qenë efektiv madje në disa raste formal dhe “vështues” i interesave personale. Drejtorët e 2 shoqërive të mëdha Enron dhe Worldcom, në veçanti mbahen si përgjegjës kryesorë për pasojat dhe mashtrimet e ndodhura në shoqëritë e tyre. Drejtorët e Enron p.sh duhet t'i paguanin 168.000.000 \$ investitorëve paditës nga të cilat 13.000.000 \$ të pa mbuluara nga siguracionet, ndërsa ata të shoqërisë tjetër WorldCom kishin për të paguar 36.000.000 \$, nga të cilat 18.000.000 \$ të pa mbuluar nga siguracionet. Mungesa e transparencës pati pasojë katastrofike. Aksionerët nuk kishin dijeni për atë që po ndodhte në kompaninë Enron dhe as ishin në gjendje të kuptonin gjuhën me të cilin ishin përpiluar pasqyrat financiare. Fakt real është se në momentin kur çdo gjë u bë publike, aksionet e kësaj kompanie ranë ndjeshëm në më pak se 1USD/aksion në nëntor 2001 në krahasim me 90USD/aksion që kishin qenë në muajin qershor 2000 e barazvlefshme kjo me 11 miliard USD/ humbje. Si pasojë e këtyre skandaleve dhe shqetësimeve të vazhdueshme për qeverisjen e korporatave, bordet kanë qenë në qendër të debatit të politikave në lidhje me reformën e qeverisjes dhe në fokus të hulumtimeve të vazhdueshme akademike. Periudha post-Enron vuri theksin tek rritja e shkallës së pavarësisë së bordeve dhe në praninë më të madhe të drejtorëve të pavarur. Në mënyrë indirekte, një bord mund të mbrohet kundër shpërdorimit të detyrës menaxheriale nëpërmjet zgjedhjes së auditit, mbikëqyrjes, nëpërmjet kërkesave të raportimit, kontrollit mbi praktikën e kontabilitetit etj. Një vend të rëndësishëm këtu zë çështja e vlerësimit të aftësisë (Holmstrom 1999), ndaj dhe bordi ka në dorë disa instrumenta që janë të vlerësuar me kohë nga literatura si p.sh: bordi mund të emërojë dhe të shkarkojë CEO-në, të përcaktojë pagën aktuale dhe të ardhme, performancën etj (Hermalin & Weisbach 1998). Në vazhdim të kësaj ideje, një ndër reformat më të rëndësishme në fushën e qeverisjes së korporatave në Amerikë mund të konsiderohet Akti Sarbanes-Oxley, akt i cili ekziston krahas akteve të tjerë si p.sh Akti i Këmbimit dhe Letrave me Vlerë të viteve 1933 dhe 1934 në rregullimin e tregjeve

financiare. Madje i krahasuar me Aktin e Këmbimit të Letrave me Vlerë. Ky akt është pjesë e modelit amerikan në kuadrin e qeverisjes së korporatave. Në “vorbullën” e viteve 2000 në kuadrin e këtij akti u ndërmorën disa masa si: forcimi i përgjegjshmërisë së korporatave, përmirësimi i transparencës financiare ndaj mashtrimeve të pasqyrave financiare etj (Romano, 2005; Healy & Palepu, 2003). Sarbanes-Oxley u kthye në ligj nga ish presidenti amerikan G.W. Bush, duke e quajtur dhe si “reformën më të suksesshme për praktikën e biznesit amerikan që nga koha e Franklin D. Roosvelt”. Ai përmban 11 seksione dhe përbën një reagim ndaj skandaleve të kontabilitetit (pasqyrave financiare të korporatave) si psh Enron, Worldcom etj. Akti Sarbanes-Oxley i vitit 2002 ishte në qendër të diskutimit të barrës rregullatore. Në përgjigje të skandaleve të mëdha të korporatave të shoqërive të mëdha publike, akti u prezantua në Shtetet e Bashkuara për të mbrojtur investitorët duke përmirësuar saktësinë dhe besueshmërinë e zbulimit të informacionit të korporatave. Megjithatë, ka qenë e argumentuar se në procesin e përpjekjes për të rivendosur besimin e publikut, akti ka krijuar edhe detyrimin rregullativ për shoqëritë publike duke dekurajuar shoqëritë vendase dhe të huaja për t’u bërë publike (Grant Thornton, 2010). Akti Sarbanes-Oxley u pasua nga nismat e tjera rregullatore në botë, veçanërisht në vendet të cilat përjetuan skandalet e korporatave, siç ishte “Ligji i Sigurimit Financiar” i vitit 2003 në Francë dhe “Ligji për Kursimet” i vitit 2006 në Itali. Ndërsa menaxhimi mban përgjegjësinë për implementimin e strategjisë së re, roli këshillues i bordit në fakt mundëson ndikimin indirekt mbi procesin e vendimmarrjes strategjike (Nicholson & Newton, 2010). Interesat e menaxherëve dhe anëtarët e bordit nuk janë domosdoshmërisht në konflikt (Pugliese *et al.*, 2009). Në këtë kontekst, Huse (2007) argumenton se: "Koncepti bazë i teorisë së drejtimit është besimi, ose marrëdhënia e besimit ndërmjet menaxherëve dhe pronarit, ose pronarëve të shoqërisë". Formulimi i suksesshëm dhe zbatimi i strategjisë do të varet nga rolet e përcaktuara në mënyrë të qartë dhe duke ndarë autoritetin dhe përgjegjësinë e strukturave menaxheriale duke filluar nga nivelet operacionale (Babiç 2010). Në këtë pikëpamje roli primar i bordit është për të mbështetur dhe ndihmuar menaxherët në arritjen e objektivave të shoqërisë, dhe jo për ti kontrolluar në mënyrë të herë pas herëshme ata. Thënë ndryshe, teoria kujdestarisë sugjeron se bordi si rol kryesor ka lehtësimin dhe dhënien e pushtetit tek menaxhimi drejt arritjes së misionit dhe objektivave të korporatës (Huse 2007), teoria e agjencisë sugjeron monitorim dhe

kontroll, por gjithashtu për shkak të detyrës menaxherët janë përgjegjës para aksionerëve, prandaj ata janë dhe duhet të jenë të vetëdijshëm se është detyrë e tyre harmonizimi i interesave të aksionerëve me grupet e pretendentëve të shoqërisë dhe pikërisht këtu gjen zbatim teoria e pretendentëve (stakeholders theory). Gjithashtu menaxherët janë një grup pretendentësh të cilët mund të bëjnë me autoritetin e tyre shpërndarjen e burimeve të shoqërisë për të plotësuar kërkesa të ndryshme të grupeve të ndryshme të një rrjeti të gjerë pretendentësh dhe pikërisht kjo pjesë i takon perceptimit teorik të këndvështrimeve të teorisë së agjencisë me atë të pretendentëve. Menaxherët janë përgjegjës para aksionerëve por ata duhet të harmonizojnë gjithashtu dhe interesat aksioner-grup pretendentësh si binom. Anëtarët e bordit kanë përvojë dhe nga pozitat e tyre drejtuese ndonjëherë dhe në korporata të tjera, kjo i bën ata të aftë për vendimmarrje strategjike. Në këtë kontekst, "bordet janë ligjërisht përgjegjës për strategjinë dhe ata janë në një pozitë të shkëlqyer për të kontribuar në strategjinë e shoqërive" (Pugliese *et al.*, 2009). Për më tepër, këtu përmendim dhe aktivizmin e palëve të interesuara për t'u marrë me çështjet strategjike. Bordet e drejtorëve duhet të rishikojë strategjinë e korporatës dhe të vlerësojnë performancën financiare të shoqërisë. Performanca vjetor duhet të përfshijë një vlerësim të CEO-së nga bordi. Edhe ato borde që shprehimisht nuk miratojnë objektivat strategjike, megjithatë, e bëjnë këtë në mënyrë implicite sa herë që ata rishikojnë performancën e korporatës. Anëtarët e bordit duhet të jetë gjithmonë të vetëdijshëm për mënyrën se si shoqëria zgjedh strategjitë e saj për të monitoruar sistematikisht proceset e planifikimit strategjik për të ofruar vendimmarrje dhe ekspertizë të nevojshme për zhvillimin e këtyre strategjive. Komiteti Candbury në Britaninë e Madhe rekomandon këto funksione të bordeve të korporatave: (1) rishikim i strategjisë së korporatës, (2) angazhimin e burimeve kryesore të korporatës (duke përfshirë edhe emërimet kyçe), (3) evolucioni i performancës së korporatës, dhe (4) vendosja e standardeve të drejtimit të korporatës.¹ Në Amerikë, drejtorët jo-ekzekutivë, ose siç thuhet drejtorë të jashtëm, tradicionalisht janë përgjegjësit primar për identifikimin, rekrutimin dhe mbështetjen e CEO-ve kompetentë e profesionalë në çdo aspekt. Bordet gjermane dhe amerikane ndryshojnë në përfshirjen e drejtorëve jo-ekzekutiv në vendime të ndryshme. Ligji gjerman është mjaft i qartë në lidhje me vendimet strategjike të cilat kërkojnë përfshirjen e bordit mbikëqyrës. Bordi duhet jo

¹ Report of the Committé on Financial Aspects of corporate Governance, Gee (1992).

vetëm të miratojë strategjinë e përgjithshme, por nga ana tjetër ai duhet të miratojë në mënyrë specifike blerje-shitjen e aseteve, planet e shitjeve apo mbylljet dhe zgjerimin e veprimtarive etj, konkretisht është përgjegjës për shëndetin afat-gjatë të korporatës, dhe kjo përfshin ndër të tjera një kthim të qëndrueshëm nga investimi i aksionerëve dhe punonjësve për atë sa ata kanë investuar duke monitoruar performancën në momentet kur duhet bërë një gjë e tillë. Pagat e CEO-ve gjatë periudhës së krizës financiare u evidentuan ose më saktë “ranë në sy” si paga që nuk justifikonin rezultatet e arritura, pra të pa përputhura me realitetin. Të gjithë jemi dëshmitarë të pagesave dhe shpërblimeve jo te drejta të anëtarëve të bordit në shoqëritë që më pas falimentuan nga rezultatet fiktive të raportuara, çka përbënte dhe një ndër elementët e krizës financiare. Shpërblimi për punën është çelësi i suksesit të qeverisjes. “Njerëzit duhet të paguhen për çfarë bëjnë, jo për çfarë janë” shprehet liberali Fridman, që do të thotë sipas performancës. Është interesante të theksohet se p.sh UBS (Union Bank of Switzerland), një shoqëri me humbje të mëdha, stimujt afatgjatë përbënin rreth 70 për qind të kompensimit të CEO-ve dhe se CEO-ve i është kërkuar për të grumbulluar dhe mbajtur aksione në vlerë sa pesë herë shumën e mesatares së tre viteve të fundit të komponentëve cash në totalin e kompensimeve. Natyrisht, shifra të tilla mund të jenë mashtruese pasi ajo që ka rëndësi për stimujt është struktura e saktë e kompensimit duke përfshirë pengesat e performancës dhe çmimin e opsioneve². Skandalet e shumta financiare që përmendëm më lart, theksojmë se nxorën në plan të parë konkluzionet e studimeve të ndryshme të cilët konvergjojnë në faktin që zgjedhja e drejtorëve të pavarur, realizimi i zgjedhjeve të hapura për anëtarët e bordit, emërimi i një kryetari bordi të pavarur dhe mbajtja e mbledhjeve të rregullta pa praninë e CEO-ve si dhe vlerësimi i performancës së bordit periodikisht janë disa nga pikat të cilët krijojnë parimet e një qeverisje të mirë në shoqëri të ndryshme.

2.3 Një vështrim mbi debatet në lidhje me teoritë e qeverisjes së korporatave

Qëllimi i qeverisjes së korporatave është për të monitoruar aktivitetet e menaxhimit dhe vendim-marrjen në mënyrë që të ketë siguri që ato janë në përputhje me kërkesat e aksionerëve.

² OECD (2008), “The recent financial market turmoil, contagion risks and policy responses”, Financial Market Trends no. 94 vol.2008/1. Market Trends no. 94 vol.2008/1.

Sipas Minzt (2004), ndonëse ekziston një larmi zgjidhjesh, “problemi i agjencisë” nuk mund të zgjidhet asnjëherë në mënyrë të përsosur”. Ilustrime të këtij pohimi mund të gjenden në skandale të shumta të përsëritura në gjithë botën si dhe në krizën globale financiare të viteve 2007-2009. Zgjidhjet potenciale të këtij problemi, sipas gjetjeve kryesore në literaturë, mund të grupohen si më poshtë:

- Domosdoshmëria e monitorimit të sjelljes së agentëve nga aksionerët, nëpërmjet ngritjes të një Bordi Drejtues profesional, ku drejtorë të aftë dhe me ekspertizën e duhur ngarkohen me përgjegjësi mbikëqyrëse dhe vishen me kompetencën për të punësuar apo shkarkuar menaxherët.
- Zbatimi i mirë i kontratave, të cilat përcaktojnë qartë të drejtat dhe përgjegjësitë e principalëve (kryesorit ose kryesorëve) dhe agentëve dhe që janë të hartuara për të formësuar sjelljen e agentëve në interesin më të mirë të aksionerëve.
- Harmonizimi i interesave të pronarëve dhe agentëve, duke kushtëzuar kompensimin e menaxherëve me performancën afatgjatë të shoqërisë dhe vlerësimin e saj financiar, dhe/ose duke emetuar aksione me option për menaxherët.
- Kontrolli i besueshmërisë së raporteve financiare që përgatiten nga menaxherët, nga auditorë të brendshëm dhe ekspertë kontabël të çertifikuar.
- Hartimi dhe zbatimi i një sistemi të brendshëm kontrolli efektiv, që konsiston në politika, procedura dhe teknologjinë e duhur për të siguruar besueshmërinë e raporteve financiare, respektimin e ligjit dhe të rregulloreve, si dhe efektshmërinë dhe eficiencën e operacioneve.

Agyris (1973) argumenton se teoria e agjencisë shikon një punonjës apo njerëzit si një qenie ekonomike, për të përmbushur aspiratat personale, të cilët mund të jenë të një individi ose të individëve (njeriu më tepër hedh vështrim të drejtuar kah interesit personal se altruizmit). Megjithatë, theksojmë se teoria, administrimin e njeh si : rëndësia e strukturave që fuqizojnë kujdestarinë dhe ofron autonomi maksimale, ndërtuar mbi besimin (Donaldson & Davis, 1991). Ajo thekson se në pozitën e tyre, punonjës apo drejtues duhet të veprojnë me më shumë autonomi në mënyrë që kthimet e aksionerëve të janë maksimale. Në të vërtetë, kjo minimizon kostot e monitorimit dhe kontrollin e sjelljeve (Davis, Schoorman & Donaldson, 1997). Në anën tjetër, Daly *et al.*, (2003) argumentoi se për të mbrojtur reputacionin e tyre si vendimmarrës në

organizata, ekzekutivët dhe drejtorët janë të prirur për të vepruar për të maksimizuar performancën financiare ashtu si aksionerët për të maksimizuar fitimet. Në këtë kuptim, besohet se performanca e firmës mund të ndikojë drejtpërdrejtë në perceptim të performancës së tyre individuale. Teoria e agjencisë fokusohet në marrëdhënien ndërmjet principalit dhe agentit ku principalin është aktori që i delegon punën një tjetër aktori që është agjenti. Në një shoqëri ku ndarja e pronësisë dhe kontrollit shfaqet, formohet një marrëdhënie agjencie.

Teoria e drejtimit gjen zbatim në vende si Japonia, ku punonjësi japonez merr rolin edhe të kujdestarit, duke marrë “pronësinë” e punës. Për më tepër, teoria, sugjeron unifikim të rolit të CEO-së dhe kryetarit të bordit, në mënyrë që të zvogëlohen shpenzimet e agjencisë dhe për të pasur rol më të madh kujdestari në organizatë. Sipas kësaj teorie për CEO-të që janë kujdestarë, dhënia e autoritetit do të thotë që CEO-ja të jetë dhe kryetar bordi. Një strukturë e tillë, mund të trajtohet si disa funksionale nga këndvështrimi i teorisë së agjencisë. Kujdestarët e maksimizojnë dobinë e tyre më shumë kur veprojnë për arritjen e objektivave të organizatave sesa për objektivat e tyre individuale. CEO është përgjegjës pa ekuivokë për performancën e organizatës dhe posedon të gjithë pushtetin e duhur të përcaktojë strategjinë që ai mendon, pa menduar se dikush tjetër (nëse tjetër individ është kryetar bordi i drejtoreve) do të ndërhyjë në urdhrat dhe vendimmarrjen e tij, në këtë mënyrë do të jenë më mirë të mbrojtur interesat e aksionerëve. Është gjetur empirikisht se kthimet e investitorëve janë përmirësuar duke pasur të dyja këto teori të kombinuar sesa të ndara (Donaldson & Davis, 1991).

Teoria e palëve të interesuar duket se është në konflikt me themelet e teorisë së agjencisë. Autorë të ndryshëm (Hill & Jones, 1992) shprehin se ka një paralele ndërmjet klasës së marrëdhënieve stakeholder-agjent dhe marrëdhënieve primar-agjent të artikuluar nga teoria e agjencisë. Sikurse relacionet stakeholder-agjent, ashtu dhe primar-agjent përfshijnë një kontratë eksplicite dhe implicite, qëllimi i së cilës është të përpiqet të pajtojë interesat që janë në divergjencë. Përveç kësaj të dyja llojet e relacioneve vëzhgohen nga struktura e qeverisjes. Teoria e palëve të interesuara mund të definohet si "një grup ose individ i cili mund të ndikojë ose të ndikohet nga arritjet e objektivave të organizatës".

Në ndryshim nga teoria e agjencisë, në të cilat menaxherët punojnë dhe i shërbejnë aksionerëve (i presupozon marrëdhëniet ndërmjet tyre si një kontratë), teoricienët e

teorisë së palëve të interesuar sugjerojnë se menaxherët në organizata kanë një rrjet të gjerë me të cilët kanë krijuar marrëdhënje dhe që duhet ti sherbejnë - kjo përfshin furnizuesit, punonjësit dhe partnerët e biznesit. Donaldson & Preston (1995) argumenton se kjo teori fokusohet në vendimmarrje menaxheriale dhe interesat e të gjitha palëve të interesuara kanë vlerë të perceptuar, dhe nuk ka grupe të interesave që presupozohet të dominojnë të tjerët.

Sipas teorisë së agjencisë, drejtuesit mund t'i japin llogari një game të gjerë të palëve të interesuar (stakeholdersat), por përgjegjësia e tyre parësore është të përmbushin interesat e aksionerëve (Goodpaster, 1991). Megjithatë në dritën e krahasimit cilësor të dy teorive (e agjencisë me atë të palëve të interesuara), Smerdon (2010) argumenton se edhe në vendet ku Teoria e Palëve të Interesuara (stakeholdersave) ishte një dimension kyç i të bërit biznes, skandalet financiare kanë qenë të pranishme dhe të shkaktuara nga dështime të ngjashme me ato në Mbretërinë e Bashkuar apo SH.B.A, vende nga të cilat teoria e agjencisë ka buruar dhe është zhvilluar.

Hillman, Canella & Paetzold (2000) pretendojnë se teoria e varësisë nga burimet fokusohet në rolin që luajnë drejtorët në ofrimin ose sigurimin e burimeve të domosdoshme për një organizatë nëpërmjet lidhjeve të tyre me ambientin e jashtëm. Në të vërtetë, Johnson *et al*, (1996) pajtohen me idenë që teoritë e varësisë nga burimet e vendos fokusin mbi emërimin e përfaqësuesve nga organizatat e pavarura si një mjet për të siguruar burime për suksesin e firmës. Për shembull, drejtorët e jashtëm janë partnerë në firma të ndryshme private, qoftë në mbledhjet e bordeve apo konsulencia. Sigurimi i burimeve nga organizata të ndryshme rrit performancën dhe mbijetesën e firmave (Daily *et al*, 2003). Sipas Hillman, Canella & Paetzold (2000) drejtorët të tillë sjellin burime për firmën të tillë si informacion, aftësi, grupe të tilla si: furnizues, blerës etj. Ndërsa drejtorët vetë si kategori mund të klasifikohen në : drejtorë të brendshëm, ekspertë të biznesit, specialistë mbështetës dhe influencues në komunitet.

Shoqëritë po i kushtojnë gjithnjë e më shumë vëmendje “përgjegjësisë shoqërore” edhe në vende anglo-sanksone si Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duke e konsideruar atë si mbështetëse të qëndrueshmërisë afatgjatë. Kjo qasje, e quajtur “vlera e zbutur e aksionerit” (*enlightened shareholder value*) është bërë objekt i akteve ligjore që përcaktojnë parimet e qeverisjes së shoqërive (Smerdon 2010).

Teoria e vlerës së aksionerit (shareholder value theory) është teoria dominuese ekonomike në përdorim nga biznesi. Vlera aksionere është një term biznesi formuluar si maksimizim i vlerës aksionere ose si modeli i vlerës aksionere dhe maksimizimi i pasurisë së aksionerëve është qëllimi i shoqërisë. Theksojmë këtu faktin se u bë shumë popullore gjatë viteve '80. Shkollat e biznesit e mbajnë teorinë e vlerës së aksionerit si një teori "parim" në qendër të vëmendjes. Madje fituesi i çmimit Nobel Milton Friedman (1970) argumenton fuqishëm idetë në favor të maksimizimit të fitimit (kthimit financiar për aksionerët). Ai thotë se "nuk është një dhe vetëm një përgjegjësi sociale e biznesit për të përdorur burimet e saj, por dhe për t'u angazhuar në aktivitete për aq kohë sa respekton rregullat e lojës".

Ndërsa Hillman & Keim (2001) mbështetur në teorinë e grupeve të interesit mbrojnë pikëpamjen e lidhjes ndërmjet krijimit të vlerës aksionere, menaxhimit të grupeve të interesit, dhe pjesëmarrjes së shoqërisë në çështjet sociale. Ata konkluduan në faktin se: "Ndërtimi i marrëdhënieve të mira me grupet e interesit primare si: punonjësit, klientët, furnizuesit, dhe komunitetet mund të çojë në rritje të pasurisë së aksionerëve duke ndihmuar firmat të zhvillojnë avantazhin konkurrues të burimeve".

Teoria normative e grupeve të interesit (normative stakeholder theory) është "baza" e teorisë së grupeve të interesit (Donaldson & Preston, 1995). Teoria normative e grupeve të interesit supozon se të gjitha palët e interesuara kanë vlera të brendshme dhe asnjë aktor nuk ka përparësi mbi aktorët e tjerë. Aspekti normativ ka dy supozime që janë të ndryshme nga Teoria e vlerës së aksionerit : Interesi relacional në krahasim me interesin vetjak dhe balancimin në vend të maksimizimit. Një aspekt tjetër përfshin i kësaj teorie përfshin një pikëpamje të balancimit të interesit të korporatës me të gjitha palët e interesuara dhe jo maksimizimin të performancës për të mirën e aksionerëve (Donaldson & Preston, 1995), Margolis & Walsh (2001, 2003).

Teoria administrimit/kujdestarisë, në kontrast me teorinë e agjencisë (Davis, Schoorman & Donaldson, 1997), përcakton situatat në të cilat menaxherët nuk janë të motivuar nga qëllime individuale, por motivohen nga arritjet dhe nevojat e përgjegjësisë (Corbetta & Salvato, 2004a; Muth & Donaldson, 1998; Pieper, Klein, dhe Jaskiewicz, 2008). Sipas tyre kujdestari është i motivuar për maksimizimin e performancës organizative, pra për të kënaqur interesat e aksionerëve. Teoria e agjencisë shpjegon në mënyrë më të plotë relacionet e grupeve me interesa të ndryshme dhe se si keto interesa harmonizohen, pra

konvergjojnë në një pikë të vetme. Sipas Hill & Jones (1992) ekziston një paralele ndërmjet klasës së marrëdhënieve stakeholder-agjent dhe primar-agjent që përcaktohet nga teoria e agjencisë. Sipas teorisë së grupeve të interesit, korporata i shërben një qëllimi më të gjerë publik: krijimit të vlerës për shoqërinë. Krijimi i vlerës për aktorë të ndryshëm, si komuniteti, punonjësit etj është ekuivalente me krijimin e vlerës financiare për aksionerët. Krahas pikëpamjes së bazuar në treg këtu shtohet dhe niveli socio-politik.

Struktura e bordit të korporatave dhe ndikimi i tij në sjelljen e firmës ka qenë një çështje e debatuar në literaturë (Anderson & Reeb, 2004; Huse, 2000; Zahra & Pearce, 1989). Diskutimet ndër vite gjithmonë janë përqendruar në strukturën e bordit të drejtorëve, p.sh cili bord ka mekanizmin më të mirë të sistemit të kontrollit të brendshëm në kuadër të qeverisjes së korporatës (Jensen, 1993). Teoria e agjencisë e trajton një shoqëri të lidhur në një marrëdhënie me një kontratë, kontratë të cilën pjesëmarrësit e realizojnë me njëri-tjetrin (Jensen & Meckling 1976), por kontrata perfekte vështirë se mund të arrihet. Pasuritë janë pronë e aksionerëve ndaj çdo problem që lind ndërmjet principalit dhe agentit (aksioner-menaxher) ka të bëjë me përdorimin produktiv të këtyre aseteve ose menaxhimit me efektivitet, thënë ndryshe të pasurisë së aksionmbajtësve. Bordi i drejtorëve është një instrument efektiv për monitorimin e menaxherëve të lartë, përballimin e situatave të ndryshme dhe reduktimin e kostos së agjencisë (Fama & Jensen, 1983). Kështu, teoria e agjencisë është përdorur për të ekzaminuar rolin që bordi i drejtorëve së bashku me kontributin e tij ka dhe duhet të ketë në punën e organizatës që ai drejton, për të pasur kjo e fundit rezultate sa më të larta (Jackling & Johl, 2009).

Një diskutim që paraqet vëmendje është edhe kontributi i drejtorëve të pavarur (sipas teorisë agjencisë), madje është dhe duhet të jetë detyrë e tyre për të “mbetur të pavarur”, përderisa përgjigjen për mbikëqyrjen operative, mbrojnë pasurinë e firmës dhe mbajtjen e menaxherëve të përgjegjshëm ndaj pretendentëve të ndryshëm kryesorë të firmës për të siguruar mbijetesën dhe të ardhmen e suksesshme të shoqërisë (Gabrielsson & Huse, 2005). Teoria e agjencisë dhe teoria e administrimit, na tregojnë se drejtorët e pavarur ushtrojnë një efekt pozitiv në performancën e firmës, por roli i bordit të drejtorëve është i ndryshëm në secilën teori. Sipas teorisë së agjencisë, drejtorët e pavarur monitorojnë të brendshmit, ndërsa sipas teorisë së kujdestarisë, drejtorët e pavarura japin këshilla të

vlefshme, këshilla të cilat janë një vlerë e shtuar në drejtim të qeverisjes së mirë dhe efektive.

Në dallim nga firmat e mëdha, modeli i pronësisë së firmave të vogla familjare dhe të mesme (Forbes & Milliken, 1999) nevojën për kontroll nga ana e bordit e ka më të vogël, kështu që prania e drejtorëve të jashtëm do të ishte e dobishme dhe do të reflektonte jo pak në shërbimin dhe këshillimin e nevojshëm për CEO-të në vend të kontrollit (Fiegener *et al.*, 2000). Sipas teorisë së kujdestarisë, roli primar i bordit është për të ofruar shërbim profesional dhe për të këshilluar në krahasim me monitorimin siç parashikon teoria e agjencisë. Megjithatë në literaturë, teoria kryesore, teoria e agjencisë luan një rol dominues në debatin për qeverisjen e korporatave në përgjithësi duke kuptuar se është teoria bazë në raport me teoritë e tjera për të investiguar mekanizmat e qeverisjes së korporatave. Në ditët e sotme studime të ndryshme empirike veçanërisht në industritë teknologjike, si industri që dominojnë tregje, kryesisht në ekonomitë anglo-saksone (Kor 2006, A.I & Wang 2009, Choi *et al.*, 2012a), kanë venë theksin në perspektivën strategjike të korporatave, pasi të menduarit në mënyrë strategjike fokusohet në faktin si të krijosh një të ardhme më të mirë duke qenë proaktiv dhe duke shtuar vlerën për shoqërinë nëpërmjet realizimit të të ardhurave të larta.

Literatura e fundit e qeverisjes së korporatave vë theksin në faktin se instrumentat e qeverisjes së korporatave në firmat e teknologjisë ndryshojnë nga njëri vend në tjetrin, psh le të shohim në Azi rastin specifik të një studimi të viteve të fundit. Në Kore, Choi (2012a) investigoi nëpërmjet një studimi efektivitetin e përqendrimit të pronësisë dhe investitorëve institucionalë si mekanizma të qeverisjes për 301 firma të teknologjisë së lartë, në mesin e vitit 2002 dhe vitit 2003. Gjetjet e tij tregojnë se në termat e strukturës së pronësisë, prania e investitorëve institucionalë të huaj përmirëson performancën e firmave të teknologjisë së lartë, ndërsa rezultatet e kundërta janë gjetur për zotëruesit e firmave me kapital vendas, madje dhe në rastet kur pronar është shteti.

2.4 Modelet e sotme të qeverisjes së korporatave. Karakteristikat e tyre

Globalizimi i Qeverisjes së Korporatave ofron një analizë të sistemeve kyçe të qeverisjes së korporatave në Britani të Madhe, SHBA dhe Gjermania nga perspektiva e zhvillimit të globalizimit ekonomik. Mekanizmat e qeverisjes së korporatave ndryshojnë nga organizata në organizatë dhe nga vendi në vend. Modeli anglo-sakson si model

është karakterizuar me dominimin në firmë të personave të pavarur dhe aksionerëve individualë. Menaxheri është përgjegjës përpara bordit të drejtorëve dhe aksionerëve, këta të fundit janë të interesuar për marrjen e dividendëve, çka tregon marrjen e rezultatit financiar të shoqërisë në fund të vitit ushtrimor.

Vendet anglo-saksone janë karakterizuar nga shfaqja e tregjeve financiare dhe kufizime të forta bankare. Britania e Madhe psh shikohet si një vend në Evropë, ku duke njohur rëndësinë e tregut financiar në Londër, shumë shoqëri kombëtare janë të listuara në bursë, pasi sot kemi mbërritur në një numër të madh bursash, për të gjetur partneritete të ndryshme, psh ndër treguesit e Bursës së Londrës janë : *The Financial Times Ordinary Index* , e cila përfaqëson indeksin e aksioneve të 30 shoqërive “blue chip”- shoqëri të mirënjohura, me regjistrime të mira në rritje dhe me mjete shumë të mëdha-përfaqësuese të industrisë dhe tregtisë britanike; *Financial Times Actuaries All Share Index* ose FT-A (përbëhet nga 650 aksione që përfaqësojnë mbi 90% të vlerës *Exchange*), *100 Share Index* ose *FOOTSIE* (list of FTSE 100 shares) etj. Sistemi bankar theksojmë se nuk ka një rol qendror në proceset apo strukturat qeverisëse, bankat konsiderohen thjesht "ofruesit e kredisë" në këto vende. Një shoqëri që të regjistrohet në bursën e Nju Yorku-ut (NYSE) duhet që përveç kërkesave të tjera, të paktën, të ketë 1.1 milion aksione të mbajtura nga publiku. Treguesi *Standart & Poor's 500 composite index* përbëhet nga aksionet e 456 shoqërive më të mëdha të listuara në NYSE që llogariten për 80% të kapitalizimit të tregut të kësaj burse ose p.sh *DIJA (Down Jones 30 Industrial Average)* etj. Për Bursën e Frankfurtit përmendim treguesin *DAX* , apo të Hong Kongut *Hang Seng index*, një indeks që u kuotua për herë të parë në vitin 1964 dhe mori emrin e bankës Hang Seng. Përmendim se rreth 170 miliard aksione të më tepër se 2800 kompanive janë të listuara në NYSE ku tregtohen më shumë se 400 milion aksione.

Në Mbretërinë e Bashkuar, por dhe në disa vende anglo-saksone, ku ekonomia e tregut është zhvilluar në mënyrë të konsiderueshme nëpërmjet rritjes së qëndrueshme ekonomike, ka një shkallë të lartë të shpërndarjes së kapitalit dhe të strukturës së aksionerëve. Popullsia mund të ndërhyjë drejtpërdrejt kur e shikon të arsyeshme në zhvillimin ekonomik nëpërmjet blerjes dhe mbajtjes së aksioneve duke i dhënë mundësi vetes për investime në tregjet e kapitalit duke u përfaqësuar në pronësi ose kapital neto në një korporatë. Megjithatë modeli anglo-amerikan karakterizohet nga tregje likuide

dhe me shkallë të ulët rregullimi si të tregut të punës edhe atij të kapitalit. Në kontrast me të, Evropa Kontinentale dhe Japonia karakterizohen nga një shkallë e lartë përqendrimi pronësie e shoqërive të mëdha, me bankat dhe shoqëritë e sigurimit si ofrues kryesorë të kapitalit. Aksionerët e shoqërive evropiane janë më të fuqishëm, për faktin se në pjesën më të madhe në përbërje janë pak aksionerë me përqindje të mëdha aksionesh (në ndarje).

Modeli i Evropës Kontinentale është karakterizuar nga një përqendrim i lartë i kapitalit. Aksionerët kanë interesa të përbashkëta me organizatën dhe marrin pjesë si në menaxhimin ashtu dhe në kontrollin e saj. Menaxherët janë përgjegjës për një grup më të gjerë të palëve të interesuara, përveç aksionerëve si psh : sindikatat, partnerët e biznesit, etj.

Në sistemin gjerman të qeverisjes, ndërmarrja është parë si kombinimin i grupeve të ndryshme të interesit që kanë për qëllim për të koordinuar objektivat kombëtare të grupeve të ndryshme të interesit. Nisur nga një pikëpamje historike, bankat gjermane kanë luajtur një rol të rëndësishëm në vendimet e korporatave. Vetëm një nga katër shoqëritë në Gjermani kanë të drejtën e transaksioneve publike, shumica e shoqërive kërkojnë ndihmë financiare nga bankat. Një rëndësi të madhe i është dhënë mbrojtjes së kreditorëve, madje deri në pikën ku një bankë mund të dominojnë një firmë ose ndërmarrje. Në Gjermani, sistemi i qeverisjes së korporatave është një sistem i dyfishtë, duke synuar në të njëjtën kohë dhe një politikë kombëtare, duke i siguruar punonjësve qasje në informata dhe pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme të ndërmarrjes. Sistemi i qeverisjes japoneze është një sistem i cili lehtëson: a) monitorimin dhe financimin në mënyrë fleksibël të ndërmarrjeve, b) komunikimin efektiv midis tyre dhe bankave, si dhe duhet thënë se burimi kryesor i financimit konsiderohet kredia bankare. Në Japoni, politikat e korporatave janë të ndikuar nga ndërhyrja aktive e qeverisë për sa kohë zyrtarët janë stakeholders në shumë shoqëri. Siç ka hulumtuar gjerësisht Tricker (2009), modelet e qeverisjes së korporatave mund të shihen të formuar në bazë të dy sistemeve të dallueshme të bordit: bordit unitar si dhe atij me dy nivele i cili është i përbërë nga bordi mbikëqyrës (drejtorë jo-ekzekutivë dhe bordi i menaxhimit). I dyti (me dy nivele) njihet si sistemi gjerman ndërsa i pari është i zakonshëm në Shtetet e Bashkuara dhe Mbretërinë e Bashkuar, duke përfshirë vendet e Commonwealth. Pikërisht ligji në Amerikë nuk ndan funksionin ekzekutiv dhe jo-ekzekutiv ndërmjet drejtuesve të

korporatës. Aksionerët janë në krye të hierarkisë, ndërkohë punët e përditshme në korporatë janë në duart e bordit të drejtorëve si organ qeverisës me mbizotërim të drejtorëve të jashtëm të pavarur, ndërsa shefi ekzekutiv (CEO) mund të mbajë përgjegjësi të dyfishtë si të shefit ekzekutiv dhe kryetarit të bordit (chairman). Kjo është një praktikë e zakonshme në SH.B.A si dhe në shumë shoqëri me pronësi anëtarë familje në disa vende të botës. Në modelin anglo-amerikan, autoriteti vendimmarrës qëndron tek menaxhimi për shkak të përqendrimit të ulët të aksionerëve. Modeli i Evropës Kontinentale (E.K) është karakterizuar nga një përqendrim i lartë i kapitalit. Në këtë rast kemi të bëjmë me shoqëri me përqendrim në strukturën e pronësisë. Fuqia për të marrë vendim në modeline evropës kontinentale, përkundrazi, është në duart e një aksioneri të vetëm ose disa të mëdhenjve (ose pak aksionerë të mëdhenj). Prandaj problemet e agjencisë që kanë të bëjnë me modelin anglo amerikan lindin ndërmjet aksionerëve dispersë dhe të menaxhimit, e kundërta e aksionerëve kryesorë ndaj aksionerëve në minorancë në modelin e E.K (Piesse *et al* ., 2011). Në kontekstin evropian një model i QK i njohur si dualist vë theks më të madh në interesat e palëve të interesuara “stakeholder’s model”. Aksionerët kanë interesa të përbashkëta në organizatë dhe marrin pjesë në menaxhimin dhe kontrollin e saj. Menaxherët janë përgjegjës për një grup më të gjerë, konkretisht të palëve të interesuara ku bëjnë pjesë sindikatat, partnerët e biznesit, etj. Në disa vende evropiane (Belgjikë, Spanjë, Portugali, Itali, etj), objektivi i zhvillimit të mekanizmave të zhvillimit të qeverisjes është përmirësimi në informacionin e dhënë në tregun e kapitalit dhe përmirësimi i performancës shoqërisë dhe konkurrencës. Për vendet me traditë në tregjet e kapitalit (në Mbretërinë e Bashkuar, Franca, Gjermania, etj), objektivi kryesor i këtyre mekanizmave lidhet me punën e bordeve të drejtorëve, që do të thotë cilësi e ofruar në informacionin e dhënë në lidhje me qeverisjen e korporatave. Në vendet post-socialiste të Evropës, adaptimi i standardeve të QK pati varësi nga trashëgimia e kaluar ligjore. Korporatat e privatizuara në disa vende (Pucko 2005) u ballafaquan me dobësi të sistemit të tyre të qeverisjes. Grupi i Evropës Qendrore dhe Lindore dhe Baltikut (CEB) kishte një trashëgimi juridike gjermane, e cila përfshin Republikën Çeke, Estoninë, Kroacinë, Letoninë, Lituaninë, Poloninë, Hungarinë, Republikën Sllovaqe dhe Slloveninë. Grupi i vendeve të Evropës Juglindore (SE) kishte një trashëgimi franceze ligjor që përfshin Bullgarinë, ish-Jugosllavinë, Rumaninë, Bosnjën dhe Hercegovinën dhe Shqipërinë. Në

jo pak raste ka patur mungesë legjislacioni të përshtatshëm apo të dhënash të besueshme, psh pronësi deisperse, apo privatizim më shumë tek pronarët “outsider’s sesa tek insiders”(Çeki, Poloni, Hungari). Pistor (2000) konstaton se trashëgimia e kaluara ligjore nuk ishte e rëndësishëm për të shpjeguar se çfarë sistemi mbizotëron në strukturën ligjore. Miratimi gjatë periudhës fillestare të transformimeve të bazës ligjore, bazë e cila do ishte udhërrëfyese për ekonomitë e tregut është shtyrë më shumë nga dëshira për të konvergjuar me sistemin ligjor të BE-së, me synimin për të arritur akses ne sistemin amerikan. Duke filluar nga viti 2002 vendet në tranzicion konvergjuan drejt modelit anglo-sankson me dy organe qeverisëse: asambleja e aksionerëve dhe bordi i drejtorëve. Diferenca në krahasim me modelin gjerman (ose i Evropës kontinentale) është se ndërmjet asamblesë së aksionerëve dhe bordit të drejtorëve qëndron këshilli mbikëqyrës (model që aplikohet në vende si Japoni, Kinë, Kore, Tajlandë). Vendet në tranzicion pas viteve 2002 filluan huazimin e modeleve nga njëri-tjetri. Me kalimin e viteve dhe anëtarësimin në BE, vende të ndryshme filluan evropianizimin e qeverisjes së korporatave. Edhe brenda BE-së vendet anëtare kanë modele të ndryshme të menaxhimit të korporatave që pasqyrojnë kulturat e tyre të ndryshme dhe pikëpamjet e ndryshme. Me kapitalizëm më specifik, më afër atij anglo-sankson paraqiten vendet që u bënë anëtarë të BE-së në vitin 2007 si Bullgaria, Rumania dhe Kroacia. Vendet në tranzicion me tregje kapitali më të zhvilluara konvergjuan drejt regjimit ligjor anglez të qeverisjes së korporatave. Vende si Sllovenia apo Estonia (anëtare e BE-së që në vitin 2004 dhe eurozonës në vitin 2011) cilësohen si vendet më liberale të Evropës madje dhe për politika sociale të suksesshme dhe eficiente me drejtim modelin e Evropës kontinentale. Përpjekje për të harmonizuar sferën e QK me mbështetjen për integrim në tregjet e kapitalit të BE-së janë treguar në dokumente apo standarde që përshkruajnë mbikëqyrjen dhe menaxhimin e shoqërive brenda BE-së dhe jashtë saj gjatë kësaj dekade (Kavalir, 2005). Modeli anglo-amerikan apo i Evropës kontinentale? Nuk mund të themi që dominon modeli anglo-amerikan. Nëse duam një model agresiv kemi modelin anglo-amerikan. Për një model me më pak risk kemi modelin evropian (të Evropës kontinentale). Qeverisja e mirë është akoma e vështirë të matet plotësisht, ajo është në evoluim, organizatat kryejnë vetë-vlerësime. Një strukturë e mirë e qeverisjes së korporatave inkurajon marrëdhënien ndërmjet aksionerëve, drejtorëve ekzekutivë dhe bordit të drejtorëve. Në një firmë të menaxhuar në mënyrë efikase edhe shpërblimet janë

të ndarë në mënyrë të barabartë ndërmjet aksionerëve dhe palëve të interesuara. Mund të konkludojmë në faktin që globalizimi dhe konvergjenca e modeleve lidhen ngushtësisht edhe me globalizimin e tregjeve dhe të produkteve.

2.4.1 Rëndësia e transparencës dhe zbulimit

Kriza financiare e vitit 2008 nxori në pah mangësitë e transparencës dhe zbulimit për investitorët. Kur është e nevojshme, përgatitësit dhe audituesit duhet të shkojnë përtej dhënies së informacioneve shpjeguese të kërkuara, për të siguruar investitorët me një kuptim të plotë të efekteve themelore ekonomike të transaksioneve dhe bilanceve.

Shumë analistë e specialistë të sektorit e vlerësonin situatën e viti 2008 kur kriza po bëhej thuajse e evidente, të ngjashme me krizën e depresionit të madh (Civici, A 2010, Kriza financiare..... apo globale). Kriza e vitit 2008 bëri që politikat mbi rregullimin e pagave të ekzekutivëve të dalin tej kornizave kombëtare.

Kriza financiare depërtoi me shpejtësi në mjaft shtete, pasi ekonomitë nuk janë as ishull dhe as oaz. Kështu ishte tremujori i parë i vitit 2008 kur kriza filloi të shfaqej në Evropë duke pasur efektet e veta jo të vogla në disa shtete, fillimisht në Angli dhe më pas në bankat e vendeve të fuqishme si në Zvicër, Francë, Gjermani etj. Kriza financiare filloi të kishte efekt jo vetëm në sistemin financiar por edhe mbi bizneset madje dhe në vendet më të zhvilluara. Kështu sondazhi i “British Chamber of Commerce” për tremujorin e tretë të vitit 2008, studimi i së cilës i aplikuar në 5 mijë biznese, fliste për “shenja shumë shqetësuese” që vinin nga ekonomia reale (Civici, A. 2010, Kriza financiare..... apo globale).

Në të vërtetë, në praktikën amerikane, kompensimi menaxherial është konsideruar si një mjet primar për harmonizimin e interesave të menaxherëve dhe aksionerëve dhe në mënyrë tipike përfshin një pjesë të madhe të opsioneve të aksioneve (me një mesatare pothuajse një e treta e totalit të kompensimit). Konkretisht planet e opsioneve të aksioneve. Aksionerët dhe menaxherët kanë pasur preferenca për skema të ndryshme kompensimi. Aksionerët shpesh dëshironin shpërblim të varur nga ecuria e çmimeve të aksioneve, ndërsa menaxherët të lidhur me rezultatin e shoqërisë. Gjatë 10 vjeçarit të fundit të shekullit të kaluar, shpërblimi i CEO-ve u rrit në mënyrë të ndjeshme si në terma absolutë ashtu dhe në terma relativë. Për fat të keq, në vend që drejtuesit të zgjidhnin standardet e performancës për shkak të integritetit profesional, apo deri diku

normat e mirëbesimit në detyrë të gërshetuar me kontrollin efikas, disa drejtues u pa të merrnin përsipër risqe të tepërta duke e bërë këtë për shkak të nën-vlerësimit, si dhe duke marrë stimuj të pamërituar. Sipas Fortune 500, një listë vjetore e përpiluar dhe publikuar nga revista *Fortune* që rendiste 500 korporata publike në SH.B.A nga të ardhurat e tyre bruto, kompensimi mesatar i CEO-ve për vitin 2008 ishte 10.4 milion \$. Shpërblimi gjithsej për “Fortunate 2500” në vitin 2008 ishte 11 miliard \$, ose një mesatare prej 4.9 milion \$/ekzekutiv.

Analiza e vjetore e Watson të kompensimit të drejtorëve në “Fortune 500” ka gjetur se në vitin 2009 paketa e pagesave për drejtorët u ngjit vetëm 1% mbi nivelin 2008. Kjo, si nivel është më e vogël se rritja 3% e marrë në vitin 2008.

Para krizes ekonomike, drejtorët kishin marrë në mënyrë të qendrueshme rritje vjetore të paguar prej gati 10%.

Sipas analizave, kompensimi i përgjithshëm për drejtorët e jashtëm në kompanitë e studiura është rritur në nivelin 200.698 \$ në vitin 2007, nga një vlere mesatare prej 199.949 \$ në vitin 2008. Kompensimi i pagave rritet me 1% (nga \$ 83,875 në vitin 2008 në \$ 85,000 në vitin 2007), ndërsa vlera e çmimeve të aksioneve (kapitalit) është rritur me një përqindje të vogël, konkretisht me 104,939 \$ nga \$ 103,963 në vitin 2007. Megjithatë paga është elementi thelbësor, pohojmë se ajo nuk është i vetmi element shpërblimi. Në vitin 2008, gati dy të tretat e totalit të kompensimit të CEO-s është dhënë në formën e aksioneve ose opsioneve të aksioneve.

2.4.1 a) Kriza dhe efektet e saj.

Krizat në institucionet financiare të vitit 2008 janë përshkruar si krizat më serioze financiare, që nga koha e Depresionit të Madh. Nga mesi i vitit 2008 ishte e qartë që, kriza në SHBA, e lidhur me mungesën e likuiditeteve pati një ndikim shumë të madh në institucionet financiare dhe në bankat e shumë vendeve. Bear Stearns u ble nga JP Morgan Chase, me mbështetjen e Federal Reserve Bank të New York-ut dhe institucionet financiare si në SHBA (Citibank, Merrill Lynch) ashtu dhe në Europë (UBS, Credit Suisse, RBS, HBOS, Barclays, Fortis, Societe Generale) vazhdonin të shtonin sasi të konsiderueshme kapitali, për të financuar ndër të tjera humbjet e mëdha në aktivet e tyre, duke zbehur, në shumë raste, ekzistencën e aksionerëve. Freddie Mac

and Fannie Mae u desh të merreshin nën kontrollin e qeverisë, kur u pa se pozicioni i kapitalit të tyre ishte më i dobët nga ai që pritej. Kolapsi i Lehman Brothers thelloi krizën, duke çuar në një humbje të përgjithshme të besimit dhe dështime e rikapitalizime bankash në Europë dhe SHBA. Të gjitha këto dështime nxjerrin në pah nevojën për të rishqyrtuar, për të analizuar përshtatshmërinë e parimeve të qeverisjes së korporatave aty ku u vu re se ishin më të dobëta, sidomos në sistemin e menaxhimit të rrezikut dhe në shpërblimet e drejtuesve ekzekutive; të dyja kompetenca të Bordit Drejtues.

a)-Limitet e përcaktuara me ligj mbi nivelin e pagës së ekzekutivëve

Imponimi i kufzimeve të specifikuara me ligj mbi nivelin e pagës së ekzekutivëve nuk kanë qenë të shumta që nga fillimi i krizës. Megjithëse presidenti francez Sarkozy përkrahte vendosjen e kufive mbi bonuset e ekzekutivëve në Shtator 2009 në samitin e G 20 në Pittsburgh të Amerikës, ky parim nuk u finalizua dhe kundërshtimi i shumë palëve në samit për këtë ide, u reflektua më vonë në numrin e kufizuar të politikave të adaptuara në nivel kombëtar, të cilat vendosnin kufij (caps) mbi nivelet e shpërblimit të ekzekutivëve. Sidoqoftë, ekzistonin disa precedentë. Për shembull, në Rusi në vitin 2009 u inicua një politikë në Dumën ruse që synonte të kufizonte me ligj nivelin e pagës së ekzekutivëve të nivelit të lartë. Në Kinë, caps u imponuan mbi nivelin e pagave të ekzekutivëve në një sërë rastesh. Në shkurt 2009, ministri kinez i financave vendosi limit prej 2,8 milion jen (410 mijë \$). Në prill 2009 vendosi një limit prej 90% të nivelit të vitit 2007 në institucionet financiare të Kinës.

b)-Trajtimet 'softer' të pagës së ekzekutivëve

Deri sot trajtimi më i përhapur për rregullimin e pagës së ekzekutivëve që prej fillimit të krizës ka qenë ajo që e quajmë rregullim i butë ('softer'). Më këtë kuptojmë përdorimin e mekanizmave të tillë të politikës që nuk i venë kufi ligjor (legal caps) nivelit të pagës së ekzekutivëve për të bërë rregullimet e synuara. Këtu përfshihen mekanizma si "naming and shaming", vota "say on pay" e aksionerëve dhe publikimi i niveleve të pagave të ekzekutivëve me qëllim që të arrihet një qeverisje më e mirë e niveleve të pagave të ekzekutivëve. Megjithëse vënia në zbatim e këtyre rregullimeve është bërë nëpërmjet rregullave detyruese, analitikisht është e dobishme t'i konsiderojmë këto

forma si “*softer*” për shkak se ato nuk detyrojnë me ligj venien e kufijve për nivelin e pagave të ekzekutivëve.

Vënia në zbatim e politikave “*say on pay*” mbi pagat e ekzekutivëve u bë mjaft e përhapur në shumë vende qysh prej fillimit të krizës. Politikat e ‘say on pay’ kanë të bëjnë me dhënien e aksionerëve brenda firmës të drejtën e votës për nivelin e pagës së ekzekutivëve. Ka një sërë shembujsh të aplikimit të politikave të tilla në Amerikë. Kështu, në vitin 2008, *The Emergency Economic Stabilization Act* u pasua nga Troubled Assets Relief Programme (TARP), i cili alokonte fonde tek firmat në vështirësi financiare. Si pjesë e Aktit/ligjit, firmat që kishin borxh para’ tek TARP-i ishin të detyruara ligjërisht për ‘say on pay’. Gjatë vitit 2009, autoritetet publike amerikane sinjalizuan për vendosmërinë e tyre për zbatimin e kësaj kërkesë për firmat që merrnin fonde nga TARP. Aplikimi i politikave ‘say on pay’ u zgjeruan më tej. Në qershor 2009, The US House of Representatives kaloi “*Corporate and Financial Institutions Compensation Fairness Act of 2009*”. Ky ligj kërkonte që ‘say on pay’ të aplikohet në të gjitha institucionet publike brenda Amerikës dhe gjithashtu, u jepte të drejtën aksionerëve të votonin mbi ‘*golden parachute*’ të ekzekutivëve.

Pagat e larta konsideroheshin të pajustificueshme në kohë krize dhe veçanërisht në sektorin financiar mos harmonizimi i shpërblimit me riskun, theksimi i ‘*short-termism*’ dhe disbalanca ndërmjet shpërblimit të ekzekutivëve të firmës dhe nivelit ekzistues të kapitalit me sistemet e shpërblimit, kishin ndihmuar në precipitimin e recesionit.

- ***Politikat në kuadrin e kornizave kombëtare***

Politikë-bërësit filluan kërkimin e zgjidhjeve që do ‘*kuronin*’ shqetësimet. U hartuan disa politika në nivel kombëtar, por ndërkohë ishte përhapur mendimi se me qëllim që të trajtoheshin si duhet problemet që lidheshin me këtë çështje, duhet që të ndërmerreshin veprime në *rang ndërkombëtar*. Tre tipe politikash u ndërmorën me qëllim që të rregullonin pagat e ekzekutivëve: a) politika e formës ‘*hard*’ që synon të ulë (to cap) nivelet e pagave të ekzekutivëve, b) politikat që janë ‘*softer*’ që përdornin teknika që u jepnin më shumë të drejta ekzekutivëve për të përcaktuar nivelin e shpërblimit dhe të kufizonin praktikën e bonuseve të garantuara shumë vjeçare, dhe c) politika në nivel ndërkombëtar. Por qeverisja e korporatave nuk mund të qëndrojë në vend numëro. Pritjet e bordeve ndryshojnë vazhdimisht – veçanërisht në kohët e sotme,

kohë e ndryshimeve të mëdha. Shoqëritë në mbarë botën gjithnjë e më tepër po kërkojnë borde efektive, fleksibël dhe dinamike në kuadrin e qeverisjes së korporatave. Kërkesa për një qeverisje dinamike është e bazuar në dy drejtime kryesore: *Së pari*, udhëheqja (lidhshipi) fillon në nivelin e bordit. Si dhe deri kur ushtrohet nga bordi i drejtorëve të një shoqërie, i cili përcakton dhe standardet e saj, respektivisht për çdo organizatë biznesi. *Së dyti*, qeverisja është si një mjet që mundëson performancën biznesit. Të gjitha gjërat shkojnë mirë kur shoqëria qeveriset mirë. Qeverisja dinamike kërkon që bordet të jenë më të fokusuar jashtë organizatave. Ata duhet të jenë të lidhur me palët e interesuara dhe shoqërinë. Adrian Cadbury argumenton : “qeverisja e korporatave duhet të njohë të drejtat e palëve të interesuara të përcaktuara me ligj ose nëpërmjet marrëveshjeve të ndërsjellë dhe të inkurajojë bashkëpunimin aktiv në krijimin e pasurisë, vendeve të punës dhe qëndrueshmërisë së ndërmarrjeve për të qenë këta të fundit të shëndetshëm financiarisht”. Së fundi duhet theksuar se rezultatet e takimit të G-20 në Pittsburgh (Shtator 2009) vendosën rregulla më të forta për Shtetet Anetare të Komunitetit Evropian, të cilat ishin të nevojshme për shperblimet që duhet të nxisin qëndrueshmërinë afat-gjatë të kompanive evropiane. Konkretisht le të shohim masat e marra nga Austria dhe Gjermania. *Austria*. Kodi i Qeverisjes së Korporatave u miratua në vitin 2010. Kemi shtrirjen vetëm për kompanitë e listuara për rregullimet mbi shpërblimet e ekzekutivit : a) Bonus, bazuar në qëndrueshmërinë afatgjatë të shoqërisë me kriteret e matshme. b) Shkallë të lartë të taksimit deri në 50% në shpërblim që kalon 60,000 EURO. *Gjermania*. Në kodin e qeverisjes së korporatave përcaktohet : a) Pagesa e ekzekutivit kufizohet në 500,000 EUR kur kompania ka marrë ndihmë financiare nga qeveria. b) Regjim për pagesën dhe shpërblimet e drejtorëve të kompanive të listuara :

**Paga e Ekzekutivit (bona fide), nuk mund të kalojë shperblimin e zakonshëm,*

**Bonusi llogaritet mbi bazën e disa viteve (mbi 4 vjet),*

**Opsionet e aksioneve mund të ushtrohen vetëm pas 4 viteve,*

**Mënyra më të lehta për reduktimin e shpërblimit nga bordi mbikeqyrës ose bordi për ekzekutivin (ose ekzekutivët e shoqërisë).*

c) Kompensimi duhet të nxisë dhe të promovojë qëndrueshmërinë në terma afatgjatë të komponentëve fiks dhe variable. Shpërblim vetëm nëse bazohet në vërtetësinë e punës efektive dhe jo fiktive.

2.5 Parimet e OECD-së. Rishikimi i Parimeve të Qeverisjes

OECD vazhdimisht ka qenë promotorë e programeve. Që në vitin 1990, psh OECD filloi aplikimin e një programi specifik “partneriteti për tranzicionin”, që synonte realizimin e një sërë studimesh për vendet i-sh socialiste të lindjes, asnjë nga të cilat nuk ishte anëtar i saj (Polonia, Çekia dhe Hungaria u anëtarësuan në OECD në vitet 1995-96, p.sh Polonia me 22 nëntor 1996 apo Hungaria 7 Maj 1996).

Si pasojë e krizës financiare aziatike të vitit 1997, mbledhja e Këshillit të OECD në nivel ministrash, i kërkoi OECD që të zhvillonte një komplet të standardeve dhe udhëzimeve mbi qeverisjen e shoqërive aksionere. Ajo është institucioni i vetëm nërkombëtar i pranuar, i parimeve të qeverisjes që trajtojnë gjithë kuadrin e qeverisjes së shoqërive aksionere, kuadrin ligjor, institucional, strukturat dhe praktikën rregullatore që krijojnë kontekstin në të cilën veprojnë shoqëritë. Aktualisht jemi në një proces interaktiv dhe evolutiv të reformës në fushën e QK (CG) pas krizës financiare, krizë e cila ende nuk ka kaluar plotësisht. Humbjet katastrofike të firmave financiare të cilat pothuajse çuan në një kolaps sistemin financiar, ndjekur nga recesioni i thellë global theksuan rëndësinë e reformimit të CG-së (Lang & Jagtiani, 2010). Parime të shëndosha të qeverisjes së korporatave janë themeli i ndërtimit të besimit mbi të cilin janë ndërtuar marrëdhëniet ndërmjet investitorëve dhe stakeholdersave që mund të jenë huadhënës, shoqëri të ndryshme etj. Praktika e mirë e qeverisjes së korporatave mund të ketë ndikim të rëndësishëm në vendimet e ndryshme strategjike të një shoqërie p.sh : në financimin e jashtëm, koston e këtij financimi, në gjetjen e burimeve të ndryshme alternative etj. Prandaj variablat e qeverisjes së korporatave të tilla si : madhësia e bordit, përbërja e bordit, aftësitë e bordit dhe shefit ekzekutiv (CEO) mund të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në ecurinë e qeverisjes nëpërmjet vendimmarrjeve të cilët duhet të jenë të mirë studiuar. Praktikën e mirë të qeverisjes së korporatave ndihmojnë shoqëritë tregtare dhe institucionet financiare të:

- përmirësojnë ecurinë, aktivitetet, konkurueshmërinë, rendimentin dhe vlerën afatgjatë
- përcaktojnë role të qarta, përgjegjësitë dhe përgjegjshmëritë

- përmirësojnë procesin e vendimmarrjes dhe cilësinë e vendimeve
- përkufizojnë dhe zbatojnë strategjinë dhe drejtimin e korporatës
- zgjerohen në mënyrë të qëndrueshme, identifikojnë dhe menaxhojnë rreziqet
- përmirësojnë rolin dhe strukturat e kontrollit të brendshëm
- vendosin elementë motivuese në përputhje me strategjinë e biznesit
- tërheqin kapital si dhe partnerë në investime dhe biznes
- ndërtojnë reputacionin dhe besimin nëpërmjet forcimit të marrëdhënieve me partnerët
- përgatiten për brezat pasardhës

OECD-ja ka përcaktuar një kuadër të detajuar (ligjor, institucional e rregullator), të quajtur ndryshe *Parimet e Qeverisjes së Korporatave*, apo *Parimet e OECD-së* siç i njohim tashmë. Ndër këto parime duhet të theksojmë :

-trajtim i drejtë i të gjithë aksionerëve (përfshi aksionerët e huaj dhe ata në pakicë)

-ndarja e qartë e kompetencave midis autoritetit mbikëqyrës dhe atij rregullator

-bashkëpunimi midis shoqërisë dhe grupeve të tjera të interesit për të kontribuar për të mirën e përbashkët

-transparenca dhe hapja ndaj personave të interesuar për financat dhe veprimet e shoqërisë

-parandalimi i ujdive të brendshme

-ushtrimi eficient i roleve menaxhuese dhe mbikëqyrëse nga ana e drejtuesve të shoqërisë dhe bordit të drejtoreve, inkluduar këtu llogaridhënien tek aksionerët.

Në mjaft vende, parime të tilla kanë ndihmuar për mbrojtjen e të drejtave të aksionerëve dhe trajtimin e barabartë të tyre (të gjithë aksionerët e së njëjtës klasë aksionesh të kenë të njëjtën të drejtë vote), inkurajimin e bashkëpunimit ndërmjet shoqërisë dhe aksionerëve (për shembull përfshirës së kreditorëve në procesin e vendimmarrës në procedurat e falimentimit, inkurajim të konsultimeve midis drejtuesve të shoqërisë dhe përfaqësuesve të punëtorëve etj.), për realizimin e transparencës dhe hapjen ndaj informacionit, ndalimin e tregtimit të brendshëm dhe ujdive të fshehta e abuzive, për rritjen e përgjegjësisë së nëpunësve dhe drejtorëve. Preambula e *Parimeve të OECD-së* shprehet në lidhje me këto parime: "janë evolucioniste në natyrë dhe duhet të rishikohet në dritën e rrethanave të ndryshimeve të rëndësishme". Gjithashtu pranohet se, "Për të mbetur konkurrues në një botë në ndryshim, korporatat duhet të përtërijnë dhe

përshtatin praktikat e tyre të qeverisjes së tyre në mënyrë që ata të mund të përmbushin kërkesat e reja dhe të kuptojnë mundësitë e reja që ofrohen". Parimet e OECD-së nuk janë detyruese as edhe për vendet e industrializuara që janë anëtarë të OECD-së, përbëjnë një nga dokumentat më influencues në promovimin dhe rregullimin e Q.K nga forume të tjera si IFC, GCGF (Global Corporate Governance Forum), organizma të tjera që operojnë në kuadrin e BE-së, si dhe hartimin e kodeve të Q.K nga vendet anëtare të BE-së. Realizuar fillimisht në Maj të vitit 1999, dhe rishikuar në vitin 2004, parimet e OECD-së janë një nga 12 standardet kyçe për stabilitetin financiar ndërkombëtar të Bordit të Stabilitetit Financiar (BSF) dhe formojnë bazën për komponentin e qeverisjes së korporatave të Raportit për Zbatimin e Standardeve dhe Kodeve të Grupit të Bankës Botërore. Parimet ofrojnë udhëzime specifike për politikëbërësit, rregullatorët, dhe pjesëmarrësit e tregut për përmirësimin e kuadrit ligjor, institucional dhe rregullator, që përbën bazën e qeverisjes së korporatave me një fokus në shoqëritë tregtare publike. Ata gjithashtu ofrojnë sugjerime praktike për bursat, investitorët, korporatat, dhe palët e tjera që kanë rol në procesin e zhvillimit të qeverisjes së mirë të korporatave. Duke u njohur si një nga 12 standardet thelbësore siç e lartpërmendëm për sistemet e përshtatshme financiare ato janë komponenti më i rëndësishëm i ROSC (Review of Standards and Codes) ndërmarrë nga BB dhe FMN si dhe janë mbështetur nga Rrjeti Ndërkombëtar i Qeverisjes së Shoqërive Aksionere. Parimet e OECD-së nuk janë detyruese as edhe për vendet e industrializuara që janë anëtarë të OECD-së, përbëjnë një nga dokumentat më influencues në promovimin dhe rregullimin e Q.K nga forume të tjera si IFC, GCGF (Global Corporate Governance Forum), organizma të tjera që operojnë në kuadrin e BE-së, si dhe hartimin e kodeve të Q.K nga vendet anëtare të BE-së. Komiteti i Qeverisjes së Korporatave i Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), aktualisht ka filluar rishikimin e parimeve (të OECD-së) mbi qeverisjen e korporative. Nëpërmjet anëtarësimit të tij në Komitetin Këshillimor të Biznesit dhe Industrisë në OECD, IFAC (International Federation of Accountants) do të marrë pjesë drejtpërdrejtë në këto rishikime. Rezultati duhet të sigurojë politikbërësve, rregullatorëve dhe organeve të tjera rregullatore, pika referimi të shëndosha për krijimin e një kuadri efektiv të qeverisjes së korporatave. Baza për rishikim do të jetë versioni i 2004-ës i parimeve, të cilat përmbajnë atë që ne e quajmë kuptim gjithëpërfshirës të një niveli të lartë të transparencës, përgjegjshmërisë,

mbikëqyrjes së bordit, dhe respektimit të të drejtave të aksionerëve si dhe rolit të të interesuarve (stakeholdersave) kryesorë si pjesë të themelimit të një sistemi të qeverisjes së korporatave që funksionon mirë. Sipas udhëzimeve përkatëse, këto “vlera themelore” duhet të “mirëmbahen”, dhe sipas rastit, të forcohen me ndryshime respektive për të pasqyruar eksperiencat e ndryshme që nga viti 2004 duke dhënë në këtë mënyrë më të mirën e mundshme për një qeverisje me standarde të larta. Metodologjia e vitit 2006 për *Zbatimin e Vlerësimit të Zbatimit të Parimeve të OECD-së të Qeverisjes së Korporatave* mbështet dialogun për zbatimin e Parimeve në një juridiksion dhe ofron një kornizë për diskutimet e politikave. OECD-ja shprehet: “..... se dobësitë e qeverisjes së korporatave në lidhje me shpërblimet e drejtuesve, me administrimin e rrezikut, me praktikën e bordit dhe me ushtrimin e të drejtave të aksionerëve, patën një rol të rëndësishëm në zhvillimin e krizës financiare, dhe se të tilla dobësi u përhapën tek shoqëritë në mënyrë të përgjithshme”. Kriza financiare duke filluar që nga viti 2008 zbuloi mangësi të rënda në qeverisjen e korporatave. Standardet ekzistuese nuk arritën të sigurojnë kontrollet dhe ekuilibrat (*checks and balances*) që shoqërive ju duhet të “kultivojnë” praktika të shëndosha biznesi. OECD-ja, në këtë kuadër lançoi një plan veprimi ambicioz për të zhvilluar një set rekomandimesh për përmirësime në fushat prioritare të tilla si shpërblimi, menaxhimi i riskut, praktikën e bordit dhe ushtrimin e të drejtave të aksionerëve. Gjashtë rishikime kanë përfunduar deri më tani:

- Menaxhimi i Rrezikut dhe Qeverisja e Korporatave (së shpejti)
- Mbikëqyrja dhe Zbatimi në Qeverisjen e Korporatave (2013)
- Emërimi i Anëtarëve të Bordit dhe Zgjedhjeve (2013)
- Transaksionet e palëve të ndërlidhura dhe të drejtat e aksionerëve në pakicë (2012)
- Roli i investitorëve institucional në promovimin e qeverisjes së mirë të korporatës (2011)
- Praktikën e Bordit: Nxitjet dhe Rreziqet Qeverisëse (2011)

2.5.1 Dështimet e qeverisjes së korporatave, rekomandimet për daljen nga kriza

Ekonomia globale vazhdon të përjetojë një klimë të vështirë vitet e fundit. Çfarë filloi si një krizë financiare në SH.B.A dhe Mbretërinë e Bashkuar shpejt u kthye në recensionin global më të madh në dekada. Kriza e fundit financiare dhe e borxheve e ka vendosur

debatin mbi qeverisjen e korporatave në një platformë të re. Madje në fakt nuk është e vështirë të vihet re se kriza e madhe financiare që lindi në 2008-ën në SHBA u intensifikua me krizën e Eurozonës prej 2011-ës e këtej, e cila ka zhbërë në pak vite reforma që kanë dashur dekada për tu zbatuar ose më saktësisht për tu bërë të zbatueshme. Duhet theksuar se së bashku me treguesit makroekonomikë, kriza financiare solli dështime në drejtim të qeverisjes së korporatave si dhe :

- a) Dobësi të rënda në ato çfarë ishin konsideruar institucione “të sofistikuar”.
- b) Shumë instrumente të qeverisjes së korporatave u provuan të ishin të paefektshëm përballë presioneve të papritur dhe konfliktit të fortë të interesit. Dështimet e qeverisjes së korporatave prekën shoqëritë financiare, por gjithashtu shumë nga dobësitë strukturore ishin dhe në shoqëritë e përbashkëta dhe shoqëritë komplekse të listuara. Këto dështime kanë ardhur kryesisht për shkak të ekzistencës dhe zbatimit të hendekut të rregullave dhe standardeve ekzistuese. Plani i veprimit i OECD-se mbi Qeverisjen e Korporatave ka përfshirë konsultime në një gamë të gjerë të përfaqësuesve të vendeve të jo të OECD-së, sektorit privat, palëve e tjera të interesuara dhe shoqërisë civile. Më konkretisht:

- a) Krijimin e një seti të përfundimeve në fushat specifike të Qeverisjes së Korporatave, ku janë gjetur mangësitë më të rëndësishme të zbatimit të parimeve.
- b) Zhvillimin e mekanizmave më të mira dhe sistematike për rishikim dhe për dialog, si instrumente të përdorura për zbatimin e monitorimit efektiv dhe identifikimin në kohë të "problemeve" të reja. Ndërkohë pikat që komiteti ka vendosur të trajtojë me prioritet janë:

1. Qeverisja e shpërblimit.
2. Zbatimi me efektivitet i menaxhimit të riskut (risk-management).
3. Cilësia e praktikave të bordit.
4. Ushtrimi i të drejtave të aksionerëve.

Në shumë raste çuditërisht lidhjet ndërmjet performancës dhe shpërblimit ishin shumë të dobët apo të vështirë për tu vendosur. Shpërblimi duhet të krijohet nëpërmjet një procesi qeverisje të shëndoshë (duke shmangur konfliktet e interesit ku roli i komiteve të pavarura dhe këshilltarëve është primar). Gjithashtu në jo pak raste risku nuk është menaxhuar me bazë ndërmarrje dhe nuk është rregulluar me strategjinë e korporatës. Nuk kemi një politikë risku për të shmangur humbjet e pritshme. Bordet ishin në një numër të rasteve jo të vetëdijshëm për rrezikun me të cilën përballej shoqëria. Menaxherët e riskut shpesh nuk janë konsideruar si një pjesë e nevojshme e vënies në

zbatim të strategjisë së shoqërisë duke qëndruar jashtë politikave të rëndësishme të planifikuara më parë. Menaxhimi i riskut shpesh ishte në vartësi të qendrave të fitimit. Duke reflektuar mungesën e standardeve adekuate, “zbulimi” i riskut të parashikimit ishte shpesh i varfër dhe mekanik për të mos thënë që ai në jo pak raste nuk llogaritej. Menaxhimi i riskut duhet të jetë i pavarur nga qendrat e fitimit dhe "zyrtari më i lartë i riskut" duhet të raportojë drejtpërdrejt në Bordin e Drejtorëve si dhe “sistemet e nxitjes për të përballuar humbjet ndërmjet matjes së riskut” duhet të monitorohen dhe ndikohen nga konsiderata të menaxhimit të riskut në frymën e përballimit të situatave jo të favorshme që mund të vijnë në kohë të ndryshme. Bordet duhet të zhvillojnë politika për identifikimin e aftësive (individualiteteve) në përbërje, për trajnimin si dhe politikën e vlerësimit. Shoqëritë duhet të shpjegojnë arsyet për zgjedhjen e strukturës së udhëheqjes së tyre dhe të bëjnë të ditur marrëveshjet e qeverisjes së korporatave, pra çfarë sugjerojnë ato (p.sh. posti i CEO-së dhe Kryetarit jo të ndarë). Një monitorim i paefektshëm nga aksionerët ka qenë një përvojë në të gjitha modelet e pronësisë. Aksionerët kanë qenë të shqetësuar se si menaxherët kanë neglizhuar efektet e politikave të marrjes së tepruar të riskut si pasiguri e ndodhjes së ngjarjeve. Shumë shoqëri kishin të punësuar ekspertë kontabiliteti, të cilët me kërkesë të shoqërisë punonin për të gjetur boshllëqe ligjore që mundësonin fshehjen e humbjeve nga raportet financiare. Kjo përjasje krejtësisht e kundërt me frymën e standardeve të Q.K. nuk është kundërshtuar nga bordet e shoqërive (ashtu si në rastin Enron). Kështu edhe teoria e buxhetimit të kapitalit e cila bashkërendon qëllimet e të mbijetuarit me atë të sigurimit të fitimit duke supozuar se drejtuesi ka si qëllim maksimizimin e vlerës së tregut të pasurisë së aksionerëve, nëpërmjet maksimizimit të vlerës së tregut të aksioneve të zakonshme nuk është ndërthurur me zbatimin e standardeve të qeverisjes së korporatave.

2.6 Qeverisja e Korporatave në Shqipëri mbështetur në kodet e publikuar të qeverisjes

QK përmirëson *performancën financiare dhe operacionale* të firmave.

- *Rrit aksesin në tregjet e kapitalit* duke rritur besueshmërinë e investitorëve.
- Shembull për Sipërmarrjet e Vogla dhe të Mesme, duke ndikuar në *krijimin e një mjedisi më të favorshëm për biznesin*.

- Ka një ndikim afatgjatë në zhvillimin e tregjeve financiare, riskut ekonomik dhe që ndikon në uljen e shkallës së korrupsionit dhe keqmenaxhimit në qarqet e biznesit dhe politikës duke influencuar në një rritje të qëndrueshme ekonomike.

Themelimi, organizimi dhe ushtrimi i aktivitetit tregtar rregullohet nga dispozitat e Ligjit nr.9901 date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”. Një sistem i koordinuar veprimtarie civile e tregtare rregullohet nga ligjet vijuese: Kodi Civil i cili përfshin rregullimin e kontratave tregtare; Ligjit nr.9901 date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, që rregullon subjektet tregtare, mënyrat e themelimit, organizimit e ushtrimit të aktivitetit tregtar; Ligjit nr.9723 (03.05.2007) “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i cili rregullon procedurat e regjistrimit tregtar, si dhe publikimin e të dhënave të detyrueshme sipas kërkesave të BE-së; Legjislacion i posaçëm mbi aktivitete të veçanta, si Ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë, Ligji nr.9879 date 21.02.2008 “Për Titujt”, etj. Ligji Nr. 9901 datë 14. 4. 2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, përcakton 4 forma të shoqërive tregtare të cilat janë si më poshtë përcaktuar :

- a. Shoqëritë Kolektive, Unlimited partnership (SHK)
- b. Shoqëritë Komandite, Limited partnership (SHKM)
- c. Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar, Limited liability company (SHPK)
- d. Shoqëritë Aksionere, Joint stock company (SHA)

Shoqëria aksionere, ose shoqëria anonime (Sh.a), është një shoqëri tregtare, kapitali i së cilës është i ndarë në aksione të nënshkruara nga themeluesit. Themeluesit janë persona fizikë ose juridikë, të cilët nuk përgjigjen personalisht për detyrimet e shoqërisë e që mbulojnë humbjet e saj vetëm me vlerën e pashlyer të aksioneve të nënshkruara. Qeverisja e korporatave bën pjesë në kuadrin e reformimit të ekonomisë shqiptare në përputhje me standardet e vendeve më të zhvilluara, ku padyshim qeveria shqiptare si aktuale por dhe të shkuarat kanë luajtur rolin e vet parësor duke i dhënë shoqërive instrumenta të rëndësishëm për të qenë sa më efektive, për të përmirësuar punën e tyre dhe për t’i dhënë drejtuesve të tyre një mundësi më shumë për sukses. Qeverisja e korporatave realizohet duke zbatuar kode, udhëzime dhe mbi gjithçka të analizueshme deri në detaj. Qeveria shqiptare dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE), si ministria kryesore, u angazhuan gjithashtu të promovojnë përgjegjësinë sociale të korporatës (CSR-në) si një element kyç i konkurrencës së qëndrueshme për

shoqëritë në Shqipëri dhe për ekonominë shqiptare në përgjithësi. Që në fillimet e demokracisë, konkretisht në vitin 1992, Shqipëria ka pasur bazë të mirë ligjore në lidhje me funksionimin e shoqërive tregtare e cila përmbante në vetvete parimet e qeverisjes së korporatave, por zbatueshmëria e tyre ka qenë e vogël. Pas ligjit të parë “Për Shoqëritë Tregtare” Nr.7638, datë 19.11.1992, kemi miratimin e Ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, që rregullon subjektet tregtare, mënyrat e themelimit, organizimit e ushtrimit të aktivitetit tregtar. Qeverisja e korporatave ka filluar ndër vite të shfaqet si një formë e rëndësishme për mirë administrimin e strukturave të shoqërive duke i dhënë atyre një dimension të ri. Në këtë kuadër, asnjë shoqëri e çfarëdo tipi qoftë, veçanërisht aksionere me aksioner shtetin apo të dala nga privatizimi dhe shoqëritë private që janë krijuar nga sipërmarrës shqiptar apo të huaj, shoqëri me model me këshill administrativ dhe administratorët (sistemi me një nivel), shoqëri me këshill mbikëqyrës dhe administratorë ose administratorët (sistemi me dy nivele në shoqëri) nuk mund të pretendojë që ka një qeverisje të mirëfilltë korporate nëse nuk zbaton kodet, me konkretisht të ketë të miratuar kodin e drejtimit të brendshëm, të jenë të përcaktuar nga shoqëria objektivat strategjike të saj, këshilli të jetë përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin e ecurisë së administratorëve, këshilli të kujdeset që shoqëria tregtare t’i respektojë aktet themeluese të saj, kërkesat përkatëse ligjore, rregullatore dhe drejtuese, të ketë rregulla të miratuara për raportimin periodik (dhe joperiodik) për aktivitetin financiar dhe kontrollin e brendshëm, të ketë një rregullore apo manual të miratuar paraprakisht për shpërblimin e anëtarëve të bordit, të ketë një rregullore (manual) që rregullon marrëdhëniet ndërmjet këshillit dhe aksionerëve, informacione të publikuara nga shoqëria (transparenca dhe zbulimi sipas q.k) në faqen zyrtare të saj në internet etj. Dy nga më të rëndësishmit janë: a) Kodi i drejtimit të brendshëm të shoqërive tregtare në Shqipëri (shoqërive aksionere jo të regjistruara në bursë). b) Manuali Shqiptar për Qeverisjen e Korporatave, pjesë e Projektit mbi Qeverisjen e Korporatave në Evropën Juglindore zbatuar nga IFC-ja (pjesë e Grupit të Bankës Botërore) dhe financuar nga Qeveria Zvicerane nëpërmjet SECO-s, (Sekretariatit të Shtetit Zviceran për Marrëdhëniet Ekonomike). Krahas këtyre dy kodeve kemi: a) Të lundrosh përmes krizave, manual për bordet, mbështetur nga IFC (pjesë e Grupit të Bankës Botërore) dhe b) Manuali i IFC-së për Qeverisjen e Biznesit Familjar është hartuar nga IFC (Korporata Financiare Ndërkombëtare), anëtare e Grupit

të Bankës Botërore në kuadër të projektit Qeverisja e Korporatave bashkëfinancuar nga SECO (Sekretariati Zvicerian i Shtetit për Çështjet Ekonomike). Këto kode i kemi përmendur në pjesën e shënimeve 1. Zbatimi me efektivitet i kodit të qeverisjes së korporatave dhe përdorimi i scorecard-it (matrica e vlerësimit me pikë), mbeten pikat më të rëndësishme për t'u diskutuar në kuadrin e qeverisjes së korporatave, duke marrë spunto nga përvoja ndërkombëtare. Madje nga ana tjetër dimë që balance scorecard (meritë të veçantë në këtë sistem ka Dr.Robert Kaplan profesor në Universitetin e Harvardit që në fillim të viteve 1990 por dhe bashkëpunëtori i tij David Norton nga kompania BS Collaborative) nuk është vetëm një sistem matje por edhe një sistem drejtimi, i cili aftëson organizatat të qartësojnë vizionin, strategjitë e tyre dhe ti kthejnë ato në veprime. Ky sistem siguron fëdback (informacion të rivlerësuar) rreth proceseve të brendshme të biznesit dhe të të ardhurave, të hyra nga jashtë tij, me qëllim përmirësimin e performancës, strategjisë dhe rezultateve të arritura. Theksojmë se si sistem matjeje, kjo metodë, nxjerr në balancë apo raporte të barabarta elementët financiarë dhe elementët jo financiarë të planit strategjik. Balance scorecard p.sh transformon planifikimin strategjik nga një projekt i shkruar në letër në një sistem nervor të një organizate. Scorecard-i qeverisjes së korporatave (CGS) u zhvillua për herë të parë në Gjermani në fund të viteve 1990 (<http://cgi-albania.org>), kohë në të cilën shoqëritë në pronësi të shtetit u privatizuan masivisht, përmendim shoqëritë blu chip të cilët përjetuan dështime serioze, si dhe shoqëri të reja të cilët kishin nevojë për kapital për aktivitetin e tyre, për të matur nivelin e respektimit të standardeve të QK-së. Në vitin 2000 Scorecard-i i ofroi ndihmë investorëve dhe analistëve të cilët kërkonin një mjet për të vlerësuar cilësinë e qeverisjes të shoqërive të tyre, e cila do t'i udhëzonte në marrjen e vendimeve për investime. Nga ajo kohë scorecard-i është përdorur në shumë vende me tregje të zhvilluara dhe në vende në zhvillim, shpeshherë me mbështetjen e IFC-së si institucion partner i rëndësishëm. Scorecard i qeverisjes së korporatave si mjet sasior,shërben për të matur nivelin e respektimit të kodit dhe/ose standardeve të qeverisjes së korporatave, me qëllim për të ndihmuar : a) rregullatorët të vlerësojnë respektimin e kodeve dhe standardeve të praktikave më të mira, b) investorët të marrin vendime të informuara, c) shoqëritë/bankat për të analizuar boshllëqet dhe mangësitë e praktikat e tyre të qeverisjes së korporatave kundrejt standardeve kombëtare; dhe d) shoqatat e biznesit për të vlerësuar praktikat e qeverisjes të anëtarëve të tyre dhe të

ndihmojë në përmirësimin e qeverisjes ndërmjet anëtarëve të tyre. Scorecard-i si instrumenti vlerësues ose kartela e rezultatit të drejtimit të domosdoshëm është një vetëvlerësim i biznesit, dhe shoqëritë nëpërmjet përdorimit të pikëve realizojnë në këtë mënyrë përmirësimin e biznesit, nëse është e nevojshme, duke iu referuar praktikave më të mira, duke rritur në këtë mënyrë edhe përgjegjësinë e korporatave ndaj partnerëve, palëve të interesuara, komunitetit, dhe shoqërisë, duke ndikuar në rritjen e mjedisit ekonomik dhe social drejt standardeve më të larta, duke i bërë shoqëritë të përgjegjshme, transparente, të qëndrueshme dhe tërheqëse për investitorët. Përvoja dhe vështirësitë që paraqet procesi i zhvillimit të një scorecard është evident në Shqipëri por shoqëritë duhet të mësohen me përdorimin e tij nëse duan rezultate. Të gjithë aktorët së bashku, rregullatorët dhe shoqëritë duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet e tyre për të vënë në praktikë rregullin “zbato ose shpjegohu” lidhur me zbatimin e Kodit të Qeverisjes së Korporatave dhe përdorimit të scorecard nga shoqëritë. Shoqëri më të mira për tregun ose segment tregun do të thotë shoqëri më e mirë jo vetëm për konsumatorin por dhe shtetin, pasi shoqëritë japin kontributin e tyre në realizimin e të ardhurave për buxhetin e shtetit. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Sipërmarrjes rreth një vit më parë ka nxjerrë për plotësim 256 pyetësorë (CG Scorecard for Unlisted JSC in Albania), adresuar në rrugë emaili ose me postë, vetëm nga sistemi bankar rregullshmëria ka qenë më e madhe, duke treguar seriozitet dhe zbatim të parimeve të qeverisjes së korporatave në këto institucione, ndërkohë që pyetësori i është drejtuar të gjithë sektorëve të ekonomisë si bujqësia, telekomunikacioni, ndërtimi etj dhe përgjigjet nuk janë dhënë, çka tregon për një nivel të ulët të transparencës por dhe në përqendrimin tek fitimi afatshkurtër i aksionerëve ose drejtuesve të shoqërisë në raport me perspektivën afatgjatë ku padyshim dhe përfitimet do të ishin më të mëdha. Scorecard-i (matrica e vlerësimit me pikë), si vetëvlerësim që plotësohet nga shoqëritë shërben që këta të fundit ta kanë më të lehtë për të parë së ku çalon puna e tyre, secila shoqëri bën analizën e vet, shikohet më mirë se ku qëndrojnë shoqëritë në cilësi, ku më e rëndësishmja është mundësia për të bërë krahasime ndërmjet industrive të biznesit për të bërë më mirë në të ardhmen, shoqëritë në këtë mënyrë bëjnë vetë vetëvlerësimin. Instrumenti vlerësues ka lindur nga investitorët, p.sh kanë qenë vetë gjermanët, siç e përmendëm me sipër, që e kanë bërë këtë vetëvlerësim (kompanitë në sektorë të ndryshëm), thënë ndryshe një “biografi” ose “foto e çastit”, dhe në këtë mënyrë çdo shoqëri e ka më të thjeshtë për të

bërë joint-venture, për të kërkuar bashkëpunim për aktivitete të caktuara dhe për të qenë më konkurrues në treg. Aktualisht në Shqipëri kemi “know-how” vendas kur shoqëritë e tjera kanë ndërkombëtarin. Instrumenti vlerësues siç e përmendëm ka anë mjaft pozitive prandaj ne duhet të veprojmë si partnerët tanë ndërkombëtarë. Shqipëria, dimë që tashmë e ka nënshkruar marrëveshjen e stabilizim asocimit, pikërisht kapitulli 6, flet për legjislacionin e shoqërive tregtare dhe kodi është pjesë e këtij instrumenti. Në muajin dhjetor 2011 bizneseve shqiptare ju paraqit kodi i realizuar me mbështetjen e IFC-së për zbatim dhe mendim, por rezultatet munguan, gjë e cila tregon për një nivel jo të mirë të qeverisjes së korporatave e për pasojë një transparencë minimale. E ritheksojmë që kodi i qeverisjes nuk është detyrim ligjor por secili në këndvështrimin e vet për konceptin dhe mentalitetin e biznesit shqiptar duhet të bëjë kujdes për zbatimin e tij pasi është një material mbështetës dhe orientues për shoqëritë tregtare që operojnë në Shqipëri, që këto të fundit të zhvillojnë një kuadër të shëndoshë të drejtimit të brendshëm. Kodi, siç shikohet në pjesën e shënimeve (shënime 1), paraqet 14 principe (parime) që duhet të ndjekë një shoqëri në qeverisjen e brendshme të saj, parime të cilat do ti garantojnë më shumë sukses në treg, daljen në tregjet evropiane dhe mbi të gjitha dhe për t’u listuar në bursë dhe madje me premisën dhe në bursat ndërkombëtare po të jetë nevoja e kërkesës nga ata për kapital. Në Shqipëri nuk mund të flitet për shoqëri të listuara, kur dihet që listimi i tyre behet në bursë dhe kjo bursë duhet të ketë funksionim të plotë në të gjitha hallkat e saj. Shumë studime në lidhje me ekonomitë në tranzicion kanë theksuar rëndësinë e zbatimit të ligjit dhe futjen në zbatim të parimeve të mirë menaxhimit të shoqërive (corporate governance) për zhvillimin e tregjeve të kapitalit (Pajuste 2002). Bursa e Tiranës, e para dhe e vetme në Shqipëri, u hap zyrtarisht me 2 Maj 1996, si departament i Bankës së Shqipërisë, me asistencë të ofruar nga GMA Capital Market Limited. Ashtu si në të gjitha vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, me një të kaluar të ngjashme me Shqipërinë, shteti edhe në Shqipëri ishte promotori dhe mbështetësi kryesor i krijimit të bursës. Duhet theksuar se në Shqipëri u ndoq një model i ndryshëm nga eksperiencia e të gjithë këtyre vendeve, pasi u vendos që Bursa e Tiranës të krijohet nën administrimin e Bankës Qendrore dhe kjo për këto arsye : a) Mungesa e një tradite të mëparshme në këtë drejtim, traditë e cila është prezent në një pjesë të mirë të vendeve në zhvillim apo vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore. b) Gama e kufizuar e instrumenteve financiarë. c) Një sektor privat më i dobët sesa në vendet e

tjera të Evropës Qendrore dhe Lindore. d) Mosfillimi për një periudhë kohe i privatizimit të ndërmarrjeve strategjike. e) Shanset e vogla të sigurimit, për një periudhë afatshkurtër, të eficiencës ekonomike të këtij institucioni të ri. f) Mungesa e ekspertëve dhe e eksperiencës përkatëse jashtë institucioneve shtetërore të sferës financiare (në rastin tonë Banka e Shqipërisë). Bursa e Tiranës është themeluar në 2002 si një shoqëri aksionere me pronësi shtetërore, ku Ministria e Financave zotëron 100% të aksioneve. Bursa e Tiranës kishte si qëllim krijimin e një tregu kapitalesh apo titujsh të cilën do ta realizonte duke krijuar një sistem tregtimi me anë të cilit ofertat për blerje, shitje, apo për këmbimin e titujve do kryhen apo pranohen rregullisht. Kjo bursë përbën tregun e vetëm të kapitalit në vendin tonë. Bursa është licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare “për të ushtruar veprimtarinë si treg i letrave me vlerë të borxhit të qeverisë, të borxhit të shoqërive dhe të aksioneve në Shqipëri”. Në këtë aspekt, Bursa e Tiranës synon që të krijojë kushtet e përshtatshme për tregtim për emetuesit, investitorët dhe ndërmjetësit financiarë. Bursa e Tiranës ka shërbyer vetëm si treg primar për shitjen e bonove të thesarit të qeverisë, funksion që e kreu deri në 1 gusht 1998, kur ky treg kaloi përfundimisht pranë Departamentit të Operacioneve Monetare të Bankës së Shqipërisë. Asnjë shoqëri aksionere nuk është listuar deri më sot në Bursën e Tiranës, e cila kërkon padyshim një transparencë më të madhe nga shoqëritë, shumë më tepër informacion të bërë publik veçanërisht të rezultateve financiare, strategjive dhe politikave të shoqërisë, shpërblimin e drejtuesve, auditimet etj. Baza ligjore ekziston. Përmendim këtu ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, ligjin “Për titujt” dhe rregullore të miratuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) lidhur me listimin e shoqërive në bursë dhe rregulloret e vetë Bursës së Tiranës. Sektori privat sipas gjasave duket sikur do të qëndrojë akoma larg Bursës së Tiranës sepse vazhdojmë që të kemi një cilësi të ulët të realitetit të raportimeve financiare ndonëse tashmë baza ligjore e politikave fiskale dhe standardeve të raportimit ka ndryshuar në përputhje me ato të BE-së, shtuar këtu dhe njohuritë e administratorëve mbi tregun e kapitaleve si dhe konkurrencën brenda sektorëve të ekonomisë. Mendojmë se duhet më tepër vëmendje nga shteti në mënyrë që Bursa e Tiranës të nisë funksionimin. Në kushtet kur sektori privat në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme mbetet vetëm një burim potencial aksionesh për Bursën e Tiranës, shteti mbetet shpresa e fundit dhe e vetme për t’i siguruar aksionet Bursës së Tiranës. Një qeverisje e mirë korporate në Shqipëri, pra një qeverisje e mirëfilltë nuk

mund të kuptohet pa funksionim burse si “lubrifikanti i kapitaleve” dhe gjetjes së partnerëve të rinj për bashkëpunim financiar. Funksioni gjithashtu dhe i fondeve të investimit duhet të jetë ndër objektivat primare pasi ashtu siç janë ligjëruar format e ndryshme të organizimit të biznesit, me Ligjin Nr.7979 dt.26.07.1995 “Për Fondet e Investimeve” si pjesë e paketës së ligjeve për strukturimin e ekonomisë së tregut, në ekonominë shqiptare ligjërohet në këtë mënyrë krijimi i shoqërive investuese si formë e organizimit të biznesit në fushën financiare.

2.7 Qeverisja e shoqërive publike në Shqipëri

Shoqëritë shtetërore në Shqipëri janë të tipit shoqëri anonime. Shoqëritë kolektive dhe komandite njihen me termin e përbashkët shoqëri personi, ndërsa shpk-të dhe sh.a-të njihen ndryshe si shoqëri kapitali. Aksionerët e një shoqërie aksionere nuk përgjigjen personalisht për detyrimet e shoqërisë, dhe mbulojnë humbjet e saj vetëm në vlerën e pashlyer të aksioneve të nënshkruara prej tyre. Kapitali i Sh.a-së është i ndarë në aksione të nënshkruara nga themeluesit të cilët mund të jenë persona fizikë dhe ose juridikë që nuk përgjigjen personalisht për detyrimet e shoqërisë ndaj të tretëve dhe kanë si detyrim vetëm dorëzimin e kontributeve të cilët kanë rënë dakort sipas nënshkrimit të kapitalit të regjistruar të shoqërisë. Ka disa opinionistë që sugjerojnë se termi QK nuk është i përshtatshëm për sektorin publik meqenëse termi korporatë lidhet me konceptin e ndërmarrjes tregtare dhe qeverisja lidhet me konceptin çdo të thotë të qeverisësh. Zyra e Thesarit në Britaninë e Madhe synon të përshtasë dhe të aplikojë praktikat më të mira në menaxhimin e korporatave, të cilët kanë vlerë për të gjithë sektorët e shoqërisë private ose publike. (Picket 2003:54, Bello.H, Zhvillimet e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik në Shqipëri, 2010 : 57). Në disa vende të zhvilluara, shoqëritë në pronësi të shtetit vazhdojnë të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të GDP-së, punësimit, dhe kapitalizimin e tregut. Qeverisja e korporatave në sektorin publik padyshim që është një sfidë mjaft e rëndësishme në shumë ekonomi të vendeve të ndryshme për vetë natyrën komplekse të saj. Shoqëritë publike në shumë vende i gjejmë në fusha të rëndësishme si transport, telekomunikacion, energji etj. Qoftë në vendet e zhvilluara apo në zhvillim këto shoqëri zënë një peshë të rëndësishme. Qeverisja e korporatave në sektorin publik është kritike, ajo ndihmon për të siguruar kontribut pozitiv në konkurrueshmërinë e përgjithshme të një vendi dhe padyshim ndihmon dhe në efikasitetin ekonomik.

Qeverisja e mirë e ndërmarrjeve shtetërore është parakusht i rëndësishëm për privatizimin efektiv, pasi do t'i bënte në treg më tërheqëse për blerësit si dhe më efektivë dhe do të rriste vlerën e tyre. Qëllimi i shoqërive publike është të arrijnë objektiva tregtare biznesi, ndërsa shoqëritë private kanë një objektiv madhor: maksimizimin e fitimit. Në Shqipëri nuk ka ligj për Shoqëritë Publike që të bëjë të detyrueshme parimet e Qeverisjes së Korporatave. Përsa i përket kuadrit institucional dhe rregullator në Shqipëri ekzistojnë disa institucione që kanë të paktën një veprimtari të tyre që përqendrohet në qeverisjen e korporatave si është psh AMF apo METE. Shoqëritë shtetërore të cilët akoma nuk janë privatizuar, ku shteti ka 100 % ose mbi 50 % të aksioneve veprojnë në përputhje me Ligjin “Për shoqëritë shtetërore”. Prona shtetërore ose "Prona" do të quajmë të gjitha pronat e paluajtshme publike të shtetit, si dhe titujt e pronësisë së shtetit mbi kapitalin e shoqërive tregtare dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore. Ndërsa vetë shoqëria shtetërore është një shoqëri tregtare, e cila zhvillon veprimtari tregtare, me interes të përgjithshëm ekonomik, aksionet e së cilës zotërohen drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë nga pushteti qendror, pushteti vendor apo nga shoqëri, ku këto pushtete veprojnë si mëmë, sipas përcaktimit të këtij ligji. Sipas rastit METE, MF apo organet e pushtetit vendor, janë përfaqësues të pronarit për pronën shtetërore. Konkretisht në rastin e METE-s (sot METS), si institucion i rëndësishëm në disa shoqëri përfaqësues i pronarit shtet, është zbatues i Ligjit “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare dhe privatizimin e tyre”, drejton punën, për hartimin e akteve të themelimit të shoqërive që krijohen nga transformimi i ndërmarrjeve, nënshkruan kapitalin themeltar dhe autorizon regjistrimin e tyre. Ministritë, departamentet, drejtoritë a institucionet e tjera që varen drejtpërdrejt nga KM, si dhe organet përkatëse të pushtetit lokal, përgjigjen për administrimin e pronës shtetërore që kanë në varësi. Prona shtetërore në shoqëritë me kapital të përbashkët administrohet nga organi që ka bërë nënshkrimin e pjesës shtetërore të kapitalit, ose, kur kjo nuk është kryer, administrohet nga dikasteri apo organi i pushtetit lokal, nga i cili ka pasur varësinë në momentin e nënshkrimit të kontratës. Shoqëritë shtetërore në krahasim me shoqëritë private mbeten akoma prapa përse i përket mënyrës së qeverisjes së tyre për arsye se niveli burokratik vazhdon të mbetet prezent. Procesi i hartimit të programeve të zhvillimit ekonomik për shoqëritë me kapital tërësisht shtetëror mbetet një rrugë e gjatë deri në finalizim, gjë e cila e bën të vështirë jo vetëm planifikimin por

dhe zbatimin e këtij programi. Shoqëritë private mbeten më fleksibël dhe për rrjedhojë nuk qarkullojnë në shumë institucione mënyrën së si do planifikojnë dhe do organizojnë procedurat për zhvillimin ekonomik dhe strategjinë. Shoqëritë shtetërore ose shoqëritë publike me kapital shtetëror hartojnë projekt-programe të zhvillimit të tyre ekonomik. Hartimi i këtyre projekt-programeve të zhvillimit ekonomik bëhet për një periudhë 1 vjeçare, në përputhje me objektivat e caktuara nga organet drejtuese të tyre. Hartimi i projekt-programeve vjetore të zhvillimit ekonomik kryhet nga drejtoritë e këtyre shoqërive shtetërore dhe miratohet nga këshilli mbikëqyrës. Projekt-programi përkatës i shoqëruar me vendimin e këshillit mbikëqyrës dhe prononcimin e ministrisë së linjës dërgohet për miratim përfundimtar në METE. Theksojmë se programi i zhvillimit në shoqëritë ku shteti zotëron mbi 50 përqind të paketës së aksioneve, miratohet paraprakisht nga këshilli mbikëqyrës i cili ja paraqet më pas për miratim përfundimtar asamblesë së aksionerëve. Siç do ta shikojmë më poshtë për të pasur një kohë të mjaftueshme dhe për të ulur riskun e mosrealizimit të detyrave, METE brenda datës 30 korrik të çdo viti realizon udhëzuesin metodik për hartimin e projekt-programit të zhvillimit ekonomik për vitin pasardhës. Kjo pasqyron qartë mënyrën e kontrollit dhe detajimit të treguesve shumë kohë përpara. Çdo vit ky udhëzues pëson ndryshime e për rrjedhojë koha është menduar që duhet të jetë e mjaftueshme për analizimet përkatëse. Drejtoritë e shoqërive ku shteti ka mbi 50 % të aksioneve hartojnë projekt-programet dhe dërgojnë brenda datës 30 gusht të çdo viti nga një kopje të tyre me relacionin shpjegues pranë këshillave mbikëqyrës të shoqërive. Ndërkohë më pas, ministritë që përfaqësojnë linjën administrative të shoqërive strategjike, p.sh portet, dhe shoqëritë që subvencionohen nga këto ministri, pasi i shqyrtojnë projekt-programet e zhvillimit, formulojnë qëndrimet për treguesit kryesorë të tyre brenda datës 30 shtator të çdo viti. Këshilli mbikëqyrës shqyrton dhe merr vendime për programet e zhvillimit brenda datës 15 tetor të çdo viti. Më pas nga ana e drejtorisë së shoqërisë, praktika përcillet brenda datës 30 tetor të çdo viti për miratim përfundimtar në METE, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Tregtare. Së fundi, sipas propozimeve të shoqërive, në raste të veçanta dhe të argumentuara kur nevojitet ndryshim programi, pas miratimit paraprak të këshillit mbikëqyrës dhe të ministrive të linjës për shoqëritë tregtare që përmendëm, ato dërgohen në METE për reflektimin përfundimtar për të realizuar apo jo ndryshimin e programit sipas rasteve specifike. Pra siç shikojmë kemi të bëjmë me një rrugë e cila

është deri diku e gjatë dhe që mbi gjithçka nuk përmban lehtësi organizative. Fleksibiliteti në vendimmarrje duhet të jetë prezent (kohë e pranueshme dhe vendime të pranueshme në unison) në këto raste duke shkurtuar kohën e hartimit të projekt-programeve të zhvillimit duke i hapur rrugë dhe një qeverisje më të mirë, pasi këto projekt-programe vërtetë janë të rëndësishme dhe pronari shtet që përfaqësohet nga METE duhet të marrë vendime, por nga ana tjetër një kohë e fillimit të përgatitjeve nuk mund të jetë rreth 6 muaj sepse do të linte vend për pasaktësira dhe gabime. Ka ardhur koha që anëtarë të këshillit të mbikëqyrës duhet të jenë dhe të punësuarit në shoqëri në mënyrë që të jenë të përfaqësuar në këtë këshill, pra të ndjejnë përgjegjësinë e përfaqësimit. Asambleja e aksionereve duhet të kërkojë nga këshilli mbikëqyrës një raport mbi mënyrën së si janë relacionet ndërmjet të punësuarve, drejtuesve dhe këshillit mbikëqyrës duke zbatuar në këtë mënyrë kodin e qeverisjes së korporatave për shoqëritë jo të listuara. Shpërblimi për anëtarët e këshillit mbikëqyrës duhet të jepet vetëm nëse është zbatuar siç duhet kodi për qeverisjen e korporatave për shoqëritë e palistuara dhe relacionet duhet aprovohen nga asambleja e aksionerëve e pronarit shtet. Ndryshimet e shpeshta të drejtuesve në institucione dhe ato në këshilla mbikëqyrës ka kohë që kanë krijuar johomogjenitet në lidhje me procedurat që duhet të ndiqen në vijimësi. Kriteri politik i cili padyshim përben një problem në administratë përsa i përket aftësisë, duhet të zëvendësohet me kriterin profesional duke respektuar kështu atë që ne e quajmë *profesionalizmin në çdo hallkë*, nga ku do të kemi më shumë cilësi krahas rezultateve pozitive. Gjithashtu, kemi pasur raste në këto vite, thënë dhe në media të ndryshme të pjesëmarrjes në shumë borde të individëve të veçantë madje dhe në 7 borde si psh në këshilla drejtues të institucioneve apo në këshilla mbikëqyrës, apo këshilla mbikëqyrës dhe drejtues njëkohësisht gjë e cila përbën jo eficiencë në vendimmarrje dhe për pasojë vazhdojmë të mbetemi më tepër përfitues të këtyre benefiteve se sa eficient në punë, pasi përgatitja për të dhënë më të mirën do ishte thuajse e pamundur. Qeverisja e korporative në sektorin publik përfshin dhe eficiencën e drejtuesve si një element që është ngritur në trajnime apo konferenca ndërkombëtare organizuar dhe nga IFC-ja. Sipas teorisë së kujdestarisë pronarët dhe menaxherët nuk konsiderohen të kenë interesa të ndryshme dhe si rrjedhojë nuk është e nevojshme që bordi i drejtorëve të ushtrojë kontroll mbi menaxherin. Kjo teori nuk shihet si e përshtatshme për rastin e Shqipërisë veçanërisht në disa nga shoqëritë publike ku decentralizimi nuk është akoma i

konsoliduar. Shoqëritë në jo pak raste janë inefiçiente, menaxherët e shoqërive shpesh zgjidhen bazuar në preferencë politike dhe si rezultat mbikëqyrja e tyre është e domosdoshme. Duke u bazuar në problematikën e mësipërme, teoria më e përshtatshme për rastin e Shqipërisë është teoria e agjencisë sipas së cilës funksioni i bordit të drejtorëve duhet të jetë monitorimi i menaxherit ose menaxhimit për të siguruar interesin e pronarëve dhe në këtë kuadër drejtorët janë të përgjegjshëm ndaj pronarëve duke përbërë në këtë mënyrë lidhjen e duhur ndërmjet pronarëve dhe shoqërisë. Së fundi ndarja e pronësisë nga kontrolli ul kontrollin politik dhe rrit transparencën. Një risi e kohëve të fundit që duhet përmendur është procedura e privatizimit me ankand e paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive tregtare që veprojnë në sektorët jostrategjikë. Vendimit i nënshtrohen të gjitha shoqëritë tregtare me kapital tërësisht apo pjesërisht shtetëror, që veprojnë në sektorët jostrategjikë, tek të cilat do të shiten paketat shtetërore të aksioneve pasi shoqëria të jetë vlerësuar dhe të ketë përgatitur dokumentacionin e nevojshëm për shitjen e këtyre paketave. Punonjësit e shoqërisë kanë të drejtë të shkëmbejnë, me vlerë nominale, bonot e privatizimit të tyre dhe ato të familjes në aksione të shoqërisë (V.K.M Nr.832, datë 03.12.2014). Theksojmë se sipas Ligjit “Për Shoqëritë Tregtare” shoqëritë duhet të kenë synim mbulimin e kostove dhe sigurimit të fitimeve. Realiteti tregon që shumica e shoqërive janë inefiçiente dhe subvencionohen nga shteti për të siguruar mbulimin e humbjeve të tyre financiare. Menaxhimi me efektivitet duhet të jetë qëllimi primar i drejtuesve të tyre, por nga ana tjetër dhe roli i institucioneve monitoruese duhet të jetë më i madh dhe gjithëpërfshirës. Duke pasur struktura dhe procese vendimmarrje të qarta atëherë roli i shtetit bëhet më domethënës në 3 aspekte kyçe të QK-së: pronësi, menaxhim, kontroll. Politika të mirëpërcaktuara së bashku me procedura të qarta vendimmarrje dhe padyshim transparente do të çonin në minimizimin e konfliktit të interesave por dhe në reduktimin e të përcaktuarit vetë të gjërave. Sigurisht në të tilla raste ulet niveli i burokracisë dhe performanca ekonomike do të jetë në vijimësi e qëndrueshme duke ditur faktin që në vendet e OECD-së ndërmarrjet në pronësi të shtetit punësojnë më shumë se 9 milion njerëz (Christiansen 2011). OECD numëron 34 shtete ku Estonia është e fundit e anëtarësuar më 9 dhjetor 2010 dhe shteti i parë SH.B.A 12 prill 1961 (<http://www.oecd.org/about/membersandpartners/list-oecd-member-countries.htm>).

KAPITULLI III

QEVERISJA E KORPORATAVE NË VENDET EVROPIANE NË ZHVILLIM

Në këtë kapitull trajtohet analiza e qeverisjes së korporatave në vendet evropiane në zhvillim e bazuar në gjetjet nga literatura. Kapitulli fillon me lidhjen ndërmjet qeverisjes së korporatave dhe zhvillimit ekonomik, mënyrën që na dërgon për tek qeverisja e përgjegjshme e korporatave, matjen e qeverisjes së përgjegjshme të korporatave në studime të ndryshme në vende të ndryshme, do të ndalemi tek përcaktimi i një indeksi të qeverisjes së përgjegjshme të korporatave për këto vende ku do të tregohet mënyra e mbledhjes së të dhënave dhe burimi përkatës dhe në fund rezultatet e hulumtimit (kërkimit).

3.1 Lidhja ndërmjet qeverisjes së korporatave dhe zhvillimit ekonomik

Rritja e flukseve financiare dhe zhvillimi i investimeve direkte është një karakteristikë e spikatur e globalizimit. Krahas kësaj edhe qeverisja e korporatave po merr një dimension të ri në këtë kuadër.

Kodet e qeverisjes së korporatave përmbajnë standardet e praktikave më të mira, në lidhje me mënyrën e drejtimin nga bordet, efektivitetin, shpërblimet, marrëdhëniet me aksionerët, llogaridhënien dhe auditin. Theksojmë në këtë pikë kodin e Mbretërisë së Bashkuar (UK). Në këtë kuadër (të qeverisjes së korporatave) shoqëritë duhet të marrin masat për veten e tyre për të përmirësuar mënyrën e drejtimit dhe të kontrollit nga pikëpamja ligjore, financiare dhe etike. Kërkimet mbi rolin e qeverisjes së korporatave në zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien janë kuptuar mirë sidomos për rëndësinë e elementëve financiarë, të drejtat e pronësisë, konkurrencës etj. Rëndësia e sistemit financiar në uljen e varfërisë është kuptuar qartësisht nga lidhja ndërmjet financave dhe nivelit të rritjes ekonomike të matur me GDP-në (PBB) për frymë (Levine 1997; Banka Botërore 2001). Qeverisja e dobët e korporatave mund të ndikojë në funksionimin e tregjeve financiare pasi në jo pak raste paqëndrueshmëria financiare e tregjeve influencohet nga shoqëritë të cilët shfaqin tendenca jo pozitive në rezultate. Ekzistojnë

të dhëna se transparenca, si një dimension i rëndësishëm, ka ndikim në çmimet e aksioneve në tregjet e aksioneve pasi investitori blen aksionin e zakonshëm duke parashikuar një kthim total që ka të bëjë me të ardhurën e zakonshme (dividentin) dhe të ardhurën kapitale, kështu Morck, Young, & Yu 2000), Claessens & Laeven (2003) theksojnë se në një mjedis ligjor të dobët firmat jo vetëm marrin më pak financim por edhe investojnë më pak sesa optimalja në aktive jo-materiale që përbëjnë aktive të identifikueshme jo monetare pa përmbajtje fizike, të mbajtura për qëllim prodhimin e produkteve ose furnizimin e mallrave ose shërbimeve, për t'ua dhënë me qira të tretëve ose për qëllime administrative, psh shpenzimet kërkimore, të trajnimit apo për reklamë etj. Kuadri i qeverisjes së mirë të korporatave bën që firmat të përfitojnë qasje më të madhe në financim, kosto më të ulët të kapitalit, performancë më të mirë dhe trajtim të favorshëm të të gjithë palëve të interesuar.

Literatura ka identifikuar disa kanale nëpërmjet të cilave qeverisja e korporatave ndikon në rritje dhe zhvillim:

- Rritje të aksesit për financim të jashtëm, e cila sjell investime dhe krijimin e mundësive më të madha të punësimit.
- Ulje të kostonë së kapitalit i bën më tërheqëse investimet, duke mundësuar rritje të punësimit.
- Qeverisja e mirë e korporatave përbën rrezik të reduktuar për shfaqjen e krizës financiare, duke pasur parasysh se krizat financiare mund të kenë kosto të mëdha ekonomike dhe sociale.
- Qeverisja e mirë e korporatave do të thotë marrëdhënie përgjithësisht të mira me të gjithë palët e interesuara, e cila ndihmon në përmirësimin e marrëdhënieve sociale dhe të punës, konkretisht ndihmon në çështje të tilla si mbrojtja e mjedisit, madje dhe në zvogëlimin e varfërisë dhe pabarazisë sociale.
- Qeverisja e korporatës mundëson një performancë të mirë.

Të gjitha këto kanale kanë rëndësi për rritjen, punësimin, zbutjen e varfërisë, dhe mirëqenien në përgjithësi.

3.2 Në drejtim të qeverisjes së përgjegjshme të korporatave. Kuptimi i kësaj pikëpamje.

Ky paragraf ka për qëllim të përshkruajë konceptet e rëndësishme teorike të përdorura për të krijuar një pikë të favorshme për pyetjen e parë kërkimore si dhe vërtetimin e hipotezës së parë.

Sipas të kuptuarit tradicional, praktikatat e qeverisjes së korporatave mund të përfshihen në aktivitete shoqërore me kusht që ato të jenë plotësisht vullnetare dhe të rezultojë një kontribut pozitiv në fitim. Për këtë arsye drejtorët e shoqërive informohen për rreziqet mjedisore, detyrimet dhe çështjet kryesore të pajtueshmërisë mjedisore me të cilat shoqëria mund të përballë (Kuhndt *et al.*, 2004). Duke u nisur nga kjo ide, bordet e korporatave besohet të jenë të përgjegjshëm vetëm për aksionerët e tyre dhe për ta nuk ka grup tjetër në shoqëri më me shumë rëndësi se ata. Për këtë arsye, bordi i përgjigjet aksionerëve dhe në disa sisteme, të punësuarve dhe kreditorëve. Pikërisht teoria e agjencisë përshkruan marrëdhënien kontraktuale ndërmjet principalit (kryesorit) dhe agjentit ku kryesori delegon disa vendimmarrje agjentit. Hart (1995) shpjegon se përse një kuadër i qeverisjes së korporatave e cila është i bazuar në informacionin asimotrik ka nevojë për dy kushte të nevojshme për të bërë struktura drejtuese të rëndësishme: kushti i parë, është që problemi i agjencisë ka të bëjë me marrëdhënien e pandarë kryesor-agjent ku të parët krijojnë marrëdhënie dhe u besojnë të dytëve, kushti i dytë është shkrimi dhe zbatimi i kontratave. Krijimi i marrëdhënieve të tilla përbën atë që në qeverisjen e korporatave quhet marrëdhënie besnikërie ose besimi, fiduciary (Shifer & Vishney 1997).

Kohët e fundit, është zhvilluar një qasje e re për qeverisjen e korporatave, e cila mbështetet në supozimin se njeriu është i lirë dhe i përgjegjshëm (Aras & Crowther, 2010). Mbi këtë bazë, korporatat janë parë si komunitete të personave të lirë dhe përgjegjës të angazhuar në një projekt krijues, të aftë për të kontribuar për të mirën e përbashkët. Termat "qeverisje e mirë korporate" ose "qeverisje e përgjegjshme korporate" janë duke u përdorur gjithnjë e më shumë në literaturën shkencore. Qeverisja jo e mirë po konsiderohet gjithnjë e më tepër si një nga shkaqet e të gjitha pasojave negative në shoqëritë tona (Shil, 2008).

Qeverisja e mirë e korporatave është një domosdoshmëri në sigurimin e vlerave të kërkuara nga grupet e ndryshme të të interesuarve (stakeholdersat).

Ajo rrit performancën e korporatave, duke krijuar një mjedis që i motivon menaxherët për të maksimizuar kthimin nga investimet si qëllimi kryesor i aksionerëve, rrit efikasitetin operacional dhe siguron rritjen afatgjatë të produktivitetit. Si pasojë, korporata të tilla rekrutojnë talentin më të mirë në shkallë globale. Ajo gjithashtu siguron përafrimin e interesave të korporatave me atë të investitorëve dhe të shoqërisë, duke krijuar drejtësi, transparencë dhe llogaridhënie në aktivitetet e biznesit ndërmjet të punësuarve, menaxhimit dhe bordit (Oman,2001). Në një korporatë, qeverisja e mirë vendoset në drejtim të maksimizimit ligjor të vlerës së aksionerëve, në një mënyrë etike dhe të qëndrueshme, duke siguruar barazi dhe transparencë për çdo palë të interesuar (stakeholders) - klientë, punonjës, investitorë, partnerët vendor, qeveria dhe komuniteti (Murthy,2006).

Një aspekt tjetër i të interesuarve (stakeholders) në qeverisjen e përbashkët është zhvillimi i "Lidershipit për përgjegjësi". Kjo i referohet shfrytëzimit të burimeve të korporatave për të sjellë ndryshime shoqërore. Një lider (udhëheqës) në qeverisjen e përgjegjshme të korporatave vështron qasjen e përgjithshme politike më tepër si një mundësi sesa një sfidë. Lidershipi kërkon krijimin e një kërkesë për veprim të qëndrueshëm në vend të përgjigjes së kërkesave për veprim të përgjegjshëm (Kuhndt *et al.*, 2004).

Lidershipi është thjesht ushtrimi i autoritetit për të drejtuar punën e të tjerëve. Kur ushtrohet autoriteti, lidershipi konsiston në të aktivizuarit e njerëzve për të bërë diçka që lideri dëshiron në zbatim të synimeve të një organizate. Në qeverisjen e një korporate ekzekutivët efektivë janë lidera përgjegjës. Esenca e lidershipit shpesh konsiderohet aftësia për të lëvizur njerëzit në drejtime të reja. Si pjesë e sjelljes organizative, lidershipi është një nga elementet kryesore të zbatimit të strategjisë në mënyrë efektive (Kume, V. Menaxhimi Strategjik 2007).

Disa autorë mendojnë se përgjegjësia sociale e korporatave është një rregullator i rëndësishëm i qeverisjes së korporatave. Qeverisja e përgjegjshme e korporatave "është një politikë e orientuar nga stakeholdersat që ndan përgjegjësitë me aktorët shoqërorë dhe që drejton përgjegjësinë (accountability)³ e korporatave" (Kuhndt *et al.*, 2004).

³ Accountability [Përgjegjësia(shmeria)] – Shkalla ndaj së ciles një përsôn duhet qe të përgjigjet tek autoritete të larta për veprimet në shoqëri apo brenda një agjencie apo organizate.

Qeverisja e përgjegjshme e korporatave është një proces i pafund, i cili zhvillohet përmes konflikteve, me kusht që konfliktet të zgjidhen aq sa është e mundur, nëpërmjet integritit dhe jo me anë të dominimit dhe kompromisit. Prandaj, qeverisja e përgjegjshme e korporatave qëndron në “demokracinë” sipërmarrëse me lidhje sistematike ndërmjet misionit të organizatës me të mirën e përbashkët (Aras & Crowther, 2010). Prandaj qeverisja e mirë e korporatës vendos ekuilibër ndërmjet zhvillimit ekonomik dhe atij social (Zinkin, 2010).

Ekspertët bashkëkohorë kanë identifikuar elementët e qeverisjes së përgjegjshme të korporatave : "fuqizimin e aktorëve të qeverisjes së korporatave; sistemet e menaxhimit dhe vlerësimit të performancës; rritja e transparencës; verifikimi llogaridhënies"(Kuhndt *et al.*, 2004).

Bizneset që karakterizohen nga qeverisje e përgjegjshme e korporatave duhet të veprojnë në përputhje me parimet e mëposhtme (Kuhndt *et al.*, 2004): "marrjen përsipër të lidërshipt shoqëror për përgjegjshmërinë; në mënyrë të qartë dhe në mënyrë të veçantë të identifikojnë vlerat e tyre sociale, mjedisore dhe ekonomike në përputhje me kërkesat e palëve të tyre të interesuara; të definojnë zonat e tyre sociale, mjedisore dhe ekonomike të veprimit; adoptimi i praktikave të veçanta të menaxhimit për të integruar këto vlera në operacionet e tyre dhe për të marrë veprime të matshme; zbulimin e të dhënave të përgjithshme në ndikimet e tyre sociale, mjedisore dhe ekonomike; përfshirja në shqyrtimin e përgjithshëm të aktiviteteve të tyre; përpjekja për mësim të vazhdueshëm ". Qeverisja e përgjegjshme e korporatave mund të përdoret me referencë të drejtpërdrejtë të qeverisjes bazuar në tri parime kryesore: drejtësi, transparencë dhe përgjegjshmëri. Praktikrat e qeverisjes së përgjegjshme të korporatave janë në themel të vizionit të përgjithshëm të organizatës, proceseve të vendimmarrjes të organizatës dhe strukturave që mbështesin qëndrueshmërinë afatgjatë të biznesit (të organizatës). Adoptimi i praktikave të qeverisjes së përgjegjshme të korporatave është konsideruar si një akt vullnetar i organizatave (Anand *et al.*, 2006), duke i lejuar atyre gjenerimin e rezultateve ekonomike, sociale dhe mjedisore. Sipas kësaj pikëpamje, praktikrat më të mira në qeverisjen e korporatave kërkojnë vizion, procese dhe struktura që sigurojnë qëndrueshmëri afatgjatë.

3.3 Matja e qeverisjes së korporatave në studime të ndryshme në vende të ndryshme

Studimi të autorëve të ndryshëm në fushën e qeverisjes së korporatave kanë evidentuar mënyra të ndryshme për të realizuar matjen e kësaj qeverisje. Macey (1998), sugjeron tre mënyra empirike për të matur performancën e një sistemi të qeverisjes së korporatave: a) duke përcaktuar nivelin e kontrollit të ushtruar nga aksionerët në krahasim me pjesëmarrjen e tyre, b) duke matur gatishmërinë e sipërmarrësve për të bërë ofertat publike fillestare të aksioneve, c) duke analizuar funksionimin e tregjeve të brendshme dhe të jashtme nga pikëpamja e kontrollit të korporatës. Për këtë qëllim, disa studime ndjekin mënyrën e matjes së rritjes së influencës së aksionerëve dhe efektet mbi industrinë dhe marrëdhëniet në shkallë të gjerë vendi, si dhe propozojnë mënyrat për të reduktuar presionin e aksionerëve nga veprimet e sindikatës (Van den Toren, 2000). Pjesa më e madhe e vëmendjes, në termat e qeverisjes së korporatave është fokusuar në drejtim të bërjes së parashikimeve në lidhje me performancën e organizatave si rezultat i zgjedhjes së praktikave të qeverisjes së korporatave (Gillan *et al.*, 2003) ose të kostove që shoqërojnë disa mekanizma të qeverisjes së korporatave (Mc Knight & Weir, 2009). Indekset për matjen e qeverisjes së korporatave janë zhvilluar nga shumë shoqëri dhe kërkime, por shumica e tyre janë të rëndësishme vetëm për vendet e zhvilluara, konkretisht: Indeksi i qeverisjes korporative është zhvilluar nga Khanna, Joe dhe Krishna (2001), Klapper & Love (2002), Ananchotikul (2008), indeksi i Qeverisjes së Korporatave FTSE-ISS (FTSE ISS Developed Corporate Governance Index (CGI) (FTSE Group is a British provider of stock market indices, ISS - Institutional Shareholder Services), indeksi Gompers, indeksi Ishii dhe Metrick (2003). Gjithashtu, disa institucione, siç janë Instituti i Shërbimit të Aksionerëve, Biblioteka e Korporatave dhe Sistemi Metrik i Qeverisjes Ndërkombëtare, kanë realizuar renditjen e qeverisjes së korporatave. Çështjet e qeverisjes së korporatave janë në fokusin e agjencive të tilla si: Shërbimeve Moody Investor, Standard & Poor dhe Fitch Ratings. Për shembull, vlerësimi i qeverisjes së korporatave për shoqëritë kineze të listuara është fokusuar në gjashtë dimensionet: "indeksi i kontrollit aksioner, indeksi i sjelljeve, indeksi i qeverisjes së bordit, indeksi i qeverisjes së menaxhimit të lartë, indeksi i zbulimit të informacionit, indeksi i qeverisjes së komiteteve (Li & Tang, 2007)". Rezultatet tregojnë se zbatimi i

qeverisjes së përgjegjshme të korporatave çon në rritjen e përfitueshmërisë, eficiencës operacionale, fleksibilitetit financiar dhe sigurisë për shoqëritë e analizuara. Një tjetër studim fokusohet në matje sasiore të cilësisë së qeverisjes së korporatave dhe pronësisë (Bebczuk, 2005) duke marrë si shembull rastin e 65 shoqërive argjentinase të listuara për të nxjerrë në pah efektin e konsiderueshëm të masave qeverisëse në përfitueshmërinë e aktiveve. Për analogji, në rastin tonë, numri i shoqërive është me i madh, 76. Evidencat ndërkombëtare janë shtuar shumë në vitet e fundit. Claessens *et al.* (1999), Klapper & Love (2002) dhe La Porta *et al.* (2002) janë përpjekur për të provuar lidhjet ndërmjet qeverisjes së korporatave dhe të performancës duke përdorur të dhëna ndërmjet vendeve, ndërsa studime të tjera kemi në vende të veçanta si Shtetet e Bashkuara (shih Gompers, Ishii dhe Metrick, 2003), Kore (shih Lë, Z.I., Jang, S.H., & Kim, Y.H. 2003) dhe Gjermani (shih Drobetz, Schillhoffer & Zimmermann, 2003). Për të analizuar marrëdhëniet ndërmjet qeverisjes së korporatave dhe strukturës së pronësisë me performancën (e matur me kthimin nga aktivet (return on assets ROA) dhe q- Tobin (ose Tobin's q) si tregues i performancës) në Argjentinë në 2000-2003 u realizua një studim. Metodologjia e përdorur ka qenë thujtë e njëjtë. Në rastin e Argjentinës, do të vemë re një turrje të shoqërive në lidhje me mbledhjen e informacionit. Për të analizuar qeverisjen e korporatave dhe strukturën e pronësisë në Argjentinë, në fillim, raportimi në lidhje me marrjen e informacionit ishte për për 103 shoqëri të listuara në nëntor 2003, mostra për qëllime ekonometrike u zvogëluar ndjeshëm sepse: (i) U përjashtuan institucionet financiare të listuara për shkak të veçantisë së linjës së tyre të biznesit dhe firmat në përgjithësi pa informacion të plotë. Mbetën për studim 65 shoqëri; dhe (ii) U mbledh informacion i plotë për pronësinë për vetëm 54 nga 65 shoqëri. Për të administruar një masë sasiore dhe kryesisht objektive të qeverisjes së korporatave, u ndërtua, për herë të parë një Indeksi i Qeverisjes së Korporatave (CGI) për shoqëritë e listuara në Argjentinë. Kjo punë kishte lidhje të ngjashme me të tjerat në këtë linjë kërkimi ⁴. CGI u projektua për të përfshirë dy masa plotësuese: (a) Indeksën e zbulimit dhe të transparencës (TDI) në bazë të informacionit publik për çdo shoqëri duke reflektuar normat e tyre të transparencës dhe të zbulimit, të cilat janë një element i

⁴See OECD (1999), Fremond and Capaul (2002), COSRA (2000), Klappër and Love (2002), Standard and Poor's (2002), Gompers, Ishii and Metrick (2003), Black, Jang and Kim (2003) and Drobetz, Schillhoffer and Zimmermann (2003).

rëndësishëm i qeverisjes së korporatave. Ky informacion vjen nga burime të informimit publik (bilancet, raportet vjetore, agjencitë rregullatore vendase dhe të huaja, prospektet e shoqërive të sigurimeve, faqet e internetit të shoqërive etj); (b) Një Indeks i plotë i Qeverisjes së Korporatave (CGI) i bazuar në një pyetësor i dërguar për t'u përgjigjur personalisht për çdo shoqëri ose elektronikisht. TDI u realizua dhe përfundoi ndërmjet muajit gusht dhe nëntor 2003, ndërsa puna për realizimin e CGI-së u pengua për shkak të shkallës shumë të ulët të përgjegjësisë nga ana e shoqërive të anketuara dhe në këtë mënyrë nuk u përdor. Studimi tregon se TDI është një masë gjithëpërfshirëse e qeverisjes së korporatave dhe shumë e lidhur me CGI-në, siç ka ndodhur në raste të tjera (shih, për shembull, Black, Jang & Kim, 2003), dhe duhet theksuar se është përdorur si masë për të matur qeverisjen e korporatave dhe në studimin e rastit në fjalë (Argjentinë). Në studim janë diskutuar tiparet më të spikatura dhe rezultatet nga TDI bazuar në mostrën e përdorur për 65 shoqëritë e listuara. TDI përbëhet nga një total prej 32 pyetjesh të tipit Po-Jo; për çdo pyetje, shoqëria ka dhënë një vlerë prej 1 në qoftë se nuk ka informacion publik të pjesshëm ose të përgjithshëm, dhe një vlerë prej 0, në rast të kundërt. Më tej kemi ndarje në tre nënindekse: *Bordi*, *Zbulimi*, dhe *Aksionerët*. Nënindeksi *bordi* mat strukturën, procedurat dhe kompensimin e bordit dhe të anëtarëve të menaxhimit të lartë. Nënindeksi *zbulimi* mat shkallën në të cilën shoqëria informon stakholdersat. Së fundi, nënindeksi *aksionerët*, mat cilësinë e informacionit në lidhje me kompensimin e aksionerëve të vegjël. Në disa vende në zhvillim, sistemi kombëtar i qeverisjes së korporatave është reflektuar në standarde dhe masa që kanë për qëllim rritjen e investimeve të huaja dhe kanalizimin në drejtim të mbrojtjes së investitorëve (Kuznetsov & Kuznetsova, 2009). Shteti dhe dinamika e qeverisjes korporative në Rusi janë përshkruar në disa studime (Lazareva *et al.*, 2009), të cilat tregojnë se shumica e shoqërive që operojnë në atë vend përkrahin standardet e qeverisjes së korporatave. Disa studime të kryera në tregjet e reja theksojnë lidhjen midis qeverisjes së korporatave, mbrojtjes së investitorëve dhe performancës (Klapper & Love, 2002) për të kuptuar më mirë mjedisin në të cilin qeverisja e korporatave merr një rëndësi të madhe. Një tjetër hulumtim interesant ka për qëllim të identifikojë një indeks të përbërë të rregullimit të qeverisjes korporative në vendet e Evropës ndërmjet viteve 1990-2005, bazuar në tre kategori të ndryshme të indekseve, "indeksi i mbrojtjes së të drejtave të

aksionerit/aksionerëve, indeksi i mbrojtjes së aksionerëve në minorancë dhe indeksi i mbrojtjes së të drejtave të kreditorëve”(Martynova M & Renneboog L, 2010).

3.4 Qeverisja e korporatave dhe sistemi bankar. Indeksi i Qeverisjes Bankare në Shqipëri

Buletini “Te reja shkencore”, periudha Janar-Qershor 2011, Buletini Nr 6, i Bankës së Shqipërisë bën me dije pjesë nga materiali konfidencial: “Qeverisja e Korporatave në Sistemin Bankar Shqiptar – Analizë e anketimit të kryer për qeverisjen e korporatave në sistemin bankar shqiptar – K. Ceca, I. Kalluci, O. Kodra, V. Kota. Indeksi i Qeverisjes Bankare (IQB) është një tregues i matur në studimin e Ceca *et al.* (2010) “*Corporate Governance in Albanian Banking System : Analysis of a corporate governance survey in the Albanian banking system*”. Ky indeks u krijua për herë të parë për rastin e bankave që operojnë në Shqipëri, duke u derivuar nga përgjigjet e marra nëpërmjet një pyetësoi drejtuar këtyre të fundit. IQB synon të matë cilësinë e qeverisjes së sistemit bankar bazuar në informacionin e grumbulluar nga bankat duke konvertuar përgjigjet cilësore të pyetësorit në ndryshore sasiore, me vlera numerike në segmentin [0;1]. Një vlerë e ulët e këtij indeksi tregon një nivel të ulët të qeverisjes së bankave, ndërsa niveli 1 tregon nivelin më të mirë të qeverisjes. Përgjigjet e ndryshme janë peshuar me pesha specifike, gjykuar nga niveli i rëndësisë së tyre. Pyetjet u grupuan sipas 6 çështjeve kryesore, dhe nëpërmjet metodës së mesatarizimit të thjeshtë të përgjigjeve të çdo banke, u ndërtuan në këtë mënyrë 6 nënindekse. Më pas u krijua edhe një indeks i përgjithshëm i qeverisjes bankare (IQB) i cili u përftua si mesatare e thjeshtë e këtyre 6 nënindekseve. Sipas botimit, meqenëse vlera e indeksit në rastin e sistemit bankar shqiptar është llogaritur vetëm për një vit dhe do të vazhdohet edhe më tej me matjen e tij vit pas viti, për momentin është i pamundur një vlerësim ekonometrik i lidhjes ndërmjet indeksit dhe treguesve financiarë. Për këtë arsye, ky punim identifikon lidhjet midis ndryshoreve nëpërmjet një analize *cross section*. Analiza *cross section* është përdorur në analizën statistikore të studimit tonë. Së fundi, meqenëse jemi në rastin e indekseve të qeverisjes bankare, Ferreira (2012) thekson se indeksi i përqëndrimit (HHI), një indeks i rëndësishëm ky, përlllogaritet si shuma e katrorëve të peshës së tregut për secilën bankë.

3.5 Metodologjia e përcaktimit të një indeksi të qeverisjes së përgjegjshme të korporatave për vendet evropiane në zhvillim

Mjedisi, faktorët socialë dhe ekonomike dhe qeverisja e korporatave janë në zemër të strategjive të biznesit dhe korporatave, ata janë pjesë përbërëse e operacioneve të përditshme, duke stimuluar punën për sukses (Salo,2008), mund të thuhet se performanca mjedisore dhe performanca e qeverisjes së korporatave, individualisht të kontribuojë në performancën e përgjithshme. Ka një lidhje ndërmjet mjedisit dhe ecurisë ekonomike. Problemet e zgjidhjes dhe përcaktimit të një modeli të caktuar rritjeje ekonomike dhe zhvillimi janë thelbësore për politikën ekonomiko-financiare dhe sociale të çdo vendi. Mënyra më e mirë për të thënë se kur një vend është më konkurrues se një tjetër, është zotërimi i mjeteve për të matur dhe krahasuar nivelin e konkurrueshmërisë të vendeve të veçanta apo grupe vendesh me filozofi të njëjta në fushën e politikave ekonomike e financiare. Konkretisht në studimin tonë përmendim rastin e vendeve në zhvillim, ku bën pjesë edhe Shqipëria. Krahasimi i niveleve të konkurrueshmërisë së ekonomive të vendeve të botës i botuar që prej 33 vitesh realizon një klasifikim, klasifikim i cili konsiderohet si një barometër shumë i mirë i dinamizmit ekonomik të çdo vendi si dhe kapacitetit të tij për t'u përshtatur në ekonominë dhe konkurrencën botërore. Origjinaliteti i tij qëndron në faktin se ai mbështetet në analizën e një game të gjerë treguesish që variojnë nga indikatorët e performancës makroekonomike (ritja ekonomike, papunësia, deficit, inflacioni, bilanci i pagesave, bilanci tregtar, borxhi i brendshëm dhe i jashtëm, etj.), të treguesit e kuadrit të funksionimit institucional (të drejtat e pronësisë, pavarësia reale e gjyqësorit, niveli i krimit të organizuar, niveli i korrupsionit, stabiliteti institucional, etj.) e deri te niveli i avancimit teknologjik, cilësia e infrastrukturës, etj. Pozicioni i Shqipërisë, siç do e shohim në vijim të studimit, nga treguesit, nuk është në nivel të lartë, ndaj kemi akoma punë për të bërë përsa i përket kuadrit të qeverisjes së korporatave por dhe reformave makroekonomike. Psh, po të kthehemi në retrospektivë, në raportin që i referohet periudhës 2004-2005 mbi "Krahasimin e niveleve të konkurrueshmërisë" të ekonomive të 117 vendeve të botës, Shqipëria rezulton në vendin e 100-nd duke mos shfaqur ndryshime nga pozicioni i viteve 2002-2003. Studime të ndryshme mbi qeverisjen e korporatave (Răileanu *et al.*, 2011; Popescu-Duduială & Stoichin, 2011) vlerësojnë përputhshmërinë e qeverisjes së korporatave të shoqërive apo të transparencës në zbatimin e parimeve të qeverisjes së

korporatave. Metodologji të ndryshme gjejnë zbatim në këtë kuadër, por një metodologji për të vlerësuar nivelin kombëtar të qeverisjes së përgjegjshme të korporatave në vendet evropiane në zhvillim është dhe metodologjia e studimit e cila mbështetet në një Indeks, Indeksi i Qeverisjes së Korporatave ose Indeksit të Qeverisjes së Përgjegjshme të Korporatave (CGI/GCR) si një perceptim dhe siç do e shohim dhe më poshtë informacionin do e marrim nga buletinet. Kështu, *Emerging Evrope Monitor* i grupon vendet në tri kategori (*Emerging Evrope Monitor M&A Report, 2012*): Vendet e Evropës Qendrore dhe Balltike (Republika Çeke, Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, Polonia, Sllovakia), Rusia dhe CIS⁵) (Armenia, Azerbajxhani, Bjellorusia, Gjeorgji, Kazakistani, Kirgistani, Moldavia, Rusia, Taxhikistani, Turkmenistani, Ukraina, Uzbekistani) dhe Evropa Juglindore (Shqipëria, Bosnja-Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi, Rumania, Serbia, Sllovenia). Nga këto, për vende të tilla si : Turkmenistani, Uzbekistani, Kirgistani, Taxhikistani, Armenia dhe Bjellorusia nuk janë gjetur të dhëna. Është parë e domosdoshme ndërmjet shteteve të përfshihet Turqia në analizë, për shkak të vendndodhjes së saj gjeografikë dhe pozitës së saj ekonomike. Tashmë dimë që Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), në fillim ka krijuar parimet kryesore të qeverisjes së korporatave në vitin 1999, dhe më pas i ka rishikuar ato në vitin 2004 për të siguruar bazën për një kuadër efektiv të qeverisjes së korporatave; të drejtat e aksionerëve dhe funksionet kyçe të pronësisë; trajtim të barabartë të aksionerëve; roli i grupeve të interesit (stakeholders) në qeverisjen e korporatave; transparenca dhe zbulimi; përgjegjësitë e bordit drejtues (OECD, 2004). Qeverisja e korporatave është një subjekt me shumë dimensione. Një pjesë e rëndësishme merret me përgjegjshmërinë (accountability) dhe mirëbesimin (fiduciary duty), që në thelbin e vet i shërbejnë zbatimit të direktivave dhe mekanizmeve, të cilët garantojnë praninë e sjelljes së mirë dhe mbrojtjen e aksionerëve (Llaci. Sh, Qeverisja e Korporatave, 2012).

Në kapitullin e parë thamë që kemi identifikuar dimensionet e nevojshme (D) për të matur qeverisjen e përgjegjshme të korporatave (GCR). Komponentët e çdo dimensionit janë nën-indekse. Duke filluar nga preambula e parimeve të OECD-së të vitit 2009 për qeverisjen e korporatës i cili thotë se “qeverisja përfshin një tërësi marrëdhëniesh

⁵ CIS (Commonwealth of independent states, bashkimi i vendeve të pavarura të ish- Bashkimit Sovjetik)

ndërmjet menaxhimit të shoqërisë, bordit të saj, aksionerëve si dhe të pretendentëve të tjerë” dhe ajo “ofron strukturën nëpërmjet së cilës përcaktohen objektivat e shoqërisë si dhe mjetet për arritjen e këtyre objektivave dhe për monitorimin e performancës” rekomandohen dimensionet e mëposhtme të matjes së qeverisjes së përgjegjshme të korporatave, strukturuar si më poshtë:

D1 - Të drejtat e aksionerëve dhe trajtimi i barabartë i tyre;

D2 - Marrëdhëniet me grupet e interesit (stakeholders);

D3 - Përgjegjësitë e Bordit Drejtues në realizimin e objektivave të korporatës;

D4 - Qëndrimi etik i korporatës (të vepruarit në mënyrë etike);

D5 -Transparenca dhe zbatimi i sistemeve të brendshëm dhe të jashtëm të kontrollit.

Për të vlerësuar pesë dimensionet e qeverisjes së përgjegjshme të korporatave është përdorur *Raporti i Konkureshmërisë Globale (The Global Competitiveness Report 2013-2014)* publikuar nga Forumi Ekonomik Botëror (Schwab dhe Sala-i-Martin, 2013) si burim i të dhënave. Ky raport vlerëson 144 shtete. Të gjitha vendet e konsideruara në zhvillim, në studimin tonë, ndodhen në këtë raport duke na ofruar një burim të qëndrueshëm dhe duke siguruar krahasueshmëri në të dhëna. Nga tërësia e treguesve të përdorur për raportim, janë zgjedhur treguesit e mëposhtëm që mbulojnë përmbajtjen e dimensioneve të propozuara. Dimensioni 1, **D1 - “Të drejtat e aksionerëve dhe trajtimi i barabartë i tyre”**, i referohet detyrimit të korporatës për të mbrojtur investimet e aksionerëve dhe trajtim të barabartë për aksionerët, duke siguruar mekanizma të sigurt për regjistrimin dhe konfirmimin e pronësisë të aksionerëve, të drejtat e votës dhe marrjen e dividendëve (siç dihet është pjesa e fitimit e cila më pas kur tërhiqet nga aksionerët tatohet sipas ligjislacionit në fuqi për *Tatimin mbi të ardhurat* dhe *Udhëzimin* përkatës). Kemi zgjedhur treguesit e mëposhtëm:

I 1.1 - Mbrojtja e aksionerëve

I 1.2 - Mbrojtja e Investimeve.

Dimensioni 2, **D2 - “Marrëdhëniet e biznesit me grupet e interesit (stakeholders)”**, krijimi i një marrëdhënie transparente dhe të ndershme midis shoqërisë dhe grupeve të interesit. Ligjvënësit duhet të sigurojnë që ligjet dhe aktet rregullatore lidhur me të drejtat e aktorëve janë konsistente (punonjësit, klientët, furnitorët etj). Këtu janë zgjedhur treguesit e mëposhtëm:

I.2.1 - Praktikë e marrjes dhe largimit nga puna,

I.2.2 - Marrëdhëniet ndërmjet punëdhënësve dhe punëmarrësve,

I.2.3 – Shkalla e fokusimit tek konsumatori.

Dimensioni 3, **D3 – “Përgjegjësitë e Bordit Drejtues në realizimin e objektivave të korporatës”**, vlerësohet me përdorimin e dy treguesve:

I.3.1 - Trajnimin e menaxhimit,

I.3.2- Delegimin e përgjegjësive tek punonjësit.

Në kuadrin e qeverisjes së korporatave bordet duhet të kenë të qartë strategjinë e shoqërisë dhe të përgjigjen në kohën e duhur për sa kërkojnë sistemet efikase të raportimit, ata gjithashtu është e nevojshme të mbikëqyrin e trajnojnë menaxhimin dhe zhvillojnë sistemet e kompensimit në përputhje me objektivat e tyre duke zvogëluar çdo lloj risku të mundshëm. Dimensioni 4, **D4 – “Qëndrimi etik i korporatës (të vepruarit në mënyrë etike)”** është bazuar në një tregues të vetëm (**I.4**), i cili mat perceptimin e sjelljes etike të korporatës në një vend të caktuar në krahasim me vendet e tjera. Dimension 5, **D5 - “Transparenca dhe zbatimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm ”**, i referohet përputhjes me standardet e raportimit dhe përcaktohet duke përdorur treguesin e mëposhtëm :

I.5.1- Përputhshmëria me raportimin dhe auditimin e performancës financiare.

Çdo organizatë ka nevojë për të mbajtur auditorë të jashtëm të pavarur si një instrument i rëndësishëm i qeverisjes së përgjegjshme të korporatave. Kufizimet për këtë pjesë të studimit lindin nga natyra e të dhënave të mbledhura nga literatura e publikuar që shprehin perceptimet e të anketuarve në vendet respektive. Deri atëherë kur vendet e ndryshme të botës do të përmirësojnë raportimin mbi mjedisin e tyre social dhe ekonomik dhe të sigurojnë vazhdimësinë, metodologjia e propozuar (e këtij punimi) do të mund të aplikohet në të dhëna sasiore duke gjeneruar rezultate të provuara akoma më mirë shkencërisht. Indeksi i qeverisjes së përgjegjshme të korporatave (GCR) për vendet evropiane në zhvillim theksojmë se është një indeks i përbërë, i bazuar në pesë nën-indekse, të cilat korrespondojnë me dimensionet e qeverisjes së përgjegjshme të korporatave, shpjeguar më sipër, dhe çdo nën-indeks është përcaktuar duke përdorur treguesit e zgjedhur (te zgjedhur në manual në pjesën respektive për secilin shtet të marrë në studim). Metodologjia e llogaritjes së indeksit të qeverisjes së përgjegjshme të korporatave nga ana matematikore jepet më poshtë :

- Vlerat e çdo treguesi brenda çdo dimensionit janë të renditura në rend zbritës, janë përcaktuar gjithashtu rezultati më i mirë (maksimum) dhe rezultati më i ulët (vlera minimale);
- Çdo vlerë e treguesve merr pikët 0-100 (0 për vlerë minimale dhe 100 për vlerë maksimale);
- Normalizimi është një llogaritje i cili realizon kthimin në vlera numerike në segmentin [0;1].

- Normalizimi arrihet duke aplikuar formulën e mëposhtme (*hapi i parë*):

$$P_i = 100 * (X_i - val_{min}) / (val_{max} - val_{min}) \quad (1)$$

ku: X_i = vlera e treguesit që do të normalizohet, val_{max} = vlera maksimale, val_{min} = vlera minimale;

hapi i dytë:

- Janë vendosur koeficientët e peshimit: çdo tregues është peshuar në mënyrë të barabartë në secilin dimension dhe çdo dimension ka peshë të barabartë në indeksin e përgjithshëm;
- Dimensionet mbledhen duke shumëzuar numrin e pikëve të marra gjatë normalizimit me koeficientët e peshave që do të maten duke përdorur formulën e mëposhtme:

$$P_{i/d} = P_i * C_d, \quad (2)$$

ku: $P_{i/d}$ = pikët për treguesin i pas peshimit, P_i = pikët për treguesin i , C_d =

Koeficienti i peshës;

së fundi

- Indeksi GCR në fund është llogaritur duke mbledhur pikët e çdo nën-indeksi, duke përdorur formulën e mëposhtme (indeksi i përgjithshëm do të ketë vlera në intervalin 0 dhe 1):

$$I_c = (P_{i/d1} + P_{i/d2} + P_{i/d3} + P_{i/d4} + P_{i/d5}) / 5/100, \quad D=5; \quad (3)$$

ku: I_c = indeksi i përbërë, $P_{i/d1,2,3,4,5}$ = pikët për treguesin i pas matjes (peshimit)

Shtetet për të parë më mirë pozitat e tyre janë rankuar në rend zbritës për sa i përket qeverisjes së përgjegjshme të korporatave, shteti me vlerë indeksi më të lartë ka përgjegjshmëri më të lartë të asaj që ne e quajmë qeverisje e përgjegjshme e korporatave (RCG) e kështu me rrallë deri në fund tek shteti me vlerë indeksi më të ulët të kësaj qeverisje.

3.6 Ecuria e veprimeve për të arritur tek rezultatet e kërkimit

Duke aplikuar metodologjinë e përshkruar më sipër, kemi përcaktuar vlerën e indeksit të qeverisjes së përgjegjshme të korporatave (responsible corporate governance index = RCGI) për çdo shtet ku përfshihet edhe Shqipëria. Por, deri sa të arrijmë në këtë vlerë kemi ndjekur rrugën e mëposhtme. Për të vlerësuar dimensionet e qeverisjes së përgjegjshme të korporatave (D), dhe për të parë se ku ndodhet Shqipëria kemi përdorur raportin që përmendëm më lart, Raportin e Konkureshmërisë Globale (*The Global Competitiveness Report*) të publikuar nga Forumi Ekonomik Botëror (Schwab dhe Sala-i-Martin, periudha 2013-2014). Në këtë raport në secilin nga shtetet e përzgjedhur ndodhet indeksi i konkureshmërisë globale i detajuar (The Global Competitiveness Index, GCI). Raporti përmban vlerën dhe rankimin përkatës. Për sa thamë më lart, OECD-ja, rekomandon dimensionet e mëposhtme të matjes së qeverisjes së përgjegjshme të korporatave (D), strukturuar si më poshtë:

D1 – Të drejtat e aksionerëve dhe trajtimi i barabartë i tyre;

D2 – Marrëdhëniet me grupet e interesit (stakeholders);

D3 – Përgjegjësitë e Bordit Drejtues në realizimin e objektivave të korporatës;

D4 – Qëndrimi etik i korporatës (te vepruarit në mënyrë etike);

D5 – Transparenca dhe zbatimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm.

Duke ditur dimensionet përkatëse më poshtë do të llogarisim indeksin e qeverisjes së përgjegjshme të korporatave, i cili është një indeks i përbërë bazuar në pesë nën-indekse, të cilat i korrespondojnë dimensioneve të lartpërmendur për të parë qeverisjen e përgjegjshme të korporatave, dhe çdo nën-indeks është përcaktuar duke përdorur treguesit e zgjedhur për periudhën 2013-2014 marrë nga raporti, raport i cili është më i fundit i publikuar në internet. Indekset i korrespondojnë numrave, kështu psh indeksi I1.1 i përshtatet në tabelë numrit 1.20, I 1.2 numrit 1.21 e kështu me radhë.

Dimensioni 1, **D1 - “Të drejtat e aksionerëve dhe trajtimi i barabartë i tyre”**, në të cilën kemi 2 nënindekse: I 1.1 (1.20) - Mbrojtja e aksionerëve (këtu përfshihen edhe aksionerët në minorancë)

I 1.2 (1.21) - Mbrojtja e Investimeve (sa e fortë është mbrojtja e investuesve).

Dimensioni 2, **D2 - “Marrëdhëniet me grupet e interesit (stakeholders)”**,

I 2.1 (7.03) - Praktikë e marrjes dhe largimit nga puna (Hiring and firing practices)

I 2.2 (7.01) - Marrëdhëniet ndërmjet punëdhënësve dhe punëmarrësve (Cooperation in labor-employer relations). I 2.3 (6.15) – Shkalla e fokusimit tek konsumatori (Degree of customer orientation). Dimensioni 3, **D3 – “Përgjegjësitë e Bordit Drejtues në realizimin e objektivave të korporatës”**, I.3.1 (7.07) - Siguria në menaxhimin profesional. I.3.2.1 (5.08) – Vazhdimi i trajnimit të stafit. I.3.2.2 (11.09) – Gatishmëria për të deleguar autoritetin. Dimensioni 4, **D4 – “Qëndrimi etik i korporatës (te vepruarit në mënyrë etike)”** është bazuar në një tregues të vetëm **(I.4)** (1,17) i cili mat perceptimin e sjelljes etike të korporatës në një vend të caktuar në krahasim me vendet e tjera **(1.17 Ethical behavior of firms)**. Dimension 5, **“Transparenca dhe zbatimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm ”**, i referohet përputhjes me standardet e raportimit dhe përcaktohet duke përdorur treguesin (I5):

I.5- Përputhshmëria me raportimin dhe auditimin e performancës financiare.

1.5.1 (1.18) Forca e auditimit dhe raportimi i standardeve.

1.5.2 (11.06) Kontrolli i shpërndarjes ndërkombëtare.

1.5.3 (1.12) Transparenca dhe politikbërja e qeverisjes.

3.7 Rezultatet e marra nga kërkimi

Mbështetur në metodologjinë e lartpërmendur, kemi përcaktuar në bazë të llogaritjeve vlerën e indeksit të qeverisjes së përgjegjshme të korporatave (responsible corporate governance index = RCGI) për çdo shtet. Konkretisht vendet në zhvillim për të cilën theksojmë që fokusohemi. Rezultatet tregohen në Tabelën:15, shtojca 2 nga ku shohim se 12 nga 23 shtetet kanë një vlerë të indeksit të GCR-së mbi 0.5. Mund të themi se shtetet me indeks mbi 0.5 janë në një situatë të mirë të qeverisjes. GCR-ja është rezultat i llogaritjes së disa nën indekseve siç e përmendëm më lart. Secili nga nënindekset është llogaritur sipas formulës së shpjeguar hap pas hapi. Estonia renditet e para, larg nga ndjekësi i saj më i afërt me një vlerë indeksi të barabartë me 0.791, e cila tregon se perceptimi i të anketuarve është shumë i favorshëm për të ndjekur parimet e qeverisjes së përgjegjshme të korporatave, pastaj renditet Turqia me 0.629, pastaj Letonia me 0.607 ndërsa Shqipëria është me treguesin 0.442 dhe renditet në vendin e 18-të. Nga analiza e 5 dimensioneve, vendet si Estonia, Turqia dhe Letonia shënojnë vlera maksimale. Pasi kemi realizuar hapin e parë dhe hapin e dytë siç e përmendëm më lart, për të llogaritur GCR-në për secilin shtet kemi përdorur formulën :

$$I_c = (P_{i/d1} + P_{i/d2} + P_{i/d3} + P_{i/d4} + P_{i/d5}) / 5 / 100 \quad (D(\text{Dimen.})=5);$$

Hapi i parë:

- Normalizimi arrihet duke aplikuar formulën e mëposhtme:

$$P_i = 100 * (X_i - \text{val}_{\min}) / (\text{val}_{\max} - \text{val}_{\min}) \quad (1)$$

P_i = pikët për treguesin i , $= 100 * (3.8 - V1 \text{ min të të gjitha shteteve vertikalisht}) / (V1 \text{ max të të gjitha shteteve vertikalisht} - V1 \text{ min të të gjitha shteteve vertikalisht}) = 68.75$ (I 1.1)

$$P_i = 100 \times (3.8 - 2.7) / (4.3 - 2.7) = 100 \times (1.1 / 1.6) = 68.75 \quad (I 1.1)$$

$$\text{Treguesi pasardhës} = 82.50 \quad (I 1.2)$$

ku: X_i = vlera e treguesit që do të normalizohet, $\text{val}_{\max}$ = vlera maksimale, $\text{val}_{\min}$ = vlera minimale;

Hapi dytë:

- Janë vendosur koeficientët e peshimit: çdo tregues është peshuar në mënyrë të barabartë në secilin dimension (D) dhe çdo dimension ka peshë të barabartë në indeksin e përgjithshëm;
- Dimensionet mbledhen duke shumëzuar numrin e pikëve të marra gjatë normalizimit me koeficientët e peshave që do të maten duke përdorur formulën e mëposhtme :

$$P_{i/d} = P_i * C_d, \quad (2)$$

ku: $P_{i/d}$ = pikët për treguesin i pas peshimit, P_i = pikët për treguesin i , C_d = Koeficienti i peshës;

$$(P_{i/d} = \text{pikët për treguesin } i \text{ pas peshimit} = P_i * C_d)$$

$(100 * (3.8 - V1 \text{ min të të gjitha shteteve vertikalisht}) / V1 \text{ max të të gjitha shteteve vertikalisht} - V1 \text{ min të të gjitha shteteve vertikalisht}) * C_d$, (koeficienti i peshës ku për dimensionin e parë D1 është 50% me 50% pasi kemi 2 indekse I 1.1 dhe I 1.2) = 75.6

$(3.8 - 2.7) / (4.3 - 2.7) \times 50 + (7.3 - 4) / (8 - 4) \times 50 = 34.37 + 41.25 = 75.6$ dhe që do ta vendosim më poshtë në veprimet që do bëjmë në formulën e tretë. Për të dytin D2, koeficienti i peshës = 1/3 pasi kemi tre nën-indeksë si pjesë e dimensioneve dhe kështu me rrallë dhe për të tjerat. Veprimet i kemi kryer nga përpunimi i tabelave në Excel.

Së fundi:

- Indeksi GCR në fund është llogaritur duke mbledhur pikët e çdo nën-indeksi, duke përdorur formulën e mëposhtme (indeksi i përgjithshëm do të ketë vlera në intervalin 0 dhe 1):

$$I_c = (P_{i/d1} + P_{i/d2} + P_{i/d3} + P_{i/d4} + P_{i/d5}) / 5 / 100, \quad (3)$$

ku: I_c = indeksi i përbërë, $P_{i/d1,2,3,4,5}$ = pikët për treguesin i pas matjes (peshimit)

Llogarisim GCR-nëpër Shqipërinë :

$$I_c = (75.6 + 71.6 + 33.8 + 11.8 + 28.4)/5/100 = 0.442.$$

Kemi bërë pjesëtimin me 5, për arsye të 5 dimensioneve.

Le ta krahasojmë me indeksin e Maqedonisë, shtetit fqinj:

$$I_c = (81.9 + 69 + 30.6 + 47.1 + 45.1)/5/100 = 0.547.$$

Pra siç shikohet, Maqedonia ka një indeks të GCR-së më të lartë në masën 24% në krahasim me Shqipërinë gjë që tregon një qeverisje korporate më të mirë të shtetit fqinj. Në Tabelën 15, shtojca 2 paraqitet renditja e shteteve nga më e larta tek më e ulta sipas alfabetit për vlerën e indeksit GCR. Gjithësej për 23 shtete. Në këtë mënyrë kemi nxjerrë nga llogaritjet një klasifikim, i cili do na ndihmojë për të parë pozicionin se ku ndodhen vendet në zhvillim pas analizës së bërë. Për të demonstruar ekzistencën e lidhjeve ndërmjet treguesve që përbëjnë dimensionet e qeverisjes së përgjegjshme të korporatave (D), kemi aplikuar metodën e korrelacionit. Korrelacioni ndodh midis dy variablave që kanë lidhje shkakësore ndërmjet tyre. Rezultatet e Tabelës 16 shtojca 2 u siguruan duke përdorur analizën e të dhënave në Excel, të cilët tregojnë vlerësime të forta, apo shumë të forta ndërmjet treguesve (variablave) që do të përmendim më poshtë (> 0.7).

Sigurisht që kush është mbi këtë tregues paraqitet më mirë : I 3.2.2 dhe I 3.1, jep vlerën 0.806658 që tregon se kemi vlerësime shumë të forta. I 3.1 dhe I 2.2, jep vlerën 0.741061 që tregon se kemi vlerësime shumë të forta. I 5.1 dhe I 1.1, jep vlerën 0.7308 që tregon se kemi vlerësime shumë të forta, ku: I.3.2.2 (11.09) D3 – Gatishmëria për të deleguar autoritetin, I.3.1 (7.07) D3 - Siguria në menaxhimin profesional, I.3.1, I2.2 (7.01) - Marrëdhëniet ndërmjet punëdhënësve dhe punëmarrësve, 1.5.1 (1.18) - Forca e auditimit dhe raportimi i standardeve, I 1.1(1.20) - Mbrojtja e aksionerëve (ku përfshihen dhe ata në minorancë). E kundërta qëndron në këtë lidhje (-0,2000) I.3.2.1 (5.08) – Forcimi (rritja) i trajnimit të stafit (D3), I 2.1 (7.03) - Praktikrat e marrjes dhe largimit nga puna (Hiring and firing practices) (D2).Si dhe me disa të tjera : I.5.2 (11.06) Kontrolli i shpërndarjes së informacioneve ndërkombëtare (control of international distribution) me I.3.2.1 (5.08) Forcimi (rritja) i trajnimit të stafit.I.3.2.1 (5.08) Forcimi (rritja) i trajnimit të stafit me I 1.2 (1.21) Mbrojtja e Investimeve (strength of investor protection 0-10 vlerësimi) (sa e fortë është mbrojtja e investuesve/investitorëve). Ose (I.4) (1,17) i cili mat përceptimin e sjelljes etike të

korporatës në një vend të caktuar në krahasim me vendet e tjera (1.17 Ethical behavior of firms) me I.3.2.1 (5.08) – Forcimi (rritja) i trajnimit të stafit.

3.8 Klasifikimi i shteteve sipas përdorimit të indeksit të qeverisjes së përgjegjshme të korporatave GCR dhe i atij të GDP-së (PBB)/frymë. Analizë krahasuese e Shqipërisë me vendet e tjera të rajonit.

Ekonomia shqiptare është një ekonomi tërësisht e liberalizuar, e hapur në një shkallë të tillë që ka realizuar një stad të pranueshëm integrimi në ekonominë rajonale, si parakusht për integrimin ekonomik evropian. Prodhimi i brendshëm bruto (Gross domestic product, GDP/ PBB) dimë që është vlera e tregut e të gjitha mallrave dhe shërbimeve përfundimtare të njohura zyrtarisht që prodhohen brenda një vendi, konkretisht është një ndër treguesit që evidentojnë ecurinë e ekonomisë dhe zhvillimin e saj. PBB/frymë përdoret shpesh si një tregues i standardit material të jetesës së një vendi. Ai është një tregues ekonomik që paraqet vlerën me çmimet e tregut të të gjitha të mirave materiale dhe shërbimeve të prodhuara brenda një shteti në një periudhë të caktuar (zakonisht një vit). PBB nuk duhet ngatërruar me Prodhimin Kombëtar Bruto (PKB) i cili paraqet vlerën me çmimet e tregut të të gjitha të mirave materiale dhe shërbimeve të prodhuara nga burimet e punës dhe pronës së banorëve të një shteti brenda apo jashtë atij shteti në një periudhë të caktuar. PBB përfshin gjithë prodhimet e shërbimet aktuale të destinuara për treg si dhe ato të prodhuara për konsum për vete nga të gjitha njësitë rezidente që veprojnë në territorin e një shteti. PBB për frymë sipas fuqisë blerëse merr parasysh faktin që me 1 dollar të shpenzuar sa mallra e shërbime mund të blihen. Dy vitet e para të tranzicionit (1991–‘92) përbëjnë periudhën më të vështirë të ekonomisë shqiptare të 50 viteve të fundit: PBB ra në 50%, rritja ekonomike arriti një shifër negative rekord prej -13%, çmimet e produkteve bazë ushqimore u rritën 5-6 herë vetëm brenda vitit 1991, prodhimi industrial dhe ai bujqësor pothuajse u paralizuan, deficitet buxhetor e kaloi shifrën prej 50% të PBB, inflacioni u rrit me ritme galopante, duke arritur në 400% në fund të vitit ‘91, borxhi i jashtëm u rrit mbi 600 milionë US\$, papunësia kapi nivele mbi 50% të popullsisë së aftë për punë etj (Civici.A, 1991-1992, Fillimi i Vështirë, Mapo 21.11.2012). Me fillimin e stabilitetit politik, PBB shënoi rritje nga viti në vit, madje në nivele dy shifrore (në 1995-13 përqind). Kriza e vitit 1997 u pasqyrua drejtpërsëdrejti në rënien e këtij treguesi. Në fillim të 1997, vlera totale e depozitave në firmat piramidale arrinte në 1.2 miliardë dollarë, ose rreth 50% të PBB të vendit. Por,

duke pasur parasysh informalitetin e lartë të këtij aktiviteti si dhe pretendimet e mëvonshme të njerëzve që kishin humbur kursimet e tyre në këto skema piramidale, vlerësohet se shumat e depozituara e kalonin vlerën 1.8 miliardë dollarë. Me rivendosjen e stabilitetit politik përsëri fillon rritja e PBB-së. Promotorë të kësaj rritjeje kanë qenë ndërtimet dhe shërbimet, të cilat, gjatë periudhës 1992-2003 u rritën respektivisht me ritme mesatare vjetore prej 18 përqind dhe 8 përqind, por peshën më kryesore në këtë rritje e kanë mbajtur të ardhurat nga emigracioni (remitancat), të cilat e kaluan nivelin e 600 milionë USD në vit. Nëse i referohemi statistikave zyrtare për të bërë një krahasim për një periudhë 5 vjeçare, PBB për frymë, në vitin 2005 në vlerë ka qenë 2596.69 USD, ndërkohë që në vitin 2010 ka qenë 3694 USD. Prodhimi i brendshëm bruto për frymë, në vitin 2007 ishte 309 611 lekë, ose rreth 9.1% më shumë se në vitin 2006. Rritja e produktit të brendshëm bruto për frymë ka ndikuar në rritjen e nivelit të jetesës (Ekonomia e-Albania.al (Burimi: Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013)). Llogaritjet e PBB-së përfshijnë të gjitha prodhimet e shërbimet aktuale të destinuara për treg si dhe ato të prodhuara për konsum për vete nga të gjitha njësitë rezidente që veprojnë në territorin të cilësuar "ekonomik" të Shqipërisë. Ai është burimi kryesor i të ardhurave nga të cilat përfitojnë njësitë rezidente, qendra e aktivitetit ekonomik e të cilave ndodhet mbi territorin ekonomik (Burimi: <http://www.instat.gov.al>). PBB sipas metodës së prodhimit llogaritet sipas formulës:

$$PBB = VSHB + TP + TD - SP.$$

Ku : PBB - Prodhimi Brendshëm Bruto (me çmimet e tregut). VSHB - Vlera e Shtuar Bruto (me çmime bazë). TP - Taksat mbi Produktet përfshirë Taksën e Vlerës së Shtuar. TD - Taksat doganore. SP - Subvencionet mbi produktet dhe importet. Mbështetur në një hulumtim mbi PBB për frymë të Shqipërisë, krahasuar me vendet e rajonit për vitet 2000-2009, bazuar në të dhënat e siguruara nga Banka Botërore, Shqipëria pozicionohet në vendin e parafundit në rajon me një PBB për frymë prej 3.808 USD (e ndjekur nga Kosova me 2.984 USD). Ndërkohë në vend të parë renditet Greqia (29,240 USD), e ndjekur nga Kroacia (14.222 USD), Turqia (8.215 USD), Mali i Zi (6.635 USD), Serbia (5.872 USD), dhe Maqedonia (4.514 USD) (Burimi open.data.al). Grafiku 17 shtojca 2. Në të pasqyrohet PBB/frymë e shteteve për vitet 2000-2009, ndërsa tabela 17 shtojca 2, jep PBB/frymë e shteteve sipas alfabetit për vitin 2011, marrë nga Raporti i Konkureshmërisë Globale 2012-2013 raport i cili jep të dhëna për vitin 2011, ndërsa raporti i vitit 2013-2014 jep të dhëna për vitin 2012. Kriza

globale në ekonominë shqiptare çoi në rënie të ritmeve të rritjes ekonomike GDP (PBB). Kështu psh në vitin 2009, ritmet e rritjes ekonomike ranë duke shkuar në nivelin rreth 0-2%, uljen e investimeve por gjithashtu dhe rënie të të ardhurave nga remitancat (pas vitit 1990 ato kanë përfaqësuar 10-22% të GDP-së së vendit).Përjasjet teorike mbështeten në analizën e disa prej modeleve ekonomike më në zë në zhvillimet e deritanishme të kapitalizmit si: modeli anglo - sankson, modeli i kapitalizmit shtetëror (Franca, Italia etj), modeli gjerman (Gjermani,Vendet Skandinave etj), modeli i Korporatave (disa vende aziatike), modeli amerikano-latin, modeli afrikan, modeli kinez. Ndërkohë që modeli i Shqipërisë lidhet me debatin e perspektivës së zhvillimit të vendit, integrimin në tregjet globale dhe fundin e tranzicionit. Një klasifikim i rëndësishëm është përdorimi i indeksit të qeverisjes së përgjegjshme të korporatave GCR së bashku me atë të GDP-së (PBB)/frymë, si një tregues i nivelit të zhvillimit ekonomik të shteteve të analizuara. Qeverisja e përgjegjshme e korporatave është e lidhur me zhvillimin ekonomik, dhe në këtë rast duke aplikuar statistikën përshkruese (Adams et. al., 2007), mundësojmë një paraqitje grafike të të dhënave. Në tabelën 18 shtojca 2, jepet shpërndarja e shteteve bazuar në 2 elementë, PBB/frymë dhe Indeksi GCR% sipas alfabetit, ndërsa në tabelën 19 shtojca 2 jepet renditja sipas treguesve të GDP/frymë e shteteve, nga më e larta tek më e ulta për vitin 2012, ndërsa në tabelën 20 shtojca 2, renditja e GCR/% e shteteve, nga më e larta tek më e ulëta për vitin 2012, marrë nga raporti i lartpërmendur për vitin 2013-2014.Indeksi GCR-së është llogaritur me metodën e përmendur në studim, ndërsa GDP (PBB) është marrë i gatshëm nga raporti. Ndërkohë, në grafikun Nr.18 në shtojcën 2 paraqet lidhjen ndërmjet GCR-së dhe GDP (PBB)/frymë për një grup shtetesh, grup në të cilën bën pjesë edhe Shqipëria. Zona e rrethuar në këtë grafik, e cila ndodhet në pjesën e poshtme në të majte, përbën rreth 1/3-ën ose 30,42% e vendeve evropiane në zhvillim të analizuar, ku janë pozicionuar 7 prej 23 vende të marrë në studim,nga ku vërejmë se një pjesë janë vende të rajonit të Evropës Juglindore, konkretisht : Moldavia(GCR 41.89% dhe GDP 2,037 USD/frymë, Ukraina (GCR 33,65% dhe GDP 3,877 USD/frymë), Bosnja dhe Hercegovina (GCR 41,63% dhe GDP 4.461 USD/frymë), Serbia (GCR 32,80% dhe GDP 4.943 USD/frymë), Bullgaria (GCR 48,66 % dhe GDP 7.033 USD/frymë, Rumania GCR 36,27% dhe GDP 7.935 USD/frymë dhe Shqipëria (GCR 44,24% dhe GDP 3,319 USD/frymë), nga ku rezultojnë se kanë një nivel të ulët të qeverisjes së

përgjegjshme të korporatave GCR dhe të zhvillimit ekonomik, matur me treguesin e GDP-së (PBB). Shqipëria, për vitin 2012, sipas Raportit të Konkureshmërisë Globale të publikuar nga Forumi Ekonomik Botëror për vitin 2013-2014 ku instituti partner për Shqipërinë është *Instituti i Studimeve Bashkëkohore* renditet në klasifikim në vendin e 20-të me 3.913 USD/frymë duke lënë mbrapa Ukrainën, Gjeorgjinë dhe Moldavinë përkatësisht me 3.877 USD/frymë, 3.543 USD/frymë dhe 2.037 USD/frymë, ndërkohë që në vendin e parë renditet Sllovenia me 22.193 USD/frymë e ndjekur nga Republika Çeke me 18.579 USD/Frymë dhe Republika Sllovake me 16.899 USD/frymë. Në lidhje me indeksin e qeverisjes së korporatave (GCR), Shqipëria renditet në vendin e 18-të me 44.24% dhe pas saj Moldavia me 41,89% dhe Bosnja dhe Hercegovina me 41,63% ndërkohë që Estonia ndodhet në vendin e parë me indeks 79.08% e ndjekur nga Turqia dhe Letonia përkatësisht me indeks GCI. 62,87% dhe Letonia 60.73% dhe pastaj me radhë shtetet e tjera si Kazakistan, Lituani, Mali i Zi etj. Duke u mbështetur në të dhënat e publikuara nga *Wikipedia* për vitin 2013, GDP/nominale për frymë për vitin 2013 sipas Bankës Botërore, renditet në vendin e parë Sllovenia me 22,059 USD/frymë, dhe më pas Estonia me 18,478 USD/frymë, ndërkohë që Shqipëria ka një nivel prej 4,652 USD/frymë, madje më pak se Maqedonia me 4,851 USD/frymë dhe thajse në të njëjtin nivel me Bosnjë Hercegovinën me 4,656 USD/frymë. FMN-ja për vitin 2013 e klasifikon Shqipërinë në nivel thajse të njëjtë si Banka Botërore me 4,565 USD/frymë, ku Bosnja dhe Hercegovina ka një nivel 4,620 USD/ frymë dhe Maqedonia 4,931 USD/frymë. Edhe sipas FMN-se, Sllovenia paraqitet më mirë, konkretisht me 23,317 USD/ frymë, ndërsa Estonia me 18,852 USD/frymë, gjithashtu në nivel të kënaqshëm, pra duke u renditur më mirë sesa shtetet e tjera (Tabelat 24,25 shtojca 2). Kështu po të shohim në retrospektivë për periudhën 2004-2005 mbi “Krahasimin e Niveleve të Konkureshmërisë” të ekonomive të 117 vendeve të botës të botuar nga *Forumit Ekonomik Botëror* në atë periudhë, të bën përshtypje fakti që Estonia si një ndër vendet e reja në atë kohë të BE-së ruajti vendin e 20-të në klasifikimin e përgjithshëm duke u shfaqur si ekonomia më kompetitive e këtij grupi vendesh. Në raportin e periudhës 2012-2013 të përgatitur nga ky forum, Forumi Ekonomik Botëror (World Economic Forum) vendet e rajonit, të Evropës Juglindore (EJG) renditen : Bullgaria e 62-ta, Mali i Zi –i 72 ti, Rumania e 78-ta, Maqedonia e 80-ta, Kroacia e 81-ta, Bosnjë – Hercegovina e 88-ta, Serbia e 95-ta, Greqia e 96-ta, etj. Ndërsa Shqipëria renditet e 89-ta në listën

prej 144 vendesh. Ekonomitë që renditen në vendet e parë janë : Zvicra, Singapori, Finlanda, Suedia, Holanda, Gjermania etj. Rezulton se ekonomitë anglo-sanksone nuk janë me performancë më të mirë se modeli kontinental. Pyetja që shtrohet është modeli anglo-sankson apo modeli kontinental evropian është më i mirë? Pikërisht sa kompetitiv është një vend në raport me një tjetër, është një pikë krahasimi e rëndësishme. Duke përdorur mjetet dhe praktikën e qeverisjes së përgjegjshme të korporatave, theksojmë se vendet mund të përmirësojnë performancën e tyre të biznesit dhe pozicionin konkurrues në tregjet ndërkombëtare, pasi dihet që biznesi i jep “frymëmarrje” ekonomisë. Le të shikojmë tani se si qëndron lidhja e Indeksit të Qeverisjes së Përgjegjshme të Korporatave GCR me PBB/frymë. Grafiku 19 shtojca 2. Statistika analitike dimë që shërben për testimin e hipotezave. Nga teoria statistikore dimë llojet e analizës, konkretisht : univariate, bivariate dhe multivariate dhe është pikërisht tipi i dytë i analizës që tregon lidhjen midis 2 variablave. Pikërisht regresi, korrelacioni, tabelat e kontigjencave, testi hi në katror etj janë pjesë e saj. Regresi linear shërben për të modeluar marrëdhëniet ndërmjet variablilit të varur Y dhe një ose më shumë variablave të pavarura shpjeguese x . Rasti i një variabli të pavarur është quajtur regresi i thjeshtë linear. Për më shumë se një variabël shpjeguese, procesi quhet regresi i shumëfishtë linear. Variabli ose variablat që përdoren për të parashikuar vlerën e variablilit të varur quhen variabla të pavarur. Forma e përgjithshme e regresionit të thjeshtë linear ka trajtën $y = b_0 + b_1x$, ku b_0 -pikëprerja me boshtin e ordinatave, b_1 -koeficienti këndor, y -vlera e variablilit të varur. Ekuacioni i vijës që gjendet me metodën e katrorëve më të vegjël përbën një vlerësim të vijës, ose të ekuacionit të regresionit të vërtetë. Vlerësimi për ekuacionin e regresit linear ka formën e sipërpërmendur. Në statistikë, koeficienti i përcaktimit (determination), shënohet R^2 dhe tregon sesi të dhënat përshtaten në një model statistikor. Kështu, *koeficienti i korrelacionit*, r mat forcën e relacionit linear që ekziston brenda një prove të n të dhënave dy ndryshore. Pra, sa mirë ky ekuacion i përftuar nga analiza e të dhënave i përshtatet të dhënave reale. Ky koeficient përdoret për testimin e hipotezave, dhe shkon nga 0 në 1 (r ndryshon nga -1 dhe 1, $r \in [-1; 1]$). Në rastin tonë kemi një R^2 të vogël, që tregon një lidhje të dobët midis variablave të varur x dhe të pavarur y , konkretisht qeverisja e korporatave në vendet në zhvillim, përfaqësuar nga GCR si variabël i varur y (që ndodhet në boshtin e ordinatave), mbështetur në PBB/frymë, variabli x (që paraqitet në boshtin horizontal) si variabël i

pavarur, nga ku vërejmë se nuk është në nivel të lartë, dhe kjo tregohet nga fortësia e R^2 i cili nuk është afër 1. Pra, në rastin konkret kemi vërtetim të hipotezës së parë të ngritur për këtë pjesë të studimit, pra qeverisja e korporatave nuk është efektive, në të kundërt do të kishim një lidhje më të fortë (p.sh në rastin e një korrelacioni 0.536 ndërlidhja ndërmjet variablave do të ishte mesatarisht e fortë, konkretisht koeficienti i korrelacionit). Analiza e korrelacionit është një teknikë matematikore që shërben për të matur “*forcën e lidhjes ndërmjet variablave*”. Koeficienti i korrelacionit shënohet me r_{xy} dhe merr vlera $[-1; 1]$, ku +1 do të thotë se lidhja është shumë e fortë dhe me drejtim pozitiv, pra me rritjen e njërit variabël rritet edhe variabli tjetër, -1 do të thotë se lidhja është e fortë, por me drejtim të kundërt, pra me rritjen e njërit variabël zvogëlohet variabli tjetër dhe nëse vlera e koeficientit të korrelacionit është 0, themi se ndërmjet këtyre variablave nuk ka asnjë lloj korrelacioni/ lidhjeje (nuk ekziston lidhje). Nga kjo analizë duket qartë se treguesit e marrë në shqyrtim janë të pakorreluar me njëri-tjetrin dhe për rrjedhojë janë të pavarur. Në rastin tonë kemi të bëjmë me një ekuacion të thjeshtë linear pasi kemi vetëm një variabël të pavarur dhe një variabël të varur dhe lidhja e tyre përafrohet në formë lineare. Theksojmë se jo domosdoshmërisht indeksi i GCR-së mund të shoqërohet me GDP të lartë dhe kjo duket dhe nga analiza e korrelacionit, konkretisht Republika Sllovake ka një GDP të lartë 16.899 USD/frymë, por një indeks të qeverisjes së korporatave disi të ulët 0.45 (45%). Një rast tjetër Gjeorgjia e cila ka GDP-në 3.543 USD/frymë dhe indeksin e qeverisjes 53.9%. Ndërsa disa vende të tjerë karakterizohen nga GDP dhe indeks i ulët i qeverisjes, konkretisht nën 50% si psh Shqipëria, Bosnjë- Hercegovina, Serbia, Ukraina, Moldavia, Rumania dhe Bullgaria të cilët janë përfshirë dhe në zonën e rrethuar të grafikut 18 shtojca 2. Krahësohet edhe me vendet e rajonit Shqipëria, matet në terma relativisht më të ulët, klasifikohet më poshtë, konkretisht duke u renditur në vendin e 20-të sipas tabelës së grupimit të të dhënave me 3913 USD/frymë si dhe në vendin e 18-të në kuadrin e indeksit të Qeverisjes së Përgjegjshme të Korporatave GCR-së. Të dhënat të cilët shërbyen për ndërtimin e grafikut flasin qartë për nevojën e marrjes së masave nga politikbërësit për të kapërcyer gjendjen dhe për të pasur në periudhat e ardhshme rritje të indeksit për Shqipërinë për t’u renditur ndër vendet e para në rajon për të pasur në vijimësi një lidhje të qëndrueshme ndërmjet indeksit të qeverisjes së përgjegjshme të korporatave GCR dhe PBB/frymë. Arritja e këtij objekti të domosdoshëm shtrun

nevojën e përpunimit të strategjive afat-shkurta dhe afat-mesme të cilat duhet të përcaktojnë qartë rrugët dhe masat e domosdoshme duke vendosur politika prioritare që do të sigurojnë zhvillim të qëndrueshëm. Duke ju përgjigjur pyetjes së parë kërkimore nga sa analizuam më lart, themi se kjo qeverisje duhet përmirësuar në tërësi në shkallë kombëtare, për të pasur nivel më të lartë të indeksit të qeverisjes së përgjegjshme të korporatave, si dhe për t'u krahasuar në të njëjtën kohë me vendet në zhvillim, për të qenë vërtetë një qeverisje e mirëfilltë korporate por dhe efektive. Një qeverisje e mirë kontribuon në zhvillimin e një ekonomie të qëndrueshme duke rritur performancën e shoqërisë (Manuali i QK-së, IFC). Gjithashtu dhe hipoteza e parë vërtetohet pasi një qeverisje larg praktikave më të mira, ka një ndikim në GDP (PBB), si matës i zhvillimit ekonomik të çdo vendi, dhe nëse shoqëritë në Shqipëri nuk do të jenë të përgjegjshme me qeverisjen e tyre duke zbatuar parimet e OECD-së, atëherë edhe treguesit ekonomik nuk do të jenë të lartë, pasi shoqëri të mirëqeverisura (p.sh përmendim bankat e nivelit të dytë) mund të kenë rezultate të larta dhe japin më shumë të ardhura për buxhetin e shtetit në formën e tatimeve dhe taksave dhe në këtë mënyrë përmirësohet dhe indeksi i qeverisjes së përgjegjshme të korporatave të Shqipërisë (GCR) duke u renditur në shkallë më lart në klasifikim. Raporti i Forumit Ekonomik Botëror (World Economic Forum) mbi “Krahasimin e Nivelit të Konkureshmërisë” i cili ka realizuar dhe klasifikimet përkatëse ku bën pjesë edhe Shqipëria, konsiderohet si barometri më i plotë në shkallë ndërkombëtare për të matur dinamizmin ekonomik të çdo vendi dhe kapacitetet e fleksibilitetit të tij për t'u përshtatur me tendencat e ekonomisë botërore. Aktualisht në Shqipëri nevojitet përputhje sa më e mirë e traditave historike e mentalitetit kombëtar me format dhe modelet e zhvillimit, zhvillimi me përparësi i biznesit të vogël dhe atij të mesëm, integrimi rajonal qoftë mesdhetar qoftë ballkanik në strategjitë e zhvillimit dhe të krijimit të një ekonomie rajonale komplementare, zhvillimi i tregjeve financiare, garantimin dhe transparencën e pronës dhe funksionimit të tregjeve, garantimi i kushteve specifike të zhvillimit për disa sektorë lokomotivë që ndikojnë ndjeshëm në PBB dhe punësim etj. Së fundi, por jo për nga rëndësia, duhet të evidentojmë ndër vendet e marra në studim Estoninë për rezultatin në fushën e qeverisjes së korporatave, konkretisht të indeksit të GCR-së për vitin 2012, i cili paraqitet në tabelën 20 shtojca 2 ($GCR\% = 79,084$), duke u renditur në vendin e parë, anëtare e BE-së që në vitin 2004 dhe eurozonës në vitin 2011. Megjithatë cilësohet si

një nga vendet më liberale të Evropës Veriore, Estonia dallohet për politika sociale të suksesshme dhe eficiente. Me kapitalizëm më specifik, më afër atij anlo-sankson, por më tepër si vullnet politik dhe dëshirë sesa aplikim konkret dhe korrekt të tij, paraqitet vende të tilla si Rumania, Moldavia etj (Civici.A,Transformimi i madh 2014, fq 216).Ekonomia e Estonisë, siç thamë një ekonomi liberale, bazohet kryesisht në elektronikë, telekomunikacion, produkte ushqimore, veshmbathje, lëndë drusore, makineri, ndërtim anijesh dhe shërbime bankare. Ekonomia ka marrë zhvillim si pasojë e kryerjes së shumë shërbimeve *online*. Estonia ka shumë porte nga ku transportohen mallra të ndryshme për dhe nga Rusia. Estonia ka një borxh të vogël, vetëm 6.7% te GDP (wikipedia.org). Për vitin 2012 sipas tabelës 20, shtojca 2,shohim se GDP-ja e Estonisë është e lartë, konkretisht 16,320 USD/frymë. Vendet në zhvillim dhe vendet e botës së tretë duhet të krijojnë një ekonomi të qëndrueshme “nëse do të jesh i bukur e i shëndetshëm vrapo, nëse do të qeverisësh i qetë krijo ekonomi të qëndrueshme” thotë një proverb i njohur grek. Në Shqipëri duhet të eliminohen disa pengesa strukturore me ndikim në GDP/bruto, si p.sh : pengesa sasiore. Aktualisht kemi një privatizim masiv, kemi shërbime fason, call center etj duke ezauruar zhvillimin sasior ndërkohë zhvillimi cilësor duhet të bazohet në inovacion dhe që siguron zhvillim të qëndrueshëm, një vlerë të shtuar në kohë fizike. Gjithashtu ndryshimi i kontributit të fushave specifike ndikon në rritjen ekonomike psh. fusha e ndërtimit. Sektori i ndërtimit kontribuon me 1 miliard Euro në vit, 10% e GDP-së, nëse punon me 60% të pjesës kontribuese, që duhet për buxhetin, atëherë ai kontribuon me 400 milion euro më pak. Sigurisht që edhe shoqëri të tjera me qeverisje të mirë padyshim që duhet të ndikojnë në GDP me kontributin e tyre por duhet te dinë se si të qeverisin. Edhe Shqipëria duhet të marrë shembull nga modelet më të përparuara, pasi është një vend kandidat për në Bashkimin Evropian dhe nuk do të jetë e largët dita kur mund të bëhemi pjesë e familjes së BE-së dhe matja me këto ekonomi kërkon standarde. Shqipëria po ecën në rrugën e përmbushjes së reformave të nevojshme dhe duam të bëhemi pjesë e familjes së Bashkimit Evropian. Sot Bashkimi Evropian beson duke hapur dritën jeshile pikërisht mbi standardet që institucionet ndjekin si dhe mbi gjithçka monitoron zbatimin e legjislacionit dhe praktikat bashkëkohore në çdo sektor dhe veçanërisht në atë të ekonomisë si pika nevralgjike e matjes së treguesve të shtetit.

KAPITULLI IV

QEVERISJA E KORPORATAVE NË SHOQËRI QË VEPROJNË NË SHQIPËRI

Reformat ligjore dhe rregullatore të kohëve të fundit e kanë përmirësuar kuadrin institucional të qeverisjes së shoqërive aksionere. Ligjet dhe rregullat janë ngritur tashmë në lartësinë e standardeve ndërkombëtare lidhur me çështjet kryesore të qeverisjes së shoqërive aksionere në shumë vende në tranzicion ish komuniste përfshi dhe Shqipërinë e cila ka krijuar tashmë bazën e saj me praktikat e qeverisjes për shoqëritë.

Në kapitujt e mësipërm kemi dhënë disa përkufizime të qeverisjes së korporatave, nga ku kuptojmë se nuk kemi një përkufizim të vetëm, pra standard për këtë qeverisje. Autorë të ndryshëm qeverisjen e shoqërive aksionere (*corporate governance*) e përkufizojnë si: sistemi që rregullon dhe mbikëqyr sjelljen e shoqërisë dhe balancimin e interesave të të gjithë grupeve të brendshëm të interesit dhe palëve të tjerë (grupe të jashtëm interesi, organet shtetërore, komunitetet lokale) të cilët mund të preken nga sjellja e shoqërisë, në mënyrë që të sigurojnë sjellje të përgjegjshme të shoqërisë dhe të arrijnë një nivel maksimal të eficiencës dhe fitimit për të.⁶ Në këtë kapitull trajtohet analiza e qeverisjes së korporatave në disa shoqëri të cilët veprojnë në mjedisin ekonomik në Shqipëri. Shoqëritë e kërkuara dhe të marra në studim janë të tipit shoqëri anonime si shoqëri të cilët janë më të konsoliduar në treg. Edhe ky kapitull vijon me të njëjtat procedura të llogaritjes së indeksit të qeverisjes së përgjegjshme të korporatave ashtu si në rastin e vendeve evropiane në zhvillim. Në këtë kapitull një pjesë e rëndësishme është ajo e procedurës së mbledhjes së të dhënave, mënyra e hartimit të pyetësorit, duke përfunduar në epilog me vlefshmërinë dhe besueshmërinë e pyetësorit.

4.1 Njësitë matëse dhe hartimi i pyetësorit

Për t'i dhënë përgjigje pyetjeve kërkimore dhe për të testuar hipotezat e ngritura janë

⁶ Du Plessis, Jean Jacques; Hargovan, Anil; Bagaric, Mirko; Principles of Contemporary Corporate Governance, Second Edition, Cambridge University Press, 2011, faqe 10, 23.

përcaktuar rastet respektive si variabla për të parë lidhjet ndërmjet tyre.

Përdorimi i pyetësorit krijon mundësinë e mbledhjes së të dhënave vetëm një herë nga grupi i zgjedhur, sepse është e vështirë t'i rikthehesh edhe një herë atyre që plotësuan pyetësorin e të mbledhësh informacion shtesë (Saunders *et al.*2009). Kjo nënkupton që planifikimi i të dhënave që do mbledhen, mënyra që do përdoret për analizimin e tyre dhe hartimi i pyetësorit janë momente shumë kritike për kërkim. Zbatimi konkret i planit të kërkimit në mbledhjen e të dhënave të nevojshme që do të përdoren në analizat e mëtejshme kishte të bënte me faktin se si i përzgjedha shoqëritë. Marrja e kampionit u bë duke përdorur zgjidhjen e rastit, duke pasur parasysh që shpërndarja e subjekteve të ishte sa më diverse bazuar në madhësinë e tyre, statusin ligjor dhe fushën e aktivitetit kryesor. Gjithashtu u bë edhe një provë pilot për të testuar pyetësorin dhe për të riparuar problemet eventuale. Testi i vlefshmërisë së pyetësorit u krye në 10 shoqëri dhe rezultati ishte pozitiv, pra pyetjet ishin të qarta dhe të formuluar drejt.

Pyetësori i hartuar, siç thamë dhe më lart është ndarë në shtatë seksione ose pjesë. Në pjesën e parë A, e cila ka në përbërje 6 pyetje synohet mbledhja e informacionit të përgjithshëm mbi shoqëritë që janë bërë pjesë e studimit, si për shembull : vitet e ushtrimit të aktivitetit, origjina e krijimit të shoqërisë etj. Për të vlerësuar madhësinë e shoqërisë do përdoret si tregues numri i punonjësve. Për këtë qëllim kemi adresuar dhe një pyetje në këtë pjesë për numrin e punonjësve. Klasifikimi i ndërmarrjeve në bazë të numrit të të punësuarve, sipas ligjit, dimë që është si vijon:

- *Mikrondërmarrje: deri në 9 punonjës; Xhiro vjetore jo më e madhe se 10 milion lekë.*
- *Ndërmarrje e vogël: 10-49 punonjës; Xhiro vjetore jo më e madhe se 50 milion lekë.*
- *Ndërmarrje e mesme: 50 – 249 punonjës. Xhiro vjetore jo më e madhe se 250 milion lekë.*

Sipas Liuhto (2001) ky tregues është më i besueshëm sepse treguesit financiarë si kthimet ose shitjet janë më të predispozuar për të mbartur një përgjigje 'të parapëlqyer' ose 'jo të drejtë'.

Në pjesën B të pyetësorit, Ndjekja e parimeve të qeverisjes së korporatave sipas manualit (Kodit të qeverisjes së korporatave), kemi këto kapituj :

Ne kapitullin I, të pyetësorit kemi të pasqyruar të drejtat e aksionerëve në të cilën ndodhen 15 pyetje.

Në kapitullin II të pyetësorit, Roli i aktorëve në praktikat e qeverisjes, kemi të bëjmë me 6 pyetje ku ndër të tjera kemi pyetjet për nënshkrimet e kontratave të punës me punonjësit, të proceseve të ndryshme në dy vitet e fundit, si gjyqësore etj, kohës për të zgjidhur një konflikt gjyqësor, informimit të punonjësve mbi vendimmarrje të rëndësishme etj. Për shembull në rastin konkret të informimit rregullisht të punonjësve mbi vendimmarrje të rëndësishme dhe mbi gjendjen në të cilën ndodhet shoqëria është matur secili prej këtyre faktorëve me shkallën e Likertit nga 1-aspak deri në 5-plotësisht.

Kapitulli III i pyetësorit, Transparenca dhe zbulimi ka në përbërje 6 pyetje, kryesisht ky kapitull ka të bëjë me informacione që bëhen publike nga shoqëria, ose për shembull nëse i gjithë informacioni nuk publikohet i plotë cilat janë pengesat për të mos e bërë një gjë të tillë, përgjegjësitë e ekspertit kontabël etj.

Kapitulli IV i pyetësorit, ka të bëjë me rolin dhe përgjegjësitë e këshillit mbikëqyrës (ose siç njihet këshilli i administrimit) i strukturuar në 6 pyetje të cilët kanë të bëjnë me mënyrën e zgjedhjes, dëdurinë e mbledhjeve etj.

Kapitulli V i pyetësorit është i përbërë nga 5 pyetje dhe i kushtohet detyrimit dhe zbatimit. Pyetja e parë në këtë seksion synon të marrë informacion mbi gjykimin e rolit të institucioneve shtetërore të cilët nëpërmjet zbatimit të legjislacionit ndikojnë dhe në qeverisjen e korporatave, më pas për vlerësimin mbi procedurat gjyqësore, mbi rolin e auditimit etj. Edhe në këtë kapitull në vlerësimet mbi procedurat gjyqësore u përdor shkalla e matjes së njësive, konkretisht nga pak të përshtatshme deri tek “nuk kemi proces gjyqësor”. Kapitulli VI i pyetësorit është i përbërë nga 18 pyetje, siguron informacion mbi njohjet, vlerësimet, politikat dhe pengesat në kuadrin e qeverisjes së korporatave. Ndër pyetjet e këtij kapitulli përmendim : nevoja për listim në bursë, pengesat për moslistim në bursë etj. Sipas Hacker & Washington (2004) përpjekja për ndryshim vlerësohet e suksesshme atëherë kur arrihen rezultatet e dëshiruara, ndërsa Waldersë *et al.* (1999), Waldersë *et al.* (2003) dhe Waldersë *et al.* (2004) masin suksesin me ‘shtrirjen në të cilën ndryshimi ka arritur objektivat fillestare’. Pyetja e parë është shumë e rëndësishme, synon të tregojë nëse zyrtarët kryesorë të shoqërisë janë të familiarizuar me praktikat e qeverisjes së korporatave të vendeve të OECD-së, duke vijuar me pyetjen e dyte mbi vlerësimin mbi legjislacionin për shoqëritë tregtare, duke u fokusuar tek pjesa e ligjit për shoqëritë anonime nga 1-jo të përshtatshëm deri në 4-në

shumë i mirë, matur me shkallën e Likertit (në shkallën Likert subjekteve u kërkohet të tregojnë shkallën e pajtimit ose të mospajtimit me secilin nga formulimet). Tjetër pyetje ka të bëjë me pengesat për një qeverisje efektive të korporatës si dhe pyetje të tjera.

Kapitulli i VII i pyetësorit, ka të bëjë me zbatimin e parimeve të drejtimit të brendshëm për shoqëritë jo të regjistruara në bursë, politikave për mbrojtjen nga risku i krizës dhe manuali për mbrojtjen e biznesit familjar i përbërë nga 44 pyetje. Konkretisht vijimësia e pyetjeve është e tillë : duke filluar nga pyetja : kuadri themelues dhe drejtues i cili është dhe kuadri bazë i drejtimit të brendshëm është konsultuar me të gjithë grupet e interesit sidomos punëmarrësit ku korniza themeluese duhet të marrë për bazë dhe përgjegjësitë sociale (psh përmes statutit dhe akteve të tjera normative)? Psh një tjetër pyetje : *A ka vendosur këshilli mbikëqyrës ose administrimit (më poshtë do i themi këshilli) objektiva strategjike dhe të sigurojë burimet financiare dhe njerëzore që shoqëria ti arrijë objektivat e veta?* Pyetje tjetër për shembull: *A keni të parashikuar në kodin etik, nëse keni, se çfarë pret shoqëria tregtare në lidhje me standardet e shërbimeve për klientët, konfliktin e interesit, ndershmëri në punë, dhuratat apo trajtimin më përparësi lidhur me furnitorët, klientët ?* etj. Gjithashtu vijohet me pyetje të tilla si : *A është përfshirë këshilli në procesin e zhvillimit strategjik dhe të paktën të aprovojë strategjinë dhe të kujdeset që strategjia të jetë brenda interesave të aksionerëve?* etj.

4.2 Analiza e të dhënave

Qëllimi i studimit ishte pasqyrimi i faktorëve që ndikojnë në qeverisjen e korporatave. Për të realizuar këtë qëllim u testuan nga programi lidhjet ndërmjet llojeve të ndryshme të rasteve duke filluar nga informacioni mbi qeverisjen e korporatave, elementët e qeverisjes dhe rezultatet përkatëse të kësaj qeverisje. Për të arritur këtë qëllim u shpërndanë pyetësorë, rezultatet e të cilëve analizohen në këtë seksion të punimit në vijim. Rezultatet e pyetësorëve të mbledhur në fillim u koduan dhe më pas u hodhën dhe u përpunuan në programin statistikor SPSS versioni 17.0.

Në fillim të kësaj pike trajtohet një informacion i përgjithshëm mbi bizneset e marra në studim, duke vazhduar me disa aspekte të rëndësishme teorike të cilat do na tregojnë rrugën drejt analizës statistikore, konkretisht shtjellimin e modelit analitik dhe llojin e

analizës së përdorur. Në fund do të paraqesim një përmbledhje të analizës së të dhënave.

4.2.1 Informacioni i përgjithshëm mbi shoqëritë e marra në studim

Sh.a-të dhe sh.p.k-të, janë një formë e organizuar mirë dhe përkufizohen si korporata, shprehet e drejta evropiane, ku si shembull vjen legjislacioni i shtetit më të ri në rajon, Kosovës. Edhe në rastin tonë kemi mbajtur parasysh këtë fakt. Nga grafiku nr 1 fq.100, në faqen vijuese, vërehet se 76% e bizneseve që morën pjesë në anketim kanë një aktivitet që zgjat më shumë se 10 vjet, duke operuar akoma në treg, të ndjekur nga ata që kanë aktivitet 6-10 vjet, pra shoqëri/ korporata që janë relativisht të reja me 16%, dhe në fund me 8% renditen ato biznese që kanë maksimumi deri në 5 vite aktivitet (6 shoqëri ose 8%, 12 shoqëri ose 16% dhe 58 shoqëri që kanë më shumë se 10 vjet ose 76% të totalit).

Tabela 1 Mënyra e themelimit të shoqërive

Si janë themeluar shoqëritë	Frekuenca	Përqindja
Themeluar si shoqëri aksionere që në fillim	61	80.3
Si rezultat i privatizimit të ndërmarrjeve shtetërore	7	9.2
Me Ligjin Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare	8	10.5
Total	76	100.0

Tabela 1 tregon se 61 ose 80.3% e shoqërive të anketuara janë themeluar që prej fillimit të tyre si Sh.a, ndjekur nga 8 shoqëri ose 10.5% regjistruar si rezultat i transformimit të ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare dhe 7 ose 9.2% e shoqërive janë krijuar si rrjedhim i privatizimit të ndërmarrjeve shtetërore. Grafiku 1 shtojca 3. Më shumë se gjysma e tyre, konkretisht 68.42% janë ndërmarrje të mesme dhe të mëdha ku numri i të punësuarve varion nga 50-249, 25% ose 19 prej tyre janë ndërmarrje të vogla me 10-49 punonjës dhe pjesa tjetër janë biznese edhe më të vogla, kryesisht familjare, 5-9 punonjës 6.6%.

Grafiku1 Vitet e aktivitetit




Tabela më poshtë pasqyron shpërndarjen e bizneseve sipas numrit të punonjësve. Gjithashtu kemi të pasqyruar këtë tabelë dhe në anën grafike. Grafiku 2 shtojca 3.

Tabela 2 Numri i punonjësve

Ndarja sipas numrit	Frekuenca	Përqindja
5-9 punonjës (mikrondërmarrje)	5	6.6
10-49 punonjës (ndërmarrje e vogël)	19	25.0
50-249 (ndërmarrje e mesme)	52	68.4
Total	76	100.0

Shoqëritë e marra në studim paraqesin karakteristika të ndryshme për sa i përket llojit të aktivitetit që ata ushtrojnë, numrit të punonjësve dhe viteve të operimit në treg. Kështu, nga 76 shoqëritë e marra në studim, 25% e tyre merren me aktivitete shërbimi, pjesa tjetër me prodhim, përpunim, nxjerrje si dhe tregti, ndërtim etj. Për sa thamë përftohet tabela e mëposhtme.

Tabela 3 Shpërndarja e bizneseve sipas llojit të aktivitetit (grupimi).

Lloji i aktivitetit	Frekuenca	Përqindjet
Shërbime	19	25%
Prodhim, përpunim, nxjerrje	31	41%
Tregti	24	32%
Ndërtim	1	1%
Tjetër	1	1%
Totali	76	100%

Nga 76 pyetësorët e grumbulluar nga qytetet e Shkodrës, Lezhës, Tiranës, Durrësit etj, ndarja e marrjes së këtyre pyetësorëve ishte kështu:

37 pyetësorë në Tiranë, 48,69%, 23 pyetësorë në Durrës 30,26 %, 6 në Korçë 8%, nga 2 në Elbasan, Shkodër, Vlorë 2,63%, dhe nga 1 në Fier, Lezhë, Gjirokastrë, Lushnjë, 1,31%. Gjithsej pra 76 shoqëri që dorëzuan pyetësorët e plotësuar (përfshirë dhe ato që u morën drejtpërdrejtë). Mbështetur në strukturën e kapitalit nga ana statistikore afërsisht 90% e kapitalit është e përqëndruar në 30% të territorit ku banon rreth 60% e popullatës. Nga këto 76 biznese, 61 prej tyre ose 80, 26% janë biznese me pronësi shqiptare, pra me kapital shqiptar, 12 janë biznese në bashkëpronësi me të huaj pra me kapital të përbashkët ose 15,79% dhe 3 janë biznese me pronësi të huaj, pra me kapital të huaj ose 3,95%. Në 35% të rasteve ka qenë vetë shefi ekzekutiv ose një anëtar tjetër i menaxhimit të lartë që ka plotësuar pyetësorin, në 30% të rasteve ka qenë menaxheri i financës, në 10% ai i marketingut dhe/ose shitjeve, dhe pjesa tjetër nga menaxherë të prodhimit (2%), menaxherë të burimeve njerëzore (5%), menaxherë të nivelit të ulët (7%) dhe në një pozicion të ndryshëm nga të mësipërmit rreth 11%, kryesisht juristë të shoqërive (njerëz të ligjit që duhet të këshillojnë shoqëritë për zbatimin e parimeve të QK-së).

4.2.2 Analiza e indeksit të qeverisjes së përgjegjshme të korporatave (dimensioneve të shoqërive)

Në këtë kapitull për 76 shoqëritë që i janë përgjigjur pyetësorit që veprojnë në Shqipëri, ashtu siç kemi vepruar dhe më lart në rastin e vendeve në zhvillim, do të vlerësojmë dimensionet (D) të qeverisjes së përgjegjshme të korporatave, konkretisht 7 dimensione për të parë se ku ndodhen shoqëritë, dimensione që shërbejnë për të përcaktuar vlerën e indeksit të qeverisjes së përgjegjshme të korporatave (responsible corporate governance index = RCGI) për çdo shoqëri. Komponentët e çdo dimensionit janë nën-indekse. Pas identifikimit të dimensioneve (D) do të ndjekim për efekt llogaritje hapat e përmendur në kapitullin e parë dhe që janë zbatuar dhe në rastin e llogaritjes së GCR-së së vendeve në zhvillim.

Për të llogaritur GCR-në për secilën shoqëri kemi ndjekur radhën e veprimeve të lart përmendur në analizën e GCR-së së vendeve në zhvillim, dhe formulën e mëposhtme e kemi sqaruar më parë:

$$I_c = (P_{i/d1} + P_{i/d2} + P_{i/d3} + P_{i/d4} + P_{i/d5} + P_{i/d6} + P_{i/d7}) / 7/100$$

ku $P_{i/di}$ janë vlerat e llogaritura për çdo indeks pas normalizimit të nën-indekseve me anë të formulës së mëposhtme:

$$P_i = 100 * (X_i - val_{min}) / (val_{max} - val_{min}).$$

ku: X_i = vlera e treguesit që do të normalizohet, val_{max} = vlera maksimale, val_{min} = vlera minimale;

Duke ditur përgjigjet e pyetjeve kemi realizuar vendosjen në programin Excel të koeficienteve të peshimit, ku përgjigjes P_o i është dhëna vlera 1, J_o i është dhënë 0, dhe kur ka pasur N/A , është karakterizuar për efekt studimi në zonën J_o . Dimensionet (D) mbledhen duke shumëzuar numrin e pikëve të marra gjatë normalizimit me koeficientët e peshave që do të maten duke përdorur formulën e mëposhtme:

$$P_{i/d} = P_i * C_d,$$

ku: $P_{i/d}$ = pikët për treguesin i pas peshimit, P_i = pikët për treguesin i , C_d = Koeficienti peshës;

Indeksi është llogaritur duke mbledhur pikët e çdo nën-indeksi, duke përdorur formulën e mëposhtme. Normalizimi është një llogaritje i cili realizon kthimin në vlera numerike në segmentin [0;1].

$$I_c = (P_{i/d1} + P_{i/d2} + P_{i/d3} + P_{i/d4} + P_{i/d5}) / 7/100,$$

Meqenëse pyetjet kanë kërkesa dhe përgjigje të ndryshme, përbëhen nga frekuenca, të cilët normalizohen brenda strukturës së përgjigjeve.

Le të analizojmë llogaritjet e shoqërisë së parë dhe të dytë sipas renditjes, nga ku më pas llogaritjet e tjera në vijim janë të njëjta.

Në fillim ndjekim hapin e parë dhe hapin e dytë siç e kemi shpjeguar dhe më lart duke zbatuar formulat përkatëse, dhe në fund llogaritjen e indeksit si më poshtë:

$$I_c = (66.7 + 50 + 50 + 50 + 75 + 0 + 100) / 7/100 = 55.592$$

$$I_c = (66.7 + 100 + 100 + 100 + 32.5 + 100 + 65) / 7/100 = 80.595$$

Pikërisht tabela 21, shtojca 2 paraqet renditjen e shoqërive mbështetur në vlerën e indeksit RCG-së në përqindje. Kemi në këtë pjesë 7 indekse të cilët kanë nënindekset përkatëse, prandaj dhe pjesëtimin e kemi bërë për numrin 7.

Le të shikojmë më poshtë dimensionet (D) rast pas rasti të cilët përbëjnë indekset dhe vetë këta përbëhen nga nënindekse.

Dimensioni 1, D1 - "Të drejtat e aksionerëve dhe trajtimi i barabartë i tyre",

I.21 A keni një strukturë të veçantë që kujdeset për mbledhjet e MPA-së (mbledhja e përgjithshme e aksionerëve), organizimet, marrëdhëniet me aksionerët, njoftime, sqarime etj?

I.22 A mendoni se ka ardhur koha që duhet një strukturë për QK?

I.23 A përgatitet raport për qeverisjen e korporatës nga administratorët ose KA (ose KM) për aksionerët e shoqërisë tuaj ?

Dimensioni 2, D2- Mbrojtja e investitorëve,

I.19. Eksperti kontabël, nëse keni, apo auditi u vijnë në ndihmë aksionerëve për probleme apo procedura tatimore edhe gjatë vitit ushtrimor si dhe gjatë kontrolleve tatimore ?

Dimensioni 3, D3- Praktika e marrjes në punë dhe largimit,

II.3 A keni nënshkruar kontrata të rregullta me punonjësit?

Dimensioni 4, D4 - Marrëdhëniet punëdhënës-punëmarrës,

II.8 A informohen rregullisht punonjësit mbi vendimmarrje të rëndësishme dhe mbi gjendjen në të cilën ndodhet shoqëria?

Dimensioni 5, D5- Etika e sjelljes së firmës,

VI.14. A keni krijuar një komitet të këshillit drejtues apo strukturë ose organ tjetër për të mbikëqyrur politikat e qeverisjes së shoqërisë?

VI.15. A mbani rregullore të qeverisjes dhe kod etik për të bërë më transparente strukturat e qeverisjes për të ndihmuar organet dhe konsulentët që të jenë më të qartë mbi të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella?

VII.3 A ka vendosur këshilli standardet e shoqërisë, të kujdeset që të kuptohen si dhe të përmbushen detyrimet kundrejt aksionerëve dhe grupeve të tjerë të interesit?

VII.6 A keni të parashikuar në kodin etik, nëse keni, se çfarë pret shoqëria tregtare në lidhje me standardet e shërbimeve për klientët, konfliktin e interesit, ndershmëri në punë, dhuratat apo trajtimin me përparësi lidhur me furnitorët, klientët?

Dimensioni 6, D6 – “Qëndrimi ndaj strategjisë”,

VII.4 A është përfshirë këshilli në procesin e zhvillimit strategjik dhe të paktën të aprovojë strategjinë dhe të kujdeset që strategjia të jetë brenda interesave të aksionerëve?

Dimension 7, D7, “Zbatimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm ”,

III.7 A keni pasur raste ku eksperti kontabël, nëse keni, ka mbajtur përgjegjësi në 5 vitet e fundit, nëse jeni penalizuar nga organet tatimore?

III.8 Si paraqiten tarifat e auditimit të ekspertit në 2 vitet e fundit?

Secila nga shoqëritë është identifikuar me ID e vet. Rezultatet e llogaritjeve të secilit indeks sipas shoqërive, emrat e të cilave për arsye etike nuk po i paraqesim, po i tabelojmë sipas Tabelës 22 shtojca 2, Renditja e shoqërive duke u mbështetur në raportin xhiro/kapital. Tabela 22.1 trajton ndarjen e shoqërive duke u mbështetur tek GCI dhe raporti TA neto/kapital. GCI është e pandryshueshme dhe nuk është llogaritur siç është llogaritur raporti TA neto/kapital.

Shpejtësia e qarkullimit ndiqet nga shumë shoqëri dhe përbën një tregues të rëndësishëm ashtu siç është dhe treguesi tjetër i të ardhurës neto ndaj kapitalit të investuar (EAN/kapitalit të Investuar).

Psh në raportin Xhiro/kapital (shpejtësia e qarkullimit të kapitalit) = 1.183, themi që për çdo 1 lek kapital të investuar janë realizuar 1.183 lekë xhiro (thënë ndryshe për 100 lekë kapital shoqëria realizon 118 lekë xhiro). Raport tjetër përmendim : Fitimi pas tatimit (FAT) /shitjet, i cili mat se sa rentabël janë shitjet e shoqërisë pas të gjitha shpenzimeve dhe tatimit të interesit zbritur më parë. Udhëzimit Nr.2 date 04.02.2014 i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve i cili ka si qëllim një administrim dhe verifikim më të mirë të pasqyrave financiare sipas Standardeve të Kontabilitetit për shoqëritë tregtare, përmendim këtu ndër raportet orientuese financiare atë të normës së fitimit bruto dhe neto, konkretisht fitimi para tatimit/xhiros dhe fitim neto/xhiros. Gjithashtu përmenden raportet:

- Të pagesës së TVSH-së / qarkullimit
- Të pagesës së tatim fitimit /qarkullimit
- Të pagesës së sigurimeve shoqërore për numër punonjësish
- Tatimit mbi të ardhurat nga punësimi për numër punonjësish
- Te ardhura për punonjës (xhiro/numrit mesatar mujor të punonjësve)

Analiza e treguesve të lartpërmendur bëhet në bazë grupimi sipas llojit të veprimtarisë psh: ndërtim banesa, ndërtime publike, tregti mallra ushqimore, tregti mallra industriale, prodhim (grup llojeve të prodhimit), transport mallrash apo udhëtarësh, shërbime (sipas llojit të shërbimeve). Pasqyrat financiare dhe treguesit financiar na tregojnë rezultatet e drejtimit lidhur me administrimin ndaj dhe janë të rëndësishme të njihen (përmendim

raporti Shitje/Klientë përfaqëson aftësinë e firmës për të arkëtuar llogaritë e klientëve me pagesa të mëvonshme, sa më i lartë raporti aq më shumë probabilitet ka për sukses shoqëria tregtare).P.sh për të matur performancën përdoren indikatorë si ROA, ROE etj.Indeksi i Rikthimit mbi Asetet (ROA) është indikator i më i suksesshëm i matjes së performancës (Bikker, 2009).Bikker & Haaf (2002),Deidda & Fattouh (2002) sugjerojnë se vendet në zhvillim kanë nevojë veçanërisht për një sistem bankar me konkurrencë më të lartë, për të nxitur rritjen ekonomike.

Ndërsa shkalla e lartë e konkurrencës, motivon bankat për të marrë përsipër më shumë risk duke rritur kështu mundësinë e falimentimit(Vives, 2001).Meqenëse jemi tek analiza e indekseve,theksojmë psh indeksin HHI (*Herfindahl-Hirschman index*) i cili është indeksi më i përdorur në praktikë nga shumë shtete në botë për matjen e konkurrueshmërisë së tregut.

4.2.3 Analiza e variablave. Lidhja funksionale ndërmjet tyre

Në shumë situata në biznes, është me rëndësi të shihen varësitë ndërmjet variablave. Për shembull, është e logjikshme të supozojmë se cilat janë lidhjet për të vërtetuar hipotezën e ngritur. Për të demonstruar ekzistencën e lidhjeve midis treguesve që përbëjnë dimensionet e qeverisjes së përgjegjshme të korporatave, kemi aplikuar metodën e korrelacionit. Regresi linear matet me ekuacionin e regresionit linear.

Analiza e korrelacionit dimë që është teknikë matematike që shërben për të matur “*forcën e lidhjes ndërmjet variablave*”. Koeficienti i korrelacionit shënohet me r_{xy} dhe merr vlera [-1; 1], ku +1 do të thotë se lidhja është shumë e fortë dhe me drejtim pozitiv, pra me rritjen e njërit variabël rritet edhe variabli tjetër, -1 do të thotë se lidhja është e fortë, por me drejtim të kundërt, pra me rritjen e njërit variabël zvogëlohet variabli tjetër dhe nëse vlera e koeficientit të korrelacionit është 0, themi se midis këtyre variabla nuk ka asnjë lloj korrelacioni/ lidhjeje.

Duke kryer analizën e korrelacionit ndërmjet treguesve të dimensioneve (D) marrim tabelën 23, shtojca 2 e cila paraqet qartësisht rezultatet e këtij korrelacioni.Shikojmë nga rezultati që kemi lidhje të dobëta ndërmjet treguesve. Nga kjo analizë duket qartë se treguesit e marrë në shqyrtim (variablat) janë të pakorreluar me njëri-tjetrin dhe për rrjedhojë janë të pavarur.

Konkretisht: Dimensionin 5, D5- Etika e sjelljes së firmës psh VII.6 A keni të parashikuar në kodin etik, nëse keni, se çfarë pret shoqëria tregtare në lidhje me standardet e shërbimeve për klientët, konfliktin e interesit, ndershmëri në punë etj me Dimensionin 4, D4-Marrëdhëniet punëdhënës-punëmarrës. II.8 A informohen rregullisht punonjësit mbi vendimmarrje të rëndësishme dhe mbi gjendjen në të cilën ndodhet kompania? Një rast tjetër psh : Dimensionin 6, D6 – “Qëndrimi ndaj strategjisë” psh VII.4 A është përfshirë këshilli në procesin e zhvillimit strategjik dhe të paktën të aprovoje strategjinë dhe të kujdeset që strategjia të jete brenda interesave të aksionereve? Me Dimensionin 5, D5- Etika e sjelljes së firmës (rezultatet për këto 2 raste që thamë dhe që gjenden në tabelën e korrelacionit janë - 0,205 dhe -0,179 (tabela 23 shtojca2). Tashmë dimë, por dhe për këtë pjesë të analizës ka rëndësi të theksohet për studimin, se regresi paraqet lidhjen ndërmjet dy apo më shumë dukurive prej të cilave njëra është e varur kurse tjetra e pavarur. Variabli i varur (Y) është ai variabël i vlerësuar të cilin dëshirojmë ta shpjegojmë, variabli i pavarur (X) është ai variabli që siguron bazën për vlerësim e që përdoret për të shpjeguar variablin e varur. Lidhja ndërmjet dy variablave, konkretisht indeksit **GCR** ose **GCI**, i njëjti term përdorur këtu e më poshtë, dhe atij **xhiro/kapital** (raport që tregon shpejtësinë e qarkullimit të kapitalit), bëhet me anë të të dhënave empirike, konkretisht funksionit linear. Forma e përgjithshme e regresit të thjeshtë linear ka trajtën: $Y = b_0 + b_1x$. b_0 -pikëprerja me boshtin e ordinatave. b_1 -koeficienti këndor. Y-Vlera e variablit të varur. Ne rastin tonë variabli i pavarur x (që paraqitet në boshtin horizontal) përfaqëson raportin financiar *Xhiro/kapital*, i llogaritur nga të dhënat e marra nga shoqëritë për secilën shoqëri kurse variabli i varur Y (që ndodhet në boshtin e ordinatave) përfaqëson treguesin *GCR*, tregues i cili ka në përbërje dimensionet të cilët janë indekset dhe nenindekset përkatëse për secilin nga këto dimensionet dhe që në total të llogaritura përbëjnë variablat e varur. Në rastin tonë kemi të bëjmë me një ekuacion të thjeshtë linear pasi kemi vetëm një variabël të pavarur dhe një variabël të varur dhe lidhja e tyre përafrohet në formë lineare. Ekuacioni i vijës që gjendet me metodën e katrorëve më të vegjël përbën një vlerësim të vijës, ose të ekuacionit të regresit të vërtetë. Vlerësimi për ekuacionin e regresit linear ka formën: $y = ax + b$. Një pikë që përmendim nga statistika është se për paraqitjen sa më të qartë të variablave përdoren diagramat të cilët shprehin marrëdhëniet ndërmjet X dhe Y . Madje dimë që diagrama që përdoret me së shumti është diagrama

skater. Diagrama skater është diagram përmes të cilit paraqitet variabiliteti në mes të dy dukurive. Lidhja midis dy variablave bëhet me anë të të dhënave empirike pra funksionit linear. Kjo do të thotë se të gjitha të dhënat shtrihen në një drejtëz, dhe rritja e variablit x , i cili psh në rastin tonë paraqet raportin *xhiro/kapital* sjell rritjen e variablit y , që paraqet indeksin *GCR* (kjo është arsyeja që korrelacioni në këtë rast quhet pozitiv) dhe për çdo vlerë të njohur të x – it mund të dimë afërsisht vlerën e y – it. Ndërkohë grafiku 20 shtojca 2 paraqet analizën korrelative ndërmjet indeksit *GCR* (qeverisjes së përgjegjshme të korporatave) dhe raportit *xhiro/kapital* dhe drejtëzën e regresit, ndërsa rezultatet e korrelacionit statistikor jepen në tabelen 23, shtojca 2. Në statistikë, koeficienti i përcaktimit (determination), shënohet R^2 dhe tregon se si të dhënat përshtaten në një model statistikor. Ky koeficient përdoret për testimin e hipotezave, dhe shkon nga 0 në 1. Në rastin tonë kemi një R^2 të vogël (afërsisht zero), që tregon një lidhje midis variablave të varur x dhe të pavarur y , konkretisht qeverisja e korporatave në shoqëritë në Shqipëri, përfaqësuar nga *GCR* si variabël i varur y , mbështetur në raportin *xhiro/kapital*, variabli x , si variabël i pavarur, nga ku vërejmë se nuk është në nivel të lartë, dhe kjo tregohet nga fortësia e r katrorit i cili është afër 0. Prandaj duke ju përgjigjur pyetjes së dytë kërkimore themi se qeverisja e korporatave është ende në fillimet e veta. Gjithashtu kemi vërtetim të hipotezës së dytë të ngritur në fillim të punimit, konkretisht se qeverisja e korporatave nuk është plotësisht efektive vërtetuar kjo nga korelacioni, në të kundërt do të kishim një lidhje më të fortë ndërmjet variablave, madje do zbatohet nga shoqëritë, përfshi dhe ato me një raport *xhiro/kapital* të ulët, të cilët për hir të së vërtetës jo plotësisht zbatojnë parimet e qeverisjes. Qeverisja e korporatave është akoma në fazat e para dhe kërkohet më shumë punë por dhe vullnet nga shoqëritë shqiptare për të vënë në zbatim parimet e qeverisjes së korporatave, ndoshta duhen më shumë trajtime dhe informacione mbi rolin që luan ajo në shoqëri tregtare veçanërisht sh.a. Për të shpjeguar grafikun 20.1 shtojca 2, nga pikëpamja e qeverisjes, kemi realizuar një ndarje të tij në katër kategori ose nivele, të cilën edhe teoria e menaxhimit strategjik e njeh si strategji analizuese për të bërë diferencime ndërmjet kategorive duke përcaktuar për secilën nga këto kategori emërtimet përkatëse dhe çfarë përfaqëson secili prej tyre, gjithashtu edhe statistika përshkruese (Adams *et. al.*, 2007), lejon paraqitjen grafike të të dhënave, paraqitje të cilën do e shpjegojmë më poshtë.

Përmeshësit, janë shoqëri me punë të mirë në aspektin e qeverisjes së korporatave dhe që kanë nivelin më të lartë të raportit xhiro/kapital. Pozicioni i dukshëm i vetëm 2 shoqërive bazohet në performancën e tyre më të mirë në qeverisjen e korporatave (grafiku 20.1 shtojca 2). Kështu psh shoqëria e parë ka një indeks GCI = 74,83% ndërsa raport Xhiro / Kapital = 7,69%, ndërsa shoqëria e dytë ka një indeks GCI = 75,87% dhe raport xhiro/kapital = 4,18%.

Humbësit, përfaqësojnë rreth 1/3 e shoqërive (25 shoqëri) dhe kanë një nivel të ulët të qeverisjes së përgjegjshme të korporatave si dhe raport xhiro/kapital të ulët. Ne besojmë se këto shoqëri mund të përmirësojnë performancën e tyre të biznesit dhe pozicionin konkurrues në treg duke përdorur mjetet dhe praktikën e qeverisjes së përgjegjshme të korporatave. Psh rasti i një shoqërie me GCI = 40,95% dhe raport xhiro/kapital = 0,65%, ose rasti i një shoqërie të dytë me GCI = 30,85 dhe raport xhiro/kapital = 0,49%.

Te ndjeshmit, janë ato shoqëri që kanë rezultat më lartë të mesatares për sa i përket indeksit të qeverisjes së përgjegjshme të korporatave, por nivel më të ulët të raportit xhiro/kapital dhe që përbejnë rreth 60 % të shoqërive (47 shoqëri). Ky paradoks mund të shpjegohet me një perceptim të favorshëm të shoqërive të anketuar. Psh rasti i një shoqërie me GCI = 85,90% dhe raport xhiro/kapital = 2,58%. Po në këtë grup një shoqëri tjetër : GCI = 78,77% dhe raport xhiro/kapital = 1,17%.

Indiferentet, janë kategoria e shoqërive, konkretisht 2 shoqëri, sipas ndarjes së bëre në grafik, konkretisht me mundësi reale të zhvillimit të praktikave të qeverisjes së përgjegjshme të korporatave, pasi ata kanë raport xhiro/kapital të lartë. Ata kanë mundësi potenciale për të rritur indeksin e qeverisjes së përgjegjshme të korporatave. Konkretisht dy shoqëritë që bëjnë pjesë në këtë seksion kanë këto rezultate : shoqëria e parë, e cila ndodhet në pjesën e sipërme të kuadrantit (ndarjes së realizuar) të grafikut e ka GCI = 49,6% dhe raport xhiro/kapital = 5,68%. Ndërsa shoqëria e dytë GCI = 44,74% dhe raport xhiro/kapital = 4,80%. Ndërkohë grafiku 20.2 shtojca 2 paraqet analizën korrelative ndërmjet indeksit GCR (qeverisjes së përgjegjshme të korporatave) dhe raportit *TA neto/kapital* dhe drejtëzën e regresit, ndërsa rezultatet e korrelacionit statistikor janë të pandryshuara si në rastin e raportit xhiro/kapital, ata jepen në tabelën 23, shtojca 2. Për të shpjeguar grafikun 20.2 shtojca 2 nga pikëpamja e qeverisjes, kemi realizuar gjithashtu si më lart një ndarje të tij në katër kategori, ose nivele, ashtu sikurse shpjeguar më lart për raportin e parë, por këtë radhë parë nga raporti financiar : *Të*

ardhura neto/kapital. Nga analiza e ndarjes së kategorive shohim se humbësit janë gjithsej 8 shoqëri, të ndjeshmit 56 shoqëri, Indiferentët 2 shoqëri dhe së fundi përmbushësit gjithsej 10 shoqëri (20.3 shtojca 2). Duke ditur që GCI është një perceptim themi se përmbushësit mbeten akoma në nivel të ulët dhe të ndjeshmit duhet që të pozicionohen sa më shpejt në anën e përmbushësve. Edhe në këtë rast kemi një R^2 të vogël, që tregon një lidhje jo të fortë ndërmjet variablave të varur x dhe të pavarur y , konkretisht qeverisja e korporatave në shoqëritë në Shqipëri, përfaqësuar nga GCR si variabël i varur y , mbështetur në raportin *TA neto/kapital*, variabli x , si variabël i pavarur, nga ku vërejmë që nuk është në nivel të lartë. Në këtë mënyrë përforcohet përgjigja e pyetjes së dytë kërkimore të lartpërmendur dhe hipotezës së dytë (vërtetimi i saj). Ashtu si në rastin *Xhiro/Kapital* dhe në raportin *Ta neto/Kapital* rezultatet e korrelacionit statistikor janë të njëjta pasi indeksi GCR është i njëjtë (ashtu siç jepet në tabelën 23, shtojca 2).

Grafiku 20.1.1, shtojca 2, paraqet analizën Klaster realizuar nga përgjigjet e pyetësorit ku vërejmë se kultura e qeverisjes është më e mirë në 32 shoqëri nga 76 shoqëri, pra siç shikohet kjo kulturë është e reduktuar.

4.3 Analiza e tabelës së kontigjencave. Testi Chi Square (Hi-katror) i koeficientit Pearson

Paraqitjen e statistikave të dy variablave e shprehim me anën e Cross-tabulation-tabulimi për të shpjeguar marrëdhënien ndërmjet 2 variablave. Tabela e kontigjencave është një element statistikor që përmbledh të dhënat për të krijuar një tabelë, e cila njihet me emrin tabela e kontigjencave. Këto tipe tabelash përdoren kryesisht në kërkime shkencore dhe inxhinierike, në sondazhe etj. Ato japin një pasqyrë të lidhjeve ndërmjet dy variablave dhe mund të ndihmojnë për të gjetur ndërveprimet ndërmjet tyre. Nëse dimensionet në kolona të ndryshme ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme ndërmjet rreshtave (apo anasjellas), themi se ka një *kontigjencë* ndërmjet të dy variablave. Me fjalë të tjera, të dy variablat nuk janë të pavarura, pra kanë varësi ndërmjet tyre. Nëse nuk ka kontigjencë, themi se të dy variablat janë të pavarur. Lloji më i thjeshtë i tabelës së kontigjencave është një tabelë në të cilën secila ndryshore ka vetëm dy nivele; kjo quhet tabela 2x2 e kontigjencave, ku në vijim për këto tabela do të kemi dhe një pikë të veçantë analize. Në parim, mund të përdoret çdo numër i rreshtave dhe kolonave. Mund

të ketë edhe më shumë se dy variabla. Siç përcaktohet dhe në analizën teorike, Testi Chi Square i Koeficientit Pearson analizon nëse ekziston një lidhje ndërmjet dy variablave cilësorë. Si pjesë e procedurës crosstabs, SPSS prodhon një tabelë që si çdo e shohim më poshtë përfshin statistikën Chi Square (Hi-katror) dhe vlerën e saj të rëndësisë e cila ndryshe njihet si Likelihood Ratio. Statistika Chi-Square e Koeficientit Pearson teston nëse dy variablat janë të pavarur. Nëse vlera e rëndësisë statistikore (e domethënies) është mjaft e vogël (zakonisht Sig σ duhet të jetë <0.05 ku 5% është niveli i besueshmërisë), atëherë hedhim poshtë hipotezën se variablat janë të pavarur dhe pranojmë hipotezën se ata kanë një lidhje ndërmjet tyre. Përzgjedhja e pyetjeve është bërë duke u mbështetur në një arsyetim logjik për lidhjet që mund të ekzistojnë ndërmjet tyre, nga ku më pas ata janë transformuar në tabela rrjedhojë e kombinimit të këtyre pyetjeve që përmbajnë përgjigjet respektive të cilat dalin nga programi (përfshirë dhe shkallët e lirisë), si vlerë e rëndësisë. Analiza e vlerës së statistikës Chi-Square të Pearson, në analizën tonë fillon me rastin 1 dhe mbaron me rastin 36. Lidhja ndërmjet variablave është domethënëse (pra variablat janë të varur) nëse vlera e Sig < 0.05 , dhe nëse kjo vlerë është > 0.05 themi se variablat janë të pavarur ndërmjet tyre. Alternative e “Chi Square” është Koeficienti Pearson i bazuar në teorinë e përgjasisë maksimale.

- **Studimi i kombinimit të rasteve**

Le të fillojmë me studimin e kombinimit të rasteve. Gjithsej 36 raste të përzgjedhura me kombinime përsa i përket rëndësisë së tyre.

Rasti 1.

A jeni të informuar mbi Kodin e Drejtimit të Brendshëm të Shoqërive Aksionere Jo të Regjistruara në Bursë publikuar nga METE dhe a keni njohuri mbi të?, me pyetjen Cila është ndarja e shoqërive sipas tipit?

Tabela 4 Lidhja midis madhësisë së biznesit dhe ndarjes së shoqërive sipas tipit.

Chi-Square Tests (Testet Hi-Katror)			
	Value (Vlera)	Df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square (Hi-katror i Pearson)	13.401 ^a	4	.009
Likelihood Ratio (Koeficienti i Përgjasise)	16.253	4	.003
Linear-by-Linear Association	8.821	1	.003
N of Valid Cases	76		

a.5 cells (55.6%) have expected count less than 5. The minimum expected count is .67.

Nga analiza e rastit të parë vëmë re se vlera e statistikës Chi- Square është = 13.401. Kjo vlerë është statistikisht e rëndësishme kur $p < 0.001$. Kjo vlerë nga përpunimi i pyetjeve na rezulton se është e rëndësishme ($p = 0.009 < 0.05$), duke na treguar se kemi lidhje varësie ndërmjet variablit shprehur në pyetjen : “A jeni të informuar mbi Kodin e Drejtimit të Brendshëm të Shoqërive Aksionere Jo të Regjistruara në Bursë publikuar nga METE dhe a keni njohuri mbi të?, me variablin të shprehur me pyetjen “Cila është ndarja e shoqërive sipas tipit?”. Ekziston një lidhje e mirë ndërmjet variablave. Variablat na rezultojnë të varur.

Një alternative e “Koeficientit Pearson Chi Square” është koeficienti statistikor i Pearsonit bazuar në teorinë e përgjasisë maksimale.

Siç thamë dhe më lart testi i raportit të përgjasisë është një test statistikor i përdorur për të krahasuar dy modele për mesataret e tyre, nëse ato janë statistikisht të njëjta (e cila është hipoteza zero) dhe rasti tjetër kur nuk janë të njëjta (hipoteza alternative). Raporti i përgjasisë në rastin tonë (Likelihood Ratio) = 16.253. Ashtu si në rastin e hi–katror do të analizojmë p -në, $p = 0.03 < 0.05$. Variablat me këtë kusht rezultojnë të janë të varur. Testi statistikor i përdorur zbuloi një lidhje sinjifikante midis variablave, konkretisht variablat janë të varur dhe lidhja midis tyre është e justifikuar.

Rasti 2.

A jeni të informuar mbi manualin e Qeverisjes së Korporatave dhe a keni njohuri mbi të? me pyetjen : A jeni të informuar mbi Kodin e Drejtimit të Brendshëm të Shoqërive Aksionere Jo të Regjistruara në Bursë publikuar nga METE dhe a keni njohuri mbi të?
Për këtë rast do paraqesim krahas testit ch-square dhe krostabin përkatës.

Tabela 5.1 Crosstab mbi Informacionin rreth Kodit të drejtimit të sh.a-ve dhe Manualit të qeverisjes së korporatave (Q.K)

A jeni të informuar mbi manualin e Qeverisjes së Korporatave dhe a keni njohuri mbi të ?	A jeni të informuar mbi Kodin e Drejtimit të Brendshëm të Shoqërive Aksionere Jo të Regjistruara në Bursë publikuar nga METE dhe a keni njohuri mbi të?							
	Po	%	Jo	%	N/A	%	Total	%
Po	12	32.4%	17	40.5%	8	27.0%	37	100.0 %
%	48.0%		44.1%		58.8%		48.7%	
Jo	10	26.7%	13	63.3%	7	10.0%	30.0	100.0 %
%	32.0%		55.9%		17.6%		0	
N/A	3	55.6%	4	.0%	2	44.4%	9.0	100.0 %
%	20.0%		.0%		23.5%		11.8%	
Total	25	32.9%	34	44.7%	17	22.4%	76	
%	100.0%		100.0%		100.0%		100.0%	

Tabela 5.2 Chi-Square Tests

	Value	Df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	12.624 ^a	4	.013
Likelihood Ratio	16.243	4	.003
Linear-by-Linear Association	.194	1	.660
N of Valid Cases	76		

a. 3 cells (33.3%) have expected count less than 5. The minimum expected count is 2.01.

Vlera e Koeficientit Pearson Chi-Square në tabelën 5.2 është = 12.624. Kjo vlerë është statistikisht e rëndësishme pasi $p = 0.013 < 0.05$ duke treguar se kemi lidhje ndërmjet variablave të lartpërmendur. Testi rezultoi i kënaqshëm dhe plotësisht me lidhje.

Raporti i përgjasisë maksimale (Likelihood Ratio) i llogaritur nga programi për këtë lidhje është = 16.243. Rezultati hi–katror ($p = 0.003 < 0.05$) tregon që variablat janë të varur.

Rasti 3.

Cili është afati i njoftimit të rendit të ditës së MPA-së? me pyetjen: Cila është mënyra për njoftimin e mbledhjes së MPA-së?

Vlera e Koeficientit Pearson Chi Square në tabelën e mëposhtme është = 4.823. Kjo vlerë nuk është sinjifikante pasi $p = 0.566 > 0.05$. Kjo vlerë në rastin më poshtë nuk është e rëndësishme pasi rezulton jo brenda parametrit të duhur statistikor ($p < 0.05$), duke treguar se nuk kemi lidhje ndërmjet variablave të lartpërmendur. Testi nuk rezultoi i kënaqshëm.

Tabela 6 Testi Chi-square

	Value (Vlera)	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square (Hi-katror i Pearson)	4.823 ^a	6	.567
Likelihood Ratio (Koeficienti i Përgjasisë)	5.066	6	.535
Linear-by-Linear Association	.976	1	.323
N of Valid Cases	76		

a.8cells (66.7%) have expected count less than 5. The minimum expected count is .16.

Raporti i përgjasisë maksimale (Likelihood Ratio) është 5.066. Kjo konfirmon rezultatin kryesor hi–katror = 0.535 ($p = 0.535 > 0.05$) duke na treguar se variablat nuk janë të varur pra nuk lidhen me njëra-tjetrën, pra nuk mund të konsiderohet një lidhje me rezultat të pranueshëm.

Rasti 4.

A njoftohen në mënyrë të përshtatshme të gjithë aksionerët për mbledhjen e MPA-së? me pyetjen : A keni pasur raste kur ka ndryshuar rendi i ditës pasi i është dërguar aksionerëve?

Vlera e Koeficientit Pearson Chi Square në tabelën e mëposhtme është = 0.387. Kjo vlerë nuk është statistikisht e rëndësishme pasi $p = 0.534 > 0.05$ duke treguar se nuk kemi lidhje ndërmjet variablave të lartpërmendur. Testi nuk rezultoi i kënaqshëm.

Raporti i përgjasisë maksimale (Likelihood Ratio) është 0.652 dhe $p = 0.419 > 0.05$. Konfirmohet rezultati kryesor Chi Square i cili shpreh ($p = 0.652 > 0.05$) se variablat janë të pavarura ku dhe në këtë rast ashtu si dhe në rastin 3, nuk mund të konsiderohet një lidhje me rezultat të pranueshëm.

Tabela 7 Testi Chi Square

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	.387 ^a	1	.534
Continuity Correction ^b	.000	1	1.000
Likelihood Ratio	.652	1	.419
Fisher's Exact Test			
Linear-by-Linear Association	.382	1	.537
N of Valid Cases	76		

a. 2 cells (50.0%) have expected count less than 5. The minimum expected count is .28.

b. Computed only for a 2x2 table

Rasti 5.

Eksperti kontabël, nëse keni, apo auditi u vijnë në ndihmë aksionerëve për probleme apo procedura tatimore edhe gjatë vitit ushtrimor si dhe gjatë kontrolleve tatimore? dhe pyetjes A keni pasur raste ku eksperti kontabël, nëse keni, ka mbajtur përgjegjësi në 5 vitet e fundit, nëse jeni penalizuar nga organet tatimore?

Vlera e Koeficientit Pearson Chi Square në tabelën e mëposhtme është = 14.738. Kjo vlerë është plotësisht sinjifikante pasi $p = 0.005 < 0.05$. Theksojmë se kjo vlerë në rastin

më poshtë është e rëndësishme pasi rezulton brenda parametrit statistikor ($p < 0.05$), duke treguar se kemi lidhje ndërmjet variablave të lartpërmendur.

Tabela 8 Testi Chi Square

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	14.738 ^a	4	.005
Likelihood Ratio	17.738	4	.001
Linear-by-Linear Association	4.393	1	.036
N of Valid Cases	76		

a. 4 cells (44.4%) have expected count less than 5. The minimum expected count is .71.

Kjo vlerë është sinjifikante e lartë kur $p < 0.001$. në këtë rast është plotësisht e tillë, pra përputhet me kushtin statistikor të lartpërmendur.

Testi rezultoi plotësisht i kënaqshëm dhe me një lidhje të plotë.

Raporti i përgjasisë maksimale (Likelihood Ratio) është = 17.738. Rezultati kryesor Chi Square ($p = 0.001 < 0.05$) na nxjerr në konkluzionin se variablat konsiderohen të varur.

Rasti 6.

A keni një strukturë të veçantë që kujdeset për mbledhjet e MPA-së (mbledhja e përgjithshme e aksionerëve), organizimet, marrëdhëniet me aksionerët, njoftime, sqarime etj? dhe pyetjes tjetër të pyetësorit : A mendoni se ka ardhur koha që duhet një strukturë e tillë?

Vlera e statistikës Chi Square sipas koeficientit Pearson në tabelën e mëposhtme është = 0,056. Kjo vlerë është statistikisht e rëndësishme kur $p < 0.001$. Kjo vlerë nuk është e rëndësishme ($p = 0.812 > 0.05$), duke treguar se nuk kemi një lidhje ndërmjet variablave të lartpërmendur. Raporti i përgjasisë maksimale (Likelihood Ratio) është = 0.109. Rezultati kryesor Chi Square ($p = 0.741 > 0.05$) na nxjerr në konkluzionin se variablat konsiderohen të pavarur, konkretisht nuk kemi lidhje ndërmjet variablave.

Tabela 9 Testi Chi Square

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	.056 ^a	1	.812
Continuity Correction ^b	.000	1	1.000
Likelihood Ratio	.109	1	.741
Fisher's Exact Test			
Linear-by-Linear Association	.056	1	.814
N of Valid Cases	76		

a. 3 cells (75.0%) have expected count less than 5. The minimum expected count is .05.

b. Computed only for a 2x2 table

Rasti 7.

A përgatitet raport për qeverisjen së korporatës nga administratorët ose KA (ose KM) për aksionerët e shoqërisë tuaj ? Mendoni se ka ardhur koha e përgatitjes së një raporti të tillë si pjesë e materialeve të MPA-së si informacion që duhet kërkuar të përgatitet si i detyrueshëm?

Vlera e statistikës Chi Square në tabelën e mëposhtme është = 0.103. Kjo vlerë dihet se është sinjifikante e lartë kur $p < 0.001$. Kjo vlerë nuk është e rëndësishme ($p = 0.950 > 0.05$), duke treguar se nuk kemi lidhje ndërmjet variablave të lartpërmendur.

Raporti i përgjasisë maksimale është 0.195. Konfirmon rezultatit kryesor hi – katror ($p = 0.907 > 0.05$) me një vlerë të papranueshme dhe variablat nuk kanë lidhje (janë të pavarura).

Tabela 10 Testi Chi Square

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	.103 ^a	2	.950
Likelihood Ratio	.195	2	.907
Linear-by-Linear Association	.091	1	.762
N of Valid Cases	76		

a. 5 cells (83.3%) have expected count less than 5. The minimum expected count is .04.

Rasti 8.

A është vendi i mbledhjes së MPA-së i përshtatshëm dhe lehtësisht i arritshëm nga aksionerët e shoqërisë (sh.a-së)? dhe pyetjes A e ka të qartë administratori (ose administratorët) që duhet të sigurohet që rendi i ditës të mos ndryshohet pasi u është dërguar të gjithë aksionerëve?

Vlera (Chi-Square) në tabelën e mëposhtme është =18.240. Kjo vlerë është plotësisht sinjifikante pasi $p = 0.000 < 0.001$.

Kjo vlerë në rastin më poshtë është e rëndësishme pasi rezulton madje edhe brenda parametrit statistikor $p < 0.05$, duke treguar se kemi lidhje ndërmjet variablave të lartpërmendur. Testi rezultoi plotësisht i kënaqshëm.

Raporti i përgjasisë maksimale është = 6.150. Përsëri kjo konfirmon rezultatin kryesor hi – katror ($p = 0.013 < 0.05$) me një vlerë plotësisht të pranueshme, kështu që variablat mund të konsiderohen të varur.

Tabela 11 Testi Chi Square

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)	Exact Sig. (2-sided)	Exact Sig. (1-sided)
Pearson Chi-Square	18.240 ^a	1	.000		
Continuity Correction ^b	4.067	1	.044		
Likelihood Ratio	6.150	1	.013		
Fisher's Exact Test				.053	.053
Linear-by-Linear Association	18.000	1	.000		
N of Valid Cases	76				

a. 3 cells (75.0%) have expected count less than 5. The minimum expected count is .05.

b. Computed only for a 2x2 table

Rasti 9.

Cilat nga çështjet e mëposhtme bëhen publike nga shoqëria juaj? dhe pyetjes : Nëse i gjithë informacioni nuk publikohet i plotë cilat janë pengesat për të mos e bërë një gjë të tillë?

Vlera e statistikës Chi-Square në tabelën e mëposhtme është = 16.262. Kjo vlerë është sinjifikante e lartë kur $p < 0.001$. Kjo vlerë nga analiza rezulton se nuk është e rëndësishme ($p = 0.435 > 0.05$), duke treguar se nuk kemi lidhje ndërmjet variablave të lartpërmendur, pra nuk mund të konsiderohet sinjifikative lidhja statistikore.

Tabela 12 Testi Chi Square

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	16.262 ^a	16	.435
Likelihood Ratio	15.063	16	.520
Linear-by-Linear Association	.710	1	.399
N of Valid Cases	76		

a. 21 cells (84.0%) have expected count less than 5. The minimum expected count is .03.

Raporti i përgjasisë maksimale është = 15.063. Rezultati kryesor hi – katror ($p = 0.520 > 0.05$) rezulton me një vlerë të papranueshme, kështu që variablat mund të konsiderohen jo të varur, pra jo të përshtatshëm.

Rasti 10.

Si bëhet zgjedhja ose emërimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës? me pyetjen : Cilat janë kriteret për emërimin e drejtorit (administratorit) ose drejtorisë (administratorëve) ekzekutive si dhe menaxherëve kryesorë?

Vlera Chi-Square në tabelën e mëposhtme është = 5.860. Kjo vlerë nuk është plotësisht sinjifikante pasi $p = 0.119 > 0.05$. Kjo vlerë në rastin më poshtë është deri diku e rëndësishme pasi rezulton thuhet brenda parametrut statistikor me një shkallë të vogël devijacioni, duke treguar se kemi një lidhje ndërmjet variablave të lartpërmendur. Testi rezultoi i kënaqshëm dhe me një lidhje të pranueshme ndërmjet variablave.

Tabela 13 Testi Chi Square.

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	5.860 ^a	3	.119
Likelihood Ratio	4.915	3	.178
Linear-by-Linear Association	2.330	1	.127
N of Valid Cases	76		

a. 5 cells (62.5%) have expected count less than 5. The minimum expected count is .26.

Raporti i përgjasisë maksimale është = 4.915. Rezultati kryesor i hi – katror rezulton ($p = 0.178 > 0.05$) me një vlerë deri diku të pranueshme, kështu që variablat mund të konsiderohen deri diku të varur.

Rasti 11.

Cila është denduria e mbledhjeve të KM në vit? dhe pyetjes Sa kohë më përpara marrin njoftim rreth mbledhjes anëtarët e kështillit mbikëqyrës (ose KA-së) ?

Vlera Pearson Chi-Square në tabelën e mëposhtme është = 23.553. Kjo vlerë është plotësisht sinjifikante pasi $p = 0.005$. Kjo vlerë në rastin më poshtë është e rëndësishme pasi rezulton në kufij të parametrut statistikor ($p < 0.05$), duke treguar se kemi lidhje të mirë ndërmjet variablave të lartpërmendur. Testi rezultoi i kënaqshëm dhe me lidhje.

Tabela 14 Testi Chi Square

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	23.553 ^a	9	.005
Likelihood Ratio	24.990	9	.003
Linear-by-Linear Association	9.814	1	.002
N of Valid Cases	76		

a. 9 cells (56.3%) have expected count less than 5. The minimum expected count is .05.

Raporti i përgjasisë maksimale është = 24.990. Rezultati kryesor i Chi Square ($p = 0.003 < 0.05$) rezulton me një vlerë të pranueshme, kështu që variablat mund të konsiderohen të varur.

Rasti 12.

Si i gjykoni procedurat gjyqësore nëse është përfshirë eventualisht shoqëria juaj? dhe pyetjes tjetër : Si i gjykoni sipas këndvështrimit tuaj vendimet e dhëna nga organet e drejtësisë për shoqërinë juaj? Vlera Chi-Square në tabelën e mëposhtme është = 218.541. Kjo vlerë është plotësisht sinjifikante pasi $p = 0.000 < 0.001$. Kjo vlerë në rastin më poshtë është e rëndësishme pasi rezulton në përputhje të plotë me parametrin statistikor ($p < 0.05$ (nivelin e sinjifikancës 0.05)), duke treguar se kemi lidhje ndërmjet variablave të lartpërmendur. Testi rezultoi i kënaqshëm. Tabelat 15.1 dhe 15.2 në faqet pasardhëse tregojnë pikërisht krostabulimiet dhe testin Chi Square (të rastit 12). Madje nga statistika dimë që testi *Hi- katror* për hipotezën e pavarësisë është: *Ho*: klasifikimet e shtyllave e rreshtave janë të pavarura (jo të lidhura). *Ha*: klasifikimet janë të varura (të

lidhura ose të lidhura në ndonjë mënyrë). Testi statistikor është : $\chi^2 = \sum_{i=1}^n \frac{(O_i - E_i)^2}{E_i}$.

Shumimi bëhet sipas të gjitha qelizave të tabelës së kontigjencës të përbërë prej r rreshtave dhe c shtyllash. O_i është vlera e vrojtuar në qelizën e i -të. E_i është vlera e pritur e vlerësuar (llogaritur) për qelizën e i -të. Shkallët e lirisë për statistikorin *Hi- katror* janë $df = (r-1)(c-1)$.

			V.5 Si i gjykoni vendimet e dhëna nga organet e drejtësisë për shoqërinë juaj?					Total
			Jo të drejta	Deri diku të drejta	Duhet të ishin më objektive	Të drejta	Nuk kemi proces gjyqësor,	
V.2 Si i gjykoni procedurat gjyqësore?	Pak të përshtatshme	Expected Count	10.3	1.5	6.3	7.0	2.9	28.0
		% within V.2 Si i gjykoni procedurat gjyqësore?	96.4%	.0%	3.6%	.0%	.0%	100.0 %
		% within V.5 Si i gjykoni vendimet e organeve të drejtësisë?	96.4%	.0%	5.9%	.0%	.0%	36.8%
	Me ndikim të ndjeshëm	Expected Count	.7	.1	.4	.5	.2	2.0
		% within V.2 Si i gjykoni procedurat gjyqësore?	.0%	100.0%	.0%	.0%	.0%	100.0 %
		% within V.5 Si i gjykoni vendimet e organeve të drejtësisë?	.0%	50.0%	.0%	.0%	.0%	2.6%
	Te kushtueshme	Expected Count	4.1	.6	2.5	2.8	1.2	11.0
		% within V.2 Si i gjykoni procedurat gjyqësore?	.0%	.0%	100.0%	.0%	.0%	100.0 %
		% within V.5 Si i gjykoni vendimet e organeve të drejtësisë?	.0%	.0%	64.7%	.0%	.0%	14.5%
Total	Te gjata në kohë	Expected Count	9.9	1.4	6.0	6.8	2.8	27.0
		% within V.2 Si i gjykoni procedurat gjyqësore?	3.7%	7.4%	18.5%	70.4%	.0%	100.0 %
		% within V.5 Si i gjykoni vendimet e organeve të drejtësisë?	3.6%	50.0%	29.4%	100.0 %	.0%	35.5%
	Nuk kemi proces gjyqësor	Expected Count	2.9	.4	1.8	2.0	.8	8.0
		% within V.2 Si i gjykoni procedurat gjyqësore?	.0%	.0%	.0%	.0%	100.0%	100.0 %
		% within V.5 Si i gjykoni vendimet e organeve të drejtësisë?	.0%	.0%	.0%	.0%	100.0%	10.5%
		Expected Count	28.0	4.0	17.0	19.0	8.0	76.0
		% within V.2 Si i gjykoni procedurat gjyqësore?	36.8%	5.3%	22.4%	25.0%	10.5%	100.0 %
		% within V.5 Si i gjykoni vendimet e organeve të drejtësisë?	100.0%	100.0%	100.0%	100.0 %	100.0%	100.0 %

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	218.541 ^a	16	.000
Likelihood Ratio	163.241	16	.000
Linear-by-Linear Association	66.387	1	.000
N of Valid Cases	76		

a. 19 cells (76.0%) have expected count less than 5. The minimum expected count is .11.

Raporti i përgjasisë maksimale është = 163.241. Rezultati kryesor i hi – katror ($p = 0.000 < 0.05$) me një lidhje plotësisht të pranueshme, kështu që variablat mund të konsiderohen të varur.

Nga krostabulimi i mësipërm shohim se në lidhje me vendimet gjyqësore (vetëm si total) 19 shoqëri ose 25% janë përgjigjur për vendime të drejta.

Rasti 13.

Si i gjykoni procedurat gjyqësore nëse është përfshirë eventalisht shoqëria juaj? dhe pyetjes Si e gjykoni sipas këndvështrimit tuaj sistemin e drejtësisë? Vlera Pearson Chi-Square në tabelën e mëposhtme është = 12.450. Kjo vlerë nuk është sinjifikante pasi $p = 0.712 > 0.05$. Kjo vlerë në rastin më poshtë nuk është e rëndësishme pasi nuk rezulton brenda parametrut statistikor me një shkallë të lartë devijacioni, duke treguar se nuk kemi lidhje ndërmjet variablave të lartpërmendur. Testi rezultoi jo i kënaqshëm.

Tabela 16 Testi Chi Square

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	12.450 ^a	16	.712
Likelihood Ratio	14.896	16	.532
Linear-by-Linear Association	.180	1	.671
N of Valid Cases	76		

a. 21 cells (84.0%) have expected count less than 5. The minimum expected count is .03.

Raporti i përgjasisë maksimale është = 14.896. Rezultati kryesor i hi – katror ($p = 0.532 > 0.05$) rezulton me një lidhje jo të pranueshme, kështu që variablat mund të konsiderohen të pavarur.

Rasti 14.

A janë zyrtarët kryesorë të shoqërisë të familiarizuar me praktikat e qeverisjes së korporatave të vendeve të OECD-së? dhe pyetjes Mendoni se praktikat e OECD-së në fushën e qeverisjes së korporatave me ndryshimet përkatëse hap pas hapi duhet të njihen prej shoqërisë tuaj?

Vlera Chi-Square në tabelën e mëposhtme është = 57.925. Kjo vlerë është plotësisht sinjifikante pasi $p = 0.000 < 0.001$. Kjo vlerë në rastin më poshtë është e rëndësishme pasi rezulton në përputhje të plotë me parametrin statisikor ($p < 0.05$), duke treguar se kemi lidhje ndërmjet variablave të lartpërmendur. Testi rezultoi i kënaqshëm.

Tabela 17 Testi Chi Square

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	57.925 ^a	4	.000
Likelihood Ratio	62.872	4	.000
Linear-by-Linear Association	42.312	1	.000
N of Valid Cases	76		

a. 4 cells (44.4%) have expected count less than 5. The minimum expected count is .26.

Raporti i përgjasisë maksimale është = 62.872. Rezultati kryesor i hi – katror ($p = 0.000 < 0.05$) me një lidhje të pranueshme, kështu që variablat mund të konsiderohen të varur plotësisht.

Rasti 15.

A keni nevojë për trajnim dhe konsulencë mbi çështjet e përmirësimit të qeverisjes së shoqërisë, (sh.a-së tuaj) ? dhe pyetja tjetër : A mendoni se shoqëria duhet të planifikojë fonde për trajnim në fushën e qeverisjes së korporatave?

Vlera Chi-Square në tabelën e mëposhtme është = 50.887. Kjo vlerë është plotësisht sinjifikante pasi $p = 0.000 < 0.001$. Kjo vlerë në rastin më poshtë (Tabela 18) është e

rëndësishtme pasi rezulton në përputhje të plotë me parametrin statisikor ($p < 0.05$), duke treguar se kemi lidhje ndërmjet variablave të lartpërmendur. Testi rezultoi i kënaqshëm. Raporti i përgjasisë maksimale është = 34.505. Rezultati kryesor i hi – katror ($p = 0.000 < 0.05$) me një lidhje të pranueshme, kështu që variablat mund të konsiderohen të varur plotësisht.

Tabela 18 Testi Chi Square

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)	Exact Sig. (2-sided)	Exact Sig. (1-sided)
Pearson Chi-Square	50.887 ^a	1	.000		
Continuity Correction ^b	42.860	1	.000		
Likelihood Ratio	34.505	1	.000		
Fisher's Exact Test				.000	.000
Linear-by-Linear Association	50.217	1	.000		
N of Valid Cases	76				

a. 1 cells (25.0%) have expected count less than 5. The minimum expected count is .92.

b. Computed only for a 2x2 table

Rasti 16.

A ka caktuar shoqëria zyrtarisht një individ, p.sh një sekretar të korporatës (shoqërisë tregtare)? dhe pyetjes tjetër : A është i nevojshëm dhe a duhet të përgjigjet një individ, p.sh një sekretar proceduralisht për mbledhjet e asamblesë së aksionerëve në kuadër të QK-së?

Tabela 19 Testi Chi Square

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)	Exact Sig. (2-sided)	Exact Sig. (1-sided)
Pearson Chi-Square	.865 ^a	1	.352		
Continuity Correction ^b	.000	1	1.000		
Likelihood Ratio	1.246	1	.264		
Fisher's Exact Test				1.000	.539
Linear-by-Linear Association	.854	1	.356		
N of Valid Cases	76				

a. 2 cells (50.0%) have expected count less than 5. The minimum expected count is .46.

b. Computed only for a 2x2 table

Vlera e statistikës Chi Square në tabelë është = 0, 865. Kjo vlerë është sinjifikante e lartë kur $p < 0.001$. Kjo vlerë është e rëndësishme për $p < 0.05$ dhe në rastin tonë për $p = 0.352 > 0.05$, duke treguar se kemi deri diku një lidhje ndërmjet variablave të lartpërmendur.

Raporti i përgjasisë maksimale është = 1.246. Rezultati kryesor i hi – katror ($p = 0.264 > 0.05$), por me një lidhje deri diku të pranueshme, kështu që variablat mund të konsiderohen deri diku të varur.

Rasti 17.

A mbani rregullore të qeverisjes dhe kod etik për të bërë më transparente strukturat e qeverisjes për të ndihmuar organet dhe konsulentët që të jenë më të qartë mbi të drejtat dhe detyrimet e ndërsjellta? dhe pyetjes tjetër të pyetësorit : Nëse jo, mendoni t'i mbani në të ardhmen në shoqërinë tuaj?

Vlera Chi-Square në tabelën e mëposhtme është = 63.107. Kjo vlerë është plotësisht sinjifikante pasi $p = 0.000 < 0.001$. Kjo vlerë në rastin më poshtë është e rëndësishme pasi rezulton në përputhje të plotë me parametrin statisikor ($p < 0.05$), duke treguar se kemi lidhje ndërmjet variablave të lartpërmendur. Testi rezultoi plotësisht i kënaqshëm.

Tabela 20 Testi Chi Square

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	63.107 ^a	2	.000
Likelihood Ratio	54.813	2	.000
Linear-by-Linear Association	51.907	1	.000
N of Valid Cases	76		

a. 3 cells (50.0%) have expected count less than 5. The minimum expected count is .79.

Raporti i përgjasisë maksimale është = 54.813. Rezultati kryesor i hi – katror rezultoi ($p = 0.000 < 0.05$) me një lidhje të pranueshme, kështu që variablat mund të konsiderohen të varur plotësisht.

Rasti 18.

A mbani rregullore të qeverisjes dhe kod etik për të bërë më transparente strukturat e qeverisjes për të ndihmuar organet dhe konsulentët që të jenë më të qartë mbi të drejtat dhe detyrimet e ndërsjellta? dhe pyetjes A keni të parashikuar në kodin etik, nëse keni, çfarë pret shoqëria tregtare në lidhje me standardet e shërbimeve për klientët, konfliktin e interesit, ndershmërinë në punë, dhuratat apo trajtimin me përparësi të furnitorëve apo klientëve?

Vlera e Chi-Square në tabelën e mëposhtme është = 15.263. Kjo vlerë është thuajse plotësisht sinjifikante pasi $p = 0.002$ dhe i afrohet kushtit $p < 0.001$. Kjo vlerë është e rëndësishme dhe rezulton në përputhje të plotë me parametrin statistikor ($p < 0.05$), duke treguar se kemi lidhje ndërmjet variablave të lartpërmendur. Testi rezultoi plotësisht i kënaqshëm.

Tabela 21 Testi Chi Square

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	15.236 ^a	3	.002
Likelihood Ratio	19.802	3	.000
Linear-by-Linear Association	4.891	1	.027
N of Valid Cases	76		

a. 4 cells (50.0%) have expected count less than 5. The minimum expected count is 2.68.

Raporti i përgjasisë maksimale është = 19.802. Rezultati kryesor i hi – katror ($p = 0.000 < 0.05$) me një lidhje plotësisht të pranueshme, kështu që variablat mund të konsiderohen të varur.

Rasti 19.

A mendoni se duhet kuptuar nga të gjithë drejtorët dhe drejtuesit ekzekutiv kryesorë koncepti i qeverisjes së korporatave dhe rëndësia e tij për shoqërinë dhe aksionerët në kuadrin edhe të krizës financiare globale? dhe pyetjes tjetër : Sipas informacionit tuaj, a ka zhvilluar këshilli administrativ apo administratorët një politikë dhe plan për të

përmirësuar praktikat e qeverisjes së korporatës dhe a janë ndërmarrë hapat e duhur për të zbatuar këtë plan?

Vlera Chi-Square në tabelën e mëposhtme është 0.191. Kjo vlerë është plotësisht sinjifikante për $p < 0.001$. Kjo vlerë është e rëndësishme kur rezulton në përputhje të plotë me parametrin statistikor ($p < 0.05$), por në rastin konkret $p = 0.909 > 0.05$ duke treguar se nuk kemi lidhje ndërmjet variablave të lartpërmendur. Testi rezultoi jo i kënaqshëm.

Tabela 22 Testi Chi Square

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	.191 ^a	2	.909
Likelihood Ratio	.193	2	.908
Linear-by-Linear Association	.010	1	.921
N of Valid Cases	76		

a. 3 cells (50.0%) have expected count less than 5. The minimum expected count is 1.66.

Raporti i përgjasisë maksimale (Likelihood Ratio) është 0.193. Kjo konfirmon rezultatin kryesor hi – katror ($p = 0.908 > 0.05$), pra me një vlerë të papranueshme.

Rasti 20.

Sipas informacionit tuaj, a ka zhvilluar këshilli administrativ apo administratorët një politikë dhe plan për të përmirësuar praktikat e qeverisjes së korporatës dhe a janë ndërmarrë hapat e duhur për të zbatuar këtë plan? dhe pyetjes : A ka vendosur këshilli mbikëqyrës ose administrimit (më poshtë do i themi këshilli) objektiva strategjike dhe të sigurojë burimet financiare dhe njerëzore që shoqëria t'i arrijë objektivat e veta?

Vlera Chi-Square në tabelën e mëposhtme është 5.881. Kjo vlerë është plotësisht sinjifikante për $p < 0.001$. Kjo vlerë është e rëndësishme kur rezulton në përputhje të plotë me parametrin statistikor ($p < 0.05$), por në rastin konkret $p = 0.208 > 0.05$ duke treguar se kemi deri diku lidhje ndërmjet variablave të lartpërmendur. Testi rezultoi deri diku i kënaqshëm.

Raporti i përgjasisë maksimale është 5.570. Rezultati kryesor Chi square ($p = 0.234 > 0.05$) me një lidhje deri diku të pranueshme, kështu që variablat mund të konsiderohen deri diku të varur.

Tabela 23 Testi Chi Square

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	5.881 ^a	4	.208
Likelihood Ratio	5.570	4	.234
Linear-by-Linear Association	.368	1	.544
N of Valid Cases	76		

a. 1 cells (11.1%) have expected count less than 5. The minimum expected count is 3.55.

Rasti 21.

A ka vendosur këshilli mbikëqyrës ose administrimit (më poshtë do i themi këshilli) objektiva strategjike dhe të sigurojë burimet financiare dhe njerëzore që shoqëria ti arrijë objektivat e veta? dhe pyetjes : A ka vendosur këshilli standardet e shoqërisë, të kujdeset që të kuptohen si dhe të përmbushen detyrimet kundrejt aksionerëve dhe grupeve të tjerë të interesit?

Vlera Chi-Square në tabelën e mëposhtme është 10.226. Kjo vlerë është plotësisht sinjifikante për $p < 0.001$. Kjo vlerë është e rëndësishme kur rezulton në përputhje të plotë me parametrin statistikor ($p < 0.05$), dhe në rastin konkret $p = 0.037 < 0.05$ duke treguar se kemi lidhje ndërmjet variablave të lartpërmendur. Testi rezultoi i kënaqshëm.

Tabela 24 Testi Chi Square

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	10.226 ^a	4	.037
Likelihood Ratio	10.609	4	.031
Linear-by-Linear Association	3.612	1	.057
N of Valid Cases	76		

a. 3 cells (33.3%) have expected count less than 5. The minimum expected count is 2.17.

Raporti i përgjasisë maksimale është = 10.609. Rezultati kryesor Chi Square ($p = 0.031 < 0.05$) me një lidhje plotësisht të pranueshme, kështu që variablat mund të konsiderohen të varur.

Rasti 22.

A ka vendosur këshilli standardet e shoqërisë, të kujdeset që të kuptohen si dhe të përmbushen detyrimet kundrejt aksionerëve dhe grupeve të tjerë të interesit? dhe pyetjes A është përfshirë këshilli në procesin e zhvillimit strategjik dhe të paktën të aprovojë strategjinë dhe të kujdeset që strategjia të jetë brenda interesave të aksionerëve?

Vlera Chi-Square në tabelën e mëposhtme është 27.737. Kjo vlerë është plotësisht sinjifikante për $p < 0.001$. Kjo vlerë është e rëndësishme kur rezulton në përputhje të plotë me parametrin statistikor ($p < 0.05$), dhe në rastin konkret $p = 0.000 < 0.05$ duke treguar se kemi lidhje ndërmjet variablave të lartpërmendur. Testi rezultoi i kënaqshëm.

Tabela 25 Testi Chi Square

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	27.737 ^a	4	.000
Likelihood Ratio	28.374	4	.000
Linear-by-Linear Association	20.519	1	.000
N of Valid Cases	76		

a. 4 cells (44.4%) have expected count less than 5. The minimum expected count is 1.30.

Raporti i përgjasisë maksimale është = 28.374. Rezultati kryesor Chi Square ($p = 0.000 < 0.05$) me një lidhje të pranueshme, kështu që variablat mund të konsiderohen të varur plotësisht.

Rasti 23.

A ka një evidencë zyrtare në të cilën shprehet së cila çështje i përket vendimmarrjes së këshillit dhe cilat duhet tu delegohen administratorëve si dhe për diskutimet e hapura që do mbahen në këshill? dhe pyetjes A keni të parashikuar në kodin etik, nëse keni, se çfarë pret shoqëria tregtare në lidhje me standardet e shërbimeve për klientët, konfliktin e interesit, ndershmëri në punë, dhuratat apo trajtimin me përparësi lidhur me furnitorët, klientët?

Vlera Chi-Square në tabelën e mëposhtme është 40.880. Kjo vlerë është plotësisht sinjifikante për $p < 0.001$. $p = 0.000 < 0.001$. Kjo vlerë është e rëndësishme, madje kur rezulton në përputhje të plotë me parametrin statistikor ($p < 0.05$), dhe në rastin konkret $p = 0.000 < 0.001 < 0.05$ duke treguar se kemi lidhje ndërmjet variablave të lartpërmendur. Testi rezultoi i kënaqshëm.

Tabela 26 Testi Chi Square

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	40.880 ^a	6	.000
Likelihood Ratio	45.954	6	.000
Linear-by-Linear Association	13.131	1	.000
N of Valid Cases	76		

a. 6 cells (50.0%) have expected count less than 5. The minimum expected count is 2.68.

Raporti i përgjasisë maksimale është = 45.954. Rezultati kryesor i hi – katror ($p = 0.000 < 0.05$) me një lidhje të pranueshme, kështu që variablat mund të konsiderohen të varur plotësisht.

Rasti 24.

A keni në këshillin tuaj anëtarë jo administratorë me kohë të pjesshme apo anëtarë të pavarur të këshillit për të ofruar oponencë konstruktive dhe të ndihmojnë në hartimin e propozimeve për strategjinë? dhe pyetja tjetër e pyetësorit : Nivelet e shpërblimit të punës a janë të mjaftueshme për të tërhequr e mbajtur anëtarët administratorë dhe jo administratorë të këshillit me cilësitë e nevojshme për ta drejtuar me sukses shoqërinë?

Tabela 27 Testi Chi Square

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	.625 ^a	2	.732
Likelihood Ratio	.969	2	.616
Linear-by-Linear Association	.563	1	.453
N of Valid Cases	76		

a. 3 cells (50.0%) have expected count less than 5. The minimum expected count is .09.

Vlera Chi-Square në tabelën e mësipërme është 0.625. Kjo vlerë nuk është plotësisht sinjifikante pasi $p = 0.732 > 0.05$. Kjo vlerë është sinjifikante e lartë kur $p < 0.001$, është e rëndësishme ($p < 0.05$). Kjo vlerë në rastin tonë nuk është e rëndësishme pasi nuk rezulton brenda parametrut statistikor me një shkallë të lartë deviacioni, duke treguar se nuk kemi lidhje ndërmjet variablave të lartpërmendur. Testi rezultoi jo i kënaqshëm.

Raporti i përgjasisë maksimale është $= 0.969$. Rezultati kryesor i hi – katror ($p = 0.616 > 0.05$) paraqitet një lidhje jo të pranueshme, kështu që variablat mund të konsiderohen të pavarur.

Rasti 25.

A keni mekanizma familjarë, nëse keni biznes të tillë, të drejtimit të brendshëm, për shembull një dokument themelues ose protokoll familjar ku të parashtrohen vizioni dhe objektivat që mund të ketë për firmën familja si dhe të përcaktohen rolet e organeve të drejtimit të brendshëm të biznesit të familjes dhe marrëdhëniet e tyre me këshillin? dhe pyetjes tjetër : Prezenca e një sistemi efektiv të qeverisjes së korporatave brenda një shoqërie ndihmon në ofrimin e një shkalle besimi, që është e nevojshme për mirëfunksionimin e shoqërisë por dhe të ekonomisë?

Tabela 28 Testi Chi Square

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)	Exact Sig. (2-sided)	Exact Sig. (1-sided)
Pearson Chi-Square	.042 ^a	1	.838		
Continuity Correction ^b	.000	1	1.000		
Likelihood Ratio	.081	1	.776		
Fisher's Exact Test				1.000	.961
Linear-by-Linear Association	.041	1	.839		
N of Valid Cases	76				

a. 3 cells (75.0%) have expected count less than 5. The minimum expected count is .04.

b. Computed only for a 2x2 table

Vlera Chi-Square në tabelë është 0.042. Kjo vlerë nuk është sinjifikante pasi $p = 0.838 > 0.05$. Kjo vlerë është sinjifikante e lartë kur $p < 0.001$, është e rëndësishme ($p < 0.05$). Kjo vlerë në rastin tonë nuk është e rëndësishme pasi nuk rezulton brenda parametrit statistikor me një shkallë të lartë deviacioni, duke treguar se nuk kemi lidhje ndërmjet variablave të lartpërmendur. Testi rezultoi jo i kënaqshëm.

Raporti i përgjasisë maksimale është 0.081. Përsëri kjo konfirmon rezultatin kryesor hi – katror ($p = 0.776 > 0.05$) me një vlerë jo të pranueshme, kështu që variablat mund të konsiderohen të pavarur (nuk kanë lidhje).

Rasti 26.

A keni mekanizma familjarë, nëse keni biznes të tillë, të drejtimit të brendshëm, për shembull një dokument themelues ose protokoll familjar ku të parashtrohen vizioni dhe objektivat që mund të ketë për firmën familja si dhe të përcaktohen rolet e organeve të drejtimit të brendshëm të biznesit të familjes dhe marrëdhëniet e tyre me këshillin dhe pyetjes tjetër : A është i nevojshëm planifikimi i menaxhimit në një biznes familjar?

Vlera Chi-Square në tabelën e mëposhtme është 2.271. Kjo vlerë nuk është plotësisht sinjifikante pasi $p = 0.321 > 0.05$. Kjo vlerë është sinjifikante e lartë kur $p < 0.001$, është e rëndësishme ($p < 0.05$). Kjo vlerë në rastin më poshtë është deri diku e rëndësishme pasi nuk rezulton plotësisht brenda parametrit statistikor, duke treguar se kemi deri diku lidhje ndërmjet variablave të lartpërmendur.

Tabela 29 Testi Chi Square

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	2.271 ^a	2	.321
Likelihood Ratio	3.369	2	.186
Linear-by-Linear Association	2.101	1	.147
N of Valid Cases	76		

a. 4 cells (66.7%) have expected count less than 5. The minimum expected count is .20.

Raporti i përgjasisë maksimale është 3.369. Kjo konfirmon rezultatin kryesor hi – katror ($p = 0.186 > 0.05$) me një vlerë deri diku të pranueshme, kështu që variablat mund të konsiderohen deri diku të varur.

Rasti 27.

A duhet të emërohet nëse nuk keni, një kryetar i pavarur i këshillit si masë e përkohshme, për shembull administratori (ose pronari themelues i shoqërisë tregtare ose kryefamiljari)? dhe pyetjes tjetër : A i ushtron i njëjti person rolin e kryetarit të këshillit dhe administratorit?

Vlera Chi-Square në tabelën e mëposhtme është 6.735. Kjo vlerë është sinjifikante pasi $p = 0.009 < 0.05$, rezulton brenda parametrit statistikor, duke treguar se kemi lidhje ndërmjet variablave të lartpërmendur. Testi rezultoi i kënaqshëm.

Raporti i përgjasisë maksimale (Likelihood Ratio) është 5.359. Kjo konfirmon rezultatin kryesor hi – katror ($p = 0.021 < 0.05$) me një vlerë të pranueshme, kështu që variablat mund të konsiderohen të varur.

Tabela 30 Testi Chi Square

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)	Exact Sig. (2-sided)	Exact Sig. (1-sided)
Pearson Chi-Square	6.735 ^a	1	.009		
Continuity Correction ^b	3.916	1	.048		
Likelihood Ratio	5.359	1	.021		
Fisher's Exact Test				.033	.033
Linear-by-Linear Association	6.647	1	.010		
N of Valid Cases	76				

a. 2 cells (50.0%) have expected count less than 5. The minimum expected count is .89.

b. Computed only for a 2x2 table

Rasti 28.

Mendoni të keni, në rast se nuk keni të tillë, anëtarë jo administratorë dhe të pavarur të këshillit për oponencë konstruktive që gjithashtu të ndihmojnë në hartimin e propozimeve për strategjinë? dhe pyetja tjetër zgjedhur për t'u kombinuar : A duhet të emërohet nëse nuk keni, një kryetar i pavarur i këshillit si masë e përkohshme, për shembull administratori (ose pronari themelues i shoqërisë tregtare ose kryefamiljari)?

Vlera Chi-Square në tabelën e mëposhtme është 18.575. Kjo vlerë është sinjifikante e lartë pasi $p = 0.000 < 0.001$, duke treguar se kemi lidhje ndërmjet variablove të lartpërmendur. Testi rezultoi i kënaqshëm.

Tabela 31 Testi Chi Square

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)	Exact Sig. (2-sided)	Exact Sig. (1-sided)
Pearson Chi-Square	18.575 ^a	1	.000		
Continuity Correction ^b	14.098	1	.000		
Likelihood Ratio	16.279	1	.000		
Fisher's Exact Test				.000	.000
Linear-by-Linear Association	18.331	1	.000		
N of Valid Cases	76				

a. 2 cells (50.0%) have expected count less than 5. The minimum expected count is 1.12.

b. Computed only for a 2x2 table

Raporti i përgjasisë maksimale (Likelihood Ratio) është 16.279. Kjo konfirmon rezultatin kryesor Chi Square ($p = 0.000 < 0.05$) me një vlerë shumë të pranueshme, kështu që variablat mund të konsiderohen të varur.

Rasti 29.

A kryen këshilli një vlerësim periodik të performancës së vet dhe të performancës së çdo anëtari të tij? dhe pyetjes tjetër : A paraqet këshilli një analizë vlerësuese të ekuilibruar dhe të kuptueshme, të gjendjes dhe të ardhmes së shoqërisë tregtare për grupet e interesit dhe të krijojë një program të përshtatshëm për angazhimin e grupeve të interesit?

Vlera Chi-Square në tabelën e mëposhtme është 54.533. Kjo vlerë është sinjifikante e lartë pasi $p = 0.000 < 0.001$, duke treguar se kemi lidhje ndërmjet variablove të lartpërmendur. Testi rezultoi i kënaqshëm.

Tabela 32 Testi Chi Square

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	54.533 ^a	4	.000
Likelihood Ratio	59.881	4	.000
Linear-by-Linear Association	33.534	1	.000
N of Valid Cases	76		

a. 2 cells (22.2%) have expected count less than 5. The minimum expected count is 4.74.

Raporti i përgjasisë maksimale (Likelihood Ratio) është 59.881. Kjo konfirmon rezultatin kryesor hi – katror ($p = 0.000 < 0.05$) me një vlerë shumë të pranueshme, kështu që variablat mund të konsiderohen të varur ndërmjet tyre.

Rasti 30.

A publikon Këshilli një raport vjetor i cili tu përshtatet nevojave të aksionerëve dhe grupeve të tjera të interesit, duke përfshirë dhe punëmarrësit, kreditorët dhe publikun e gjerë? dhe pyetja: Nëse publikon a përmban ai një përmbledhje të strategjisë tregtare të shoqërisë dhe të risqeve të mundshme që e shoqërojnë këtë strategji si dhe deklaratën e parimeve të drejtimit të brendshëm të shoqërisë tregtare si dhe shkallën me të cilën e ka respektuar kodin specifik të drejtimit të brendshëm?

Tabela 33 Testi Chi Square

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	71.950 ^a	4	.000
Likelihood Ratio	93.129	4	.000
Linear-by-Linear Association	51.828	1	.000
N of Valid Cases	76		

a. 4 cells (44.4%) have expected count less than 5. The minimum expected count is .63.

Vlera Chi-Square në tabelën e mësipërme është 71.950. Kjo vlerë është sinjifikante e lartë pasi $p = 0.000 < 0.001$. Dimë që është e rëndësishme për $p < 0.05$. Kjo vlerë në rastin tonë është sinjifikante e lartë, duke treguar se kemi lidhje ndërmjet variablave të lartpërmendur. Testi rezultoi i kënaqshëm.

Raporti i përgjasisë maksimale (Likelihood Ratio) është 93.129. Kjo konfirmon rezultatin kryesor Chi Square ($p = 0.000 < 0.05$) me një vlerë shumë të pranueshme, kështu që variablat mund të konsiderohen të varur.

Rasti 31.

Krahas statutit a keni akte normative për kuadrin bazë të drejtimit të brendshëm të shoqërisë? dhe pyetja : Kuadri themelues dhe drejtues i cili është dhe kuadri bazë i drejtimit të brendshëm është konsultuar me të gjithë grupet e interesit, sidomos punëmarrësit ku korniza themeluese duhet të marrë për bazë dhe përgjegjësitë sociale (për shembull nëpërmjet statutit dhe akteve të tjera normative)?

Vlera Chi-Square në tabelën e mëposhtme është 3.590. Kjo vlerë nuk është plotësisht sinjifikante pasi $p = 0.464 > 0.05$. Kjo vlerë në rastin më poshtë nuk rezulton brenda parametrut statistikor duke treguar se nuk lidhje ndërmjet variablave të lartpërmendur.

Raporti i përgjasisë maksimale është 4.520. Kjo konfirmon rezultatin kryesor hi – katror ($p = 0.340 > 0.05$) me një vlerë të papranueshme dhe variablat mund të konsiderohen të pavarur.

Tabela 34 Testi Chi Square

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	3.590 ^a	4	.464
Likelihood Ratio	4.520	4	.340
Linear-by-Linear Association	.329	1	.566
N of Valid Cases	76		

a. 3 cells (33.3%) have expected count less than 5. The minimum expected count is 1.12.

Rasti 32.

Mendoni se mund të vijë koha që shoqëria juaj të kuotohet në tregjet e kapitalit në vendet më të zhvilluara? dhe pyetja tjetër : A mendoni se ka ardhur koha për listim në bursë të shoqërisë tuaj dhe shoqërive tregtare në përgjithësi?

Vlera Chi-Square në tabelën e mëposhtme është 4.829. Kjo vlerë nuk është sinjifikante pasi $p = 0.566 > 0.05$. Kjo vlerë është sinjifikante e lartë kur $p < 0.001$, është e rëndësishme ($p < 0.05$). Kjo vlerë në rastin më poshtë, pasqyrar në tabelë, nuk është e rëndësishme pasi nuk rezulton plotësisht brenda parametrut statistikor, duke treguar se nuk kemi lidhje ndërmjet variablave të lartpërmendur.

Tabela 35 Testi Chi Square

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	4.829 ^a	6	.566
Likelihood Ratio	5.600	6	.469
Linear-by-Linear Association	.964	1	.326
N of Valid Cases	76		

a. 8 cells (66.7%) have expected count less than 5. The minimum expected count is .42.

Raporti i përgjasisë maksimale është 5.600. Kjo konfirmon rezultatin kryesor hi – katror ($p = 0.469 > 0.05$) me një vlerë të papranueshme dhe variablat mund të konsiderohen të pavarur.

Rasti 33.

Si ka qenë situata financiare e vitit 2013 në krahasim me vitin 2012? dhe pyetjes tjetër : Nëse situata financiare ka qenë në rënie cilat kanë qenë arsyet dhe a mendoni në përmirësim të saj? Vlera Chi-Square në tabelën e mëposhtme është 76.835. Kjo vlerë është sinjifikante e lartë pasi $p = 0.000 < 0.001$, duke treguar se kemi lidhje ndërmjet variablave të lartpërmendur. Testi rezultoi i kënaqshëm.

Raporti i përgjasisë maksimale është 103.656. Kjo konfirmon rezultatin kryesor Chi Square ($p = 0.000 < 0.05$) me një vlerë të pranueshme dhe variablat mund të konsiderohen të varur.

Tabela 36 Testi Chi Square

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	76.835 ^a	6	.000
Likelihood Ratio	103.656	6	.000
Linear-by-Linear Association	50.567	1	.000
N of Valid Cases	76		

a. 6 cells (50.0%) have expected count less than 5. The minimum expected count is .24.

Rasti 34.

A mendoni të përfshini në raportet financiare dhe një raport për strukturën dhe praktikën e qeverisjes së korporatës? dhe pyetjes A përgatitet raport për qeverisjen e korporatës nga administratorët ose KA (ose Km) për aksionerët e shoqërisë tuaj ?

Vlera Chi-Square në tabelën e mëposhtme është 49.816. Kjo vlerë është sinjifikante e lartë pasi $p = 0.000 < 0.001$. Kjo vlerë në rastin tonë është sinjifikante e lartë, duke treguar se kemi lidhje ndërmjet variablave të lartpërmendur. Testi rezultoi i kënaqshëm. Raporti i përgjasisë maksimale është 23.504. Kjo konfirmon rezultatin kryesor Chi Square ($p = 0.001 < 0.05$) me një vlerë të pranueshme dhe variablat mund të konsiderohen të varur, pra që kanë kuptim dhe konsiderohet statistikisht e qëndrueshme lidhja e këtij rasti.

Tabela 37 Testi Chi Square

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	49.816 ^a	6	.000
Likelihood Ratio	23.504	6	.001
Linear-by-Linear Association	5.694	1	.017
N of Valid Cases	76		

a. 10 cells (83.3%) have expected count less than 5. The minimum expected count is .12.

Rasti 35.

A janë zyrtarët kryesore të shoqërisë të familjarizuar me praktikat e qeverisjes së korporatave të vendeve të OECD-së? dhe pyetjes: A përgatitet raport për qeverisjen e korporatës nga administratorët ose KA (ose Km) për aksionerët e shoqërisë tuaj ?

Kjo vlerë në rastin më poshtë është e rëndësishme pasi rezulton brenda parametrut statistikor, duke treguar se kemi lidhje ndërmjet variablave të lartpërmendur.

Testi rezultoi i kënaqshëm pasi $p = 0.012 < 0.05$.

Tabela 38 Testi Chi Square

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	12.892 ^a	4	.012
Likelihood Ratio	13.789	4	.008
Linear-by-Linear Association	5.295	1	.021
N of Valid Cases	76		

a. 6 cells (66.7%) have expected count less than 5. The minimum expected count is .39.

Raporti i përgjasisë maksimale është 13.789. Kjo konfirmon rezultatin kryesor Chi Square ($p = 0.008 < 0.05$) me një vlerë të pranueshme dhe variablat mund të konsiderohen të varur, pra që kanë kuptim dhe konsiderohet statistikisht e qëndrueshme lidhja.

Rasti 36.

Krahas statutit a keni akte normative për kuadrin bazë të drejtimit të brendshëm të shoqërisë? dhe pyetjes tjetër : A mbani rregullore të qeverisjes dhe kod etik për të bërë më transparente strukturat e qeverisjes, për të ndihmuar organet dhe konsulentët që të jenë më të qartë mbi të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella?

Kjo vlerë është sinjifikante e lartë kur $p < 0.001$, por është e rëndësishme ($p < 0.05$).

Kjo vlerë në rastin më poshtë është e rëndësishme pasi rezulton brenda parametrut statistikor, duke treguar se kemi lidhje ndërmjet variablave të lartpërmendur.

Testi rezultoi i kënaqshëm pasi $p = 0.018 < 0.05$.

Raporti i përgjasisë maksimale është : 8.498. Kjo konfirmon rezultatin kryesor Chi Square ($p = 0.014 < 0.05$) me një vlerë të pranueshme dhe variablat mund të konsiderohen të varur, pra që kanë kuptim dhe konsiderohet statistikisht e qëndrueshme lidhja e këtij rasti.


Tabela 39 Testi Chi Square

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	7.994 ^a	2	.018
Likelihood Ratio	8.498	2	.014
Linear-by-Linear Association	.225	1	.636
N of Valid Cases	76		

a. 2 cells (33.3%) have expected count less than 5. The minimum expected count is 2.68.

Nga analiza e 36 rasteve të mësipërme na rezulton se në 21 prej tyre kemi një lidhje të realizuar plotësisht ndërmjet variablave, në 4 raste pothuaj kemi lidhje dhe mund të konsiderohen raste të mira dhe në 11 raste nuk kemi lidhje ndërmjet variablave (grafiku 2). Konkretisht nga përzgjedhja ndërmjet 106 pyetjeve, 69% e kombinimeve të pyetjeve si më lart, konkretisht të dy pyetjeve ose mbi 2/3-tat e përbëjnë raste të mira, pra raste të përshtatshme dhe 31% raste jo të përshtatshme (vetëm si lidhje).

Grafiku 2 Variablat



Burimi: Materiali studimor

4.4. Analizë e tabelave të kryqëzuar (kontigjencave) të rasteve të marra në studim

Në statistikë, tabela e kontigjencave (gjithashtu mund të thuhet ndryshe tabela e kryqëzuar) është një lloj tabele në formën e një formati matrice që paraqet shpërndarjen (me shumë ndryshore) të frekuencave (përqindjeve) të variablave. Kjo tabelë është një proces statistikor që përmbledh të dhënat kategorike dhe pikërisht këto të dhëna krijojnë tabelën e kontigjencave.

Përmendëm që lloji më i thjeshtë i kësaj forme tabele është një tabelë në të cilën secila ndryshore ka vetëm dy nivele; kjo quhet tabela 2x2 e kontigjencave, tabelë e cila është përgatitur për 36 rastet tona ashtu si testi Chi Square (Hi-katror) test i cili përmban dhe treguesin Likelihood Ratio. Të gjitha rastet pasqyrojnë qartësisht lidhjet ndërmjet pyetjeve duke dhënë përqindjen që zë njëra pyetje tek tjetra, duke na e bërë në këtë mënyrë më të qartë vërtetësinë e lidhjeve ndërmjet pyetjeve. 36 tabelat e testit Chi Square si pjesë e punimit, së bashku me krostabulimet, na japin një ide të përgjithshme dhe të saktë të vërtetësisë dhe kuptimit të pyetësorit. Një pjesë e krostabulimeve, për raste specifike, është vendosur në këtë punim.

4.4.1 Analiza e disa rasteve specifike

Le të shikojmë lidhjen tabelore (krostabulimin) të disa pyetjeve ndër 36 rastet e marra në shqyrtim.

Lidhja e pyetjes : A jeni të informuar mbi Kodin e Drejtimit të Brendshëm të Shoqërive Aksionere Jo të Regjistruara në Bursë publikuar nga METE dhe a keni njohuri mbi të me lidhjen me pyetjen : Cila është ndarja e shoqërive sipas tipit (Tabela 40 në faqen pasardhëse 142).

Seksionet e tabelës kanë të analizuar qartësisht përgjigjet e lidhjeve : **Po, Jo dhe N/a**. Kështu për pjesën **Po**, po të analizojmë raportet horizontalisht, në përqindje, kemi ndarjet 28% (7/25), 12% dhe 60% sipas shoqërive.

Le të shpjegojmë më konkretisht lidhjet e pyetjeve të nxjerra nga programi. Për lidhjen e mësipërme, nga numri në total i përgjigjeve për pjesën **Po**, na rezulton nga analiza se janë 25 shoqëri, dhe raporti 7/25 në total tregon se 28 % e shoqërive që janë të informuar mbi këtë kod janë shoqëri të përbashkëta, (3/25) 12% e shoqërive që janë të informuar gjithashtu mbi këtë kod janë shoqëri me kapital të huaj dhe 15/25 = 60% e

shoqërive që janë të informuar po mbi këtë kod janë shoqëri shqiptare (gjithashtu mbi kodin). Ndërsa vertikalisht në lidhje me totalin e të gjitha përgjigjeve pra për **Po**, **Jo** dhe **N/a**, për pjesën e parë **Po** të përgjigjes, 58.3% (7/12 shoqëri) i takojnë shoqërive të përbashkëta që kanë informacion mbi këtë kod, 100% atyre të huaj (3/3) dhe 24,6% (15/61) atyre shqiptare që kanë informacion mbi këtë kod.

Tabela 40 Krostabulimi ndërmjet pyetjeve: Ndarja e Shoqërive sipas Tipit dhe Informacioni mbi Kodin e Drejtimit të Brendshëm të Shoqërive Aksionere (Sh.A)

A jeni të informuar mbi Kodin e Drejtimit të Brendshëm të Shoqërive Aksionere Jo të Regjistruara në Bursë publikuar nga METE dhe a keni njohuri mbi të?	Cila është ndarja e shoqërive sipas tipit							
	Shoqëri e përbashkët	%	Shoqëri me kapital të huaj	%	Shoqëri shqiptare	%	Total	%
Po	7	28.0%	3	12.0%	15	60.0%	25	100.0%
%	58.3%		100.0%		24.6%		32.9%	
Jo	5	14.7%	0	.0%	29	85.3%	34	100.0%
%	41.7%		.0%		47.5%		44.7%	
N/A	0	.0%	0	.0%	17	100.0%	17	100.0%
%	.0%		.0%		27.9%		22.4%	
Total	12	15.8%	3	3.9%	61	80.3%	76	100.0%
%	100.0%		100.0%		100.0%		100.0%	

Gjithashtu dhe për përgjigjet **Jo**, përdorim të njëjtin arsyetim. Po të analizojmë raportin horizontalisht, në përqindje kemi : 14,7% shoqëri të përbashkëta (5/34), 0% shoqëri të huaja (0/34) dhe 85,3% shoqëri shqiptare (29/34) të cilët nuk janë të informuar mbi këtë kod, ndërsa vertikalisht për totalin e përgjigjeve për pjesën **Jo** na rezultojnë përqindjet në këtë mënyrë : 41,7% (5/12) i takojnë shoqërive të përbashkëta, 0% (0/3) e shoqërive me kapital të huaj dhe 47,5% (29/61) e shoqërive shqiptare, për informacionin për këtë kod. Kështu siç shihet në tabelë në total janë përgjigjur për secilën shoqëri, 5 shoqëri të

përbashkëta, 0 me kapital të huaj dhe 29 shqiptare, gjithsej 34 nga ku rezultojnë dhe raportet përkatëse si më sipër përmendur.

Ndërsa përgjigjet e lidhjes **N/a**, për të njëjtin arsyetim janë : horizontalisht kemi përgjigje N/a vetëm nga 17 shoqëri për informimin mbi këtë kod, nuk ka zgjedhje nga asnjë shoqëri e përbashkët dhe shoqëri e huaj. Pra 100% shoqëri shqiptare (17/17). Ndaj totalit të përgjithshëm të përgjigjeve, vertikalisht kemi 17/61, 27,9% pra për shoqëritë shqiptare. Shoqëritë e tjera nuk kanë zgjedhur këtë pjesë.

Tabela.41 Krostabulimi ndërmjet pyetjeve: Informacioni mbi manualin e qeverisjes së korporatave dhe Informacioni rreth drejtimit të brendshëm të sh.a-ve

A jeni të informuar mbi Kodin e Drejtimit të Brendshëm të Shoqërive Aksionere Jo të Regjistruara në Burse publikuar nga METE dhe a keni njohuri mbi te?	A jeni të informuar mbi manualin e Qeverisjes së Korporatave dhe a keni njohuri mbi të ?							
	Po	%	Jo	%	N/A	%	Total	%
Po	12	48.0%	8	32.0%	5	20.0%	25	100.0%
% within A4 A jeni të informuar mbi manualin e Qeverisjes së Korporatave dhe a keni njohuri mbi të ?	32.4%		26.7%		55.6%		32.9%	
Jo	15	44.1%	19	55.9%	0	.0%	34	100.0%
% within A4 A jeni të informuar mbi manualin e Qeverisjes së Korporatave dhe a keni njohuri mbi të ?	40.5%		63.3%		.0%		44.7%	
N/A	10	58.8%	3	17.6%	4	23.5%	17	100.0%
% within A4 A jeni të informuar mbi manualin e Qeverisjes së Korporatave dhe a keni njohuri mbi të ?	27.0%		10.0%		44.4%		22.4%	
Total	37	48.7%	30	39.5%	9	11.8%	76	100.0%
% within A4 A jeni të informuar mbi manualin e Qeverisjes së Korporatave dhe a keni njohuri mbi të ?	100.0%		100.0%		100.0%		100.0%	

Në faqen 144, Tabela 41, paraqitet krostabulimi i 2 pyetjeve. Le të analizojmë rastin e lidhjes tabelore (Tabelën 41). *Lidhja e pyetjes: A jeni të informuar mbi manualin e Qeverisjes së Korporatave dhe a keni njohuri mbi të, me pyetjen : A jeni të informuar mbi Kodin e Drejtimit të Brendshëm të Shoqërive Aksionere Jo të Regjistruara në Bursë publikuar nga METE dhe a keni njohuri mbi të?*

Kështu për pjesën **Po**, e cila ka lidhje me kodin e drejtimit të brendshëm, nëse analizojmë raportin horizontalisht 12/25 (nr i përgjithshëm i përgjigjeve) vëmë re se 48%, e shoqërive që janë informuar mbi manualin e Qeverisjes së Korporatave dhe kanë njohuri mbi të tregon që ata janë të informuar dhe mbi Kodin e Drejtimit të Brendshëm të Shoqërive Aksionere Jo të Regjistruara në Bursë, publikuar nga METE, 32% (8/25) Jo dhe 20% (5/25) N/A, nuk janë përgjigjur. Ndërsa vertikalisht në lidhje me totalin e të gjitha përgjigjeve pra për Po, Jo e N/a, për rastin e parë për përgjigjet Po, $12/37 = 32,4\%$ e shoqërive të cilët janë informuar për manualin e qeverisjes së korporatave dhe kanë njohuri mbi të kanë dhënë përgjigjen **Po**, për pyetjen : *A jeni të informuar mbi Kodin e Drejtimit të Brendshëm të Shoqërive Aksionere Jo të Regjistruara në Bursë publikuar nga METE dhe a keni njohuri mbi të*, ndërsa 26,7 % (8/30) kanë thënë **Jo** dhe 55,6% (5/9) kanë dhënë përgjigjen **N/A**.

Ndërsa thjesht vertikalisht dhe horizontalisht totalët e krostabulimeve përputhen plotësisht me anën grafike. Psh: A jeni të informuar mbi manualin e Q.K-së nga ku 37 shoqëri në total horizontalisht kanë thënë Po, dhe me radhë përgjigjet e tjera. Ndërsa për kodin e drejtimit të brendshëm për sh.a-të e jo të regjistruar në bursë 25 shoqëri kanë thënë Po, 34 Jo dhe 17 N/a (Grafiku 1.1 dhe 1.2 shtojca 3 na jep qartë argumentimin e bërë nga ana jonë).

Kështu për pjesën **Jo**, e cila ka lidhje me kodin e drejtimit të brendshëm të Sh.a-ve, po të analizojmë raportin horizontalisht 15/34 (nr i përgjithshëm i përgjigjeve) 44.1% (Po), e shoqërive janë të informuar mbi manualin e Qeverisjes së Korporatave dhe kanë njohuri mbi të, tregon që janë të informuar dhe mbi Kodin e Drejtimit të Brendshëm të Shoqërive Aksionere Jo të Regjistruara në Bursë, publikuar nga METE, 55.9% (19/34) Jo dhe 0% (0/34) N/A, nuk janë përgjigjur, nuk kanë zgjedhur këtë pjesë. Ndërsa vertikalisht në lidhje me totalin e të gjitha përgjigjeve, për rastin **Jo**, $15/37 = 40,5\%$ e shoqërive të cilët janë informuar për manualin e qeverisjes së korporatave dhe kanë

*njohuri mbi të kane dhënë përgjigjen **Po**, për pyetjen : A jeni të informuar mbi Kodin e Drejtimit të Brendshëm të Shoqërive Aksionere Jo të Regjistruara në Bursë publikuar nga METE dhe a keni njohuri mbi të, 63,3% janë shprehur **Jo** (19/30) dhe 0% (0/9) **N/A**.*

Kështu, për pjesën **N/A**, e cila ka lidhje me kodin e drejtimit të brendshëm të shoqërive aksionere po të analizojmë raportin horizontalisht 10/17 (nr i përgjithshëm i përgjigjeve) 58,8% e shoqërive janë informuar mbi manualin e Qeverisjes së Korporatave dhe kanë njohuri mbi të tregon që janë të informuar dhe mbi Kodin e Drejtimit të Brendshëm të Shoqërive Aksionere Jo të Regjistruara në Bursë, publikuar nga METE, 17,6% (3/17) Jo dhe 23,5% (4/17) **N/A** kanë refuzuar të përgjigjen. Ndërsa vertikalisht në lidhje me totalin, përpërgjigjet *Po*, $10/37 = 27\%$ e shoqërive të cilët janë informuar për manualin e qeverisjes së korporatave dhe kane njohuri mbi të kanë dhënë përgjigjen **Po** për pyetjen : A jeni të informuar mbi Kodin e Drejtimit të Brendshëm të Shoqërive Aksionere Jo të Regjistruara në Bursë publikuar nga METE dhe a keni njohuri mbi të, 10% **Jo** (3/30) dhe 44,4% (4/9) **N/A**.

Ndër 48% e atyre shoqërive që janë përgjigjur se kanë njohuri rreth Manualit të qeverisjes së korporatave, rreth 1/3 ose 32.4% kanë njohuri gjithashtu edhe për Kodin e drejtimit të brendshëm të Sh.a-ve që nuk janë të regjistruara në bursë.

Grafikët 1.1 dhe 1.2 shtojca 3 japin një panoramë të përgjigjeve për njohjet e manualit të qeverisjes së korporatave dhe kodit të drejtimit të brendshëm të shoqërive aksionere jo të regjistruara në bursë. Ndërsa tabela 42 në faqen pasuese 147, na jep një informacion mbi krostabulimin e pyetjeve që kanë të bëjnë me kodin e drejtimit të brendshëm dhe manualit të QK-së.

.

Tabela 42 Informacioni mbi Kodin e Drejtimit të Brendshëm dhe Manualin e Qeverisjes së Korporatave

A jeni të informuar mbi manualin e Qeverisjes së Korporatave dhe a keni njohuri mbi të ?	A jeni të informuar mbi Kodin e Drejtimit të Brendshëm të Shoqërive Aksionere Jo të Regjistruara në Bursë publikuar nga METE dhe a keni njohuri mbi të?								
		Po	%	Jo	%	N/A	%	Total	%
	Po	12	32.4%	15	40.5%	10	27.0%	37	100.0%
	%	48.0%		44.1%		58.8%		48.7%	
	Jo	8	26.7%	19	63.3%	3	10.0%	30	100.0%
	%	32.0%		55.9%		17.6%		39.5%	
	N/A	5	55.6%	0	.0%	4	44.4%	9	100.0%
	%	20.0%		.0%		23.5%		11.8%	
	Total	25	32.9%	34	44.7%	17	22.4%	76	100.0%
	%	100.0%		100.0%		100.0%		100.0%	

KAPITULLI V

ANALIZA E REZULTATEVE TË KËRKIMIT NË SHOQËRITË SHQIPTARE

A. NDJEKJA E PARIMEVE TË QEVERISJES SË KORPORATAVE SIPAS MANUALIT (KODIT TË QEVERISJES SË KORPORATAVE).

5.1. KAPITULLI I. TË DREJTAT E AKSIONERËVE

E drejta e aksionerëve për të marrë pjesë dhe për të votuar në mbledhjet e aksionerëve u njhet atyre ligjërisht dhe kompania duhet të kuptojë se mbledhjet e aksionerëve janë një mjet themelor për të ndërtuar besimin e aksionerëve në çështjet e një rëndësie thelbësore për kompanitë. Është fakt real që burimi i autoritetit të bordit janë pronarët ku në pjesën më të madhe të rasteve pronarët e shoqërisë janë aksionerët e saj, themi në pjesën më të madhe pasi dimë që në disa vende qeveria me ligj ka përcaktuar dhe punonjësit si pronarë. Theksojmë se Neni 14 (2) i ligjit “Për Shoqëritë Tregtare” thotë : “Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga ky ligj ose nga statuti, në rrethana të njëjta, ortakët dhe aksionerët gëzojnë të njëjtat të drejta, kanë të njëjtat detyrime e trajtohen në mënyrë të barabartë”. Ne lidhje me pyetjen: Cili është sipas mendimit tuaj njohja dhe mbrojtja e të drejtave të aksionerëve në përgjithësi në shoqërinë tuaj, rezulton se 27 shoqëri ose 36% kanë dhënë përgjigjen mirë ndërsa 49 shoqëri ose 64% dhanë përgjigjen shumë mirë, ndërkohë që për zgjedhjet e : *i papërshtatshëm dhe mesatar* nuk pati përgjigje. Interesi i shoqërisë nuk është interesi i aksionerëve mazhoritarë, por interesi i të gjithë aksionerëve dhe i grupeve të interesit, ku ndër më të rëndësishmit përmendim kreditorët e shoqërisë.


Grafiku 3 Opinione mbi të drejtat e aksionerëve



Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve që përfaqëson aksionerët merr vendime thelbësore, p.sh shpërndarja e përfitimeve dhe humbjeve. *Bordi i Drejtorëve* është përgjithësisht i përgjegjshëm për drejtim dhe ndjekjen e strategjive të shoqërisë dhe kontrollin e menaxherëve të shoqërisë. Ekzekutivët përfundimisht ndjekin operacionet e përditshme të tilla si : implementimi i strategjisë, biznes planeve, menaxhimin e burimeve njerëzore, zhvillimin e strategjive të marketingut dhe shitjeve si dhe menaxhimin e aseteve.

Ndërsa në lidhje me pyetjen: *Cila ka qenë frekuenca e organizimit të asamblesë së përgjithshme*, 1 shoqëri ose 1,3% (është kështu në frekuencë) është përgjigjur deri në 4 herë në vit, 2-4 herë në vit 24 shoqëri ose 32% dhe 1 herë në vit 51 shoqëri ose 67,1%. Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve, vendos për çështjet më jetike të shoqërisë si emërimi dhe shkarkimi i anëtarëve të këshillit, emërimi dhe shkarkimi i ekspertëve kontabël të regjistruar, miratimi i llogarive vjetore, shpërndarja e dividendit, ndryshimet në statutin e shoqërisë apo në aktin e themelimit, riorganizimin e shoqërisë e të tjerë.

Grafiku 4 Koha e mbledhjes së asamblesë



Cila ka qenë arsyeja për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme si organi më i lartë vendimmarrës, 52 shoqëri ose 68,4% kanë thënë Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së zhvillimit të biznesit, 1 shoqëri emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të KM-së (ose KA-së) ose 1,3%, 18 shoqëri ndryshim statuti ose

23,7% dhe 5 shoqëri ose 6,6% përcaktimin (vendosjen e politikave tregtare të shoqërisë). Grafiku 3 shtojca 3.

Ndërkohë për pyetjen - *Cili është afati i njoftimit të rendit të ditës së MPA-së*, 21 ditë përpara janë përgjigjur 14 shoqëri ose 18,4%, me pak së 21 dite 56 shoqëri ose 74%, dhe në ditën e mbledhjes 6 shoqëri ose 8 %. Grafiku 4 shtojca 3. Theksojmë se në grafik ndodhet shifra përkatëse, dhe pas presjes gjendet dhe përqindja përkatëse për të pasur një sqarim më të mirë.

Për pyetjen: *A keni pasur raste kur ka ndryshuar rendi i ditës pasi i është dërguar aksionerëve*, 55 shoqëri janë përgjigjur Po ose 72,4%, ndërsa 21 shoqëri ose 27,6% janë përgjigjur Jo. Grafiku 5 shtojca 3. Në grafik ndodhet shifra dhe pas presjes përqindja përkatëse. Në këtë mënyrë grafikët janë më sqarues.

Ndërkohë për pyetjen : *A njoftohen në mënyrë të përshtatshme të gjithë aksionerët për mbledhjen e MPA-së*, 75 shoqëri ose 99% janë përgjigjur Po dhe vetëm 1% Jo. Grafiku 6 shtojca 3.

Cila është mënyra për njoftimin e mbledhjes së MPA-së, më poshtë janë shprehur 16 shoqëri ose 21,7%, me postë elektronike 35 shoqëri ose 46,1%, me telefon 23 shoqëri ose 30,3% dhe me gazetë 2 shoqëri ose 2,6%. Grafiku 7 shtojca 3, tabela 43.

Tabela 43 Mënyra e njoftimit për mbledhjet e asamblesë

Njoftimi	Frekuenca	Përqindja
Postë	16	21.1
Postë elektronike	35	46.1
Kemi raste dhe me telefon	23	30.3
Gazetë	2	2.6
Total	76	100.0

Ndërkohë në lidhje me pyetjen, *Eksperti kontabël, nëse keni, apo auditi u vijnë në ndihmë aksionerëve për probleme apo procedura tatimore edhe gjatë vitit ushtrimor si dhe gjatë kontrolleve tatimore*, 43 shoqëri ose 57% janë përgjigjur Po, 6 kompani ose 8% Jo dhe 27 shoqëri ose 35% në raste të rralla. Grafiku 8 shtojca 3.

Për pyetjen - *A keni një strukturë të veçantë që kujdeset për mbledhjet e MPA-së (mbledhja e përgjithshme e aksionerëve), organizimet, marrëdhëniet me aksionerët,*

njoftime, sqarime etj, 4 shoqëri ose 5% kanë thënë Po dhe 72 shoqëri ose 95% kanë thënë Jo. Grafiku 9 shtojca 3.

Ndërkohë në lidhje me pyetjen : *A mendoni se ka ardhur koha që vërtet duhet një strukturë e tillë e lartpërmendur*, 75 shoqëri ose 98.7% kanë thënë Po dhe vetëm 1 shoqëri ose 1% kanë thënë Jo. Grafiku 10 shtojca 3.

Ligji u njeh mbrojtje të gjithë grupeve të interesit të shoqërisë nëpërmjet deklaratës së qeverisjes së shoqërive aksionere. Neni 134 i ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, kërkon që “shoqëritë aksionere sh.a, në raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe pasqyrat financiare vjetore duhet të përshijnë një dokument shpjegues, ku trajtohen e shpjegohen parimet e rregullat e mirëadministrimit dhe të drejtimit të brendshëm të shoqërisë dhe praktikrat që ndiqen prej saj në zbatim të dispozitave të këtij ligji”. Deklarata e miradministrimit të shoqërisë duhet të përmbajë një profil të administratorëve dhe të anëtarëve të këshillave, si dhe të shpjegojë elementët e faktet, për të cilat këta individë janë të kualifikuar për të kryer detyrat që i janë caktuar nga shoqëria. Kjo deklaratë vendoset edhe në faqen e internetit të shoqërisë. Pyetjes së pyetësorit tonë - *A përgatitet raport për qeverisjen e korporatës nga administratorët, KM (ose KA) për aksionerët e shoqërisë tuaj ?* 4 shoqëri ose 5,26% kanë thënë Po, 3 shoqëri ose 3,95% kanë thënë Jo, dhe 69 ose 90,79% janë për N/a. Grafiku 5.

Grafiku 5 Përgatitja e raporteve për qeverisjen e korporatave



Ndërkohë në lidhje me pyetjen, *Mendoni se ka ardhur koha e përgatitjes së një raporti të tillë si pjesë e materialeve të MPA-se si informacion që duhet kërkuar të përgatitet si i detyrueshëm ?* 75 shoqëri ose 99% kanë thënë në përgjigjet e tyre Po dhe 1 shoqëri ose 1% është shprehur për Jo. Grafiku 10 dhe 10.1 shtojca 3.


Në lidhje me pyetjen: *Cilat janë informacionet që shfrytëzohen nga aksionerët dhe që duhet t'u vihet në dispozicion atyre*, kemi përgjigjet: *Raporti i organit mbikëqyrës (organi mbikëqyrës, audituesi i brendshëm)*, shfrytëzohet nga 68 shoqëri ose 89,47% e shoqërive, ndërkohë vetëm 8 shoqëri ose 10,53% janë shprehur raporti i audituesit të jashtëm (ose ekspertit kontabël). Grafiku 11 shtojca 3.

5.2 KAPITULLI II. ROLI I AKTORËVE NË PRAKTIKAT E QEVERISJES SË SHOQËRISË.

Roli i aktorëve në krijimin e pasurisë po njihet gjithmonë e më tepër. Kapitali njerëzor po bëhet një burim kryesor i sigurimit të avantazhit konkurrues për shoqëritë në një numër sektorësh të ekonomisë. Në shumë raste janë punonjësit dhe njohuritë e tyre që përbëjnë asetet më të vlefshme të kompanive. Bordet dhe menaxherët duhet ti ndajnë mirë përgjegjësitë ndërmjet organeve të ndryshme të shoqërisë për sa i takon marrëdhënjëve me aktorët. Informimi i vazhdueshëm i punonjësve mbi çështjet që mund ti prekin, mund të ndihmonte dukshëm në krijimin e një perceptimi mbi qëllimin e përbashkët (OECD 2003, White Paper). Marrëdhënja juridike duke nënshkruar kontrata padyshim përbën një pikë të rëndësishme.

Në lidhje me pyetjen: *A keni nënshkruar kontrata të rregullta me punonjësit*, 62 shoqëri ose 82% kanë deklaruar Po, në raste të veçanta 11 ose 14% dhe 3 kompani ose 4% kanë thënë Jo. Grafiku 6.

Grafiku 6 Nënshkrimi i kontratës me punonjësit



Ndërsa në lidhje me pyetjen: *Keni pasur procese të ndryshme në 2 vitet e fundit dhe çfarë konkretisht, përgjigjet e dhëna janë* : 59 shoqëri ose 77,63% deklarojnë se kanë procese gjyqësore, 2 shoqëri ose 2,63% tregojnë se kanë pasur procese në organe të ndryshme shtetërore, 13 shoqëri ose 17,10% tregojnë në organe përmbarimore dhe

2,63% ose 2 shoqëri shprehen në asnjërën prej tyre dhe 0 shoqëri në organin e akuzës, prokurorisë. Grafiku 12 shtojca 3.

Tabela 44 Proçeset gjyqësore

Proceset	Frekuenca	Përqindja
Punonjësit	61	80.3
Furnitorët	10	13.2
Kreditorët	1	1.3
Ish pronarët	4	5.3
Total	76	100.0

Ndërkohë në lidhje me pyetjen: *Me cilin nga aktorët e mëposhtëm në 2 vitet e fundit ka pasur proces të hapur shoqëria*, me punonjësit rezultojnë 61 shoqëri ose 80.3% e totalit të shoqërive, me furnitorët 10 ose 13.2%, me kreditorët 1, ose 1.3% dhe me ish pronarët 4 ose 5.3% ndërsa me asnjërin përgjigja është 0. Tabela 44, Grafiku 13 shtojca 3.


Ndërkohë në lidhje me pyetjen, *Sa kohe ju duhet që të zgjidhni një konflikt gjyqësor me një aktor të caktuar*, 36 shoqëri ose 47% tregojnë mbi 4 vite, 3-4 vite 26 shoqëri ose 34%, 1-3 vjet, 14 shoqëri ose 19%, dhe 0-1 vit kemi përgjigjen 0. Grafiku nr 14 dhe 14.1 shtojca 3. Për pyetjen- *A informohen rregullisht punonjësit mbi vendimmarrje të rëndësishme dhe mbi gjendjen në të cilën ndodhet shoqëria*, 51 shoqëri ose 67% shprehen normal, 22 shoqëri ose 29% shprehen plotësisht, 3 shoqëri ose 4% shprehen pak. Grafikët 15 dhe 15.1 shtojca 3. Pyetjes : *Si mendoni mbi procedurën e falimentimit në gjykatë*, asnjë shoqëri nuk mendon se është e shkurtër në kohë si procedurë, apo e shkurtër koha e hapjes nga kërkesa, apo me kosto të pranueshme, 34 shoqëri ose 45% mendojnë se është e gjatë në kohë si procedurë, 10 shoqëri ose 13% mendojnë se është e gjatë koha e hapjes nga kërkesa, 20 shoqëri ose 26% mendojnë se është me kosto të lartë dhe 12 shoqëri ose 16% janë shprehur për mospasje dijeni për sa shprehur në pikat e lartpërmendura. Grafikët 16 dhe 16.1 shtojca 3.

5.3. KAPITULLI III. TRANSPARENCA DHE ZBULIMI

Transparenca dhe zbulimi përbëjnë një nga shtyllat qendrore të qeverisjes së efektshme në një shoqëri aksionere dhe të funksionimit të tregut të kapitaleve. Transparenca dhe

zbulimi përbëjnë gjithashtu një bllok të qëndrueshëm për monitorimin e kompanive mbi bazat e tregut. Duhet theksuar se bursat kanë rënë dakort mbi baza vullnetare për të zbatuar standarde më të larta zbulimi. Detyrimet e zbulimit nuk zbatohen njesoj dhe besueshmëria e informacionit të bërë publik mbetet një çështje kryesore siç është p.sh publikimi i raporteve vjetore. Raportet vjetore përgatiten duke ndjekur standardet kombëtare financiare (madje seicili vend ashu sikurse Shqipëria ka të vetat) megjithatë nënkuptohet që ato duhet të jenë në përputhje me IFRS-të pasi standartizimi në pasqyra të unifikuara mund të bëhet shpejt (siç veprojnë bankat, sh.a-të me qarkullim të lartë etj). Në funksion të garantimit të një certifikimi të vërtetë dhe të saktë, Ligji Nr. 10091, datë 05.03.2009, “Për auditimin e detyrueshëm, rregullimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar” ka parashikuar rregulla në lidhje me certifikimin e llogarive vjetore të shoqërisë. Komiteti i certifikimit të llogarive vjetore (komiteti i auditimit) duhet të ketë detyra të sakta të përcaktuara në rregulloren e ushtrimit të aktivitetit të tij dhe duhet të jetë përgjegjës, ndërmjet të tjerash, për monitorimin e efektivitetit të kontrollit të brendshëm të shoqërisë, sistemet për menaxhimin e riskut, auditimin statutor të llogarive vjetore dhe për pavarësinë e ekspertëve kontabël të regjistruar. Mbështetur në pyetësin tonë, në lidhje me *çështjet që bëhen publike nga shoqëria*, 62 shoqëri ose 81,6% kanë thënë rezultatet financiare dhe operative. Aksionerët dhe struktura e pronësisë 6 shoqëri ose 7,9%, struktura e qeverisjes dhe politikat 5,26% ose 4 shoqëri, 3,95 ose 3 shoqëri politikat e shoqërisë lidhur me biznesin e saj dhe 1,31% ose 1 shoqëri objektivat, organizimi (misioni, vizioni). Grafiku 7.

Grafiku 7 Çështjet që bëhen publike



Për pyetjen - *Nëse i gjithë informacioni nuk publikohet i plotë cilat janë pengesat për të mos e bërë një gjë të tillë kemi këto përgjigje ndarë në frekuenca dhe përqindje*, Tabela 45 grafiku 17 shtojca 3.

Ndërkohë për pyetjen : *A keni pasur raste ku eksperti kontabël, nëse keni, ka mbajtur përgjegjësi në 5 vitet e fundit, nëse jeni penalizuar nga organet tatimore*, Po, janë shprehur 9 shoqëri ose 11,8%, Jo, 46 shoqëri ose 60,5%, nuk kam dijeni, 21 shoqëri ose 27,6% e tyre. Grafiku 18 shtojca 3.

Tabela 45 Pengesat për publikimin e informacionit

Pengesat	Frekuenca	Përqindja
Nuk ka një deryrim ligjor	17	22.4
Është proces i kushtueshëm	2	2.6
Nuk ka kërkesa për të dhënë të gjithë informacionin	12	15.8
Ruajtja e konfidencialitetit për të dhënë informim	23	30.3
Nuk lejohet enkas nga drejtuesit	22	28.9
Total	76	100.0

Sinonim i qeverisjes është të kontrollosh. Titullarët e organizatave (veçanërisht ata të sektorit publik) janë përgjegjësitar primar për të mirëmbajtur sistemin e kontrollit të brendshëm. Audituesit e brendshëm duhet të vlerësojnë dhe rishikojnë sistemin e menaxhimit të risqeve dhe efektivitetin e sistemeve të kontrolleve të brendshme duke përmbushur standardet e QK.

Në lidhje me pyetjen- *Si paraqiten tarifat e auditimit të ekspertit në 2 vitet e fundit?* Normal, rritur shume pak dhe rritur pak janë shprehur 7 shoqëri ose 9,2% dhe pa ndryshime 55 shoqëri ose 72,4%. Grafiku 19 shtojca 3. Ndërkohë në lidhje me pyetjen e pyetësorit - *Cilët mendoni se janë faktorët që ndikojnë në cilësinë e shërbimit të auditimit?*

Cilësia e stafit të audituesve ka marrë përgjigjen e 50 shoqërive ose 65,8%, pavarësia dhe integriteti ka marrë përgjigjen e 6 shoqërive ose 7,9%, konkurrenca nga 18 shoqëri ose 23,7%, performanca e lartë e firmës audituese nga 2 shoqëri ose 2,6%. Tabela 46 Grafiku 20 shtojca 3 e punimit.

Tabela 46 Faktorët që ndikojnë në cilësinë e shërbimit të auditit

Faktorët	Frekuenca	Përqindja
Cilësia e stafit dhe audituesve	50	65.8
Pavarësia dhe integriteti	6	7.9
Konkurrenca	18	23.7
Performanca ekonomike e firmës audituese	2	2.6
Total	76	100.0

Sipas ligjit ‘Për Kontabilitetin’, Nr. 9228, datë 29.04.2004, i ndryshuar, pasqyrat financiare duhet të pasqyrojnë me vërtetësi dhe besueshmëri gjendjen financiare, performancën, ndryshimet në gjendjen financiare dhe rrjedhjen e parasë së njësive ekonomike.⁷ Ligji “Për auditimin e detyrueshëm, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, i cili në Nenin 41 të tij rendit shoqëritë aksionere të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit. Ndërkohë në lidhje me pyetjen: *Si gjykoni rolin që mund të luajë media në drejtim të informimit mbi veprimtarinë e shoqërive dhe në parandalimin e abuzimeve*, për pjesën nuk është i nevojshëm dhe pak i nevojshëm janë shprehur 0 shoqëri, me ndikim janë shprehur 28 shoqëri, ose 36,8% dhe me shumë ndikim 63,2% ose 48 shoqëri. Grafikët 21 dhe 21.1 shtojca 3 e punimit. Në Ligjin Nr.10091 dt.05.03.2009 “Per auditin ligjor” nenet 45 e 46 ngarkojnë ekspertët kontabël që në rastin e shoqërive të listuara në bursë, bankave dhe shoqërive të sigurimit që brenda 3 muajve nga mbyllja e vitit të botojnë në faqen zyrtare të internetit një raport mbi transparencën që duhet të përmbajë përshkrimin e strukturës, informacionin financiar etj.

5.4 KAPITULLI IV. ROLI DHE PËRGJEGJËSIA E KËSHILLAVE MBIKËQYRËS

Këshilli mbikëqyrës sipas Ligjit “Për Shoqëritë Tregtare” është në funksion jo vetëm të


⁷ Neni 9, ligji Nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin”, i ndryshuar.

aksionerëve të shoqërisë që investojnë paratë e tyre, por ai vepron për të mbrojtur një interes më të gjerë, duke përfshirë edhe interesin e kreditorëve, punëmarrësve dhe shoqërisë në tërësi. Anëtarët e këshillit emërohen nga asambleja e përgjithshme e aksionerëve. Këshilli përbëhet nga një numër anëtarësh i cili nuk mund të jetë më shumë se 21 dhe më pak se 3. Përveç këtij kushti, ligji përcakton se shumica e anëtarëve duhet të jenë të pavarur. Neni 155 (1) detyrimisht kërkon: “Këshilli i administrimit përbëhet nga të paktën tre apo një numër më i madh, por jo më shumë se 21 anëtarë. Anëtarët janë individë, shumica e të cilëve duhet të jenë të pavarur dhe të ndryshëm nga administratorët e shoqërisë.”

Në lidhje me pyetjen: *Si bëhet zgjedhja ose emërimi i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës kemi* : sipas përcaktimeve të statutit (ne momentin e krijimit të Sh. a-së) janë përgjigjur 71 shoqëri ose 93,4%, zgjedhje të lirë të asamblesë 5 shoqëri ose 6,6%, ndërsa me vendim të aksionerëve kontrollues dhe me emërim të veçantë përgjigjet ishin 0. Grafiku 22 shtojca 3.

Ndërkohë në lidhje me pyetjen *Cila është denduria e mbledhjeve të KM në vit?* Kemi këtë ndarje: 1 herë në vit 48% ose 37 shoqëri, 1 herë në 3 muaj 34% ose 26 shoqëri, çdo muaj 1 shoqëri ose 1% dhe çdo 6 muaj 12 shoqëri ose 16%. Grafiku 8.

Grafiku 8 Denduria e mbledhjeve të organizuara



Ndërsa për pyetjen: *Sa kohë më përpara marrin njoftim rreth mbledhjes anëtarët e këshillit mbikëqyrës (ose KA-së),* 1 ditë përpara mbledhjes 4 shoqëri ose 5,3%, 1 javë përpara 35 shoqëri ose 46,1%, deri 2 javë para 18 shoqëri ose 23,7% dhe më shumë se 2

javë para 19 shoqëri ose 25%. Grafiku 23 shtojca 3. Pyetjes : *Cilat nga materialet e mëposhtme u jepen anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës për shfrytëzim në mbledhje?* të anketuarit i janë përgjigjur si më poshtë (tabela 47), grafiku 24 shtojca 3.

Tabela 47 Materialet e mbledhjes

Përmbajtja e materialeve	Frekuenca për secilën përgjigje	Përqindja e secilës përgjigje
Axhenda e mbledhjes së bordit	76	100
Shpjegime për çdo pike të rendit të ditës	65	85.5
Draft vendimet që do të merren	61	80.2
Pasqyrat financiare për periudhën më të fundit raportuese	62	81.5
Parashikimet e ecursisë së veprimtarisë së Sh.a-së	10	13.15
Mendime mbi strategjinë e biznesit, financës dhe marketingut.	10	13.15
Total	76 shoqëri	

Nga përgjigjet rezulton se axhenda e mbledhjes, shpjegimet për çdo pikë të rendit të ditës si draft vendimet që do të merren dhe pasqyrat financiare për periudhën më të fundit raportuese janë ndër materialet më kryesore që zënë përqindjen më të madhe që u jepen anëtarëve të këshillit. Këshilli i shoqërisë duhet të sigurojë që administratorët të hartojnë rregullisht llogaritë vjetore të shoqërisë apo çdo raport tjetër lidhur me performancën e shoqërisë që kërkohet nga ligji apo nga statuti. Këshilli i miraton llogaritë vjetore të hartuara nga administratorët, përpara se ato të paraqiten për miratimin final nga asambleja e përgjithshme.

Ndërkohë pyetjes : *Si është organizuar raportimi i drejtuesve të shoqërisë tek Këshilli Mbikëqyrës?* Çdo muaj dhe të paktën çdo tre muaj përgjigjet janë 0 dhe për pjesën tjetër të përgjigjeve e kemi tabelën e frekuencave dhe përqindjeve ku 32.9% kanë thënë për të paktën 1 herë në vit. Tabela 48, grafiku 25 shtojca 3.

Tabela 48 Koha e raportimit tek drejtuesit e shoqërisë

Koha/ndarja	Frekuenca	Përqindja
Të paktën 1 herë në vit	25	32.9
Përpara çdo mbledhje të KM-së.	21	27.6
Nuk kemi një programim të tillë për raportim	18	23.7
Në rastë se kërkon vetë këshilli mbikëqyrës	12	15.8
Total	76	100.0

Në lidhje me pyetjen se : *Cilat janë kriteret për emërimin e administratorit ose administratorëve apo menaxherëve*, 53 shoqëri ose 69,7% shprehen për nivelin e shkollimit dhe të kualifikimit të kandidatit, 4 shoqëri ose 5,3% kualifikimet profesionale në përgjithësi dhe në fushën e veprimtarisë së sh.a-së në veçanti, përputhja e kualifikimit me veprimtarinë e shoqërisë, 8 shoqëri ose 10,5% dhe afriteti me aksionerët 11 shoqëri ose 14,5%.Grafiku 26 shtojca 3.

5.5 KAPITULLI V. DETYRIMI DHE ZBATIMI

Ky është ndër kapitujt më të rëndësishëm në kuadrin e zbatimeve të parimeve të qeverisjes së korporatave. Për pyetjen : *Si e gjykoni rolin e institucioneve shtetërore të cilët nëpërmjet zbatimit të legjislacionit ndikojnë dhe në qeverisjen e korporatave*, kemi tabelën e mëposhtme të frekuencave dhe përqindjeve. Tabela 49, grafiku 27 shtojca 3.

Tabela 49 Roli i institucioneve shtetërore lidhur me zbatimin e legjislacionit

Roli/ndarja	Frekeunca	Përqindja
Jo të përshtatshëm	8	10.5
Të ulët	12	15.8
Të mirë	4	5.3
Shumë të mirë	1	1.3
Mesatare	51	67.1
Total	76	100.0


Ndërkohë në lidhje me pyetjen *Si i gjykoni procedurat gjyqësore nëse është përfshirë eventualisht shoqëria juaj*, për përgjigjet e dhëna nga respondentët kemi tabelën e mëposhtme të frekuencave dhe përqindjeve. Tabela 50, grafiku 28 shtojca 3.

Si e vlerësoni rolin e auditit të brendshëm, në mirëfunksionimin e shoqërisë? janë përgjigjur pa ndikim 1 shoqëri ose 1,3% e tyre, me ndikim të ndjeshëm 6 shoqëri ose 7,9% e tyre, deri diku 5 shoqëri ose 6,6% e tyre, të efektshëm 64 ose 84.2% e tyre. Grafiku 29 shtojca 3.

Tabela 50 Gjykimi mbi procedurat gjyqësore

Gjykimi/ndarja	Frekeunca	Përqindja
Pak të përshtatshme	28	36.8
Me ndikim të ndjeshëm	2	2.6
Të kushtueshme	11	14.5
Të gjata në kohë	27	35.5
Nuk kemi proces gjyqësor	8	10.5
Total	76	100.0

Grafiku 9 Gjykimi mbi vendimet e dhëna nga organet e drejtësisë



Si i gjykoni sipas këndvështrimit tuaj vendimet e dhëna nga organet e drejtësisë për shoqërinë tuaj? Jo të drejta janë përgjigjur 28 shoqëri ose 36,8% e tyre, deri diku të

drejta 4 shoqëri ose 5,3% e tyre, duhet të ishin më objektivë 17 shoqëri ose 22.4% e tyre, të drejta 19 shoqëri ose 25% e tyre dhe nuk kemi proces gjyqësor ndaj dhe nuk gjykojmë dot janë përgjigjur 8 shoqëri ose 10,5% e tyre. Tabela 50 dhe Grafiku 9.

Pyetjes së pyetësorit : *Si e gjykoni sipas këndvështrimit tuaj sistemin e drejtësisë* : shumë mirë janë përgjigjur 4 shoqëri ose 5,3% e tyre, të mire 1 shoqëri ose 1,3% e tyre, mesatar 60 shoqëri ose 78,9% e tyre, jo të mirë dhe me elementë korrupsioni 6 shoqëri ose 7,9% e tyre, të korruptuar 5 shoqëri ose 6.6% e tyre. Grafiku 30 shtojca 3.

5.6 KAPITULLI VI- PYETJET E FUNDIT. NJOHJET, VLERËSIMET, POLITIKAT DHE PENGESAT NË KUADRIN E Q.K.

Në lidhje me pyetjen e kësaj pjese : *A janë zyrtarët kryesorë të shoqërisë të familjarizuar me praktikën e qeverisjes së korporatave të vendeve të OECD-së?* 21 shoqëri respondente ose 27,6% kanë theksuar po, ndërsa jo kane thënë 10 shoqëri ose 13,2% aq sa është e nevojshme 45 shoqëri ose 59,2%.Grafiku 31 shtojca 3.


Si e gjykoni pjesën në Ligjin Për Shoqëritë Tregtare që rregullon veprimtarinë e shoqërive anonime? Jo të përshtatshëm janë përgjigjur 3 shoqëri ose 3,9%, mesatar 28 shoqëri ose 36,8%, të mire 27 shoqëri ose 35,5%, shumë të mirë 18 shoqëri ose 23,7%.Grafiku 32, shtojca 3.

Ndërkohë në lidhje me pyetjen : *Cilat janë qëllimet kryesore që duhet të arrijë sistemi i qeverisjes në shoqërinë tuaj,* nga përgjigjet veçojmë se 57 shoqëri ose 75% janë shprehur për rritje të eficiencës në veprimtarinë e shoqërisë (grafiku 33 shtojca 3).

Pyetjes : *Sipas mendimit tuaj cilat mund të jenë pengesat për një qeverisje efektive të korporatës tuaj?* Për mungesë informacioni/njohurish janë shprehur 71 shoqëri ose 93,4% e tyre, mungesë specialistësh të kualifikuar 4 ose 5,3% e tyre, informacioni për çështjet e qeverisjes së sh. a-ve jep informacion shume për konkurrencën 1 shoqëri ose 1,3%. Ndërsa legjislacioni i mangët mbi Sh.a-të dhe shpenzimi i burimeve për çështjet e qeverisjes së Sh.a-së nuk sjell asnjë përfitim kanë pasur përgjigjen 0. Grafiku 10.Ndërkohë më poshtë le të shohim një grup tjetër pyetjesh të kërimit të realizuar nëpërmjet pyetësorit.

A ka në shoqërinë tuaj rregullore për secilin organ të saj dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre? Po janë përgjigjur 7 shoqëri ose 9,2% e tyre, Jo 38 shoqëri ose 50% dhe N/a 31 shoqëri ose 40,8% e tyre. Grafiku 34 shtojca 3.

Grafiku 10 Pengesat e një qeverisje efektive



A keni nevojë për trajnim dhe konsulencë mbi çështjet e përmirësimit të qeverisjes së shoqërisë (sh.a-së tuaj)? Po, kanë thënë 66 shoqëri gjithësej ose 86,8% e këtyre shoqërive, Jo 10 shoqëri ose 13,2% e tyre. Grafiku 35 shtojca 3. Ndërkohë për pyetjen :A mendoni se shoqëria duhet të planifikojë fonde për trajnim dhe konsulencë në fushën e qeverisjes së korporatave, 69 shoqëri ose 90,8 % janë shprehur Po, 7 shoqëri ose 9,2% janë shprehur Jo. Grafiku 36 shtojca 3.

A mendoni se ka ardhur koha për listim në bursë të shoqërisë tuaj dhe shoqërive tregtare në përgjithësi? Po janë përgjigjur gjithësej 39 shoqëri ose 51,3%, Jo kanë thënë 8 ose 10,5% dhe duhet edhe pak kohë 29 shoqëri ose 38,2% e shoqërive. Grafiku 37 shtojca 3. Ndërsa për pyetjen Nëse po, jepni vlerësim rreth pengesave për të bërë një gjë të tillë ndër përgjigjet 53 shoqëri ose 69,7% janë shprehur për mungesë të traditës (janë shprehur me rezerva). Grafiku 38 shtojca 3.

A ka caktuar shoqëria zyrtarisht një individ, për shembull një sekretar të korporatës (shoqërisë tregtare)? Po kanë thënë 41 shoqëri ose 53,9% dhe jo 35 shoqëri ose 46,1%. Grafiku 39 shtojca 3. Ndërkohë për pyetjen : A është i nevojshëm dhe a duhet të përgjigjet proceduralisht për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme të aksionerëve në

kuadër të QK? Përgjigjet janë : 75 shoqëri janë përgjigjur Po ose 98.7% dhe 1 shoqëri ose 1,3%, Jo. Grafiku 40 shtojca 3.

A keni krijuar një komitet të këshillit drejtues apo strukturë ose organ tjetër për të mbikëqyrur politikat e qeverisjes së shoqërisë? Po janë përgjigjur 8 shoqëri ose 10,5% e tyre, Jo janë përgjigjur 15 shoqëri ose 19,7% e tyre, dhe për pyetjen një komitet i tillë është i nevojshëm në çdo shoqëri, janë përgjigjur 53 shoqëri gjithësej ose 69,7% e tyre. Grafiku 41 shtojca 3 e punimit.

A mbani rregullore të qeverisjes dhe kod etik për të bërë më transparente strukturat e qeverisjes për të ndihmuar organet dhe konsulentët që të jenë më të qartë mbi të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella? 12 shoqëri ose 15,8% janë përgjigjur Po, ndërsa Jo janë përgjigjur 64 shoqëri ose 84,2%. Grafiku 42 shtojca 3. *Nëse jo, mendoni t'i mbani në të ardhmen në shoqërinë tuaj?* 57 shoqëri ose 75% janë përgjigjur Po, 5 N/A, ose 6,6% dhe 14 shoqëri ose 18,4%, duhen mbajtur dhe duhen kuptuar. Ndërsa Jo nuk është përgjigjur asnjë shoqëri. Grafiku 43 shtojca 3.

Për pyetjen: *A mendoni së duhet kuptuar nga të gjithë drejtorët dhe drejtuesit ekzekutiv kryesorë koncepti i qeverisjes së korporatave dhe rëndësia e tij për shoqërinë dhe aksionerët në kuadrin edhe të krizës financiare globale?*, 69 shoqëri janë përgjigjur Po, ose 90,8%, 0 shoqëri Jo dhe N/A janë përgjigjur 7 shoqëri ose 9,2% e totalit të shoqërive. Grafiku 44 shtojca 3.

Në lidhje me pyetjen: *A mendoni se baza ligjore e Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentit ku përfshihen dhe standardet kombëtare të masës së falimentit do ju vinin në ndihmë në kushtet e krizës financiare ku rreziku për shoqëritë për falimentim është i madh?* 70 shoqëri ose 92,1% janë për Po, Jo janë përgjigjur 0 shoqëri ,ndërsa 6 shoqëri janë përgjigjur N/A, që përfaqësojnë 7,9% të tyre, konkretisht të totalit. Grafiku 45 shtojca 3.

Sipas informacionit tuaj, A ka zhvilluar këshilli administrativ apo administratorët një politikë dhe plan për të përmirësuar praktikën e qeverisjes së korporatës dhe a janë ndërmarrë hapat e duhur për të zbatuar këtë plan? Po kanë thënë 31 shoqëri ose 41% e tyre, Jo 27 kompani ose 35% e tyre, N/A 18 shoqëri ose 24% e tyre. Grafiku 11.

Grafiku 11 A ka plan KM për politikat e qeverisjes së korporatave?



Sipas mendimit tuaj, me njohuritë që keni, në cilin stad ndodhet qeverisja e korporatave në Shqipëri në krahasim me vendet e tjera në Evropën Juglindore apo vende të tjera në tranzicion? Për këtë pjesë ndër përgjigjet e dhëna, 30 shoqëri ose 39,5% e tyre shprehen në hapat e para. Tabela 51, grafiku 46 shtojca 3.

Tabela 51 Niveli i qeverisjes së korporatave në Shqipëri

	Frekuenca	Përqindja
Të ulët	20	26.3
Mesatar	19	25.0
Në hapat e para	30	39.5
Nuk kam njohuri	7	9.2
Total	76	100.0

5.7 VII. ZBATIMI I PARIMEVE TË DREJTIMIT TË BRENDSHËM PËR SHOQËRITË JO TËREGJISTRUARA NË BURSË, POLITIKAVE PËR MBROJTJEN NGA RISKU I KRIZËS DHE MANUALI PËR QEVERISJEN E BIZNESIT FAMILJAR.

Zbatimi i këtyre parimeve e bën këtë kapitull vërtetë të rëndësishëm në kërkimin tonë në kuadrin e qeverisjes së korporatave. Shoqëritë kanë dhënë përgjigje të ndryshme. Le ti

shohim më konkretisht : Për pyetjen : *Kuadri themelues dhe drejtues i cili është dhe kuadri bazë i drejtimit të brendshëm është konsultuar me të gjithë grupet e interesit, sidomos punëmarrësit ku korniza themeluese duhet të marrë për bazë dhe përgjegjësitë sociale (për shembull nëpërmjet statutit dhe akteve të tjera normative)?* Po kanë thënë 33 shoqëri ose 43,4%, Jo 5 shoqëri ose 6,6%, N/A 38 shoqëri ose 50% e tyre. Grafiku 47 shtojca 3. Ndërkohë për pyetjen : *A ka vendosur këshilli mbikëqyrës ose administrimit (më poshtë do i themi këshilli) objektiva strategjike dhe të sigurojë burimet financiare dhe njerëzore që shoqëria ti arrijë objektivat e veta?* ndër përgjigjet kemi : 37 shoqëri ose 48,7% e tyre janë përgjigjur Po. Grafiku 48 shtojca 3. Ndërkohë në lidhje me pyetjen: *A ka vendosur këshilli standardet e shoqërisë, të kujdeset që të kuptohen si dhe të përmbushen detyrimet kundrejt aksionerëve dhe grupeve të tjerë të interesit?* Ndër përgjigjet kemi: 49 shoqëri ose 64,5% e tyre janë përgjigjur Po. Grafiku 49, shtojca 3.

A është përfshire këshilli në procesin e zhvillimit strategjik dhe të paktën të aprovojë strategjinë dhe të kujdeset që strategjia të jetë brenda interesave të aksionerëve? Po, janë përgjigjur 49 shoqëri ose 64,5%, Jo 18 shoqëri ose 23,7% dhe N/A 9 shoqëri ose 11,8% e totalit të shoqërive që janë përgjigjur. Grafiku 50, shtojca 3.

Ndërsa në lidhje me pyetjen: *A ka një evidencë zyrtare në të cilën shprehet se cila çështje i përket vendimmarrjes së këshillit dhe cilat duhet tu delegohen administratorëve si dhe për diskutimet e hapura që do mbahen në këshill?* 44 shoqëri ose 57,9% janë përgjigjur Po, ndërsa Jo janë përgjigjur 20 shoqëri ose 26,3% dhe N/a 12 ose 15,8% e tyre. Grafiku 51 shtojca 3.

Për pyetjen: *A keni të parashikuar në kodin etik, nëse keni, se çfarë pret shoqëria tregtare në lidhje me standardet e shërbimeve për klientët, konfliktin e interesit, ndershmëri në punë, dhuratat apo trajtimin me përparësi lidhur me furnitorët, klientët?* Po janë përgjigjur 20 shoqëri ose 26,3% e tyre, Jo, 18 shoqëri ose 23,7 %, nuk kemi kod etik 17 shoqëri ose 22,4% dhe N/a 21 shoqëri ose 27,6% e shoqërive. Grafikët 52 dhe 52.1, shtojca 3. Në lidhje me pyetjen : *Mbledhjet e këshillit a organizohen në atë mënyrë që të maksimizojnë kontributin e anëtarëve, ku çdo anëtar të marrë pjesë aktive në vendimmarrje të bazuar në informata?* 75 shoqëri ose 98,7% e tyre janë përgjigjur Po dhe 1 shoqëri ose 1,3% Jo. Grafiku 53, shtojca 3. Në lidhje me pyetjen : *Nivelet e shpërblimit të punës a janë të mjaftueshme për të tërhequr e mbajtur anëtarët*

administratorë dhe jo administratorë të këshillit me cilësitë e nevojshme për ta drejtuar me sukses shoqërinë? Nga përgjigjet e dhëna kemi : 47 shoqëri ose 61,8% e tyre janë përgjigjur Po, 7 shoqëri janë përgjigjur Jo dhe 22 shoqëri duhen më të larta. Grafiku 54 shtojca 3.

Pyetjes në lidhje me anëtarët jo administratorë, konkretisht: *A keni në këshillin tuaj anëtarë jo administratorë me kohë të pjesshme apo anëtarë të pavarur të këshillit për të ofruar opionencë konstruktive dhe të ndihmojnë në hartimin e propozimeve për strategjinë?* Po, është përgjigjur 1 shoqëri ose 1,3% dhe Jo 75 shoqëri ose 98,7% e tyre. Grafiku 55 shtojca 3. Në lidhje me pyetjen e bërë për identifikimin e risqeve: *A ka identifikuar risqet kryesore strategjike dhe operative përpara të cilave mund të ndodhet shoqëria tregtare, ku kontrolli brendshëm dhe raportimi financiar janë primare?* Kështu për Po, janë përgjigjur 28 shoqëri ose 36,8% e tyre, 32 shoqëri Jo ose 42,1% e tyre dhe 16 N/a ose 21,1% e tyre. Grafiku 56 shtojca 3 e punimit.

Ndërkohë për pyetjen: *A qëndron në kontakt këshilli me mendimin e aksionerëve qoftë dhe me mjete elektronike komunikimi?* 41 shoqëri ose 53,9% kanë thënë Po, dhe 35 shoqëri Jo ose 46,1%. Grafiku 57 shtojca 3. *A janë të përfshirë në formim profesional anëtarët e këshillit, formim i cili ua rrit në mënyrë specifike funksionin e tyre si anëtarë të këshillit të administrimit të shoqërisë tregtare?* 32 janë përgjigjur Po ose 42,1%, Jo 8 shoqëri ose 10,5% dhe N/a 36 shoqëri ose 47,4% e tyre. Grafiku 58 shtojca 3.

A keni mekanizma familjarë, nëse keni biznes të tillë, të drejtimit të brendshëm, për shembull një dokument themelues ose protokoll familjar ku të parashtrohen vizioni dhe objektivat që mund të ketë për firmën familja si dhe të përcaktohen rolet e organeve të drejtimit të brendshëm të biznesit të familjes dhe marrëdhëniet e tyre me këshillin? 3 shoqëri janë përgjigjur Po ose 3,9%, Jo 73 shoqëri ose 96,1%. Grafiku 59 shtojca 3.

A i ushtron i njëjti person rolin e kryetarit të këshillit dhe administratorit? Po, janë përgjigjur 4 shoqëri ose 5,3%, Jo kanë thënë 72 shoqëri ose 94,7%. Grafiku 60 shtojca 3.

A duhet të emërohet nëse nuk keni, një kryetar i pavarur i këshillit si masë e përkohshme, psh administratori (ose pronari themelues i shoqërisë tregtare ose kryefamiljari)? Për Po, janë shprehur 59 shoqëri ose 77,6% e tyre dhe nuk është e nevojshme për momentin 17 ose 22,4% e tyre. Grafiku 61 shtojca 3.

Meqenëse shumica e ndërmarrjeve të mëdha sipas parimeve mund të ketë nevojë për komitete për përmbushjen e detyrave, për shembull komitetin e pagave, komitetin e auditimit, të respektimit të detyrimeve etj, mendoni ti bëni këto komitete?, Po janë përgjigjur 68 shoqëri ose 89,5% dhe N/A 8 shoqëri ose 10,5%.Grafiku 12.

Grafiku12 Mendoni të krijoni komitete?



Mendoni të keni, në raste se nuk keni të tillë, anëtarë jo administratorë dhe të pavarur të këshillit për oponencë konstruktive që gjithashtu të ndihmojnë në hartimin e propozimeve për strategjinë? Po, kanë thënë 71 shoqëri ose 93,4% e tyre, dhe kemi anëtarë të tillë, 5 shoqëri ose 6,6% e tyre. Grafiku 62 shtojca 3.

A kryen këshilli një vlerësim periodik të performancës së vet dhe të performancës së çdo anëtari të tij? Po, janë përgjigjur 32 shoqëri ose 42,1% e tyre, Jo, janë përgjigjur 20 shoqëri ose 26,3% e tyre dhe N/a, 24 shoqëri ose 31,6% e tyre. Grafiku 63 shtojca 3.

A paraqet këshilli një analizë vlerësuese të ekuilibruar dhe të kuptueshme, të gjendjes dhe të ardhmes së shoqërisë tregtare për grupet e interesit dhe të krijojë një program të përshtatshëm për angazhimin e grupeve të interesit? Po janë përgjigjur 40 shoqëri ose 52,6% e shoqërive, Jo janë përgjigjur 18 shoqëri 23,7% e tyre dhe gjithashtu 18 shoqëri për pjesën N/A 23,7% e tyre. Grafiku 64 shtojca 3.

A publikon Këshilli një raport vjetor i cili tu përshtatet nevojave të aksionerëve dhe grupeve të tjera të interesit, duke përfshirë dhe punëmarrësit, kreditorët dhe publikun e gjerë? Po janë përgjigjur 31 shoqëri ose 40,8%, Jo janë përgjigjur 33 shoqëri ose 43,4%

dhe N/A 12 shoqëri ose 15,8% e totalit të shoqërive që janë përgjigjur. Grafiku 65 shtojca 3.

Nëse publikon a përmban ai një përmbledhje të strategjisë tregtare të shoqërisë dhe të risqeve të mundshme që e shoqërojnë këtë strategji si dhe deklaratën e parimeve të drejtimit të brendshëm të shoqërisë tregtare si dhe shkallën me të cilën e ka respektuar kodin specifik të drejtimit të brendshëm? Po janë përgjigjur 26 shoqëri, ose 34,2%, Jo janë përgjigjur 4 shoqëri ose 5,3%, në një të ardhme të afërt 46 shoqëri ose 60,5%. Grafiku 66 shtojca 3.

Mendoni se një qeverisje korporate larg praktikave më të mira sjell pozita financiare jo të mira të shoqërisë tuaj por dhe indirekt të ekonomisë (pra është një faktor ndikues)? Po janë përgjigjur 54 shoqëri ose 71,1%, Jo janë përgjigjur 7 shoqëri ose 9,2% e tyre dhe N/A 15 shoqëri ose 19,7% e shoqërive. Grafiku 67 shtojca 3.

Krahas statutit a keni akte normative për kuadrin bazë të drejtimit të brendshëm të shoqërisë? Po janë përgjigjur 24 shoqëri, ose 31,6 %, Jo janë përgjigjur 35 shoqëri ose 46,1% dhe N/A janë përgjigjur 17 shoqëri ose 22,4%. Grafiku 68 shtojca 3.

Krahas statutit a keni akte normative për kuadrin bazë të drejtimit të brendshëm të shoqërisë? Po, janë përgjigjur 24 shoqëri ose 31,6% e shoqërive, Jo janë përgjigjur 35 shoqëri ose 46,1% e tyre dhe N/A 17 shoqëri ose 22,4% e tyre. Grafiku 68 shtojca 3. *Ku i keni të përcaktuar kompetencat e vendimeve të çështjeve që mbeten në dorë të aksionerëve dhe atyre që mbeten në dorë të Këshillit?* Ndër përgjigjet e dhëna, 46 shoqëri ose 60,5% e tyre janë përgjigjur në statut, Grafiku 69 shtojca 3. *Për pyetjen: Mendoni se mund të vijë koha që shoqëria juaj të kuotohet në tregjet e kapitalit në vendet me të zhvilluara?* Ndër përgjigjet e dhëna Jo, nuk jemi të përgatitur, janë përgjigjur 41 shoqëri ose 53,9%. Grafiku 70 shtojca 3. *Koha padyshim mund të vijë shpejt pasi nevojat për kapital rriten.*

Sipas mendimit tuaj si mund të funksionoi tregu i kapitaleve në Shqipëri? Me mbikëqyrjen e shtetit mendojnë 26 shoqëri ose 34,2%, duke zhvilluar entet rregullatore mbikëqyrëse 25 shoqëri ose 32,9%. Duke funksionuar ndërmjetësit financiar (bankat e investimit, firmat e brokerimit), 2 shoqëri ose 2,6%, duke evoluar në mënyrë spontane 23% ose 30,3%. Grafiku 71 shtojca 3.

Si ka qenë situata financiare e vitit 2013 në krahasim me vitin 2012? Thuhet në të njëjtin nivel, janë përgjigjur 39 shoqëri ose 51,3% e tyre, më e mirë 6 shoqëri ose 7,9%

e tyre dhe në rënie 31 shoqëri ose 40,8% e tyre. Fakt real në këtë pyetje është se për shumë e mirë nuk është shprehur asnjë shoqëri. Grafiku 72 shtojca 3. Ndërsa për pyetjen e pyetësorit : *Nëse situata financiare ka qenë në rënie cilat kanë qenë arsytet dhe a mendoni në përmirësim të saj?* Ndër përgjigjet e dhëna nga shoqëritë, 42 shoqëri ose 55,3% mendojnë në përmirësim të situatës së tyre, 15 shoqëri, ose 19,7% mendojnë kriza financiare, qeverisja e korporatës 16 shoqëri ose 21,1% dhe nuk mendojnë në përmirësimin e situatës janë përgjigjur 3 shoqëri ose 3,9% e tyre. Grafiku 73 shtojca 3. *Mendoni se qeverisja e mirë e korporatës do të ketë ndikim në biznesin tuaj në vitin 2014?* Po, kanë thënë 68 shoqëri ose 89,5%, deri diku 8 shoqëri ose 10,5% e shoqërive, ndërsa Jo janë përgjigjur 0 shoqëri, duke ditur rëndësinë që paraqet kjo qeverisje në vijim të punës së tyre si një pjesë e rëndësishme për të qenë të suksesshëm. Pra, siç shikohet shoqëritë po ndërgjegjësohen për të pasur një qeverisje sa më efektive. Grafiku 74 shtojca 3. Ndërkohë pyetjes: *Në cilën mënyrë realizohet bashkëpunimi ndërmjet administratorëve/administratorit dhe Këshillit Mbikëqyrës?* Nga përgjigjet e dhëna 25 shoqëri ose 32,9% e tyre janë përgjigjur: administratorët dhe këshilli kanë përgjegjësi solidare, ku administratorët japin informacion të mjaftueshëm KM-së. Grafiku 75 dhe grafiku 75.1 shtojca 3. Ndërkohë pyetjes : *Një sistem i qeverisjes së korporatës për të qenë sa më efektiv ku mendoni se duhet të fokusohet më tepër?* Ndër përgjigjet e dhëna, 19 shoqëri ose 25% e tyre kanë zgjedhur : *Në identifikimin dhe menaxhimin e risqeve me të cilat mund të ballafaqohet shoqëria që sjell dështimin e saj.* Grafiku 76 shtojca 3. Pyetjes: *Një qeverisje e mirë e korporatës kryesisht në kohën kur është e nevojshme të menaxhohet kriza lejon (me zgjedhje me alternativa të ndryshme) i janë përgjigjur :* 22 shoqëri ose 28,9% për pjesën: *Drejtimin efektiv të të gjitha hallkave si përbërësit kryesorë për një sukses të qëndrueshëm organizativ.* Grafiku 77 shtojca 3. Ndërkohë për pyetjen : *A i shton vlerë shoqërisë sistemi i qeverisjes së korporatës ndërmjet veprimeve të mëposhtme të bordit?* Nga zgjedhjet e bëra rezulton se: 38 shoqëri ose 50% e tyre kane zgjedhur: *Duke ofruar bordi administrimit të dhëna dhe ide të reja mbi zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë.* Grafiku 78 shtojca 3.

Ndërsa për pyetjen *A ndihmon shoqërinë bordi të pakësojë riskun duke kryer veprimet e mëposhtme (dhënë informacioni përkatës në pyetje)* 27,6% e shoqërive ose 21 shoqëri, pra pjesa me e madhe kanë zgjedhur : *Rrit besimin për të ardhmen e shoqërisë tek palët*

e jashtme të interesuara, veçanërisht tek investitorët dhe punonjësit. Grafiku 79 shtojca 3.

Pyetjes: *Prezenca e një sistemi efektiv të qeverisjes së korporatave brenda një shoqërie ndihmon në ofrimin e një shkalle besimi, që është e nevojshme për mirëfunksionimin e shoqërisë por dhe të ekonomisë*, 75 shoqëri i janë përgjigjur Po, pra thuhet në unison 98,7% sipas tabelës së frekuencave dhe vetëm 1 shoqëri ose 1,3% është përgjigjur Jo. Grafiku 80 shtojca 3

Në pyetjen e këtij kapitulli : *Në cilën nga komponentët e mëposhtëm bazohet paga e administratorit/administratorëve?* 43,4% ose 33 shoqëri kanë zgjedhur piken pak më lart se niveli i pagës minimale të përcaktuar nga qeveria dhe më pas 25% ose 19 shoqëri kanë zgjedhur, *Rritja e kostos jetesës me kufi pagën minimale*, 23,7% ose 18 shoqëri, *Performanca e kaluar, me kufi pagën minimale*, 5 shoqëri ose 6,6%, *Rritja e përgjegjësisë, me kufi pagën minimale* dhe 1 kompani ose 1,3% është përgjigjur N/a (konkretisht ka refuzuar përgjigjen). Grafikët 81, 81.1 shtojca 3. Pyetjes : *Ku mendoni se duhet të fokusohet skema e shpërblimit në përgjithësi në shoqërinë tuaj?* Nga përgjigjet e dhëna : 42 shoqëri që kanë plotësuar pyetësin ose 55,3% mendojnë në analizën e rezultateve të shoqërisë, ndërsa për përgjigjen në mënyrën e indeksimit si një mjet që lidh pagën me komponentë të performancës 32,9% ose 25 shoqëri, në një strukturë ku të hartohen kontrata të veçanta shpërblimi 8 shoqëri ose 10,5% e tyre dhe N/a është përgjigjur 1 shoqëri ose 1,3%. Grafiku 82 shtojca 3.

Mendoni se praktikët e OECD-së në fushën e qeverisjes së korporatave me ndryshimet përkatëse hap pas hapi duhet të njihen prej shoqërisë tuaj? Po janë përgjigjur 36 shoqëri ose 47,4% e shoqërive, Jo 2 shoqëri ose 2,6% dhe aq sa është e nevojshme 38 shoqëri ose 50% e shoqërive. Grafiku 83 shtojca 3. Në lidhje me pyetjen: *A mendoni të përfshini në raportet financiare dhe një raport për strukturën dhe praktikën e qeverisjes së korporatës?* Ndër përgjigjet e dhëna 37 shoqëri ose 48,7% e tyre, janë përgjigjur në një kohe të pacaktuar. Grafiku 84 shtojca 3. *A mendoni se me rritjen e shoqërisë, bizneset familjare duhet të kenë*, (pyetje me alternativa kjo), ndër përgjigjet e dhëna 34 shoqëri ose 44,7% e tyre kanë zgjedhur një strukturë më formale menaxhimi. Grafiku 85 shtojca 3.

Në pyetjen : *A është i nevojshëm planifikimi i menaxhimit në një biznes familjar*, 44 shoqëri ose 57,9% e tyre kanë thënë Po, 5 shoqëri ose 6,6% e tyre Jo dhe N/a 27 shoqëri

ose 35,5% e tyre. Grafiku 86 shtojca 3. Në lidhje me pyetjen : *Një plan efektiv i suksesit të qeverisjes çfarë mendoni se siguron*, 56 shoqëri ose 73,7% kanë zgjedhur *Vazhdimësi të biznesit pasi rritet mbijetesa e biznesit familjar pasi përcillet brez pas brezi*, ndërsa 18,4% ose 14 shoqëri, *Zgjedhjen e personave kompetent është apo jo anëtar i familjes*, 5 shoqëri, ose 6,6% *Sigurimi i aftësive dhe lidhshirësit për të zëvendësuar çdo menaxher që largohet*, dhe 1 shoqëri ose 1,3% *Vendosjen e drejtuesve të jashtëm në drejtim*. Grafiku 87 shtojca 3. *Çfarë mendoni në vijimësi për shoqërinë tuaj në lidhje me qeverisjen efektive të saj*, 22 kompani ose 28,9% kanë zgjedhur një vazhdim të menaxhimit nga themeluesit, ndërsa pjesën më të madhe 48 shoqëri ose 63,2% e zë përgjigja një menaxhim me drejtues të specializuar dhe ekspertizën që kërkon rritja dhe kompleksiteti i shoqërisë, ndërsa përgjigja N/a është dhënë nga 6 shoqëri ose 7,9% e tyre. Grafiku 88, shtojca 3. Grafiku 20.1.1 shtojca 2, siç e kemi përmendur, analiza Klaster, na tregon se vetëm 32 shoqëri kanë një kulturë qeverisje atraktive (42.1%).

5.8 Përfitimet e një qeverisje më të mirë në shoqëritë aksionere në këndvështrimin e administrimit të biznesit të këtyre shoqërive. Analizë krahasuese e një pjese të rezultateve marrë nga studimet përkatëse.

Vëzhgimi mbi gjendjen e Corporate Governance (Qeverisjen e korporatave) në Shqipëri është realizuar nga Shoqata Shqiptaro-Amerikane e Tregtisë dhe Zhvillimit (The Albanian American Trade and Development Association of Albania, AATDA-AL) e cila prezantoi në vitin 2008 studimin “Përmirësimi i qeverisjes së shoqërive anonime në Shqipëri”. Në këtë studim ashtu si dhe në rastin tonë, metodologjia e vëzhgimit të SHA-ve bazohet në intervistimin e drejtpërdrejtë të një numri shoqëri aksionere (sha) dhe institucionesh të interesuara, të përzgjedhura paraprakisht. Vëzhgimi u krye në qytetet e Tiranës, Durrësit, Korçës dhe Shkodrës.

5.8.a Analiza e Grupit të SHA-ve të tjera (të dala nga privatizimi, SHA-të shtetërore dhe ato të krjuara me ligje të veçantë).

Për pjesën e grupit të mësipërm, në lidhje me të drejtat e aksionerëve, nga 65 SHA-të e intervistuar të këtij grupi, 37 nga përgjigjet pohojnë se ekziston njohje shumë e mirë rreth të drejtave të aksionerëve 57,92% ndërsa 28 përgjigjeve reflektojnë një njohje të

mirë 43,07%. Mendojmë se në vlerësimin e këtyre përgjigjeve duhet pasur parasysh se në grupin e studiuar janë përfshirë një grup i konsiderueshëm i SH.A-ve më ortak të vetëm (SH.A-të shtetërore), gjë që ka ndikuar në rezultatin e përgjithshëm.


Në rastin e studimit tonë, në lidhje me pyetjen: *Cili është sipas mendimit tuaj mbrojtja dhe njohja e të drejtave të aksionerëve në përgjithësi në shoqërinë tuaj* rezultojnë që 27 shoqëri ose 36% kanë dhënë përgjigjen *mirë* ndërsa 49 shoqëri ose 64% dhanë përgjigjen *shumë mirë*, ndërkohë që për përgjigjet *i papërshtatshëm* dhe *mesatar* nuk kishte përgjigje nga shoqëritë. Përgjigja *për njohje shumë të mirë* bie në sy në rritje në përqindje për rastin tonë (në studim). Në studimin e lartpërmendur të AATDA-AL rezultojnë që asamblëtë e aksionerëve zhvillohen rregullisht, 24 përfaqësues të shoqërive deklarojnë se asamblëtë e aksionerëve mbahen deri 4 herë në vit ndërsa 41 prej tyre deklarojnë shifrën 2-4 herë në vit. Përgjigjet e mbledhura pohojnë pjesëmarrje të mirë të aksionerëve në asamblëtë e përgjithshme të organizuara sipas ligjit pasi mbizotëron shifra e pjesëmarrjes nga 75-100 % (18 përgjigje japin shifrën 100 % të pjesëmarrjes në asamblëtë e përgjithshme, ndërsa pjesa tjetër luhet nga kufijtë 55-80 %). Ndërsa në studimin tonë, në lidhje me pyetjen : *Cila ka qenë frekuenca e organizimit të asamblesë së përgjithshme*, 1 shoqëri ose 1, 3% është përgjigjur deri në 4 herë në vit, 2-4 here në vit janë përgjigjur 24 shoqëri ose 32%, dhe 1 here në vit 51 shoqëri janë përgjigjur ose 67, 1%. Nga krahasimi vëmë re se shoqëritë në pjesën më të madhe në rastin tonë mblidhen më shumë se 1 herë në vit ose 67,1%. Mbështetur në studimin e AATDA-AL, aksionerët e ushtrojnë mjaft mirë të drejtën e shfrytëzimit të informacionit mbi shoqërinë. Pjesa më e madhe e të intervistuarve (73 %) pranojnë se aksionerët kanë mundësi të shfrytëzojnë një kategori të gjerë të dokumenteve të prodhuara nga shoqëria. Në studimin tonë në lidhje me pyetjen e informacioneve që shfrytëzohen, pikërisht : *Raporti i organit mbikëqyrës* (organi mbikëqyrës, audituesi i brendshëm), shfrytëzohet nga 68 shoqëri, ose 89,47% ndërkohë vetëm 8 shoqëri ose 10,53% sipas tabelës së frekuencave janë shprehur raporti i audituesit të jashtëm (ose ekspertit kontabël).

5.8.b Mbi rolin e aktorëve në praktikën e qeverisjes, Grupi i SHA-ve të tjera (të dala nga privatizimi, SHA-të shtetërore dhe ato të krijuara me ligje të veçanta).

Studimi i AATDA-AL na jep një tablo të përgjigjeve që tregojnë praninë në masë dërrmuese të kontratave individuale të punës me punonjësit. Në rreth 89 % të rasteve,

zbulohet se në pjesën dërrmuese shoqëritë aplikojnë këtë formë të kontraktimit me punonjësit, ndërsa vetëm 11 % prej tyre kanë nënshkruar kontrata kolektive me punonjësit e tyre. Ndërsa në studimin tonë, në lidhje me pyetjen: A keni nënshkruar kontrata të rregullta me punonjësit, 62 shoqëri ose 82% kanë deklaruar Po, në raste të veçanta 11 ose 14% dhe 3 kompani ose 4% kanë thënë Jo. Siç shikohet kemi një shifër relativisht të njëjtë. Pra raporti 82% me 89% është thujse i njëjtë. Sipas studimit të AATDA-AL shoqëritë bëjnë publike në radhë të parë pasqyrat financiare, pasi 34 % e përgjigjeve mbështesin këtë përfundim. Në vend të dytë për nga numri i përgjigjeve pohuese renditet publikimi i Raporteve Vjetore (26 % e përgjigjeve) pasuar nga publikimi i informacioneve mbi statutet e shoqërisë dhe aktet e saj (17 %), skemat e organizimit të shoqërive (12 %) dhe informacionet mbi transaksionet me aksionet (11 %). Nga 12 zgjedhjet e mundshme, përqindjen më të vogël e zënë pohimet mbi ekspozimin e informacionit mbi shpërblimin e anëtarëve të këshillave mbikëqyrës (vetëm 9 % e përgjigjeve), politikave që shoqëritë aplikojnë mbi biznesin e tyre (6 % e përgjigjeve), apo dhe mbi mbrojtjen e punonjësve (vetëm 3 % e përgjigjeve). Në studimin tonë në lidhje me çështjet që bëhen publike nga shoqëria, 62 shoqëri ose 81,6% kanë thënë rezultatet financiare dhe operative. Aksionerët dhe struktura e pronësisë 6 shoqëri ose 7,9%, struktura e qeverisjes dhe politikat 5,26% ose 4 shoqëri, 3,95 ose 3 shoqëri politikat e shoqërisë lidhur me biznesin e saj dhe 1,31% ose 1 shoqëri objektivat, organizimi (misioni, vizioni).

Grafiku 13 Vlerësimi mbi proceset gjyqësore




Burimi: AATDA-AL

Sipas studimit të AATDA-AL, mbi 80 % e të intervistuarve (54 përgjigje) pranojnë që deri më tani nuk janë organizuar trajnime mbi funksionimin e këshillave mbikëqyrës si dhe nga 65 % e intervistave pohohet se në dy vitet e fundit Këshillat Mbikëqyrës nuk kanë bërë asnjë vlerësim të punës së tyre.

Ndërsa në rastin e pyetësorit tonë *A mendoni se shoqëria duhet të planifikojë fonde për trajnim në fushën e qeverisjes së korporatave?* 69 shoqëri ose 90,8% kanë deklaruar Po, 7 shoqëri kanë deklaruar Jo, ose 9,2% e tyre. *A janë të përfshirë në formim profesional anëtarët e këshillit, formim i cili ua rrit në mënyrë specifike funksionin e tyre si anëtarë të këshillit të administrimit të shoqërisë tregtare?* 32 shoqëri ose 42,1% kanë deklaruar po, 8 shoqëri ose 10,5% jo dhe 36 shoqëri ose 47,4% kanë deklaruar N/A. *A kryen këshilli një vlerësim periodik të performancës së vet dhe të performancës së çdo anëtari të tij?* 32 shoqëri ose 42,1%, jo 20 shoqëri, ose 26,3%, dhe N/a 24 shoqëri ose 31,6%.

Sipas studimit të AATDA-AL, shpërndarja e përgjigjeve të pyetjeve mbi rolin e procedurave gjyqësore tregon se këto procedura konsiderohen me ndikim (22 përgjigje). Por 16 përgjigje i shohin ato të kushtueshme, ndërsa 18 përgjigje i konsiderojnë të gjata në kohë dhe 22 përgjigje me ndikim.

Grafiku 14 Vlerësimi i procedurave gjyqësore ku përfshihet edhe shoqëria



Burimi: Materiali studimor.

Ndërkohë në studimin tonë në lidhje me pyetjen *Si i gjykoni procedurat gjyqësore nëse është përfshirë eventualisht shoqëria juaj*, përgjigjet i kemi : pak të përshtatshme 28 shoqëri ose 36,8%, me ndikim të ndjeshëm 2 shoqëri ose 2,6%, të kushtueshme 11 shoqëri ose 14,5%, të gjata në kohë 27 shoqëri ose 35,5%, nuk kemi proces gjyqësor 8 shoqëri ose 10,5% e këtyre shoqërive. Në total 76 shoqëri.

Sipas studimit të AATDA-AL, në përgjigjet për rolin e auditit, mbizotërojnë vlerësimet që e shohin këtë rol si “të efektshëm por të kushtueshëm”. Nga 65 përgjigje, 49 prej tyre kanë bërë këtë zgjedhje, ndërsa 16 përgjigjet e mbetura i takojnë zgjedhjes “me ndikim të ndjeshëm”.

Në studimin tonë për pyetjen : *Si e vlerësoni rolin e auditit të brendshëm në mirëfunksionimin e shoqërisë?* Janë përgjigjur : pa ndikim 1 shoqëri ose 1,3% e tyre, me ndikim të ndjeshëm 6 shoqëri ose 7,9% e tyre, deri diku 5 shoqëri ose 6,6% e tyre, të efektshëm 64 ose 84.2% e tyre.

Një studim i TIA (Transparency International) duke bërë publike të dhënat e barometrit global të korrupsionit për vitin 2013 (Gazeta Panorama 10 Korrik 2013) në pjesën ku flitet për sistemin e drejtësisë thuhet se sistemi i gjyqësor në Shqipëri perceptohet si më i korruptuari nga të anketuarit po ashtu dhe sistemi shëndetësor. Në një shkallë nga 1 në 5 sipas shkallës Likert (1= aspak, 5 shumë të korruptuar), institucionet më të korruptuara në Shqipëri perceptohet të jenë : gjyqësori dhe sistemi shëndetësor 4,3 pikë), të ndjekura nga partitë politike, sistemi arsimor, parlamenti/legjislativi, policia etj, thuhet në raport. Ndërkohë pyetjes së studimin tonë : *se si e gjykoni sipas këndvështrimit tuaj sistemin e drejtësisë*, 60 shoqëri ose 78,9% e tyre kanë thënë mesatar, jo të mirë dhe me elementë korrupsioni 6 shoqëri ose 7,9% e tyre, të korruptuar janë shprehur 5 shoqëri ose 6,6%, shumë të mirë 4 shoqëri ose 5,3% dhe të mirë është shprehur vetëm 1 shoqëri ose 1,3%, pra vetëm 5 shoqëri kanë dhënë një përgjigje pozitive për këtë sistem i cili vazhdon të mbetet “thembra e akilit” në procesin e perceptimit në lidhje me vendimet e dhëna dhe kohën e dhënies së këtyre vendimeve ku në jo pak raste shoqërohen këto vendime dhe me pasoja financiare.

Grafiku 15 Ndarja e shoqërive sipas emërimit



Burimi: Instituti Agenda


Lidhjet familjare mbizotërojnë në shoqëritë aksionere me pronësi vendase në Shqipëri. Këto lidhje janë prezent në strukturat drejtuese madje në disa raste pavarësisht aftësive. Është fakt që shumica e bizneseve familjare është me kohëzgjatje shumë të shkurtër, sepse themeluesi i tij e ndërpret qeverisjen, 95 % e bizneseve familjare dështon dhe nuk e tejkalon brezin e tretë të pronarëve (Rrjeti i Biznesit Familjar, www.fbn-i.org/fbn/main.nsf/doclu/facts). Përqindja e lartë e dështimit të bizneseve familjare i përket një numri të madh të shkaqeve. Disa prej tyre u takojnë shkaqeve për shkak të cilëve çdo biznes tjetër do të dështonte siç janë: drejtimi i papërshtatshëm, financa të pamjaftueshme, kontrolli i çmimit i papërshtatshëm, si dhe industria dhe makro-kushtet në treg (Manuali i ICF për qeverisjen e biznesit familjar).

Në jo pak raste biznesi i familjarizuar është më pak i interesuar në lidhje me shpërndarjen e saktë të detyrimeve dhe procedurave të organizimit dhe vendimarrjes së punëve. Studimi i “*Instituti Agenda*” tregon se kjo po bëhet faktor pengesë në zbatimin e praktikave të qeverisjes së korporatave në sipërmarrjet shqiptare.

Nga 85 shoqëri që janë të përfshira në këtë analizë, 40% kanë të paktën tre anëtarë me të njëjtin mbiemër dhe 60% kanë dy persona (anëtarë) me të njëjtin mbiemër (Grafiku 15). Grafiku, thekson studimi i lartpërmendur, tregon se individët që mbajnë të njëjtin mbiemër në një firmë përbëjnë një ngjarje të zakonshme në Shqipëri. Kjo prirje konsiderohet se krijon pengesa në praktikën e përzgjedhjes së forcës së punës drejtuese dhe jo drejtuese, dhe ngre pikëpyetje serioze nëse praktikën e marrjes në punë në Shqipëri nxisin profesionalizimin apo favorizimin. Punës njeriun dhe jo njeriut punë.

Ndërsa sipas studimit tonë, ndarja sipas numrit të personave me mbiemër të njëjtë jepet në grafikun e mëposhtëm ku dhe në këtë studim na rezulton së 54%, ose 41 shoqëri përbëhen nga individët që mbajnë të njëjtin mbiemër, thuajse me një përqindje të përafërt. Më poshtë jepet grafiku përkatës për ndarjen e shoqërive (Grafiku 16).


Grafiku 16 Ndarja e shoqërive



Burimi: Materiali studimor.


Gjithashtu në studimin tonë, ne kemi bërë dhe një ndarje sipas tipit të pronësisë (Grafiku 17) dhe kemi vënë re nga pyetjet e bëra se përqëndrimi i individëve me të njëjtin mbiemër shfaqet në shoqëritë me pronësi ose kapital 100% shqiptar, pra në zonën e 41 shoqërive ose 54% të lartpërmendur (shoqëritë me kapital shqiptar).

Grafiku 17 Ndarja e shoqërive sipas tipit të pronësisë



Burimi: Materiali studimor.


Grafiku 18 Ndarja e shoqërive sipas tipit të pronësisë



Burimi: Materiali studimor.

Sipas të dhënave të grafikut të *Institutit Agenda* rezulton se përqendrimi i individëve me të njëjtin mbiemër shfaqet në shoqëritë që janë në pronësi të individëve shqiptarë. 58% e shoqërive shqiptare kanë të paktën dy individë me të njëjtin mbiemër që punojnë në ekipin kryesor menaxhues, ndërsa e njëjta dukuri është e pranishme vetëm në 10% të shoqërive me pronësi të huaj. Shoqëritë me pronësi të huaj, sipas studimit në fjalë kanë zhvilluar një kulturë të qeverisjes së korporatave në vendet e origjinës dhe se ato përdorin praktika profesionale në përzgjedhjen e forcës së punës. Gjithsesi, 10% e shoqërive të tilla, sipas Institutit, shfaqin një tendencë nepotizmi, që mund të jetë rezultat ose i ndikimit të kapitalit shqiptar në minorancë, ose në rastin kur shoqëritë vijnë pas një procesi privatizimi, kjo mund të jetë rezultat i procedurave të rekrutimit të kryera përpara se shumica e kapitalit të kalonte në duar të të huajve.

Grafiku 19 Ndarja e shoqërive sipas llojit të pronësisë



Burimi: *Instituti Agenda*

Të dhënat nga grafiku i *Institutit Agenda* dhe konkluzionet e tij tregojnë se pronësia vendase e shoqërisë është e lidhur në mënyrë pozitive me mbizotërimin e lidhjeve familjare në strukturat qeverisëse. Në studimin tonë, për pyetjen e cila kërkon informacion mbi mekanizmat në bizneset familjar, konkretisht : *A keni mekanizma familjare, nëse keni biznes të tillë, të drejtimit të brendshëm, p.sh një dokument themelues ose protokoll familjar ku të parashtrihen vizioni dhe objektivat që mund të ketë për firmën familja si dhe të përcaktohen rolet e organeve të drejtimit të brendshëm të biznesit të familjes dhe marrëdhëniet e tyre me këshillin?* Nga shoqëritë (respondentët) kemi përgjigjet të cilat pasqyrohen në grafikun 20 (fq 179) :

Grafiku 20 A keni mekanizma familjarë në biznesin tuaj?



Burimi: Materiali studimor.

Siç shikohet nga grafiku Po, janë përgjigjur 3 shoqëri ose 4% dhe Jo 73 shoqëri ose 96%. Ndërkohë pyetjes : *A i ushtron i njëjti person rolin e kryetarit të këshillit dhe administratorit?* 4 shoqëri ose 5,3 % janë përgjigjur Po, ndërsa 72 ose 94,7% Jo, çka do të thotë se në një përqindje të papërfillshme, por veçanërisht në bizneset familjare (me përbërje të anëtarëve familjarë në struktura) ka persona të tillë që mbajnë të njëjtin funksion. Nga analiza shohim madje se formaliteti ekziston në strukturim. Bursa është padyshim institucioni financiar me i rëndësishëm dhe luan një rol parësor në kuadrin e një qeverisje efektive korporate. Bursa e Tiranës si institucion kërkon që pasqyrat vjetore financiare (bilanci, pasqyra e fitim/humbje dhe cash flow-t) të jenë të audituara (kontrolluara) nga ekspertë kontabël të pavarur dhe të mbulojnë një periudhë kohore për 3 vitet e fundit financiarë, pra një analizë të dokumentacionit ligjor financiar të mbajtur. Kjo kërkesë është padyshim një pikë “e fortë” që në Shqipëri për momentin shoqëritë të

hezitojnë për listim ndaj momentalisht kjo bën që të mos kemi asnjë shoqëri të listuar në bursë. Në jo pak raste biznesi është jo transparent me procedurat në lidhje me publikun e gjerë dhe me shtetin. Jemi dëshmitarë të shmangieve të detyrimeve, të raportimit financiar korrekt etj. Gjithsesi Shqipëria duhet të jetë në rrugën e Zbatimit të Standardeve të Raportimit Financiar dhe Auditimit. Arritja më e madhe është që Shqipëria duke filluar nga viti 2008, zbaton një sistem kontabël që përgatit pasqyrat financiare bazuar në Standardet Ndërkombëtare dhe në Standardet Kontabël Kombëtare të hartuara në koherencë me të parët. Nga një studim i zhvillimeve aktuale në fushën e kontabilitetit në rrafsh nderkombëtar konstatohet për standartizimin dhe unifikimin e kontabilitetit, pra kalimi nga përpjekjet për harmonizim në ato për standartizimin. Në lidhje me pyetjen : *A mendoni se ka ardhur koha për listim në bursë të shoqërisë tuaj dhe shoqërive tregtare në përgjithësi*, po janë përgjigjur 39 shoqëri ose 51,3% e tyre, jo 8 shoqëri ose 10,5% e tyre dhe duhet edhe pak kohë 29 shoqëri ose 38,2% e tyre. Ndërsa për pyetjen, Nëse po, a mund të jepni një vlerësim rreth pengesave për të bërë një gjë të tillë, mungesa e informacionit dhe njohurive ka qenë përgjigja për 5 shoqëri ose 6,6% e tyre, mungesa e traditës për 53 shoqëri ose 69,7% e tyre, mosplotësimi i standardeve nga shoqëritë anonime në përgjithësi është zgjedhur nga 4 shoqëri ose 5,3% e tyre dhe nevoja e ulët për kapitale është zgjedhur nga 14 shoqëri ose 18,4% e tyre. Shoqëritë janë dhe mbeten e ardhmja e zhvillimit ekonomik të vendit tonë. Zhvillimi dhe modernizimi i një ekonomie nuk mund të perceptohet pa një treg kapitali e bursë të zhvilluar, pa tregues të lartë makro e mikroekonomikë dhe financiarë. Bankat e nivelit të dytë në vendin tonë janë të mëdha në numër dhe kryejnë larmi shërbimesh dhe disa kanë fuqi financiare të madhe, por ato në asnjë rast nuk mund të zëvendësojnë rolin e institucioneve të tjera të tregut, një ndër të cilat është dhe Bursa e Tiranës. Një sistem financiar i shëndoshë kërkon praninë e bankave, por edhe të institucioneve të tjera jobankare, konkretisht kompleks institucionesh financiare. Ndërkohë duhet theksuar se bursa është edhe më e ndjeshme se sa bankat e nivelit të dytë ndaj informalitetit ekonomik, mungesës së bilanceve reale etj. Në Bursën e Tiranës nuk ka shoqëri të listuar, ndërkohë që Bursa e Zagrebit numëron 233 shoqëri, Bursa e Beogradit 1339 shoqëri, bursa e Maqedonisë 70 shoqëri dhe e Malit të Zi 55 shoqëri. Nga ana tjetër vlera e këtyre bursave varion dhe arrin deri 22 miliardë dollarë amerikan në Kroaci dhe 2 miliardë dollarë amerikan në Maqedoni. Një shembull i mirë është

shoqëria Fox Marble një shoqëri e cila operon 100% në Kosovë. Ajo është shoqëria e parë në Kosovë dhe në rajon e cila ka zyrat qendrore në Londër dhe që është pranuar të tregtojë aksione në Bursën e Londrës, arritje kjo që u përcoll me shkrime të shumta nga mediat botërore si: Financial Times, The Daily Express, London Evening Standard, The business Desk etj. Listimi në bursën e Londrës mundësoi që shoqëria të akumulonte 9,6 milion paund ose 12 milion euro nëpërmjet shitjes së aksioneve për të investuar më tej në përpunimin e nxjerrjes së mermerit. Kjo shoqëri është krijuar në vitin 2011. (Kadia. B, të listohesh në bursë dhe biznesi shqiptar, MAPO 21 Shtator 2012). Ky shembull shërben për ti treguar biznesit shqiptar se në këto vite të tranzicionit padyshim që ka humbur shumë nga mundësia për të zgjeruar dhe më tej aktivitetin ekonomik në vend e në rajon dhe për të shfrytëzuar në maksimum instrumentet financiare për të akumuluar fonde financiare me kosto minimale. Tradita padyshim që përbën një faktor kyç pasi vendet e tjera të rajonit duke përfshirë dhe vendet që thamë më lart, kanë një traditë shumë vjeçare në lidhje me bursën dhe madje eksperiencë më të madhe. Vlen të përmendet fakti se ekziston një numër i caktuar shoqërish me strukturë kapitali të ndryshme (shtetërore, private, mikse) të cilat i plotësojnë kriteret e listimit në Bursën e Tiranës. Përveç sistemit bankar shoqëritë aksionere në Shqipëri vazhdojnë të mbështeten kryesisht në burimet e brendshme për të përmbushur nevojat për financim. Asnjë vend nuk ishte i imunizuar nga kriza financiare dhe aq më pak Shqipëria. Një pjesë e mirë e shoqërive nuk e përballoi dot krizën, disa të tjerë u përballën me vështirësi të ndryshme por mbijetuan dhe vazhdojnë të mbijetojnë. Në lidhje me pyetjen *Si ka qenë situata financiare e vitit 2013 në krahasim me vitin 2012*, 39 shoqëri ose 51,3% e tyre shprehen së është thuajse në të njëjtin nivel, më e mirë janë shprehur 6 shoqëri ose 7,9% e tyre, në rënie 31 shoqëri ose 40,8% e tyre. Në lidhje me arsyet dhe a mendoni në përmirësim të saj, 15 shoqëri, ose 19,7% janë shprehur për krizën financiare, qeverisjen e korporatës 16 shoqëri ose 21,1%, mendojnë në përmirësim të situatës, 42 shoqëri ose 55,3% e tyre, nuk mendojnë në përmirësimin e situatës 3 shoqëri ose 3,9% e tyre. Ndërkohë në lidhje me pyetjen: *Mendoni se qeverisja e mirë e korporatës do të ketë ndikim në biznesin tuaj në vitin 2014*, 68 shoqëri ose 89,5% e tyre janë shprehur Po, ndërsa me përgjigjen *deri diku* janë shprehur 8 shoqëri ose 10,5% e tyre sipas frekuencave.

KAPITULLI VI

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Në këtë kapitull përmbyllës të këtij punimi prezantohen konkluzionet në lidhje me qeverisjen e korporatave në vendet evropiane në zhvillim duke përfshirë dhe Shqipërinë, parë në kuadrin e krahasimit me këto vende si dhe qeverisjen e korporatave në shoqëritë që veprojnë në mjedisin ekonomik në Shqipëri. Qëllimet e këtij punimi ishin dy: së pari realizimi i renditjes së vendeve evropiane në zhvillim mbështetur në një indeks të qeverisjes së përgjegjshme të korporatave duke identifikuar dimensionet e nevojshme për të matur këtë qeverisje dhe komponentët e çdo dimensionit, përdorimin e metodës përkatëse për të llogaritur indeksin e lartpërmendur për këto vende si dhe realizimi i rankimit të shteteve sipas vlerës së këtij indeksi, së dyti realizimi i renditjes së shoqërive duke u mbështetur në treguesin xhiro/kapital. Faktor i rëndësishëm i cili mat suksesin e qeverisjes në organizatat e biznesit është edhe indeksi i qeverisjes së korporatave në krahasim me raportin (treguesin) Të ardhura neto/kapital krahas raportit tjetër atij të xhiros (Qarkullim/kapital).

Fillimisht do të trajtohen disa konkluzione të përgjithshme të punimit, duke vazhduar me konkluzionet specifike të rezultateve nga analiza statistikore e të dhënave të mbledhura nga pyetësorët. Në fund të kapitullit jepen edhe kufizimet e këtij punimi dhe sugjerime për kërkime të mëtejshme në fushën e qeverisjes së korporatave.

Pavarësisht përpjekjeve të bëra në Shqipëri në lidhje me Q.K me ndryshime drastike në infrastrukturën ligjore, në më të mirën e njohurive tona, studime empirike lidhur me Q.K, të publikuara, janë sporadike dhe pranohet që ka një mungesë të njohurive dhe të njohjes së benefiteve nga implementimi i këtyre praktikave.

Arsyet kryesore të kësaj vonese janë:

- 1 Ndërmjet vendeve të Evropës Juglindore (EJG) Shqipëria ka historikun më të shkurtër si një ekonomi e orientuar ndaj tregut, me infrastrukturë institucionale jo shumë të zhvilluar dhe pasiguri politike dhe ekonomike
- 2 Mungesë e grupeve të fuqishme investuese
- 3 Mungesë e udhëzuesve ose e kodeve të praktikave të mira (aprovimi i manualit në dhjetor 2011)

- 4 Kulturë e vakët korporative dhe mungesë e specialistëve në Q.K dhe tregun menaxherial të punës.

6.1 Konkluzione specifike nga analiza statistikore mbi qeverisjen e korporatave

Qëllimet e këtij punimi i përmendëm në fillim të këtij kapitulli, dhe qëllimin e parë e kemi në kapitullin e tretë, ku në këtë pjesë të analizës, në raport me vendet e tjera në zhvillim, ndër 23 shtetet e marra në studim, Shqipëria në lidhje me indeksin GCR (qeverisjes së përgjegjshme të korporatave) rankohet në vendin e 18-të. Ndërsa në lidhje me GDP(PBB) për frymë si tregues i standardit të jetesës renditet në vendin e 20-të. Nuk duhet të harrojmë faktin që vende si Polonia, Republika Çeke, Hungaria, Lituania, Sllovenia, Estonia, Letonia, Bullgaria, Rumania janë vende anëtare të BE-së (dy shtete e fundit janë anëtarësuar në BE në Janar 2007) dhe që kanë avancuar në drejtim të treguesve ekonomik dhe të qeverisjes së korporatave. Vendet me PBB të lartë kanë dhe indeks të qeverisjes së përgjegjshme të korporatave të lartë pra në përpjesëtim të drejtë, ndaj dhe themi që ekziston lidhje korelative midis këtyre variablave. Standardi i jetesës së qytetarëve të një vendi është i lidhur direkt me punësimin si në sektorin privat apo shtetëror me ndikim në zhvillimin ekonomik (kemi cilësi jetese dhe rritje të ardhurash). Judge & Elenkov (2005) treguan se ekziston një lidhje pozitive ndërmjet GCR-së dhe PBB. Po kështu Judge *et al.*, (2009) arritën në një rezultat të ngjashëm duke treguar se GCR-së është e lidhur pozitivisht me PBB në Rusi. Ganesku & Ganone, (2012) arritën në të njëjtin rezultat si rezultati jonë duke treguar një lidhje të tillë ndërmjet GCR-së dhe PBB duke matur qeverisjen e përgjegjshme të korporatave etj. Shqipëria duhet të bëjë më shumë për t'u ngjitur në renditjen e vendeve (treguar në punimin tonë). Fakt real për sa thënë më lart është dhe analiza e disa shoqërive shqiptare për të parë se si paraqitet qeverisja e korporatave në to dhe që analizohet në kapitullin e katërt.

Vendet në zhvillim kanë energji dhe asete të shumta, dhe të gjitha segmentet e sektorit privat apo shtetëror duhet të demonstrojnë aftësinë për t'ju përgjigjur standardeve të qeverisjes së korporatave. Një qeverisje e mirë korporate rrit aksesin e saj në treg. Premiumi për të blerë një shoqëri me qeverisje të mirë korporate varion 30% për shoqëritë e Europës Lindore dhe Afrikës dhe 22% për ato të Azisë dhe Amerikës Latine. Gjithashtu sipas studimit 63% e shoqërive të intervistuar do të mënjanonin investimin

në ato shoqëri ku qeverisja është jo e mirë (Global Investor Opinion Survey, Korrik 2002, Mc Kinsey & Company).

Shoqëritë që veprojnë në mjedisin ekonomik në Shqipëri, që janë marrë në studim 80,3% kanë mbi 10 vjet që operojnë në Shqipëri ku 68,4 % e tyre konsiderohen ndërmarrje të mesme. Sipas rezultateve të studimit (lidhja GCI me raportin Xhiro/kapital) vetëm dy shoqëri kanë bërë një punë të mirë në aspektin e qeverisjes së korporatave renditur tek *Përmbushësit*. 60 % e shoqërive kanë rezultat më lartë të mesatares përse i përket indeksit të qeverisjes së përgjegjshme të korporatave, por nivel të ulët të raportit xhiro/kapital duke u klasifikuar tek të *Ndjeshmit*. Ndërsa *Humbësit*, përfaqësojnë rreth 1/3 e firmave dhe kanë një nivel të ulët të qeverisjes së përgjegjshme korporative si dhe raport *xhiro/kapital* të ulët. *Indiferentët* përbëhen nga 2 shoqëri me mundësi reale të zhvillimit të praktikave të qeverisjes së përgjegjshme të korporatave, pasi ata kanë raport *xhiro/kapital* të lartë. Ata kanë mundësi potenciale për të rritur indeksin e qeverisjes së përgjegjshme të korporatave.

Në lidhje me treguesin GCI në krahasim me raportin financiar *e ardhura neto/kapital*, nga analiza e ndarjes së kategorive, shohim se *Humbësit* janë gjithësej 8 shoqëri, të *Ndjeshmit* 56 shoqëri ndërsa *Indiferentët* 2 shoqëri dhe së fundi *Përmbushësit* gjithësej 10 shoqëri. Edhe në këtë rast përmbushësit janë përsëri në nivel të ulët.

Nga përpunimi i informacionit ndërmjet lidhjeve (Crosstabulation) nëse shohim psh lidhjen *A jeni të informuar mbi Kodin e Drejtimit të Brendshëm të Shoqërive Aksionere Jo të Regjistruara në Bursë publikuar nga METE dhe a keni njohuri mbi të me pyetjen : Cila është ndarja e shoqërive sipas tipit*, për Kodin e Drejtimit të Brendshëm të Shoqërive Aksionere Jo të Regjistruara në Bursë publikuar nga METE, 58.3% i takojnë shoqërive të përbashkëta që kanë informacion mbi këtë kod, 100% atyre të huaj dhe 24,6% shoqërive shqiptare, ndërsa që nuk kanë informacion, rezultojnë 41,7% e shoqërive të përbashkëta, 0% e atyre me kapital të huaj dhe 47,5% shoqërive shqiptare për informacionin për këtë kod, ndërsa nuk janë përgjigjur fare 27,9% e shoqërive, që e përbëjnë shoqëritë shqiptare (pikërisht këtë përqindje). Nga përqindjet e lidhjes lehtësisht nxjerrim konkluzionin që shoqëritë shqiptare duhet të kërkojnë nëpërmjet personave kompetentë më shumë mundësi për njohje të praktikave qeverisëse duke planifikuar dhe fonde për trajnime për një qeverisje të mirëfilltë korporate.

Ndërkohë nga lidhja e pyetjes: *A jeni të informuar mbi manualin e Qeverisjes së Korporatave dhe a keni njohuri mbi të me pyetjen : A jeni të informuar mbi Kodin e Drejtimit të Brendshëm të Shoqërive Aksionere Jo të Regjistruara në Bursë publikuar nga METE dhe a keni njohuri mbi të?* rezulton se ndër 48% e atyre shoqërive që janë përgjigjur se kanë njohuri rreth Manualit të qeverisjes së korporatave, 32,4% kanë njohuri gjithashtu edhe për Kodin e drejtimit të brendshëm të Sh.a-ve që nuk janë të regjistruara në Bursë. Pra 32,4% e shoqërive të cilët janë informuar për Manualin e Qeverisjes së Korporatave dhe kanë njohuri mbi të, janë të informuar mbi Kodin e Drejtimit të Brendshëm të Shoqërive Aksionere Jo të Regjistruara në Bursë publikuar nga METE ndërsa 26,7 % janë shprehur Jo dhe 55,6% N/A. Theksojmë se është e ulët njohja nga shoqëritë për të dyja kodet njëkohësisht. Duke analizuar gjendjen, në mënyrë të veçantë, shohim se vetëm 49% (37 shoqëri) e shoqërive janë të informuar mbi manualin e qeverisjes së korporatave dhe vetëm 33% (25 shoqëri) mbi Kodin e Drejtimit të Brendshëm të Shoqërive Aksionere Jo të Regjistruara në Bursë, publikuar nga METE, nga ku duket qartësisht se dhe njohuritë nuk mund të jenë shumë specifike, por pozitiv është fakti që shoqëritë mendojnë në 65,8% (50 shoqëri) të rasteve se pikërisht ka ardhur koha për të zbatuar parimet e manualit të qeverisjes së korporatave dhe kodin e drejtimit të brendshëm të lartpërmendur. Ndërkohë që njohja e të drejtave të aksionerëve është shumë e mirë, 64% dhanë përgjigjen shumë mirë, në krahasim me studimin e AATA-AL, për 65 shoqëri 57,92%, ndërkohë raporti i organit mbikëqyrës vazhdon të mbetet më i shfrytëzuari në 89,47% të rasteve. Duhet theksuar se në 82% të rasteve, kontraktimi me punonjësit është prezent çka tregon një seriozitet në marrëdhëniet juridike punëdhënës-punëmarrës. Publikimi i informacionit duhet të jetë ndër prioritetet nëse duam të kemi qeverisje të mirëfilltë korporate. Shumica e shoqërive nuk bëjnë publike të gjithë informacionin pasi 30,3% e tyre janë shprehur për ruajtje të konfidencialitetit për të dhënë informim. 81,6% kanë thënë që bëjnë publike vetëm rezultatet financiare dhe operative, por vetëm ato rezultate të cilët publikohen në bilanc (i përcakton bilanci sipas ligjit). Ndërkohë shoqëritë ende nuk përgatisin një raport për qeverisjen e korporatave i cili është kusht sipas standardeve të kësaj qeverisje, ku vetëm 5,3% e bëjnë një gjë të tillë, 3,9% nuk e bëjnë një gjë të tillë dhe 90,8% kanë zgjedhur abstenimin nga analiza e përgjigjes, por pozitiv është fakti se 99% e shoqërive mendojnë se ka ardhur koha për një raport të tillë si pjesë e materialeve të MPA-së.

Sistemi gjyqësor vazhdon të mbetet ndër vite një pikë delikate, një sistem ku vendimet zgjaten në kohë. Koha për të zgjidhur një konflikt gjyqësor vazhdon të mbetet një bumerang ç'ka tregon se shoqëritë hasin pengesa në zgjidhjen e problemeve ndër të tjera me organe si : tatimet, doganat etj. Kështu për 47,4% e shoqërive është mbi katër vjet, ndërsa 36,8% (28 shoqëri) e shoqërive e konsiderojnë pak të përshtatshme. Procedura e falimentimit në gjykatë mbetet e gjatë për 44,7% e shoqërive, kjo pikërisht përbën pengesë për ta pasi siç dihet në kushtet e krizës financiare dhe të ekonomisë së tregut falimentimi është prezent për arsye të ndryshme. Ndërkohë sistemi i drejtësisë konsiderohet mesatar nga 78,9% e shoqërive. Auditimi mbetet padyshim pika kyçe. Sipas raportit Candbury (1992) “Auditimi vjetor është një moment kyç në qeverisjen e korporatave. Auditimi ofron një kontroll të jashtëm dhe objektiv për mënyrën se si janë përgatitur dhe prezantohen pasqyrat financiare”. Ekspertët kontabël të autorizuar vërtetë çertifikojnë bilance në përputhje me ligjin, por nuk mbajnë përgjegjësi nëse ka ndodhur penalizim nga organet tatimore në ndonjë shoqëri ku ata kanë bërë çertifikimin e bilancit i cili ka në përbërje veprimet financiare dhe kjo pohohet nga 60,5% e rasteve. Ndërkohë që 75% e shoqërive, kanë theksuar dhe janë të ndërgjegjësuar se një sistem i mirë i qeverisjes *rrit eficiencën e shoqërive dhe përmirësim të pozicionimit në treg* është zgjedhur nga 14,5% e shoqërive, por *mungesa e njohurive* është faktori më kryesor pengues në 93,4% të rasteve si dhe *mungesa e rregulloreve* në 90,8% të rasteve ndërkohë që *trajnimi dhe konsulenca* mbetet pika më nevralgjike për të pasur një qeverisje të mirë korporate, zgjedhur në masën 86,8%. Gjithashtu, shoqëritë në pjesën më të madhe 51,3% e rasteve, duan të listohen në bursë, por nëse nuk do të kemi një qeverisje dhe zbatim të kodeve kjo gjë do të jetë e vështirë (që të listohesh duhet ti përmbahesh kërkesave të kodit pasi është kusht i bursës) por dhe *mungesa e traditës* është një faktor pengues i cili shprehet nga 69,7% e rasteve. Shpesh shoqëritë sugjerohen të kenë edhe kodin e etikës (një pjesë e mirë e bankave të nivelit të dytë e kanë këtë kod publikuar dhe në internet, një pjesë e tyre). Disa studiues janë skeptikë për efikasitetin e këtyre kodeve, por sjellja etike nuk derivon nga prania ose jo e kodit pasi ekzistojnë dhe mekanizma të tjerë dhe shoqëritë në 84.2% nuk e kanë një kod të tillë por njëkohësisht dhe rregullore të qeverisjes. Në lidhje me zhvillimin nga këshilli administrativ apo administratorët të një politike ose plani për të përmirësuar praktikën e qeverisjes së korporatës vetëm 40,8% janë shprehur Po. Ndërkohë pozitivisht po në

lidhje me vendosjen e objektivave strategjike janë shprehur vetëm 48,7% e shoqërive. Anëtarët jo administratorë me kohë të pjesshme apo anëtarë të pavarur të këshillit në 99% të rasteve nuk janë prezent, gjithashtu mekanizmat familjarë të drejtimit të brendshëm, psh një dokument themelues ose protokoll familjar ku të parashtrohen vizioni dhe objektivat që mund të ketë për firmën familja, në 96,1% nuk ekzistojnë. Nuk duhet të ndodhë që i njëjti person të ushtrojë edhe rolin e kryetarit të këshillit dhe të administratorit, por kjo ndodh në 4 shoqëri ose në 5,3% të rasteve. Qeverisja e korporatave ka ndikim në biznes dhe sigurisht që rezultat më pas nuk do mungojnë dhe këtë e pohojnë 89,5% e shoqërive. Një sistem i qeverisjes së korporatave për pjesën më të madhe duhet të fokusohet në identifikimin dhe menaxhimin e risqeve me të cilat mund të ballafaqohet shoqëria dhe që sjell dështimin e saj. Ndërkohë që në raportet financiare duhet të përfshihet dhe një raport për strukturën dhe praktikën e qeverisjes së korporatës mendohet nga 42,1% e shoqërive. Në këtë këndvështrim qeverisja e korporatave merr një tjetër dimension nga shoqëritë duke u bërë vërtetë një pikë nevralgjike dhe që duhet vlerësuar maksimalisht njësoj sikur të rregullohej me ligj. Madje 99% e shoqërive mënojnë se duhet të paktën një individ që të ketë përgjegjshmëri për funksionimin e qeverisjes duke filluar që nga mbledhja e asamblesë etj. Në këtë mënyre theksojmë se kemi një seriozitet në mendim për të bërë më të mirën për një qeverisje efektive. Shoqëritë duhet të bëjnë më tepër për të rritur kulturën e qeverisjes, Grafiku 20.1.1 shtojca 2, siç e kemi përmendur, analiza Klaster, na tregon se 32 shoqëri kanë një kulturë qeverisje atraktive nga 76 shoqëri gjithësej.

6.2 Konkluzione të përgjithshme

Vlerësimi i përgjithshëm është se *njohuritë dhe gatishmëritë për zbatimin e praktikave të QK konsiderohen të mira*, por implementimi aktual i këtyre praktikave në SHA në Shqipëri nuk është në të njëjtin nivel. Reforma e qeverisjes së korporatave është jetësore për vendet në zhvillim të cilat kërkojnë të tërheqin investimet e huaja dhe rrjedhimisht të forcojnë ekonominë e tyre. Çështjet që mbulon kodi i qeverisjes si: transparenca konflikti i interesit, procedurat e falimentimit, e drejta e pronësisë, zbatimi i kontratave, korrupsioni etj, përbejnë një sfidë për funksionimin e një ekonomie tregu si dhe të një shoqëri e demokratike. *Zbatimi i të drejtave të aksionerëve* është në përputhje me njohjen e këtyre të drejtave. Ka një nivel të mirë të njohurive në lidhje me *të drejtat e*

aktorëve të tjerë. Megjithatë, ka vend për përmirësime dhe ka nevojë për ndërgjegjësimin më të mirë të aktorëve të tjerë dhe rolin që mund të luajnë në përmirësimin e qeverisjes si dhe ndikimin që mund të kenë në forcimin e transparencës së shoqërisë. Ka një numër të kufizuar biznesesh në Shqipëri që kanë implementuar procedurat e qeverisjes së mirë të korporatave dhe kanë marrë frytet e këtyre procedurave, psh ka një grup shoqëriash të cilët kanë importuar nga mëmat, kryesisht bankat e nivelit të dytë, pikërisht këtë qeverisje, por dhe shoqëritë e mëdha të huaja si psh korporatat (veçanërisht nënvizojmë banka me kapital të huaj), shoqëri si Vodafone Albania, AMC Eagle Mobile etj, shoqëri të cilat kuptojnë frytet e implementimit të politikave më të mirë të saj (qeverisjes së korporatave). Një numër i madh biznesesh familjare kanë adaptuar pak ose shumë pak praktikën të mirë të qeverisjes së korporatave. Me kalimin e kohës do të ndërgjegjësohen më shumë bizneset për procedurat e qeverisjes (vendosjen e standardeve) së korporatave. Forma më e përhapur e biznesit në Shqipëri është biznesi familjar i kontrolluar nga shumë pak aksionerë ose ortakë, për rrjedhojë nuk ka pasur një presion nga aksionerët e minorancës për implementimin e qeverisjes së korporatave në shumicën e shoqërive. Shumica e bizneseve janë me dy ose tre aksionerë, ku në pjesën më të madhe janë pjesë e familjes, ose në lidhje fare të ngushtë familjare, në shume raste këshilli mbikëqyrës është thujse formal, ose thënë ndryshe thujse pa asnjë efekt në shoqëri pasi pjesa dërmuese e shoqërive aksionere janë formuar si të tilla (duke kërkuar ekzistencën e një këshilli mbikëqyrës) jo për shkak të nevojës për një qeverisje korporate me përbërjen e këshillit mbikëqyrës, por për shkak se legjislacioni jua kërkon aty ku është e nevojshme themelimin si Sh.a në përputhje me biznesin që bëjnë apo kapitalin e këtij biznesi (kapitali themeltar përcaktohet me ligj). Nëse do të jetë gjithëpërfshirëse në biznese të rritura ku volumi i informacionit është i madh, kërkimet për përpunimin e këtij informacioni do të jenë të larta, atëherë nevojshmëria e qeverisjes së korporatave bëhet gjithnjë e më e madhe. Pronarët shqiptarë ndoshta nuk janë shumë të predispozuar për të ndarë pronësinë e rrjedhimisht kontrollin e shoqërisë me persona të tjerë ku një ndër faktorët është dhe mungesa e një tregu aktiv të letrave me vlerë (bursës), aty ku harmonizohen kërkesat e blerësve dhe ofertat e shitësve për kapitale. Mendojmë se për të paktën dhe për 10 vitet e ardhshme, tregu shqiptar do ta kishte shumë të vështirë të fitonte (ti jepte konfidencën) një bursë shqiptare për shkak të faktit se vendi është shumë

i vogël dhe nuk ka eksperiencë të mëparshme të investimeve të publikut shqiptar në shoqëri të listuara në bursë. Një bursë e mirëfilltë do t'i jepte qeverisjes së korporatave një kuptim të gjerë. Bursa kontrollon informacionet e shoqërive përpara procesit të listimit në të, dhe padyshim është “transparenca” më e mirë për shoqëritë. Bursa ka rregullat e forta të antarësimit si psh : kodin e etikës apo kriteret ligjore dhe tregtare për anëtarët, standardet financiare dhe administrative të aktivitetit ndërmjetësues etj.

Së pari: të gjithë aktorët e një shoqërie duhet të ndërgjegjësohen, menaxherë, ortakë etj të cilët akoma nuk kane të implementuar parimet e qeverisjes së korporatave në lidhje me përfitimet e kësaj qeverisje, përfitime të cilat nuk janë të pakta dhe si pasojë kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në faktin se si biznesi duhet të orientohet në treg me/dhe për të gjithë grupet e interesit, *së dyti* qeverisja e mirë e korporatave dhe ndërtimi i strukturave përkatëse brenda shoqërisë është çelësi për vazhdimin e suksesit të një biznesi familjar në momentin kur ortaku themelues i tij del nga skema e menaxhimit me “duart e veta” (own hands).

Aktivizimi i Bursës së Tiranës do të garantonte:

-Akses më të madh në sigurimin e kapitalit dhe fondeve për zgjerim të aktivitetit ekonomik, shlyerje të borxheve, kërkim-zhvillim.

-Krijimin e mundësive për aksionerët ekzistues për të shitur/blerë aksione sipas nevojës për likuiditete në kohë të ndryshme për zgjerim kapitali.

-Alternativë investimi në mënyrë të rregulluar dhe me standarde.

-Rritje të eficiencës së tregut financiar, përmes nxitjes së konkurrencës, decentralizimit dhe rritjes së transparencës.

-Rritje e eficiencës ekonomike të shoqërive, nëpërmjet përmirësimit të cilësisë së administrimit në to.

-Alternativë aktualisht e pashkelur financimi për shoqëritë shqiptare.

-Formalizim të tregut informal të titujve të pronësisë.

-Inkurajim dhe tërheqje të kapitalit vendas dhe të huaj në alternativa të reja e të besueshme investimi.

-Zgjerim të gamës së shërbimeve financiare që i ofrohet publikut investitor nga sistemi financiar shqiptar.

-Hyrje të operatorëve të rinj në këtë treg (shtëpi brokerimi, fonde investimesh firma të menaxhimit të portofolit të letrave me vlerë etj.) Në këtë pikë përmendim fondet e

investimeve që funksionojnë sipas Ligjit nr.7979 dt.26.07.1995, ku e veçanta e këtij fondi qëndron në elementët e grumbullimit të burimeve financiare. Fondi mund të grumbullojë duke bërë efektive dhe bonot e privatizimit të zhvlerësuar tashmë të cilët po blihen nga individë në ambiente rruge me normë shumë të ulët interesi 4-5%, thuajse të zhvlerësuar. Aksionet e fondit sipas ligjit duhet të jenë të regjistruara dhe lehtësisht të transferueshme. Fondi mund të jetë i regjistruar dhe në bursë.

-Zhvillim të kulturës ekonomike e financiare në vend.

Numri i bizneseve me ortakë që nuk janë të lidhur familjarisht në Shqipëri është i kufizuar, por gjithsesi implementimi i parimeve të qeverisjes së korporatave duke bërë më të mirën e mundshme është padyshim përfitim për secilin prej ortakëve, pasi u jep atyre transparencën e nevojshme të informacionit për të marrë vendime të sakta dhe efektive në vendin dhe kohën e duhur. Vendet e Evropës Lindore dhe Qendrore në krahasim me Shqipërinë janë më të avancuara në implementimin e praktikave të qeverisjes së korporatave, ndaj dhe mbetet shumë punë për të bërë veçanërisht nga entet shtetërore, të cilëve u del detyra e ndjekjes së politikave sensibilizuese dhe pse jo ndoshta në të ardhmen mbase dhe detyruese nëse shikohet e arsyeshme nga organet kompetente ose ligjzbatuese. Në Shqipëri nuk ka një ligj të mirëfilltë për qeverisjen e korporatave, por ekziston Ligj “Për Shoqëritë Tregtare” si dhe Kode të qeverisjes. Ligji prevalon mbi kodin. Ndjekja e parimeve të OECD-së është një domosdoshmëri në kuadrin e qeverisjes së korporatave. OECD ka publikuar tashmë një numër të madh parimesh për qeverisjen e korporatave, ndaj dhe shoqëritë duhet t’i shohin me sy tjetër, madje si të domosdoshme këto parime sidomos bankat e nivelit të dytë në momentet e kredidhënies për shoqëritë. Kriza financiare zbuloi mangësi të rënda në qeverisjen e korporatave. Kur shumica e standardeve ekzistuese dështuan për të siguruar checks and balance (shqyrtim dhe barazpeshim) u arrit në konkluzionin se shoqëritë kanë nevojë që të përdorin praktika me të shëndosha për biznesin. Në vitin 2010, siç dimë, OECD-ja publikoi plane veprimi për përmirësime në fusha prioritare si shpërblimi, menaxhimin e rrezikut, praktikën e bordit dhe ushtrimin e të drejtave të aksionerëve. Këto rekomandime na adresojnë në zbatimin e standardeve të përmirësuar në mënyrë që qeverisja e korporatave të ofrojë strukturën nëpërmjet së cilës vendosen objektivat e shoqërisë duke ofruar nxitësit e duhur për bordin dhe menaxherët për të realizuar objektiva që janë në interes të shoqërisë dhe aksionerëve dhe për të lehtësuar

monitorimin efektiv, duke nxitur shoqëritë të përdorin burimet e tyre në mënyrë më efikase. Një qeverisje e mirë korporate dhe me standarde do të shmangte madje dhe falimentimin e shoqërive ose shoqërisë, i cili në kushtet e ekonomisë së tregut shfaqet jo në pak raste si fenomen sa shqetësues por dhe i rrezikshëm si rrjedhojë dhe e mungesës së njohurive krahas paaftësisë së organeve drejtuese apo mbikëqyrëse të shoqërisë për të drejtuar apo mbikëqyrur në mënyrën e duhur atë. Ky fenomen sjell një ecuri jo pozitive për shoqëritë, duke çuar në rënie të konsiderueshme të shitjeve, fitimeve, gjendje të ulët likuiditeti etj. Konkretisht efektivitet shumë të ulët. Mendojmë se krahas Standardeve të Kontabilitetit, Kombëtare dhe Ndërkombëtare edhe Standardet Kombëtare për Administrimin e Masës së Falimentit, mbeten një kuadër shumë i domosdoshëm për t'u njohur, madje përvetësuar mirë, dhe me trajnime nga autoritetet që kanë për detyrë të bëjnë këto trajnime, gjithnjë në kuadrin e një qeverisje të mirë. Theksojmë këtë duke ditur faktin real, që ndër shkaqet e falimentimit janë dhe : gjendja e paaftësisë paguese dhe mbingarkesa me borxhe, që vijnë padyshim ndër të tjera dhe si rrjedhojë e paaftësisë së organeve drejtuese të shoqërive apo mungesës së bashkëpunimit midis ortakëve duke sjellë rënie të vlerës së pasurisë së shoqërisë tregtare (mund të kemi përkeqësim si pasojë e qeverisjes jo të mirë të raportit borxh/kapitalin e vet në shoqëri). Madje Ministria e Drejtësisë ka organizuar dhe më parë dhe duhet të vazhdojë të organizojë trajnime dhe seminare për një njohje më të mirë të Standardeve Kombëtare për Administrimin e Masës së Falimentit krahas çertifikimit me provim kualifikimi të administratorëve të falimentit të liçensuar. Sikurse tashmë duhet theksuar se provimet që duhet të japë një auditues në sektorin publik për tu pajisur me çertifikatën e auditimit janë krahas të tjerave dhe QK dhe Kontrolllet e Brendshme. Përmirësimi i qeverisjes së korporatës patjetër do të kontribuojë në krijimin e një sistemi bankar shqiptar më të mirë, më të fortë dhe më të qëndrueshëm. Megjithatë, edhe pse parimet e qeverisjes së korporatave, të udhëhequra nga praktikat më të mira, janë globalisht të forta e të rëndësishme, zbatimi i tyre në tregje si Shqipëria paraqet sfida të konsiderueshme.

6.3 Rekomandime

Qeverisja e përgjegjshme e korporatës përfshin një vizion afat-gjatë që integron përgjegjësitë sociale, ekonomike dhe mjedisore në strategjinë e biznesit për të përmbushur interesat e aksionerëve. Roli i QK është manifestuar në : krijimin e vlerës

për të korporatën dhe mbështetjen e transparencës (Lamm, 2010b), mbrojtjen e të drejtave të aksionarëve (përfshi dhe ata në minorancë si pjesë e rëndësishme, pasi çdo aksioner ka të drejtën e tij pavarësisht sa ka investuar në shoqëri) dhe për të siguruar trajtimin e tyre të barabartë, marrjen e përgjegjësisë nga ana e Bordit të Drejtorëve, integritetit dhe sjelljes etike (pasqyruar në Kodin e Etikës), transparencës në zbatimin e sistemeve të brendshme dhe të jashtme të kontrollit për të vërtetuar vlefshmërinë e raporteve financiare të korporatave si një ndër parimet më kyeshore të QK (Dobrota, *et al.*, 2011).

Qeverisja e mirë sjell padyshim qëndrueshmëri dhe efikasitet në aktivitetin e biznesit, më shumë mundësi për të arritur në burimet e kapitalit, vlerë të rritur të shoqërive. Praktikave të mirëqeverisjes së korporatave sjellin përfitime reale shoqërisë. Konkretisht:

- Përmirësojnë vendimmarrjen dhe menaxhimin e riskut.
- Sigurojnë besueshmërinë e duhur.
- Lehtësojnë aksesin në kapital.
- I japin kredibilitet kreditorëve

Korrelacioni ndërmjet praktikave të Q.K dhe GDP-së na tregon për angazhim më të madh në të ardhmen të strukturave shtetërore në kuadër të QK. Të ushtrohet më tepër kontroll për zbatimin në praktikë të legjislacionit në fushën e raportimit financiar dhe transparencës. Ndërgjegjësim më i madh për rëndësinë praktike të QK për ekonominë e vendit, nëpërmjet seminareve, dialogut dhe tryezave të rrumbullakëta. Përdorimi i stimujve ekonomikë për të nxitur praktikave të qeverisjes dhe tek bizneset e tjera që nuk janë në formë korporate.

Shqipëria si një ekonomi e ish-centralizuar, për shkak të karakteristikave të saj kombëtare, ka adaptuar një transformim të saj në lidhje me modelin e QK-së.

Vlerësimi i përgjithshëm i njohurive mbi QK mund të konsiderohet deri diku i mirë, por zbatimi aktual nuk është në të njëjtin nivel.

SHA-shqiptare janë duke përmirësuar nivelin e tyre të njohurive të (dhe gatishmërinë për të aplikuar) standardeve të publikuara madje deri diku dhe atyre të pranuar ndërkombëtare të QK. *Transparenca dhe zbulimi i informacionit, Roli dhe përgjegjësitë e KM/KA*, duhet të përmirësohen, veçanërisht nëpërmjet trajnimeve, pjesëmarrje aktive në diskutime etj).

Ky studim mund të shërbejë si referencë për përpjekje të mëtejshme që synojnë rritjen e nivelit të implementimit të QK nga shoqëritë shqiptare.

Një *ndërgjegjësim më i mirë mbi benefitet afatgjata të QK* mund ti ndihmojnë shoqëritë veçanërisht SHA-të në tërheqjen e investitorëve të fuqishëm të huaj dhe në këtë mënyrë të nxisë zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Duhet të bëhen *përpjekje të mëtejshme për eliminimin e tregut informal dhe forcimin e auditimeve*, e cila do të sjellë transparencë reale dhe do të ndikojë drejtpërdrejt në publikimin e informacionit.

Rekomandojmë shoqëritë për të zbatuar *një dialog të përhershëm me aktorët e tjerë* për të përmirësuar performancën afatgjatë. Shoqëritë duhet të *zhvillojnë kodin e vet të etikës si dhe të përqafojnë parimet dhe udhëzimet e kodit të QK dhe të publikojnë raportet vjetore të përditësuar*. Shpërndarja e pyetësorëve ishte e *përqendruar në qytetet më të mëdha*, kështu rezultatet duhet të interpretohen me kujdes për të gjithë vendin. Në të ardhmen studime të tjera mund të jenë të shtrira në një afat kohor më të gjatë duke i dhënë mundësi mbledhjes së të dhënave në vite, duke ndihmuar më shumë bizneset për një qeverisje të mirëfilltë korporate. Implementimi i parimeve që janë publikuar në manuale dhe kode, funksionimi i strukturave të qeverisjes, ofrimi nga bordet i ideve të reja mbi zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë, do të krijonte mundësinë e një sistemi efektiv të qeverisjes së korporatës, gjithmonë në pajtueshmëri me kodet, e cila forcon besimin e aksionerëve që fondet e tyre janë duke u menaxhuar me përgjegjësi si dhe do t'i hapte udhë tërheqjes së investuesve të rinj të kapitalit për të mundësuar që edhe kreditorët të kenë besim në kreditim. Investitorët janë në kërkim të shoqërive tek të cilët mund të vendosin kapitalet e tyre në formë investimi me qëllim që të marrin fitime nga ky investim. Në procesin e tyre të vendimmarrjes, investitorët nuk do të investojnë në një shoqëri ku të drejtat e tyre duke qenë në pakicë shkelen, ku nuk ka transparencë në mënyrën e vendimeve (vendimmarrja), ku mundësitë e lëvizjes së kapitalit (pra të tërheqjes apo shitjes së kuotave) janë të kufizuara, apo ku nuk zbatohen rregullat e kontrollit të brendshëm të auditit. Shoqëritë tregtare, statusi i të cilave përcakton qartë të drejtat e aksionerëve, e në mënyrë të veçantë atyre në pakicë (minorancë) ku janë të përcaktuara dhe të qarta mekanizmat e kontrollit mbi organet e shoqërisë, kompetencat e strukturave ekzekutive të saj, detyrimi i qartë për transparencë dhe akses në informacionet e shoqërisë, janë shoqëri shumë tërheqëse për investitorët dhe kreditorët. E parë nga këndvështrime të ndryshme, qeverisja e korporatave jo vetëm i ofron

mundësinë shoqërive tregtare (dhe aksionerëve të tyre) të tërheqin kapitale të reja, por njëkohësisht u ofron investitorëve mundësinë e zgjerimit të tregjeve të reja. Në vendet në zhvillim, organizatat ndërkombëtare financiare, publike apo private qofshin ato, janë përqëndruar në përkrahjen e qeverisjes së korporatave. Tregjet e këtyre vendeve ku bën pjesë edhe Shqipëria (pavarësisht se është treg i vogël në raport me këto vende) siç e kemi thënë në këtë studim janë tërheqëse për investitorët si pasojë e kostos së ulët të investimit. Qeverisja e mirë ul koston e përthithjes së kapitalit të ri në shoqëri. Shoqëritë që funksionojnë në bazë të një skeme të qeverisjes së mirë janë më të besueshme për bankat, apo institucionet e tjera kreditore, pasi këto të fundit e konsiderojnë një shoqëri të tillë si një shoqëri që mbart risk më të vogël investimi, rrjedhimisht që ato kanë akses më të madh ndaj kapitalit të kreditorëve, por edhe kostot e marrjes së kredive janë më të vogla e cila sjell rritje të vlerës së shoqërisë. Në rastin e vendit tonë, mendojmë se është pikërisht koha edhe për një tjetër hap në kuadrin e qeverisjes së shoqërive publike, pikërisht koha që të rregullohet më mirë kontabiliteti për sektorin publik, me objektivin që brenda një periudhe kohe disavjeçare të kalohet nga sistemi aktual drejt hartimit dhe zbatimit të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit Publik, të cilat duhet të konvergjojnë me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit Publik (IPSAS). Parimet, sistemet dhe metodologjia e kontabilitetit publik kombëtar, duhet të synojnë të jenë plotësisht në pajtim me “Acquis Communautaire” të Bashkimit Evropian, dhe me praktikën më të mirë ndërkombëtare dhe Evropiane. Në vendet si Maqedoni, Kosovë, Bullgari, Serbi etj është pranuar rregullimi i kontabilitetit me 2 paketa: për kompanitë e mëdha me interes publik dhe tregut bankar si dhe për kompanitë SME, ku për të parat parashikohet përdorimi i plotë të SNK/SNRF dhe e dyta SKK-të të hartuara në koherencë me SNK-të dhe SNRF-të. Një rol të rëndësishëm mendoj se kanë anëtarët e pavarur në borde, ata kanë kontribut të çmuar konstruktiv në vendimmarrjen e bordit që vjen prej njohurive dhe kontakteve të tyre. Bordet me përbërje më të shumëllojshme ka të ngjarë të kenë më shumë specialistë dhe si rrjedhojë të përfitojnë më shumë nga ekspertiza e tyre. Natyrisht, kjo është e vërtetë në rast se këta janë njerëz me karakterin dhe përvojën e përshtatshme. Në Shqipëri ekzistojnë dy teori të qeverisjes së korporatave në sektorin publik konkretisht: teoria e agjencisë dhe teoria e kujdestarisë. Teoria e kujdestarisë është e ngjashme me teorinë e agjencisë përse i përket ndarjes ndërmjet pronësisë dhe kontrollit, por që ndryshojnë në një aspekt të

rëndësishëm që është pikëpamja mbi motivimin njerëzor dhe rolin e menaxherit. Sipas kësaj teorie interesat e organizatës dhe menaxherit përputhen dhe menaxherit mund t'i besohet menaxhimi duke i dhënë liri për të vepruar në këtë organizatë. Theksojmë se faktorët cilësorë duhet të jenë në vëmendje të drejtuesve gjatë procesit të vendimmarrjes. Meqenëse është e pamundur të shprehet në terma sasiorë (të shprehet në mjete monetare) efekti i rënies së moralit të punonjësve në shoqëri (demotivimi) ose humbja e emrit të mirë tek klientët, në kuadrin e qeverisjes së korporatave duhet të paraqitet një informacion i matshëm financiar për drejtuesit në mënyrë që ti kushtohet vëmendje atyre faktorëve cilësorë që mund të kenë ndikim në leverdishmërinë e ardhshme dhe në këtë rast duhet të jenë strukturat e qeverisjes së korporatës që duhet të ndikojnë tek kontabiliteti për të bërë një gjë të tillë. Marrëdhënia me të tretët (furnitorë, klientë) dhe procesi i vendimmarrjes ndikojnë në rezultatet e shoqërive. Gjithsesi vetëm vendosja e parimeve nuk mjafton për të pasur sukses. Duhet theksuar se është më pak e rëndësishme që drejtuesit e korporatave apo aksionerët të flasin për parime gjithë kohës në vend që të kuptojnë çfarë janë parimet, pse janë të rëndësishme dhe ti zbatojnë në punën e tyre të përditëshme. Parimet do të mbeten fjalë boshe nëse ato nuk përkthehen në “politikën e ditës” dhe të vendosen e zbatohen në praktikë në shoqëri. Është urgjentisht i nevojshëm konceptimi dhe krijimi i një modeli/kornize të përbashkët të qeverisjes së korporatave, ku të përfshihen të gjithë grupet e interesit : shoqëritë, institucionet, mbikëqyrësit e rregullatorët e tregut bankar, industria private bankare, organet e mbrojtjes së konsumatorit, konsumatorët, qarqet akademike etj. Të hartohen dhe ndërmerren sa më shpejt programe për edukimin e drejtuesve apo aksionerëve të shoqërive me konceptet e terminologjinë e qeverisjes së korporatave. Sipas OECD-së, ”edukimi i shoqërive me termat e qeverisjes së korporatave në rradhë të parë dhe më pas me parimet është instrumenti më i mirë për mbrojtjen e tyre nga rreziku i falimentimit sidomos pas krizës financiare të vitit 2008 si dhe indirekt konsumatorëve”. Në këtë drejtim, një bursë dhe treg dytësor kapitalesh funksional (sidomos për titujt privat, por jo vetëm), do të jetë pa dyshim një pikë kthese për sigurimin e një rritje më të qëndrueshme ekonomike, rritje të konkurrueshmërisë të ekonomisë shqiptare në shkallë rajonale dhe të një stabiliteti më të madh në tregun financiar shqiptar. Gjykohet si domosdoshmëri nga ana e politikëbërësve dhe institucioneve mbikëqyrëse e rregullatore të sistemit financiar, shprehja dhe artikulimi i një vullneti të qartë, në drejtim të

rivitalizimit të Bursës së Tiranës, mirëfunksionimi i të cilës si një treg dhe institucion do të mund të kontribuonte sadopak për zbutjen e problematikës për ekonominë shqiptare, nxjerrjes së kapitalit (shih rezoluten e Kuvendit të Shqipërisë të vitit 2014 për marrjen e masave shtrënguese, Meka. E, qershor 2014). Zbatimi i *Balance Scorecard* mendoj se përbën një risi si një ndër metdoat që duhet të gjejë zbatim në kuadër të qeverisjes së korporatave duke ditur faktin real që metoda sugjeron që ta shikojmë shoqërinë në 4 perspektiva : 1. Të perfeksionuarit dhe perspektiva e rritjes, 2. Perspektiva e procesit të biznesit. 3. Perspektiva e klientit (identifikon segmentin e tregut të synuar nga njësia apo pjesën që ajo zotëron në këtë treg) 4. Perspektiva financiare (vlerësohet nëpërmjet saj përfitueshmëria e strategjisë, pra rezultati financiar i saj). Pra vlerësimi i performancës nëpërmjet Balance Scorecard (BS) i jep shoqërive avantazhe pasi në ndërtim ajo përbëhet nga : Objektivat, Matjet, Inisiativat si dhe performanca e synuar apo faktike. Në këtë kuadër, edhe GCI/GCR është një matricë llogaritje ku siç e kemi thënë dhe më lart është një perceptim nëpërmjet llogaritjeve të indekseve duke grumbulluar të dhëna nga disa burime, si psh ndër të tjera nga pasqyrat financiare bazë si : bilanci, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, ashtu dhe nga burime të tjera në lidhje me furnitorët, klientët, punonjësit etj. Ndërsa për të analizuar pozicionin e Shqipërisë, të rëndësishëm janë treguesit e konkurueshmërisë globale të forumit ekonomik Botëror (WEF), nga ku ne gjenerojmë indeksin e qeverisjes së korporatave për të parë pozicionin e saj (Shqipërisë) dhe si konkurren ajo me vendet e tjera, kryesisht vendet në zhvillim ose me vendet e tjera të rajonit (EJL). Në epilog të punim vëmë theksin edhe njëherë tek teoria e agjencisë si teori shumë e rëndësishme në kuadrin e qeverisjes së korporatave e cila pasqyrohet dhe në punimet e Nobelitit të vitit 2014 Jean Tirol, presidentit të Shkollës Ekonomike të Tuluzës në Francë punime të cilat janë fokusuar konkretisht tek kohëzgjatja e kontratave ndërmjet sektorit publik dhe privat, duke evidentuar faktin e vështirësive që ekzistojnë në modifikimin konkret të tyre, si dhe rreziqet reale të përplasjes e paqartësive nëpërmjet autoriteteve rregullatore dhe shoqërive e korporatave që duhet të rregullohen në aktivitetin e tyre në këto tregje specifike. Sipas tij qeveritë duhet të bëjnë përpjekje maksimale që të zotërojnë një informacion maksimal mbi veprimtarinë dhe sjelljen e këtyre aktoreve në treg. Si sipërmarrës në fushën akademike dhe atë të kërkimit e inovacionit, Tirol thekson se: “të menaxhosh korporatën me efektivitet do të thotë që të gjitha strukturat të jenë duke

punuar mirë dhe për rrjedhojë rezultati financiar i shoqërisë në treg do të jetë i lartë me kosto të ulët e cilësi shërbimesh sipas specifikës”. Zbatimi i standadeve dhe praktikave bashkëkohore të qeverisjes së shoqërive aksionere, përbën një nga çështjet me shumë ndikim në përmirësimin e klimës së biznesit kudo në botë, në ndërtimin e një ekonomie tregu të qëndrueshëm, bazuar në standarde dhe rregulla loje. Komiteti i auditimit dhe auditimi janë një pikë e rëndësishme e QK-së që duhet të jenë në fokus të çdo shoqërie. Kryetari i komitetit të auditimit duhet të jetë një anëtar i pavarur i këshillit (Kodi i Drejtimit të Brendshëm të SH.A-ve dhe Rregullorja e Kontrollit të Cilësisë IEKA). Auditimi i brendshëm është një garanci e pavarur dhe objektive e cila e ndihmon organizatën t’i përmbushë objektivat përmes ndjekjes së një qasjeje sistematike dhe të disiplinuar për vlerësimin dhe përmirësimin e efektivitetit të menaxhimit të riskut, masave të kontrollit të brendshëm dhe proceseve të drejtimit të brendshëm. Roli i komiteve të auditimit, si forume profesionale dhe këshilluese në lidhje me çështje të menaxhimit të riskut, kontrolleve të brendshme dhe QK-së mundëson vlerësimin e performancës së auditimit të brendshëm në lidhje me vlerat që ky funksion i shton shoqërisë (rekomanduar nga Bello.H,2010.Zhvillimet e auditimit të brendshëm në sektorin publik :107).Një rol të rëndësishëm duhet ti kushtohet audituesit të pavarur ku misioni i tij është pavarësi dhe besnikëri ndaj ligjit dhe shoqërisë, ku bordi i shoqërive duhet të jetë më kërkuar ndaj punës dhe rolit të tyre, pasqyruar dhe në ligj, pasi kriza financiare tregoi krejt të kundërtën ku shumë ekspertë auditë të kompanive më të njohur kishin punuar për të fshehur humbjet nën petkun e hapsirave ligjore (në një masë disi më të vogël pas Aktit Sarbanes-Oxley,2002).Qeverisja e mirë veçanërisht në shoqëritë shqiptare, konkretisht me kapital shqiptar përforcon sigurinë, integritetin dhe eficiencën e tregut, duke bërë kështu të mundur rritjen ekonomike dhe stabilitetin financiar të vendit, dhe duke e bërë Shqipërinë një vend gjithmonë e më tërheqës për investitorët të cilët mund të kërkojnë dhe “ura” bashkëpunimi, madje duke i bërë shoqëritë akoma më tërheqëse dhe ndoshta të kuotuar dhe në tregjet ndërkombëtare të kapitalit, pasi integrimi në BE mendoj se nuk do të jetë i largët edhe për një vend të vogël por me shumë aspirata si Shqipëria.Tashmë reformat kanë nisur dhe po vazhdojnë nga qeveria dhe duhet të vijojnë nga çdo qeveri në vijim si promotorë të politikave rregulluese, ndaj dhe të gjithë ne duhet të punojmë për një qëllim të përbashkët: “qenia në një të ardhme të afërt anëtar i familjes së madhe të BE-së”.

FAQET E SHËNIMEVE

Në këtë pjesë të cilën ne kemi titulluar faqet e shënimeve kemi vendosur një pjesë të materialit të rëndësishëm por te pa përfshirë ne faqet kryesore.

SHËNIME 1

Në vendet evropiane, parimet bazë të QK-së janë pjesë e Ligjit mbi Shoqëritë Tregtare, pjesa më e madhe e këtyre vendeve kanë miratuar tashmë Kode të veçanta të QK-së, ndërkohë që kompanitë e listuara në bursa u nënshtrohen rregullave shtesë mbi qeverisjen e tyre. Më poshtë po japim pjesë nga Kodet e publikuara në Shqipëri.

Kodet e Qeverisjes së Korporatave publikuar në Shqipëri.

- 1.Kodi i drejtimit të brendshëm të shoqërive tregtare në Shqipëri. Hartuar me mbështetjen e ekspërteve ndërkombëtar të IFC-së.
- 2.Manuali Shqiptar për Qeverisjen e Korporatave. pjesë e Projektit mbi Qeverisjen e Korporatave në Evropën Juglindore zbatuar nga IFC-ja (pjesë e Grupit të Bankës Botërore) dhe financuar nga Qeveria Zvicerane nëpërmjet SECO-s, (Sekretariatit të Shtetit Zviceran për Marrëdhëniet Ekonomike).
- 3.Të lundrosh përmes krizave.Manual për Bordet, mbështetur nga IFC (pjesë e Grupit të Bankës Botërore).
- 4.Manuali i IFC për Qeverisjen e Biznesit Familjar është hartuar nga IFC (Korporata Financiare Ndërkombëtare), anëtare e Grupit të Bankës Botërore në kuadër të projektit Qeverisja e Korporatave bashkëfinancuar nga SECO (Sekretariati Zvicerian i Shtetit për Çështjet Ekonomike).Le të shikojmë në mënyrë të shkurtuar se çfarë përmbajnë këto kode.

1.Kodi i drejtimit të brendshëm të shoqërive tregtare në Shqipëri (shoqërive aksionere jo të regjistruara në bursë).

Në këtë Kod janë të përcaktuara qartë 14 parimet e drejtimit të brendshëm për të gjitha shoqëritë aksionere që nuk janë të regjistruara në bursë. Në një kuadër efektiv të qeverisjes së shoqërive tregtare përcaktohen rolet, përgjegjësitë si dhe një shpërndarje e kompetencave ndërmjet aksionerëve, bordit, menaxhimit dhe palëve të tjera të interesuara.

Parimi 1: Aksionerët e shoqërisë duhet të ngrenë kuadrin e duhur themelues dhe drejtues të shoqërisë.

Parimi 2: Shoqëria duhet të bëjë përpjekje të forta për të krijuar një këshill të efektshëm, i cili të mbajë përgjegjësi solidare për suksesin afatgjatë të shoqërisë, duke përfshirë edhe përcaktimin e strategjisë së shoqërisë.

Parimi 3: Madhësia dhe përbërja e këshillit duhet të pasqyrojë shkallën dhe kompleksitetin e shoqërisë.

Parimi 4: Këshilli duhet të mblidhet rregullisht në mënyrë të mjaftueshme për t'i përmbushur detyrimet e veta, dhe duhet të marrë në kohën e duhur informacionin e duhur.

Parimi 5: Nivelet e shpërblimit të punës duhet të jenë të mjaftueshme për të tërhequr, mbajtur dhe motivuar anëtarët administratorë dhe jo administratorë të këshillit, me cilësitë e nevojshme për ta drejtuar me sukses shoqërinë. Individët nuk duhet të kenë kompetencë për vendosjen e pagës së tyre. Mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të këshillit duhet ta aprovojnë aksionerët, sidomos kur kjo përfshin dhënien e aksioneve dhe opsioneve.

Parimi 6: Këshilli është përgjegjës për kontrollin mbikëqyrës të risqeve dhe duhet të mbajë një sistem të shëndoshë të kontrollit të brendshëm për t'i mbrojtur interesat e shoqërisë dhe investimet e aksionerëve.

Parimi 7: Duhet të ketë dialog midis këshillit dhe aksionerëve, mbështetur në kuptimin e njëjtë të objektivave. Këshilli ka përgjegjësinë solidare për t'u kujdesur për zhvillimin e një dialogu të kënaqshëm me të gjithë aksionerët.

Parimi 8: Të gjithë anëtarët e këshillit duhet të ndjekin një instruktim fillestar me t'u anëtarësuar në këshill dhe duhet t'i përditësojnë dhe rifreskojnë njohuritë rregullisht.

Parimi 9: Shoqëria e kontrolluar nga një familje duhet të ngrejë mekanizma familjare të drejtimit të brendshëm të cilat nxisin bashkërendimin dhe mirëkuptimin reciprok midis anëtarëve të familjes, si edhe t'i organizojë marrëdhëniet ndërmjet drejtimit të aktiviteteve tregtare të familjes dhe drejtimit të shoqërisë.

Parimi 10: Duhet të ketë një ndarje të qartë të përgjegjësi në kryesinë e shoqërisë ndërmjet drejtimit të këshillit dhe drejtimit të aktivitetit tregtar të shoqërisë. Asnjë individ i vetëm nuk duhet të ketë kompetenca të papenguara vendimmarrjeje.

Parimi 11: Këshilli duhet të ketë anëtarë me gërshetimin e mjaftueshëm të aftësive dhe përvojës. Asnjë person i vetëm (apo asnjë grupim i vogël individësh) nuk duhet të mbizotërojë në vendimmarrjen e këshillit. Duhet kushtuar vëmendje e duhur përparësive të larmisë në këshill, duke përfshirë edhe përbërjen gjinore.

Parimi 12: Këshilli duhet të ngrejë komitetet e duhura të këshillit, për të mundësuar një përmbushje më të efektshme të detyrave.

Parimi 13: Këshilli duhet të kryejë një vlerësim periodik të performancës së vet dhe të performancës të çdo anëtari të tij.

Parimi 14: Këshilli duhet të paraqesë një analizë vlerësuese të ekuilibruar dhe të kuptueshme, të gjendjes dhe të ardhmes së shoqërisë tregtare, për grupet e interesit, dhe të krijojë një program të përshtatshëm për angazhimin e grupeve të interesit.

2.Manuali Shqiptar për Qeverisjen e Korporatave. Programi mbi Qeverisjen e Korporatave zbatuar nga IFC-ja, Korporata Financiare Ndërkombëtare, pjesë e Grupit të Bankës Botërore, me mbështetjen e Qeverisë Zviceriane nëpërmjet Sekretariatit të Shtetit për Marrëdhëniet Ekonomike (SECO).

Manuali Shqiptar për Qeverisjen e Korporatave është pjesë e Projektit mbi Qeverisjen e Korporatave në Evropën Juglindore zbatuar nga IFC-ja (pjesë e Grupit të Bankës Botërore) dhe financuar nga Qeveria Zvicerane nëpërmjet SECO-s, (Sekretariatit të Shtetit Zviceran për Marrëdhëniet Ekonomike).Manuali është një udhëzuese për bizneset në Shqipëri, për qeverisjen e mirë të tyre. Për më tepër, manuali ndihmon shoqëritë aksionere t'i kushtojnë një vëmendje të veçantë tregut të kapitaleve në Shqipëri, duke ju bërë të mundur atyre mënyra të reja investimi. Manuali udhëzon bordet dhe menaxhimin e lartë të shoqërive për të qenë largpamës në strategjitë dhe politikat e drejtimit, si dhe të mbajnë përgjegjësi para aksionerëve dhe grupeve të interesit. Mbi të gjitha manuali ndihmon në ndërgjegjësimin e aksionerëve dhe të menaxhimit për rritjen e transparencës dhe dhënies së informacionit.

Ky manual u jep ekzekutivëve, drejtorëve dhe aksionerëve një përmbledhje të përgjithshme mbi strukturën e Qeverisjes së Korporatave, të praktikave të përditësuar, si dhe një guidë praktike të krijuar për të ndihmuar zbatimin e qeverisjes së mirë.Manuali i jep lexuesit: (i) një paraqitje të kërkesave ligjore dhe rregullatore në

lidhje me Qeverisjen e Korporatave me referenca ligjore, si dhe në disa raste paraqet praktikat më të mira për Qeverisjen e Korporatave; dhe (ii) shembuj praktik se si standardet e Qeverisjes së Korporatave mund të zbatohen nga ana e ekzekutivit dhe drejtuesve, në mënyrë që këta të fundit të përmbushin detyrimet e tyre në përputhje me qeverisjen e shoqërisë. Ky manual u vjen në ndihmë edhe qeveritarëve, avokatëve, gjykatësve, investitorëve, e të tjerë, me anë të një strukture e cila vlerëson nivelin dhe sferën e referimit të praktikave për qeverisjen e korporatave të shoqërive shqiptare. Ky manual do ju shërbejë si një mjet pune për edukimin institucional të gjeneratës së ardhshme të menaxherëve shqiptar, të investitorëve, të politikbërësve si dhe të praktikave për mirëqeverisjen e korporatave.

3. Të lundrosh përmes krizave. Manual për Bordet, mbështetur nga IFC (pjesë e Grupit të Bankës Botërore).

Ky manual paraqet përgjigjen ndaj krizës nga perspektiva e bordeve dhe e drejtorëve joekzekutivë, duke u përqendruar tek shoqëritë në tregjet në zhvillim. Manuali mendohet të shërbejë si një mjet për të ndihmuar shoqëritë në tregjet në zhvillim, në mënyrë që bordet të përmirësojnë përgatitjen ndaj krizave, të marrin veten nga trazirat e fundit financiare e të dalin si biznese më të qëndrueshme. Manuali përmban ide praktike dhe këshilla përmenaxhimit të krizës dhe përfshirjen e bordit në një format të përmbledhur dhe të thjeshtë, në mënyrë që lexuesi të përfitojë maksimalisht.

4. Manuali i IFC për Qeverisjen e Biznesit Familjar.

Manuali i IFC për Qeverisjen e Biznesit Familjar është hartuar nga IFC (Korporata Financiare Ndërkombëtare), anëtare e Grupit të Bankës Botërore në kuadër të projektit Qeverisja e Korporatave bashkëfinancuar nga SECO (Sekretariati Zvicerian i Shtetit për Çështjet Ekonomike). Ky Manual shërben si udhërrëfyes për shoqëritë të cilat kërkojnë të fuqizojnë praktikën e qeverisjes në biznesin e tyre familjar. Biznesi është në tërësi në pronësi dhe menaxhimin e themeluesit/ve.

SHËNIME 2

ANALIZA E TEORIVE STATISTIKORE NË NDIHMË TË PËRPUNIMIT TË TË DHËNAVE TË STUDIMIT.

2.1 Variablat

2.1.1 Variablat e pavarur dhe të varur

Dimë nga statistika që $y = f(x)$ na tregon se y është i njohur si një variabël i varur dhe x është një variabël i pavarur.

Për të testuar hipotezat kemi nevojë të masim variablat. Variablat e pavarur marrin vlera të ndryshme. Pjesa më e madhe e hipotezave mund të shprehet në drejtim të dy variablave: një çështje e sugjeruar dhe një përfundim ose rezultat i sugjeruar.

Variabli që mendohet si shkak quhet ndryshore e pavarur (sepse vlera e tij nuk varet nga variablat e tjerë). Variabli që e mendojmë se është i ndikur quhet variabli i varur sepse vlera e këtij variabli varet nga shkak (variabël ose ndryshore e pavarur). Këto terma janë të lidhura shumë ngushtë me metodat eksperimentale apo në punën kërkimore në të cilat shkak në të vërtetë manipulohet nga eksperimentuesi ose kërkuesi.

Në kërkimin Cross-sectional nuk manipulohet ndonjë variabël dhe nuk mund të bëjmë ekspozim rastësor ndërmjet variablave, kështu që nuk ka kuptim të flasim për variabla të varur dhe të pavarur për shkak se të gjithë variablat janë variabla të varur në një kuptim ose në një tjetër. Një mundësi është për të braktisur kushtin variabli i varur dhe i pavarur dhe të përdorim termat variabël parashikues dhe variabël rezultati. Në punën eksperimentale ose punën kërkimore shkak, ose variabli i pavarur, është një parashikues, dhe efekti, ose variabli i varur, është thjesht një rezultat (një përfundim). Kjo terminologji gjithashtu i përshtatet punën cross-sectional ku statistikisht të paktën, mund të përdorim një ose më shumë variabla për të bërë parashikime në lidhje të tjera ose tjetrën (variabël) pa pasur nevojë për ndodhjen rastësore.

2.1.2. Nivelet e matjes

Variablat marrin forma të ndryshme. Marrëdhënia ndërmjet asaj që është duke u matur dhe numrave që paraqesin atë që është duke u matur njihet si niveli i matjes.

Përgjithësisht, një variabël mund të jetë kategorik ose i vazhdueshëm, dhe mund të ketë nivele të ndryshme të matjes.

Kur kemi dy gjëra që janë ekuivalente në një kuptim të dhënë me të njëjtin emër (ose numër), por ku ka më shumë se dy mundësi, variabli është e thënë të jetë një variabël nominal.

2.1.3 Gabimi i matjes

Për të testuar hipotezën ose hipotezat kemi nevojë për të matur variablat. Natyrisht, është e rëndësishme që të maten me saktësi këto variabla. Teorikisht, duam që matjet tona të kalibrohen në mënyrë të tillë që këto vlera të kenë të njëjtin kuptim me kalimin e kohës dhe në të gjitha situatat.

Nëse do të thjeshtohen gjërat kaq shumë, atëherë ka dy mënyra për të provuar një hipotezë: Ose duke parë së çfarë ndodh natyrshëm ose duke manipuluar disa nga pyetjet me përgjigje dhe duke vërejtur efektet të cilat kanë të bëjnë me lidhjen ose jo të variablave që na interesojnë dhe duke nxjerrë më pas rezultatin.

Gjatë matjes mund të ndodhin edhe gabime. Për shembull një gabim në të dhënat ndodh sa herë që vlera e të dhënës që merret nuk është e barabartë me vlerën e vërtetë, ose me vlerën reale që do të mund të merrej në qoftë se do të zbatohet një procedurë e rregullt.

2.2 Analizimi i të dhënave

Faza përfundimtare e procesit të kërkimit është analizimi i të dhënave që kemi mbledhur. Kur të dhënat janë sasiore kjo përfshin qoftë të dhënat në mënyrë grafike për të parë tendencat e përgjithshme në këto të dhënat, ashtu dhe modelin e përshtatshëm statistikorë të të dhënave.

2.3 Analiza e të dhënave cilësore

Ndonjëherë, nuk jemi të interesuar në testimin e rezultateve ose madhësitë e vazhdueshme, por në variablat cilësorë. Kemi variabla që përshkruajnë kategoritë e subjekteve. Gjithashtu gjejmë tipe të ndryshme të variablave cilësorë, por në teori një rasti duhet ti përgjigjet një kategori.

Kemi dhe raste kur përdoren variabla kategorike për të parashikuar një lloj rezultati të vazhdueshëm, por ka dhe raste kur duam të shohim marrëdhëniet ndërmjet shumë variablave cilësorë.

Në studim shohim rastin e dy variablave kategorike dhe metodën statistikore Hi-Katror (Chi Square). Ky model shërben për të treguar lidhjen ndërmjet variablave cilësorë të zgjedhur.

2.4 Teoria e analizimit të të dhënave kategorike

